



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



Raporti i vetëvlerësimit të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës 2020-2021

Prishtinë 2023



Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Raporti i vetëvlerësimit të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës 2020-2021

Vetëvlerësimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës kundrejt kërkesave të
Standardeve Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit.

Ekipi vlerësues: **Qendresë Mulaj, Dafina Strana Ujkani, Edona Abazi Demolli, Saranda Husaj Baraliu**

Tabela e përmbajtjes

Shkurtesat	4
Mirënjohje	5
(a) Hyrje	6
(b) Deklarata e rishikuesit të pavarur	8
(c) Menaxhmenti i ZKA-së dhe përdorimi i rezultateve	9
(d) Gjetjet dhe vëzhgimet kryesore mbi performancën e ZKA-së dhe ndikimi ..	10
i) Vlerësimi i integruar i performancës së ZKA-së	10
ii) Vlera dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit – duke bërë ndryshim në jetën e qytetarëve	15
(iii) Analizë e përpjekjeve të ZKA-së për zhvillimin e kapaciteteve dhe perspektivat për përmirësime të mëtejshme.....	18
Kapitulli 1: Metodologjia e vlerësimit	19
Kapitulli 2: Metodologjia e notimit sipas KMP-së së ISA-ve	21
Kapitulli 3: Informata për vendin dhe ZKA-në	22
3.1 Përshkrimi i qeverisjes së vendit dhe mjedisit më të gjerë në të cilin operon ZKA-ja	22
3.2 Përshkrimi i mjedisit buxhetor në sektorin publik duke përfshirë menaxhimin e financave publike dhe ndikimi në performancën e ZAK-së	25
3.3 Përshkrimi i kuadrit ligjor dhe institucional të ZKA-së, strukturës organizative dhe burimeve	29
Kapitulli 4: Vlerësimi i performancës së ZKA-së	31
4.1 Domeni A: Pavarësia dhe Korniza Ligjore.....	31
4.2 Domeni B: Qeverisja e brendshme dhe etika.....	39
4.2.5 SAI-7: Planifikimi i përgjithshëm i auditimit [2].....	53
<i>Dimensioni (i) Procesi i planifikimit të përgjithshëm të auditimit/kontrollit</i>	53
<i>Dimensioni (ii) Përmbajtja e përgjithshme e planit të auditimit/kontrollit</i>	55
4.3 Domeni C: Cilësia e Auditimit dhe Raportimi	56
Dimensioni (i): Standardet dhe politikat e auditimit të performancës;	79
Dimensioni (ii): Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit në auditimet e performancës;	82
Dimensioni (iii): Kontrolli i cilësisë në auditimin e performancës.....	84
Dimensioni (i): Planifikimi i Auditimit të Performancës	87
Dimensioni (ii): Zbatimi/Ekzekutimi i Auditimeve të Performancës	89
Dimensioni (iii) Raportimi i Auditimit të Performancës.....	91
Dimensioni (ii): Publikimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës	95
Dimension (iii): Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve dhe vëzhgimi nga ISA	95
Dimensioni (i) Standardet dhe politikat e auditimit të pajtueshmërisë.....	97
Dimensioni (ii): Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit të auditimit të pajtueshmërisë	99
Dimensioni (iii) Kontrolli i cilësisë në auditimin e pajtueshmërisë	99
4.3.10 SAI-17: Rezultatet e auditimit të pajtueshmërisë – Nota [3]	106
Dimensioni (i): Dorëzimi në kohë i raporteve të auditimit të pajtueshmërisë	106
Dimensioni (ii): Publikimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Pajtueshmërisë	107

Dimensioni (iii): Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe observimeve nga ISA	107
4.4 Domeni D: Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse.....	108
4.5 Domeni E: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Plani i Trajnimeve dhe Zhvillimi.....	112
• <i>Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;</i>	112
• <i>Rregulloren (ZKA) nr. 01/2021 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;</i>	112
• <i>Rregulloren (ZKA) Nr. 02/2021 për klasifikimin e vendeve të punës;</i>	112
• <i>Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2021 për pranimin dhe karrierën;</i>	112
• <i>Rregulloren (ZKA) Nr. 04/2020 për vlerësimin e rezultateve në punë; dhe</i>	112
• <i>Planin Strategjik të Zyrës Kombëtare të Auditimit 2018-2021.</i>	112
4.5.1 SAI-22: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore – Nota [4]	112
4.5.2 SAI-23: Zhvillimi Profesional dhe trajnimet – Nota [4]	118
4.6 Domeni F: Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit	123
4.6.1 SAI-24: Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin - Nota [4]	123
Kapitulli 5: Procesi i zhvillimit të kapaciteteve të ZKA-së	131
5.1 Reformat e kohëve të fundit dhe ato në vijim	131
5.2 Përdorimi i rezultateve të ISA-së nga ofruesit e jashtëm të mbështetjes financiare.....	133
Shtojca 1: Përmbledhje e Treguesve të Performancës	134
Shtojca 2: Burimet e informacionit dhe dëshmisë për të mbështetur notimin e treguesit	135

Shkurtesat

AAP	Asistent Auditor i Përgjithshëm
AB	Auditimi i Brendshëm
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BNJ	Burimet Njerëzore
DA	Drejtor i Auditimit
IDI	Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Institucionet Supreme të Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KAB	Komiteti i Auditimit të Brendshëm
KC	Kontrulli i Cilësisë
KDPI	Korniza për Deklarata Profesionale e INTOSAI-t
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
KMP	Korniza për Matjen e Performancës
KRrPP	Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik
LMFPA	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënie
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
NP	Ndërmarrje Publike
NJQHAB	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm
OB	Organizatë Buxhetore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatë e Shërbimit Civil
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PBV	Produkti Bruto Vendor
PVA	Plani Vjetor i Auditimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RVF/BK	Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Kosovës
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
SC	Sigurimi i Cilësisë
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
SIMFP	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave Publike
SITA	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Auditimit
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik
SHKÇAK	Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
UE	Udhëheqës Ekipi
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZKAS	Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë
ZKGJ	Zyra e Komisionerit për Gjuhë

Mirënjohje

Ekipi i vlerësimit në përbërje nga Qendresë Mulaj, Udhëheqëse e Ekipit, së bashku me Dafina Strana Ujkani, Edona Abazi Demolli dhe Saranda Husaj Baraliu, anëtare të ekipit, për vetëvlerësimin e performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, shprehin mirënjohjen e tyre për mbështetjen e marrë nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI). Ekipi i vlerësimit, gjithashtu është mirënjohës ndaj Auditorës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës, Vlorë Spanca, për mbështetjen e ofruar si dhe ndaj stafit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për korrektësinë dhe bashkëpunimin gjatë procesit të vlerësimit.

(a) Hyrje

Korniza e Matjes së Performancës (KMP) u ofron Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA) kornizën për të vlerësuar vullnetarisht performancën e tyre kundrejt Standardeve Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (SNISA), kornizës ligjore kombëtare dhe praktikave tjera të mira ndërkombëtare të vendosura për auditimin e jashtëm publik. Dokumenti i KMP-së është hartuar nga Grupi Punues i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) për Vlerën dhe Dobitë e ISA-ve sipas vendimit të Kongresit të INTOSAI-t të mbajtur në Afrikën e Jugut në vitin 2010. Ng viti 2013 deri në vitin 2015 kjo kornizë është pilotuar dhe ka qenë subjekt i konsultimeve të gjera dhe testimi në më shumë se 20 vlerësime. Një version i ri, i cili reflekton të gjitha ndryshimet e nevojshme nga procesi i pilotimit, është miratuar nga Kongresi i INTOSAI-t i mbajtur në Abu Dabi në vitin 2016.

Përmbledhje e Përgjithshme

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në vend, ndërmerr disa veprime për të siguruar që ZKA-ja si institucion suprem i auditimit të kryejë detyrat e veta në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor dhe në përputhje me SNISA-t. Në këtë drejtim, Auditorja e Përgjithshme, ka vlerësuar se është e rëndësishme që të bëhet një vlerësim i gjendjes aktuale dhe performancës së institucionit sipas metodologjisë së INTOSAI-t, Kornizës për Matjen e Performancës së ISA-ve.

Në vitin 2020, ZKA-ja ka përditësuar metodologjinë e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë si dhe ka filluar përdorimin e softuerit të ri të auditimit të quajtur SITA. Sipas opinionit të Auditorës së Përgjithshme, tani është një moment i përshtatshëm për të vlerësuar rëndësinë, koherencën, qëndrueshmërinë dhe ndikimin e zhvillimeve dhe ndryshimeve të fundit.

Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është matja e performancës aktuale të ZKA-së, për të ofruar një pasqyrë të saktë mbi zhvillimin institucional, dhe identifikimi i pikave të forta dhe atyre të dobëta ku ka nevojë për përmirësim.

ZKA-ja ka ambicien për të rritur më tej performancën dhe ndikimin e saj duke qenë në gjendje, që nëpërmjet rezultateve të vlerësimit, të vendosë pikëpamje objektive dhe pritshmëri të qarta e të arritshme për të ardhmen.

Në mbështetje të kësaj, Auditorja e Përgjithshme ka autorizuar Ekipin e Vlerësimit për të kryer vetëvlerësimin e ZKA-së sipas kësaj kornize. Auditorja e Përgjithshme është pronare e rezultateve të këtij vlerësimi, të cilat do t'i shërbejnë si udhërrëfyes dhe orientim për planifikimin strategjik për vitet e ardhshme.

Ekipi i vlerësimit e ka zhvilluar këtë proces duke u udhëhequr nga parimet e Kornizës për Matjen e Performancës së ISA-ve e vitit 2016. Kjo kornizë është universale dhe mund të zbatohet nga të gjitha llojet ISA-ve, pavarësisht strukturës qeverisëse, mandatit, kontekstit kombëtar dhe nivelit të zhvillimit. Rezultatet nga vlerësimi i bazuar në KMP kontribuojnë dhe i shërbejnë ISA-ve për përmirësimin e zhvillimit të kapaciteteve për planifikim strategjik, nëpërmjet promovimit dhe menaxhimit të

performancës, si dhe për identifikimin e mundësive për të forcuar dhe monitoruar performancën e institucionit dhe forcuar përgjegjshmërinë.

Në përputhje me objektivat e ISSAI – 12 Vlera dhe Dobitë e ISA-ve – duke bërë një ndryshim në jetën e qytetarëve, KMP-ja gjithashtu u ofron ISA-ve një bazë për të demonstruar në vazhdimësi rëndësinë për qytetarët dhe palët e tjera të interesit. Përmes këtij vlerësimi, ZKA-ja mat kontributin e vet në forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit në institucionet publike që i nënshtrohen auditimit dhe aspirojnë për t'u bërë organizatë model, duke udhëhequr me shembull në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies nëpërmjet raportimit publik të besueshëm për performancën e saj.

(b) Deklarata e rishikuesit të pavarur



Raporti i performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, datë 29 mars 2023 Deklaratë për rishikimin e pavarur

Iniciativa për Zhvillimin e INTOSAI-t (IDI), si drejtuese operationale e KMP-ISA-së, ofron mbështetje për vlerësimet e KMP-ISA-së atëherë kur kërkohet. Një mbështetje e tillë përfshin kryerjen e rishikimeve të pavarura (RP) të draft raporteve të vlerësimit. Një kërkesë për një RP të tillë e pranuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës më 29 mars 2023.

Ky Raport i Performancës së ISA-së (RP-ISA) u përgatit nga ekipi i vlerësimit i përbërë nga **Qendresa Mulaj, udhëheqëse e ekipit, Dafina Strana Ujkani, Edona Abazi Demolli dhe Saranda Husaj Baraliu, anëtare të ekipit, për vetëvlerësimin e performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, shpreh vlerësimin e tyre për mbështetjen e marrë nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI).** Udhëheqësja dhe anëtarët e ekipit konsiderohen se i kanë aftësitë dhe përvojën e duhur për të kryer një vlerësim me cilësi të lartë.

Sipas metodologjisë së rekomanduar të KMP-ISA-së, kreu i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës ka pranuar draft raportin për ta rishikuar dhe për të dhënë komente, me synimin që të sigurojë se raporti është faktikisht i saktë.

Rishikimi i pavarur i aranzhuar nga IDI-ja u krye nga Anas ABOU EL MIKIAS, rishikues i pavarur i IDI-së. Ai nuk ka pasur asnjë përfshirje në përgatitjen e RP të ISA-së dhe konsiderohet se i ka njohuritë dhe përvojën e duhur dhe të nevojshme për këtë detyrë. Objektivi i këtij rishikimi ishte të sigurohej që metodologjia KMP-ISA-së ishte respektuar, se dëshmitë në RP të ISA-së ishin të mjaftueshme për të justifikuar notimin e treguesve dhe se analiza ishte në përputhje me dëshmitë gjatë gjithë raportit. Përfundimi i arritur pas rishikimit është se të gjitha objektivat ishin përmbushur në mënyrë të kënaqshme në raportin përfundimtar që IDI ka pranuar në mars 2023. Për të arritur në këtë përfundim, rishikuesi i pavarur është mbështetur në proceset e kontrollit të cilësisë së ekipit të vlerësimit dhe proceset e sigurimit të cilësisë së ISA-së për të siguruar se faktet mbi të cilat bazohen përfundimet janë të besueshme dhe të sakta.

Çështjet e rëndësishme të ngritura gjatë procesit të rishikimit të pavarur janë adresuar në këtë version të RP të ISA-së.

Përgatitur nga: **Anas ABOU EL MIKIAS**

Lëshuar nga IDI

Datë: **29 prill 2023**

(c) Menaxhmenti i ZKA-së dhe përdorimi i rezultateve

Qëllimi i KMP/ISA-së është matja e performancës aktuale të ZKA-së, për të ofruar një pasqyrë të saktë mbi zhvillimin institucional, dhe identifikimi i pikave të forta dhe atyre të dobëta ku ka nevojë për përmirësim. Rezultatet e këtij vlerësimi të pavarur do t'i shërbejnë Auditorës së Përgjithshme si udhërrëfyes për planifikimin dhe orientimin strategjik të ZKA-së për vitet e ardhshme. Sipas vlerësimit, ZKA-ja ka arritur të përmbushë mandatin e saj kushtetues dhe ligjor duke i ofruar Kuvendit dhe qytetarëve një opinion të pavarur dhe të bazuar mbi mënyrën se si institucionet publike i përdorin burimet dhe kompetencat e tyre, duke i zbatuar SNISA-t në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, janë identifikuar çështje specifike, të cilat duhet të adresohen. Në këtë drejtim, Auditorja e Përgjithshme është e përkushtuar që të ndërmarrë veprime menaxheriale dhe të zhvillojë më tej kornizën metodologjike, udhëzuesit dhe rregulloret përkatëse. Auditorja e Përgjithshme synon të zbatojë plotësisht Kornizën e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe për këtë do t'i shërbejnë rezultatet e KMP/ISA-së.

Rezultatet e vlerësimit do të ndahen me Kuvendin dhe palët e tjera të interesit, për të rritur edhe më tej vetëdijesimin rreth rolit dhe rëndësisë së ZKA-së për sa i përket menaxhimit të financave publike në vend.

Auditorja e Përgjithshme i shpreh mirënjohjen ekipit vlerësues, rishikuesve të pavarur, dhe ekipit të IDI-së për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në këtë proces.

(d) Gjetjet dhe vëzhgimet kryesore mbi performancën e ZKA-së dhe ndikimi

Kjo pjesë përmban të gjeturat mbi mënyrën se si ZKA kryen funksionet e saj kryesore. Ekipi i vlerësimit ka kryer një analizë të shkakut rrënjësor bazuar në të gjitha aspektet që ndikojnë në performancën e e ZKA-së dhe rezultatet janë përmbledhur si në vijim:

- Mbulimi me auditim;
- Cilësia e raporteve të auditimit dhe rekomandimeve
- Afatet kohore të dorëzimit dhe publikimit të rezultateve të auditimit; dhe
- Përcjellja e rezultateve të auditimit nga ZKA-ja

i) Vlerësimi i integruar i performancës së ZKA-së

Mbulimi me auditim

Shkaku i l-rë kryesor i identifikuar: ZKA nuk ka një plan strategjik për përzgjedhjen e temave të auditimit të performancës

Shkaku rrënjësor: Mungesa e një analize të thellë në procesin e planifikimit dhe ndërveprimin me palët e interesit

Niveli i ndikimit: nën kontrollin e ZKA-së

Në përputhje me mandatin e saj kushtetues dhe ligjor, ZKA-ja kryen kryesisht këto lloje auditimi:

- Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë), ku përfshihen të gjitha organizatat buxhetore si ministri, institucionet e pavarura dhe komunat (bazuar në sistemin e parasë së gatshme), ndërmarrjet publike (bazuar në sistemin aktual), si dhe projektet e financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare.
- Auditime të performancës të angazhimeve qeveritare, sistemeve, operacioneve dhe programeve. Auditimet e TI-së, kryesisht zhvillohen në kuadër të auditimeve të performancës.

Siç përcaktohet edhe te treguesi SAI – 8, ZKA-ja ka një nivel të lartë të mbulueshmërisë me auditim të institucioneve publike të cila përgatisin pasqyrat vjetore financiare (PVF).

Për periudhën audituese 2020/2021, ZKA-ja kishte kryer gjithsej 127 auditime, ku përfshihen: Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, 102 auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) prej të cilave 90 organizata buxhetore dhe 12 ndërmarrje publike, 11 auditime të performancës dhe 13 projekte të financuara nga donatorët si Banka Botërore dhe SIDA.

Auditimit të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) i janë nënshtruar 100% e PFV-ve të pranuar nga ZKA-ja, dhe si rezultat mbulueshmëria e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë është arritur me sukses.

Po aq të rëndësishme sa edhe auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë janë edhe auditimet e performancës të cilat janë të orientuara drejt ekzaminimit të performancës, ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike. Auditimet e performancës mbulojnë jo vetëm operacione

specifike financiare, por një gamë më të gjerë të veprimtarisë së qeverisë që përfshin si sistemet organizative ashtu edhe ato administrative.

Gjatë pesë viteve të fundit, ZKA-ja ka kryer 57 audime të performancës duke mbuluar fusha me rëndësi siç janë: zhvillimi ekonomik, edukimi, mbledhja e të hyrave, mjedisi, shëndetësia, financa publike, infrastruktura, siguria sociale dhe tregu i punës, etj. Pra fushat e mbuluara plotësojnë kriteret bazuar në ISSAI 12:5, ISSAI 300:36.

Megjithatë, ZKA-ja nuk ka plan strategjik për përzgjedhjen e temave të auditimit të performancës, si dhe nuk ka një proces interaktiv me palët e interesit, i cili do të siguronte se janë kuptuar pritshmëritë e palëve dhe rreziqet e shfaqura janë katoriazuar në planet e auditimit, sipas ISSAI 12:5.

Prandaj, temat e auditimit nuk përzgjidhen “nëpërmjet procesit të planifikimit strategjik (dhe/ose operacional) të ISA-s, i cili mundëson që të analizohen temat e mundshme dhe të kryehen kërkime për të identifikuar rreziqet dhe problemet”, ashtu siç kërkohet nga ISSAI 300:36.

Procesi i përzgjedhjes së temave të auditimit bëhet në baza vjetore. I cili fillon me propozimin e temava nga niveli poshtë - lartë, ku secili anëtar i ekipit propozon tema të auditimit, bazuar në një hulumtim paraprak. Procesi i përzgjedhjes së temave pastaj diskutohet dhe prioritizohet në nivele të ndryshme menaxheriale. Për shkak se ZKA-ja, është e obliguar të kryej auditimin (financiar dhe të pajtueshmërisë) të gjitha organizatave buxhetore, shumica e kapaciteve janë të orientuar në përmbushjen e mandatit ligjor, si rrjedhojë numri i auditimeve të performancës është më i vogël dhe para se temat të përzgjidhen dhe të vendosen në planin vjetor të auditimit merren në konsideratë kapacitet apo burimet në dispozicion.

Cilësia e raporteve të auditimit dhe rekomandimeve

Shkaku i 1-rë kryesor i identifikuar: Udhëzuesi për kontrollin e cilësisë nuk është përditësuar në pajtim me manualin dhe metodologjinë e re, e cila filloi të aplikohet gjatë vitit 2020

Shkaku rrënjësor: rotacioni dhe mungesa e stafit

Niveli i ndikimit: nën kontrollin e ZKA-së

ZKA-ja ka të rregulluar dhe vendosur një sistem për kontrollin e cilësisë brenda zyrës. Konform kësaj sipas Rregullores nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës dhe Rregullores nr.02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës, janë përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë fillimisht të secilit departament dhe njëkohësisht edhe secilës pozitë brenda këtyre departamenteve.

Për sa i përket auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë, janë të caktuara pikat kyçe të cilat specifikojnë mandatin dhe detyrat në kuadër të departamentit të cilat kanë rol në kontrollin e cilësisë. Përveç drejtorit të departamentit dhe ndihmës auditorit të përgjithshëm, edhe udhëheqësi i ekipit luan rol kyç në këtë proces.

Mënyra e rishikimit të punës gjatë auditimit është e rregulluar me hapa të caktuara në Doracakun e Auditimit, ndërsa mënyra e kontrollit të cilësisë është e rregulluar në SITA, ku çdo letër e punës e vendosur në dosje vlerësohet nga udhëheqësi i ekipit (UE) dhe drejtori i auditimit (DA) dhe varësisht nga faza e auditimit aprovet për të vazhduar më tutje.

Të gjitha pikat e kontrollit në fund të secilës fazë të auditimit evidentohen në një listë të ashtuquajtur Listë Kontrolluese, e cila plotësohet nga UE, DA dhe Departamenti për Sigurimin e Cilësisë (në rastet kur është bërë kontrolli për atë auditim) me të gjitha dokumentet të cilat janë vendosur dhe bëjnë referencimin për to.

Departamenti për Sigurimin e Cilësisë në Auditim bënë rishikimin e cilësisë për auditime të caktuara dhe ofron siguri të arsyeshme se auditimet janë kryer në përputhje me SNISA-t. Ky Departament, përgatit dhe plotëson formularët e përcaktuar me Udhëzuesin e Kontrollit të Cilësisë në Auditim dhe nxjerr konkluzione për rezultatet e rishikimit, si dhe paraqet komente për nivelin e cilësisë duke ofruar edhe rekomandime për përmirësim. Siguron se gjetjet e auditimit janë të mbështetura në dëshmitë e dukura dhe në raste të caktuara rishikon dhe analizon edhe mostrat e përzgjedhura, si dhe rishikon dhe analizon opinionet e auditimit. Kjo vlen vetëm për auditimet e rregullsisë por jo edhe për auditimet e performancës. Edhe sa i përket auditimeve të kontraktuara. Udhëzuesi për Kontrollin e Cilësisë nuk është azhurnuar ende sipas Doracakut dhe metodologjisë së re, i cili ka filluar të aplikohet gjatë vitit 2020.

Shkaku i 2-të kryesor i identifikuar: Mungesa e procedurave të shkruara për sigurimin e cilësisë

Shkaku rrënjësor: Departamenti për SC i themeluar rishtazi

Niveli i ndikimit: nën kontrollin e ZKA-së

Me strukturën e re organizative, AP-ja ka marrë vendimin të transformojë Njësinë për Kontrollin e Cilësisë në Departament për Sigurimin e Cilësisë. Qëllimi është të krijojë një funksion për sigurimin e cilësisë (SC) në pajtim me qëllimin e SNISA 140, i cili do të ketë për detyrë të monitorojë dhe analizojë funksionimin e sistemit të kontrollit të cilësisë (KC) në nivel të të gjithë organizatës. Drejtori i Departamentit i raporton drejtpërdrejt AP-së dhe harton raporte periodike për gjetjet nga procesi i rishikimit.

Departamenti ende nuk ka hartuar ndonjë procedurë të shkruar për sa i përket sigurimit të cilësisë. Kjo pritet të kryhet me mbështetjen nga projekti dypalësh me ZKAS-në deri në fund të vitit 2023.

Shkaku i 3-të kryesor i identifikuar: Mungesa e udhëzuesit për KC në auditimet e performancës

Shkaku rrënjësor: mungesa e sistemit për kontrollin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë

Niveli i ndikimit: nën kontrollin e ZKA-së

Sa i përket auditimeve të performancës, pavarësisht se ZKA-ja nuk ka udhëzues të veçantë të KC-së e gjithë puna e kryer e auditimit duke filluar nga faza e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit, i nënshtrohet rishikimit nga nivele të ndryshme menaxheriale, si një mjet për të kontribuar në cilësinë dhe për të promovuar mësimin dhe zhvillimin e personelit si dhe procesi i rishikimit dokumentohet. KC-ja kryhet dhe sigurohet në disa nivele, duke u nisur në nivelin e parë - nga drejtorët e departamentit dhe pastaj në nivelin e dytë - nga ndihmës auditori i përgjithshëm (AAP).

Departamenti për Sigurimin e Cilësisë në Auditim, nuk bën rishikimin e cilësisë për auditime të performancës megjithatë, ZKA-ja ka praktikë të kryej rishikimin kolegjial për memorandumit dhe draft-raportin e auditimit. Ky rishikim bëhet nga anëtarët e emëruar (auditorë me përvojë) brenda divizionit, përpara se draft - raporti të shqyrtohet nga menaxhmenti. Parastudimet dhe draft-raporti rishikohen në mënyrë sistematike, përmes diskutimeve brenda ekipit nga udhëheqësi i auditimit dhe menaxhmenti i lartë. Për disa nga temat janë angazhuar këshilltarë të jashtëm nga Zyra

Kombëtare e Auditimit e Suedisë (ZKAS) dhe sipas nevojës apo specifikave të temës që auditohet angazhohen edhe ekspertë vendorë të fushave përkatëse. Vlen të përmendet që në vitin 2019 nga ZKAS, është realizuar një rishikim i ftohtë për praktikën e auditimit të performancës. Rishikimi ka arritur në përfundimin se ZKA-ja zbaton shumicën e proceseve të auditimit, megjithatë është potencuar nevoja për forcim të KC-së dhe SC-së.

Nga vlerësimi i cilësisë së dëshmimeve në dosjet e testuara të auditimit dhe përmbajtjes së raporteve të auditimit, ekipi i vlerësimit ka nxjerrë përfundimin se ekipet e auditimit kanë arritur të dëshmojnë qartë procesin e auditimit të kryer sipas kërkesave të Doracakut, të nxjerrin opinion të bazuar në dëshmi, të japin rekomandime adekuate sipas natyrës të së gjeturës, si dhe të dëshmojnë komunikimin me entitetin e audituar.

Ekipi i vlerësimit ka vlerësuar edhe bazën për dhënien e opinionëve dhe ka vërejtur se të gjitha opinionet nga dosjet e vlerësuara kishin mbështetje me dëshmitë përkatëse dhe të gjitha ishin të vendosura në letrat e punës dhe të aprovuara sipas linjës menaxheriale.

Për sa i përket përmbajtjes së raporteve të auditimit, është i përcaktuar shablloni i raportit sipas kërkesave të standardeve dhe Doracakut të Auditimit. Gjithashtu, raportet përmbajnë të gjitha elementet dhe janë të shkruara mjaftueshëm qartë. Gjetjet dhe rekomandimet janë mirë të prezantuara dhe të sqaruara, duke treguar ndikimin e secilës gjetje dhe rekomandimin e dhënë për menaxhmentin e audituar.

Afatet kohore të dorëzimit dhe publikimit të rezultateve të auditimit

Shkaku i 1-rë kryesor i identifikuar: Vonesa në dorëzimin dhe publikimin e raporteve të auditimit

Shkaku rrënjësor: Situata Covid-19; ndryshimet në metodologjinë e auditimit; futja në përdorim e softuerit SITA

Niveli i ndikimit: nën kontrollin e ZKA-së

ZKA-ja ka të rregulluar edhe me ligj por edhe me aktet tjera nënligjore afatet dhe mënyrën e dorëzimit dhe publikimit të rezultateve të punës. Siç kërkohet edhe me nenin 22 të Ligjit 05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, ekipi përgatit draft raportin dhe e dërgon në entitet për komente me një afat prej 15 ditësh kalendarike. Në rast se ka komente, ZKA-ja i shqyrton ato para finalizimit të raportit, dhe nëse ato komente nuk janë të mbështetura me dëshmi, ISA e publikon atë raport duke i bashkangjitur edhe komentet nga entiteti. Kurse, në rastet ku entiteti i audituar nuk ka komente, atëherë ai dërgon një letër konfirmim, me ç'rast i bashkëngjitet raporti final. Procesi i dërgimit të raportit tek entiteti duhet të jetë para datës 30 qershor, kur është afati ligjor për publikimin e tyre, sipas LMFPP, neni 48.2.

ZKA i dorëzon institucioneve të audituara raportet finale të auditimit. Kopje mund t'i dorëzohen çdo institucioni tjetër të ndërlidhur. ZKA publikon raportet finale të auditimit një (1) ditë pas dorëzimit të këtyre raporteve.

Megjithatë gjatë vitit 2020, për shkak të situatës me pandeminë COVID-19, ndryshimeve në metodologjinë e auditimit, si dhe futjes në përdorim të softuerit SITA, ka pasur vonesë në dorëzimin, rrjedhimisht edhe në publikimin e një numri të raporteve të auditimit. Vetëm 40% e

auditimeve të planifikuara kanë arritur të dorëzohen dhe publikohen me kohë, dhe si rezultat i kësaj, treguesi SAI-11 dimensionit (i) është vlerësuar me **notën 2**.

Vlen të theksohet se që nga themelimi i ZKA-së, ky ka qenë viti i parë ku ka pasur vonesa në publikimin e Raporteve të Auditimit.

Nuk ka ndonjë datë të përcaktuar me ligj se kur duhet të dorëzohen raportet e auditimit të performancës. Ndërkaq, koha e auditimit dhe e raportimit të auditimeve të performancës përcaktohen në Planin Vjetor të Auditimit. Për dallim nga auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, dorëzimi dhe publikimi i auditimeve të performancës është bërë sipas planit.

Të gjitha raportet e auditimit janë të qasshme në ueb faqen e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Përcjellja e rezultateve të auditimit nga ISA

Shkaku i 1-rë kryesor i identifikuar: Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të auditimit

Shkaku rrënjësor: Mungesa e një mekanizmi përcjellës nga Kuvendi

Niveli i ndikimit: pjesërisht nën kontrollin e ZKA-së

Sipas nenit 23.5 të Ligjit 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, entiteti i audituar brenda 30 ditët nga pranimi i raportit të auditimit, duhet të përgatis dhe t'ia dorëzojë ZKA-së planin e veprimit sipas formatit të kërkuar, ku përcaktohet se si institucioni do t'i adresojë rekomandimet e dhëna në raportin final të auditimit. Po ashtu, sipas kësaj procedure entitetet dy herë në vit duhet të raportojnë për progresin në zbatimin e rekomandimeve. Këtë raport duhet ta dorëzojë edhe në Kuvend, apo Kuvendet komunale.

Nga pesë dosjet e vlerësuara, tre prej tyre kishin dorëzuar planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve; një nuk kishte dorëzuar; dhe për auditimin e kontraktuar kjo nuk ishte e aplikueshme sepse në raport nuk kishte gjetje të identifikuara.

Është kërkesë e Doracakut të Auditimit dhe praktikë brenda ZKA-së që gjatë auditimit të vitit aktual, ekipet audituese bëjnë vlerësimin e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të dhëna për vitin paraprak. Çdo rekomandim i pazbatuar trajtohet dhe vendoset në raportin aktual. Po ashtu, këto rekomandime evidentohen në softuerin e auditimit në një bazë të veçantë, ku secili ekip i angazhuar në atë auditim e ka për detyrë të azhurnojë të dhënat lidhur me statusin e secilit rekomandim. Statusi i implementimit të rekomandimeve të caktuara duhet të vendoset bazuar në analiza të dëshmimeve të auditimit, i cili është deri në një masë i ngjashëm me atë për procedurë substanciale të auditimit.

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është pjesë e procesit të vazhdueshëm të auditimit. Vlerësimi se si dhe në ç'masë janë zbatuar ato bëhet për secilën OB gjatë auditimit të rregullt, dhe rezultatet për vitin paraprak paraqiten në raportet e auditimit për vitin pasardhës. Sipas Raportit Vjetor të Auditimit (RVA) për vitin 2020, niveli i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2019 është në masën prej 45% krahasuar me 40% sa ishte për rekomandimet e vitit 2018. ZKA-ja konsideron se ky nivel i zbatimit të rekomandimeve nuk është i kënaqshëm.

Po ashtu, është arritur progres në përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të performancës, duke kryer auditime të veçanta të përcjellës së rekomandimeve, ndërsa në vitin 2020 është publikuar një raport përmbledhës për vlerësimin e rekomandimeve në raportet e dhëna në vitin 2017. Po ashtu, është hartuar udhëzimi për zbatimin e rekomandimeve të performancës si dhe ka filluar publikimi i planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Edhe pse ZKA vlerëson zbatimin e rekomandimeve çdo vit, përgjegjës për të siguruar se ato po zbatohen është Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike në kuadër të Kuvendit të Kosovës. Përveç kësaj, ZKA çdo vit publikon edhe planet e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve që dërgohen nga entitetet e audituara.

ii) Vlera dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit – duke bërë ndryshim në jetën e qytetarëve

Ndonëse ka vetëm 19 vite të ekzistencës si institucion suprem i auditimit, ZKA ka arritur të zhvillojë dhe rrisë kapacitetet njerëzore dhe profesionale në nivel të kënaqshëm. E dedikuar që të ofrojë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, të ndihmojë entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përmes rekomandimeve praktike dhe konstruktive, ZKA-ja synon që përmes punës audituese t'i kontribuojë ndryshimit pozitiv në vend.

1) Forcimi i përgjegjësisë, transparencës dhe integritetit të qeverisë dhe entiteteve të sektorit publik

Rritja e ndikimit të ZKA-së në përmirësimin e qeverisjes në sektorin publik në interes të qytetarëve, është një proces i vazhdueshëm i cili mbështetet në auditime cilësore që ofrojnë informacion të bazuar dhe të saktë.

Bashkëpunimi konstruktiv me Kuvendin, ekzekutivin dhe organizatat e audituara i kontribuon këtij procesi dhe është esencial për të siguruar se gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm po merren në konsideratë.

ZKA-ja në baza vjetore kryen më shumë se 120 auditime dhe të gjitha raportet bëhen publike në ueb faqen e saj.

Në Raportin Vjetor të Performancës (RVP) për vitin 2020¹ është konstatuar se puna audituese ka ndikuar në përmirësimet të dukshme në menaxhimin e financave publike si:

- Përmirësimi i raportimit financiar në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit.
- Zvogëlimi i transaksioneve financiare të parregullta.
- Përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit (kthimi i pagesave në buxhet).
- Rritja e transparencës për shpenzimin e parasë publike.
- Përmirësimi i mbikëqyrjes profesionale të zbatimit të projekteve.

¹ [Raporti Vjetor i Performancës 2020](#), f. 12

Përmes auditimeve të performancës, ZKA mbulon fusha me interes të veçantë për qytetarët, Kuvendin dhe palët e tjera të interesit. Përmes tyre, ZKA-ja synon të ndikojë në rritjen e efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës në administratën publike.

Përzgjedhja e temave të auditimeve të performancës për vitin 2021 ishte ndikuar nga shtrirja e pandemisë Covid-19. Për shkak të kësaj, ZKA-ja nuk kishte arritur të zhvillojë konsultimet e zakonshme me organizatat e shoqërisë civile dhe akterët tjerë. Megjithatë, në planin e auditimit për sezonin 2020/2021, ishin përfshirë tema nga fusha të rëndësishme si: shëndetësia dhe siguria, ekonomia, investimet publike (prokurimi publik), mjedisi dhe teknologjia e informacionit.

Rëndësi e veçantë gjatë vitit 2021 i është dhënë kryerjes së auditimeve të performancës për pandeminë Covid-19, me qëllim që Kuvendit dhe Qeverisë t'i ofrohet informacion i bazuar lidhur me menaxhimin e pandemisë në Republikën e Kosovës. Raportet e publikuara të auditimit "Furnizimi me barëra dhe materiale shëndetësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me Covid – 19" dhe "Optimizimi i resurseve njerëzore dhe pajisjeve teknike mjekësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19" kanë marrë vëmendje të madhe nga mediat dhe shoqëria civile.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është treguesi më i mirë për të kuptuar nëse institucionet publike po i përmirësojnë proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar gabimet dhe parregullsisë. ZKA-ja në vazhdimësi ka ndërmarrë hapa për të krijuar mekanizma dhe instrumente² për të nxitur zbatimin e rekomandimeve të auditimit dhe për të përcjellur nivelin e zbatimit. Pavarësisht se është vërejtur një rritje e vërtetë në vitin e fundit, niveli prej 45% nuk është i kënaqshëm.

2) Demonstrimi i rëndësisë së vazhdueshme për qytetarët, Parlamentin dhe palët tjera të interesit

Pritshmëritë e qytetarëve, të Kuvendit, të Qeverisë dhe të palëve tjera të interesit janë të larta për rezultatet e auditimit të jashtëm publik. Në përputhje me mandatin e saj kushtetues e ligjor, ZKA-ja në vazhdimësi ka bërë përpjekje të rris portofolion e auditimeve të performancës dhe mbulimin më të madh me auditim të ndërmarrjeve publike. Për këtë qëllim në përgatitjen e planit vjetor të auditimit merren parasysh edhe kërkesat dhe rekomandimet për auditime të performancës që vijnë nga Kuvendi, Organizata të Shoqërisë Civile dhe Media.

Në tri vitet e fundit ZKA-ja përfunduar dhe publikuar 29 raporte të auditimit të performancës duke mbuluar fusha me interes të veçantë siç janë: shëndetësia, edukimi, prokurimi publik, infrastruktura, sisteme të TI-së etj. Gjithashtu përmes auditimit të ndërmarrjeve publike ka arritur të ofrojë informacion të bazuar për qytetarët dhe palët tjera të interesit kryesisht në fushën e telekomunikimit, furnizimit me ujë dhe trajtimit të mbeturinave.

Megjithatë, obligimi ligjor për të audituar Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të të gjitha Organizatave Buxhetore (OB), e ka sfiduar vazhdimisht ZKA-në, duke i ngushtuar mundësinë e përzgjedhjes së auditimeve bazuar në rrezik dhe të atyre në interes për qytetarët.

² [Rregullorja e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit Udhëzues për përcjelljen e rekomandimeve të auditimit të performancës Sistemin e vëzhgimit të rekomandimeve](#)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, kryesisht përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) gjatë vitit 2021 ka shqyrtuar 25 raporte të auditimit për të cilat ka nxjerrë rekomandime me kërkesa të veçanta për krerët e OB-ve që ndërlidhen me zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

ZKA-ja bën përcjellje sistematike për të vlerësuar ndikimin e punës audituese dhe se sa po zbatohen rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit. Informatat për progresin e arritur të OB-ve të audituara paraqiten në raportet individuale të rregullsisë (financiar dhe pajtueshmëri) dhe në raportet përcjellëse të performancës.

Megjithatë, nuk ka praktikë të përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve për të gjitha raportet e auditimit të performancës. Vitet e fundit ZKA-ja ka treguar progres edhe në këtë drejtim. Në disa raste janë kryer disa auditime të veçanta për zbatimin e rekomandimeve, ndërsa në vitin 2020 është publikuar një raport përmbledhës për vlerësimin e rekomandimeve në raportet e dhëna në vitin 2017. Po ashtu, është hartuar udhëzimi për zbatimin e rekomandimeve të performancës si dhe ka filluar publikimi i planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Aktualisht është zhvilluar baza e të dhënave për zbatimin e rekomandimeve, e cila është e qasshme në ueb faqe të ZKA-së. Mirëpo, është ende herët për të vlerësuar zbatueshmërinë dhe efektivitetin e këtyre masave në praktikë.

ZKA-ja ka të zhvilluar qasje të bashkëpunimit të vazhdueshëm me palët e interesit, e cila kontribuon në sigurimin e efektivitetit, efikasitetit dhe përmirësimin e ndikimit të punës së ZKA-së. Komunikimi me palët e interesit zbatohet përmes strategjisë së Komunikimit të ZKA-së që ka për qëllim "Rritjen e ndikimit dhe ngritjen e vetëdijesimit publik rreth rolit të ZKA-së"

3) Të qenit një organizatë model duke udhëhequr përmes shembullit

ZKA-ja ka arritur të përmbush mandatin e saj kushtetues dhe ligjor duke i ofruar Kuvendit dhe qytetarëve opinion të pavarur dhe të bazuar për mënyrën se si institucionet publike i përdorin burimet dhe kompetencat e tyre.

Kryen çdo vit mbi 120 auditime individuale si dhe Raportin Vjetor të Auditimit (RVA) të PFV-ve të buxhetit të shtetit. Të gjitha raportet i publikon në ueb faqen e vet brenda 24 orëve nga dorëzimi i tyre në Kuvendin e Kosovës dhe te entiteti subjekt i auditimit.

RVP-ja e ZKA-së ofron informacion për përmbushjen e mandatit ligjor të ZKA-së, të gjitha aktivitetet audituese dhe jo-audituese, zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe shfrytëzimin e burimeve të saj financiare gjatë një viti. Në këtë raport gjithashtu përfshihen edhe PFV-të si dhe opinionin e auditorit të jashtëm.

Me zhvillimin e sistemit elektronik të auditimit SITA, ZKA-ja ka digjitalizuar punën audituese, përmes së cilit do të racionalizohet koha në auditim, rritet cilësia dhe siguria e auditimeve dhe forcohet transparenca.

Ueb faqja e ZKA-së azhurnohet në vazhdimësi duke ju ofruar qytetarëve dhe të gjitha palëve të interesit informacion mbi auditimet dhe zhvillimet në ZKA.

Në vitin 2020 Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ), në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE), ka vlerësuar ZKA-na në mesin e institucioneve që

kanë treguar praktikë të shkëlqyeshme të përkthimit në gjuhët zyrtare duke respektuar Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Një praktikë e tillë vazhdon ende dhe ueb faqja mirëmbahet në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.

Edhe në raportet nga institucione dhe organizatave ndërkombëtare siç është raporti i Këshillit të BE-së për vendin, raporti i PEFA, raporti i SIGMA-s, Bankës Botërore dhe IMF ka vlerësime pozitive sa i përket performancës së ZKA-së. Megjithatë, të dhënat nga raporti i Barometrit Ballkanik për vitin 2021 për perceptimin e qytetarëve sa i përket pavarësisë së institucionit nga ndikimi politik tregojnë se ka pasur një rënie të dukshme, nga 48% sa ishte në vitin 2017 në 30.7% në vitin 2021. Ne vlerësojmë se ZKA-ja mund të rris edhe më shumë performancën e vet dhe të vazhdojë të jetë shembull i mirë duke e forcuar edhe më shumë pavarësinë institucionale, të përmirësojë sistemin e kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë, si dhe të rris edhe më shumë komunikimin me palët e interesit.

(iii) Analizë e përpjekjeve të ZKA-së për zhvillimin e kapaciteteve dhe perspektivat për përmirësime të mëtejshme

Pavarësisht sfidave të viteve të fundit, ZKA-ja ka arritur të bëjë zhvillime të rëndësishme institucionale dhe të rris kapacitetet. Duke u fokusuar në përmbushjen e misionit të saj kushtetues dhe statutor, ndërtimin e kapaciteteve profesionale dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira me palët e jashtme, ZKA është treguar një institucion i besuar në vend. Rezultatet e auditimit kanë ofruar një bazë të shëndoshë për përmirësimin e menaxhimit të financave publike, përdorimin efektiv dhe efikas të fondeve publike si dhe arritjen e vlerës për paranë.

Pavarësisht rezultateve të arritura, ZKA në vazhdimësi ndërmerr veprime për zhvillime të mëtejshme. Rritja e cilësisë së auditimeve është një synim i vazhdueshëm i ZKA-së, jo vetëm në zbatimin e standardeve dhe kërkesave në fushën e auditimit, por edhe në sigurimin që auditimet e kryera t'i japin publikut dhe Kuvendit informacion në kohë dhe të besueshëm mbi administrimin dhe përdorimin e fondeve dhe pasurisë publike.

Nga ana tjetër, zhvillimi profesional është objektivi kryesor dhe i vazhdueshëm i ZKA-së, e cila përmes zhvillimit profesional hap rrugën e sigurt drejt arritjes së objektivave strategjike në proceset e auditimit në mënyrë profesionale. Kjo qasje synon të sigurojë që stafi ka aftësitë dhe kapacitetet e duhura për të përmbushur detyrat e përcaktuara për arritjen e objektivave të auditimit.

Kapitulli 1: Metodologjia e vlerësimit

ZKA-ja është pajtuar t'i nënshtrohet vlerësimit sipas KMP-së së ISA-ve për të matur performancën e institucionit dhe vlerësuar nëse operon në pajtueshmëri me ISSAI-t, kornizën ligjore të vendit dhe nëse ka burime të mjaftueshme për të përmbushur mandatin e vet kushtetues dhe ligjor.

Rezultatet e vlerësimit do t'i shërbejnë Auditorës së Përgjithshme si bazë për përgatitjen dhe zhvillimin e planit të ri strategjik gjithëpërfshirës, me qëllim të rritjes së ndikimit të rezultateve të auditimit si dhe zhvillimin e kapaciteteve të ZKA-së.

Fushëveprimi i vlerësimit

Vlerësimi mbulon të gjitha domenet dhe indikatorët sipas KMP-së së ISA-ve, me përjashtim të atyre që nuk janë të aplikueshme për ZKA-në.

ZKA-ja është institucion supreme i auditimit sipas modelit 'Westminster', dhe nuk ka mandat gjyqësor. Për këtë arsye, treguesit të cilët nuk ishin të aplikueshëm për vlerësim janë:

SAI – 8 (iv): Mbulueshmëria e kontrollit juridiksional.

SAI – 18: Kontrolli juridiksional, standardet dhe menaxhimi i cilësisë.

SAI – 19: Procesi i kontrollit juridiksional.

SAI – 20: Rezultatet e kontrollit juridiksional.

Vlerësimi është objektiv dhe i bazuar në dëshmi me fokus në vitin 2021 për auditimet e vitit 2020, sa i përket vlerësimit të auditimeve të rregullsisë, ndërsa për auditimet e performancës në fokus ishin auditime nga viti 2018 e më tutje. Mostrat janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, të pavarur dhe objektive.

Për auditimin e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) janë përzgjedhur 5 mostra (përfshirë nivelin qendror me buxhetin më të madh, nivelin lokal, një auditim të Ndërmarrjeve Publike dhe një auditim të kontraktuar). Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë janë vlerësuar veçmas por janë bazuar në të njëjtat mostra duke u fokusuar në kapitujt përkatës.

Mostrat e përzgjedhura janë:

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2020 (niveli qendror – buxhetin më të madh)
2. Komuna e Vushtrrisë për vitin 2020 (nivel lokal)
3. Ndërmarrja Publike Regjionale e Ujit "Prishtina" për vitin 2020 (NP)
4. Institucioni i Avokatit të popullit për vitin 2020 (i kontraktuar)
5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2020 (Institucion i Pavarur)

Sa i përket auditimeve të performancës, janë përzgjedhur tri mostra me fokus në performancë dhe TI, performancë dhe prokurim dhe një auditim përcjellës.

Mostrat e përzgjedhura janë:

1. Zbatimi i rekomandimeve të raportit “Administrimi i programit mjekësor për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike dhe vlerësimi i rezultateve” - 2020
2. Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Statistikave - 2020
3. Vlera për para në prokurimet e centralizuara – pjesa e parë - 2018

Për të shmangur çdo konflikt interesi, raporti për auditimin e buxhetit të shtetit dhe raportet tjera ku anëtarët e ekipit ishin të angazhuar janë përjashtuar nga mostrimi.

Ekipi i vlerësimit përbëhet nga katër anëtarë: Qëndresa Mulaj, udhëheqëse e ekipit, Dafina Strana-Ujkani, Edona Abazi – Demolli dhe Saranda Husaj – Baraliu, anëtare.

Udhëheqësja e ekipit ka njohuritë e nevojshme dhe përvojën e duhur për të siguruar se procesi i vlerësimit ecën pa probleme dhe për të mbështetur ekipin në këtë proces. Si tërësi, ekipi ka përgatitje profesionale, përvojë të gjatë dhe njohuri në auditimet e rregullsisë dhe të performancës, si dhe shërbimet e përbashkëta, me theks në komunikim dhe burime njerëzore.

Ekipi ka ndjekur kursin për zbatimin e Kornizës për Matjen e Performancës së ISA-ve, të organizuar nga IDI.

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit përfshinë rishikimin e dokumenteve relevante, intervistave dhe komunikimit formal dhe jo formal me drejtorin e Përgjithshëm udhëheqësit e departamenteve relevante dhe stafin. Për vlerësimin e mostrave të përzgjedhura të auditimit janë siguruar nga dosjet përkatëse të auditimit dhe nga sistemi i auditimit – SITA. Sa i përket vlerësimit të shërbimeve korporative, dëshmitë janë siguruar nga zyrtarët përgjegjës dhe Departamenti për Administrimin e Dokumenteve në ZKA. Vlerësimi është mbështetur gjithashtu në takimet dhe intervistat me zyrtarët përgjegjës si dhe komunikimit përmes e-mailës.

Kontrolli i cilësisë

Udhëheqësja e ekipit ka siguruar se vlerësimi është kryer në pajtueshmëri me SNISA-t dhe sipas KMP-së. Përgjatë gjithë procesit të vlerësimit ekipi ka kryer vlerësime të kontrollit të cilësisë për të siguruar se janë trajtuar të gjitha informatat e pranuar. Gjithashtu për të siguruar cilësinë e raportit nga aspekti metodologjik, ekipi vazhdimisht është mbështetur nga zyrtarët e IDI-së, Dafina Dimitrova dhe Eirij Rubbani.

Për të siguruar se gjetjet dhe konkluzionet e paraqitura në raport janë të bazuara në fakte të qëndrueshme, Safet Berisha, drejtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe Kundër Mashtrimeve, i caktuar nga Auditorja e Përgjithshme, ka kryer rishikimin e brendshëm dhe ka dhënë mendimin e tij për raportin.

Rishikuesi i pavarur i caktuar nga IDI-ja ka kryer rishikimin e raportit sipas Kornizës për Matjen e Performancës së ISA-ve.

Procesi i përgatitjes së raportit të vlerësimit

Raporti me rezultatet e vlerësimit është përgatitur në gjuhën shqipe dhe angleze.

Kapitulli 2: Metodologjia e notimit sipas KMP-së së ISA-ve

KMP e ISA-ve përmban 6 domene që vlerësojnë performancën e ISA-së në fushat kyçe si:

- A. Pavarësia dhe Korniza Ligjore
- B. Qeverisja e brendshme dhe etika
- C. Cilësia në auditim dhe raportimi
- D. Menaxhimi Financiar, pasuritë dhe struktura mbështetëse
- E. Burimet njerëzore dhe trajnimet
- F. Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit

Secili nga domenet përmban një numër të caktuar të treguesve, nga 25 sa janë në total. Secili tregues përbëhet nga dy dhe katër dimensione, të cilat pastaj përbëhen nga disa kritere. Një ilustrim se sistemi i treguesve është i ndërtuar është prezantuar në diagramin 1 më poshtë.




Figura 1. KMP e ISA-ve terminologjia

Në shumicën e rasteve, kriteret merren drejtpërdrejt nga Korniza e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale të (KIDP) ose praktika të tjera të mira ndërkombëtare. Pasi çdo kriter vlerësohet kundrejt dëshmive të duhura dhe vlerësohet si i 'plotësuar' ose 'jo i plotësuar', rezultati në nivel dimensionit dhe treguesit agregohet duke përdorur tabelat e konvertimit sipas dokumentit të KMP-së për ISA-t.

Treguesit dhe dimensionet vlerësohen duke përdorur një shkallë numerike nga 0 në 4, ku 0 është niveli më i ulët dhe 4 është më i larti. Pikët në përgjithësi korrespondojnë me nivelin e zhvillimit në fushën e matur nga treguesi. KMP për ISA-t nuk jep një rezultat të përmblodhur në nivel domeni ose për shumën e aktiviteteve të ISA-it, siç bëjnë disa mjete të tjera. Niveli i zhvillimit dhe si rrjedhim pikët mund të ndryshojnë përgjatë aktiviteteve të ISA-së. Notimi i rezultateve të treguesve nga 0-4 pasqyrojnë nivelin e zhvillimit për aktivitetet e ndryshme siç përshkruhet më poshtë:

Notimi 0: Veçoria nuk është krijuar apo mezi funksionon

Nuk ka asnjë aktivitet apo funksion, ose veçoria ekziston vetëm në emër.

Notimi 1: Niveli bazik

Veçoria ekziston, por është shumë themelor. Për shembull, një ISA kryen auditime të performancës, por ato janë aq të parregullta sa që nuk ka qasje sistematike. Nuk është fituar përvoja dhe njohuritë e duhura, dhe kjo reflektohet në cilësinë e punës.

Notimi 2: Niveli i zhvillimit

Veçoria ekziston dhe ISA ka filluar të zhvillojë dhe zbatojë strategji dhe politika përkatëse, por këto nuk janë të plota dhe nuk zbatohen rregullisht. Për shembull, ISA mund të ketë një plan veprimi strategjik dhe zhvillimor, një strategji të burimeve njerëzore dhe një strategji komunikimi. Megjithatë, nëse këto janë të dobëta dhe/ose zbatohen vetëm pjesërisht, kjo do të reflektohet në rezultat.

Notimi 3: Niveli i përforcuar

Veçoria funksionon gjerësisht siç pritej sipas SNISA-ve (nivelet 1-3). Nën Domenin C, kjo do të nënkuptojë se për auditimin e pajtueshmërisë, financiar dhe të performancës janë ndërmarrë dhe janë ndjekur gjerësisht parimet në nivelin 3 në kuadër të SNISA-ve. Një pjesë e madhe e pasqyrave financiare të marra i nënshtrohen auditimit financiar. Raportet e auditimit japin një pamje tërësore mbi përdorimin e të gjitha burimeve publike dhe mbi performancën e organeve të audituara. Shumica e raporteve të auditimit publikohen në një format që është i përshtatshëm për audiencën e synuar.

Notimi 4: Niveli i menaxhuar

Ky tipar funksionon duke ndjekur parimet në SNISA (nivelet 1-3) dhe ISA i zbaton aktivitetet në një mënyrë që i mundëson vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tij. Për Domenin C, auditimet e pajtueshmërisë, financiare dhe të performancës kryhen të gjitha duke ndjekur parimet në nivelin 3 në kuadrin SNISA-ve dhe shihen si vlerë e shtuar nga klientët e auditimit. Përveç kësaj, ISA ka ndërmarrë një rishikim të pavarur të praktikave të tij të auditimit, për shembull duke përdorur Mjetin e Vlerësimit të Pajtueshmërisë ISSAI (iCAT), duke konfirmuar se praktikat e auditimit të ISA-s përputhen me SNISA të nivelit 4.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se edhe me një rezultat të lartë, duhet të jetë gjithashtu e qartë se ISA bën përpjekje për të ruajtur këtë nivel të performancës. Kjo përshkruhet në narrativë dhe përfshihet në analizën e performancës.

Kapitulli 3: Informata për vendin dhe ZKA-në

Ky kapitull ofron informata për Republikën e Kosovës dhe ZKA-në si institucion suprem i auditimit. Ky informacion do t'i shërbej lexuesit për të kuptuar performancën e ZKA-së dhe karakteristika tjera të saj thelbësore në një kontekst më të gjerë.

3.1 Përshkrimi i qeverisjes së vendit dhe mjedisit më të gjerë në të cilin operon ZKA-ja

Republika e Kosovës gjendet në Evropën jug-lindore dhe ka një sipërfaqe prej 10.905.25 km². Ka shpallur pavarësinë e vendit në vitin 2008, dhe nga aspekti administrativ qeverisja është e ndarë në dy nivele: atë qendror dhe lokal.

Shteti i Kosovës karakterizohet me strukturë shumë të re të popullsisë, ku mosha mesatare është 30.2 vjet. Numri total i popullsisë në Kosovë rreth 1.8 milionë nga të cilët 920.543 apo 51% janë femra dhe

877.645 apo 49% janë meshkuj. Duke qenë vendi me moshën më të re në Evropë, popullsia vlerësohet burim për prosperitetin e ardhshëm të vendit. Popullsia është e koncentruar në 1.469 vendbanime të organizuara sipas ligjeve të vendit.

Sipas të dhënave nga Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe vlerësimit të PEFA-s, rritja reale ekonomike në Kosovë është luhatur rreth 3.4% në vitin 2018 dhe 4.8% në vitin 2019. Kjo ishte vazhdimësi e zhvillimit ekonomik dhe u bazua në përmirësimin e kushteve të kreditimit, rritjen e të ardhurave nga jashtë (remitancat dhe kompensimin e punëtorëve) dhe konsumi dinamik (privat dhe publik). Nga ana tjetër, viti 2020 performoi ndryshe nga ky trend ekonomik, por kjo ishte kryesisht për shkak të ndikimit ekonomik të distancimit social dhe COVID-19.

Bazuar në të dhënat preliminare tremujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Bruto Produkti Vendor (BPV) reale gjatë vitit 2020 ka shënuar rënie për 3.9% krahasuar me vitin paraprak. Kjo ka ardhur kryesisht nga një rënie e ndjeshme e investimeve me 19% në vit (si private ashtu edhe publike) dhe uljes së eksporteve të shërbimeve me 41.4%. Kjo rënie vjen kryesisht si pasojë e pasigurive të krijuara për shkak të masave kufizuese të shkaktuara nga situata e krijuar nga pandemia COVID-19, dhe kufizimeve të udhëtimit.

Në vazhdimësi vendi ka treguar përparim të konsiderueshëm socio-ekonomik që nga shpallja e pavarësisë, dhe me politikat e saj të drejtuara drejt objektivit politik gjithëpërfshirës të integritimit evropian, ajo aspiron të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian (BE).

Rregullimet ligjore dhe rregullative

Pushteti në Republikën e Kosovës është i bazuar në parimin e ndarjes, kontrollit dhe balancimit në mes të pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor.




Figura 2. Ndarja e pushteteve në Republikën e Kosovës

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë. Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandant i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë të Kosovës. Bazuar në Kushtetutën e Kosovës, Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Institucionet e Pavarura të themeluara me kushtetutë janë: Institucioni i Avokatit të Popullit, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Banka Qendrore e Kosovës, Komisioni i Pavarur i Medieve.

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës, i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Ka 120 deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë. Njëzet prej 120 vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Kuvendi i Republikës së Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar. Kuvendi i Republikës së Kosovës i ushtron kompetencat në përputhje me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: miraton Kushtetutën, ligje, rezoluta, deklarata dhe akte të tjera të përgjithshme, vendos ta ndryshojë Kushtetutën, shpall referendum, në pajtim me ligjin, ratifikon traktate ndërkombëtare, miraton buxhetin e Republikës së Kosovës, zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit, zgjedh dhe mund ta shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës, zgjedh Qeverinë dhe mund të shprehë mosbesimin ndaj saj, mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, që në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve i raportojnë Kuvendit, zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në përputhje me Kushtetutën, propozon gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese, mbikëqyr politikën e jashtme dhe politikën e sigurisë, jep pëlqimin për dekretin e Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, vendos për çështjet e interesit të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.

Gjyqësori - Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata. Sistemi i Gjykatave përbehet nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

Qeveria e Republikës së Kosovës përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësive të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. Qeveria merr vendime në pajtim me Kushtetutën dhe me ligje, propozon projektligje dhe ndryshimin e ligjeve ekzistuese dhe akteve të tjera, si dhe mund të jap mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo.

Administrata shtetërore, është aparati organizativ dhe profesional i Qeverisë, që i shërben interesit publik nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave³.

Administrata shtetërore përbëhet nga struktura hierarkie të organizuara, nën drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e Qeverisë. Administrata shtetërore përbëhet nga Zyra e Kryeministrit, sistemet ministrore dhe agjencitë rregullative.

³ Ligji nr. 06/l -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.




Figura 3. Administrata Shtetërore

Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial - Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunitetet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale. Në Republikën e Kosovës janë 38 Komuna.




Figura 4. Qeverisja lokale

3.2 Përshkrimi i mjedisit buxhetor në sektorin publik duke përfshirë menaxhimin e financave publike dhe ndikimi në performancën e ZAK-së

Republika e Kosovës ka 91 OB, prej tyre 53 të nivelit qendror dhe 38 të nivelit lokal (komuna).

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është institucioni kryesor për sa i përket buxhetit dhe Thesari i cili operon nën këtë ministri është përgjegjës për menaxhimin e fondeve të Republikës së Kosovës. Administrata Tatimore dhe Doganat e Kosovës janë dy institucionet që administrojnë me

taksat. Përgjegjësitë e kontrollit janë të organizuara në kontrollet dhe auditimin e brendshëm si dhe kontrollet dhe auditimin e jashtëm të kryera nga Komisionet Parlamentare relevante dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit e cila kryen auditimin e jashtëm të menaxhimit të financave publike bazuar në mandatin e vet kushtetues dhe ligjor.

Buxheti i Kosovës përgatitet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), në koordinim me OB-të, dhe miratohet në fund të vitit nga Kuvendi i Kosovës. Buxheti për vitin e ardhshëm përgatitet gjatë vitit aktual, përmes një vargu veprimesh të njohura si Proces Buxhetor. Në kohën kur Kuvendi miraton ndarjet buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal, këto ndarje buxhetore bëhen ligj i cili quhet Ligji për Buxhetin për atë vit të caktuar. Ky Ligj i Buxhetit i miratuar nga Kuvendi, u ofron organizatave buxhetore autorizim për të shpenzuar apo transferuar fonde publike, deri në kufijtë e caktuar dhe për qëllimet e caktuara sipas ligjit, gjatë një viti të caktuar fiskal.




Figura 5. Procesi i Buxhetit për OB-të

OB-të janë të obliguara të përgatisin dhe të dorëzojnë **Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV)** në Thesar⁴. PFV-të përgatiten brenda 30 ditëve pas përfundimit të vitit fiskal. PFV-të përgatiten në harmoni me LMFPF-në, duke adaptuar Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për raportim financiar të bazuar në para të gatshme. Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Kryesor Administrativ i OB-së janë përgjegjës për dorëzimin e raportit të pa audituar financiar të organizatës buxhetore për vitin përkatës fiskal tek drejtori i përgjithshëm i Thesarit, bashkë me një deklaratë me shkrim se ky Raport Financiar është një pasqyrim i vërtetë dhe i drejtë i transaksioneve financiare të organizatës buxhetore për vitin përkatës fiskal.

Auditori i Përgjithshëm për çdo vit do të auditojë ekzekutimin e buxhetit të shtetit për vitin paraprak fiskal.

⁴ Rregullore MF - nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, Neni 5, Afatet kohore për dorëzimin e raporteve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13258>

Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm shtrihen në të gjitha organizatat buxhetore, autoritetet publike, ndërmarrjet publike si dhe të gjitha fondet dhe programet publike pavarësisht nga mënyra e menaxhimit ose financimit të tyre, duke përfshirë edhe komunat.

Për auditimet e Rregullsisë, Auditori i Përgjithshëm ua dorëzon raportet përfundimtare secilit institucion të audituar si dhe subjektit i cili i përgjigjet drejtpërdrejtë institucioni përkatës, si dhe Ministrin, jo më vonë se me 30 Qershor. Për auditimin e raportit vjetor financiar të Qeverisë lidhur me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i dorëzon Qeverisë një Projekt Raport Vjetor të Auditimit për komentim me apo para 31 Korrikut. Ky raport përfshin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm lidhur me faktin se nëse deklaratat financiare japin një pasqyrë të saktë dhe të drejtë. Auditori i Përgjithshëm dorëzon në Kuvend Raportin Përfundimtar Vjetor të Auditimit, duke përfshirë komentet e Qeverisë, me apo para 31 Gushtit.

Prokurimi Publik- Dy institucionet kyçe për rregullimin e prokurimit publik janë: i) Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) dhe ii). Organi Shqyrtues Publik (OSHP). KRPP është institucioni kryesor qeveritar përgjegjës për rregullimin e funksionit të prokurimit dhe zbatimin e e-prokurimit në Kosovë i cili ka filluar **të aplikohet** që në vitin 2016. Sistemi i prokurimit elektronik në Kosovë është një sistem i centralizuar dhe i unifikuar duke mbuluar të gjitha proceset e mundshme të prokurimit nga planifikimi i prokurimit deri te pagesa. KRPP është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Ligji gjithashtu i jep KRPP-së mandatin për të krijuar dhe mirëmbajtur ueb faqen e prokurimit elektronik duke i ofruar qasje të plotë publikut në të gjitha informatat lidhur me Prokurimin Publik në Kosovë.

Ligji fillestar për Prokurimin Publik është hartuar në vitin 2008. Ligji në fuqi për Prokurimin Publik është nxjerrë në vitin 2011 (nr. 04/L-042) dhe është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligji nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 për harmonizimin e funksionit me direktivat publike të BE-së.

Sipas vlerësimit të PEFA-as , qasja në informacione të plota, të besueshme dhe me kohë të prokurimit është në dispozicion në faqet e internetit të KRPP-së dhe OSHP. Shpërndarja publike e informacionit mbi proceset e prokurimit dhe rezultatet e tyre janë kyçe elementet e transparencës. Një sistem i mirë informacioni është i disponueshëm dhe funksionon në mënyrë efektive në gjenerim dhe qasje publike, të dhëna në kohë dhe të besueshme për transaksionet e prokurimit dhe të gjithë informacionin përkatës pa pagesë.

Kërkesat plotësohen për të gjashtë elementët. Të gjitha informacionet, të dhënat dhe statistikat në lidhje me prokurimin janë të qasshme në faqen e internetit të KRPP-së. Prandaj, rezultati për këtë dimension është vlerësuar me A.

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion i rëndësishëm i sistemit të kontrollit i cili siguron menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Komiteti i Auditimit (KA) është organ këshillëdhënës i menaxhmentit të lartë të Subjekteve të Sektorit Publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm duke siguruar pavarësinë e tyre, vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve dhe siguruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Korniza ligjore për funksionin e auditimit të brendshëm⁵ bazohet në Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Në kuadër të objektivave të Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike është avancimi i AB-së përmes zbatimit të programit për zhvillimin profesional, sigurimit të cilësisë për pajtueshmëri si dhe azhurnimit të kornizës ligjore. Në shërbim të këtij qëllimi Ministria e Financave - Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, në shkurt 2020 ka hartuar Doracakun e Auditimit të

⁵ Ligji për AB ka hyrë në fuqi në shtator 2009 me Ligjin për Auditimin e Brendshëm (Ligji 03/L-128), i cili është shfuqizuar në vitin 2018.

Brendshëm. NjQHAB është koordinatore e gjithë procesit për auditim të brendshëm dhe ndër të tjera monitoron subjekte të sektorit publik për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Rregullimet institucionale për auditimin e brendshëm janë si më poshtë⁶:

- **Njësia Qendrore e Harmonizimit (NjQH)** që operon si departament i veçantë në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është përgjegjëse për auditimin e brendshëm dhe menaxhimin financiar, politikat, udhëzimet për zbatimin e metodologjive përkatëse, monitorimi i zbatimit të kontrollit të brendshëm dhe auditimin e brendshëm, duke vlerësuar kapacitetin dhe procesin në vend. NjQH siguron ngritjen e kapaciteteve të auditorëve të brendshëm. Raport vjetor për veprimtarinë e kontrollin e brendshëm financiar dhe auditimin e brendshëm përgatitet dhe i dorëzohet Qeverisë.
- **42 Njësi të Auditimit të Brendshëm** në organizatat buxhetore të qeverisë qendrore.

Sipas vlerësimit të PEFA-s, auditimi i brendshëm është vlerësuar me B+. **Mbulueshmëria me AB** për vitin 2020 ishte 83% në total shpenzimet e planifikuara dhe 100% në të hyrat.

Sipas Raportit Vjetor të Auditimit të brendshëm për vitin 2020, vlerësohet se auditimet e brendshme vazhdojnë të mbeten të orientuara drejt pajtueshmërisë dhe më pak të përqendruara në auditime të performancës dhe të sistemeve.

Pasqyrat Vjetore Financiare të Qeverisë së Kosovës janë përgatitur në përputhje me LMFPP nr. 03/L-048, dhe duke zbatuar Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP 2017 i aplikueshëm që nga viti 2019) - Raportimi financiar në përputhje me parimin e kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Shënimet në pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e të kuptuarit të pasqyrave. Shpenzimet janë të kategorizuara sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional. Ato aplikohen për qeverinë qendrore dhe organizatat buxhetore të qeverisjes lokale.

Raportet financiare janë përgatitur dhe janë të krahasueshme sipas klasifikimit të përdorur në buxhetin e miratuar. Ato përmbajnë informacion mbi të ardhurat, shpenzimet, financiare dhe pasuritë e prekshme (Aneksi 7 dhe 8 në PVF), detyrimet dhe garancitë dhe a pasqyra e rakorduar e rrjedhës së parasë. Raportet vjetore financiare dorëzohen për auditim të jashtëm brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit fiskal.

Auditimi i jashtëm në Kosovë kryhet nga Auditori i Përgjithshëm dhe ZKA. Auditori i Përgjithshëm i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ka të drejtë të auditojë të gjitha financat, administrative dhe të tjera aktivitetet, programet dhe projektet e menaxhuara nga institucionet publike.

Sipas vlerësimit të PEFA-s, Auditimi i jashtëm është vlerësuar me B+.

ZKA ka analizuar raportet financiare duke përfshirë të hyrat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e pothuajse të gjitha subjekteve të qeverisë qendrore për vitet fiskale 2017, 2018 dhe 2019⁷. Opinione

⁶ PEFA 2020

⁷ Përfshirë buxheti i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Radio Televizionit të Kosovës, Banka Qendrore (e cila auditohet nga një auditor i jashtëm komercial), dhe ZKA*-ja (e cila auditohet nga një auditor i jashtëm- kompani private). Buxheti total i këtyre tre agjencive është i parëndësishëm kur krahasohet me buxhetin total (afërsisht 1%).

e auditimit për të gjitha pasqyrat financiare jepen dhe plotësohen me një përshkrim të mjedisit të kontrollit të brendshëm, përputhshmërinë e prokurimit me kornizën rregullative.

Në Kosovë, roli i **shqyrtimit legjislativ të raporteve të auditimit** i takon Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike⁸. Këto rregulla përcaktojnë se ky organ është, ndër të tjera, përgjegjës për (i) mbikëqyrjen e ligjshmërinë e shpenzimeve të parasë publike bazuar në raportet dhe pasqyrat vjetore dhe periodike të audituara, si dhe si raporte auditimi të ZKA-së; (ii) mbikëqyrjen e raporteve të auditimit të ZKA-së për organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike; (iii) mbikëqyrjen e raporteve të performancës të hartuara nga ZKA; (iv) mbikëqyrjen e shpenzimeve publike, nëpërmjet raportet e agjencive buxhetore, me kërkesë të veçantë të komisionit; (v) detyrat që lidhen drejtpërdrejt me rishikimin e operacioneve të ZKA-së, dhe (vi) organizimi i seancave dëgjimore publike.

Sipas vlerësimit të PEFA-es Shqyrtimi legjislativ i raporteve të auditimit është vlerësuar me C+.

Ndikimi i COVID-19

Në vitin 2020, situata dhe perspektiva ekonomike në Kosovë ndryshoi për shkak të pandemisë COVID-19. Ndikimi në ekonomi dhe masat e marra nga qeveria kanë ndryshuar projeksionet fiskale për këtë vit krahasuar me parashikimet fillestare të buxhetit 2020 duke çuar në një rishikim të buxhetit në mes të vitit. Për më tepër, masa kufizuese gjatë vitit 2020, e cila kufizoi aktivitetin si të individëve, ashtu edhe të bizneseve, kontribuoi në uljen e konsumit të mallrave që janë të prirur ndaj akcizës si benzina, alkooli dhe duhani ndër të tjera. Prandaj, përgjigja ndaj COVID-19 dhe rënia ekonomike në vitin 2020, pati një ndikim të drejtpërdrejtë në devijimin midis parashikimeve dhe të ardhurave aktuale të mbledhura.

3.3 Përshkrimi i kuadrit ligjor dhe institucional të ZKA-së, strukturës organizative dhe burimeve

Siç u tha më lartë, Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar dhe Zyra Kombëtare e Auditimit mbështet Auditorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. ZKA-ja, kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik të Republikës së Kosovës. Mandati dhe detyrat e Auditorit të Përgjithshëm janë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Organizimi i ZKA-së është i rregulluar me aktet e brendshme nënligjore. Fokusi i menaxhmentit është vendosur në zhvillimin dhe promovimin e kapaciteteve të personelit përmes vendosjes së politikave dhe proceseve, të cilat promovojnë qeverisjen e përbashkët të bazuara në vlera dhe kontribute. Personeli është i trajnuar dhe certifikuar, dhe me përvojë solide për të adresuar zbatimin e Planit Strategjik dhe Planeve operative të ZKA-së.

⁸ Fushëveprimi dhe kompetencat e tij përcaktohen me Rregulloren e Punës të Kuvendi (2010)




Figura 6. Skema organizative e ZKA-së

Auditori i Përgjithshëm i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe **ka të drejtë të kontrollojë** të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike duke përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e aseteve, privatizimet dhe koncesionet. Raportet e auditimit të ZKA-së ofrojnë një bazë solide për të mbajtur përgjegjës menaxherët e çdo organizate buxhetore, për të promovuar llogaridhënien, për të rritur besimin e publikut në shpenzimin e fondeve publike dhe për të luajtur një rol aktiv në garantimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit.

Në përputhje me mandatin e vet ligjor, ZKA-ja kryen: auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) të organizatave buxhetore (ministritë, institucionet e pavarura dhe komunat) sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme; të Ndërmarrjeve Publike, sipas kontabilitetit të bazuar në akruale; të projekteve të financuara nga donatorët dhe institucioni financiar ndërkombëtar; auditime të performancës, sistemeve, operacioneve, programeve, aktiviteteve apo organizatave të qeverisë. Auditori i Përgjithshëm mund të angazhojë çdo person, firmë ose institucion tjetër suprem të auditimit për të ndihmuar në kryerjen e ndonjë prej detyrave të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Për ta bërë këtë, duhet të respektohen standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht, si dhe standardet e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Auditori i Përgjithshëm është përgjegjës për rezultatet dhe cilësinë e punës së kryer.

Gjatë sezonit të auditimit 2020/21, ZKA-ja ka kryer 127 auditime, ku përfshihet raporti financiar vjetor i buxhetit të Republikës së Kosovës; 90 organizata buxhetore (25 prej të cilave janë kontraktuar me një kompani private); 12 ndërmarrje publike; 11 auditime të performancës; dhe 13 projekte të financuara nga Banka Botërore dhe SIDA.

Burimet njerëzore janë aseti kryesor i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Aktualisht, ajo ka gjithsej 171 punonjës, 142 ose 83%, staf auditues duke përfshirë pozicionet drejtuese dhe 29, ose 17%, staf mbështetës auditimi dhe staf mbështetës profesional dhe administrativ. Objektivi kryesor në konceptin e menaxhimit është forcimi i qasjes korporative dhe investimi në zhvillimin e kompetencës profesionale të stafit.

Burimi kryesor i financimit të ZKA-së është buxheti i Republikës së Kosovës. Siç është paraqitur në tabelën 1, për vitin 2020 buxheti i ndarë ishte 3,084 milionë euro. Gjithashtu, ZKA merr donacione dhe grante për të mbështetur aktivitete dhe funksione specifike, ndërsa të ardhurat nga auditimet e projekteve, të financuara nga donatorët, derdhen në buxhetin e shtetit dhe përdoren për trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit të ZKA-së.

Tabela 1. Buxheti i ZKA-së për vitin 2020

Raporti i buxhetit për vitin 2020				Mil€
	Buxheti fillestar	Buxheti final	Buxheti i shpenzuar	% i shpenzuar
Totali	3,115	3,084	3,041	99%

Kapitulli 4: Vlerësimi i performancës së ZKA-së

Në këtë kapitull paraqiten informata mbi vlerësimin e elementeve kyçe të performancës së ZKA-së, të matura sipas treguesve të përcaktuar në KMP. Rezultatet nga vlerësimi nxjerrin në pah progresin, praktikat e mira dhe synimet e ISA-s si dhe dobësitë dhe nevojën për përmirësim.

4.1 Domeni A: Pavarësia dhe Korniza Ligjore

Në **Domenin A** vlerësohet mandati dhe pavarësia e institucionit. Qëllimi i këtij domeni është të marrë në konsideratë bazën institucionale për operacionet e saj, për të mbështetur të kuptuarit se si ZKA-ja funksionon si organizatë. Pavarësia dhe korniza ligjore e një institucioni suprem të auditimit nuk janë drejtpërsëdrejti nën kontrollin e saj, megjithatë, kontribuojnë ndjeshëm në efektivitetin e institucionit, prandaj edhe kanë një rëndësi të veçantë në kuadër të këtij vlerësimi.

Domeni A: Pavarësia dhe Korniza Ligjore		Dimensioni				Rezultati i përgjithshëm
Treguesi	Emri	i	ii	iii	iv	
SAI-1	Pavarësia e ZKA-së	4	1	4	4	3
SAI-2	Mandati i ZKA-së	3	4	4		3

4.1.1 SAI-1: Pavarësia e ZKA-së – Rezultati (3)

Treguesi SAI-1 mat nivelin e pavarësisë që gëzon ISA, duke vlerësuar aspektet kyçe të pavarësisë siç janë të përcaktuara në Deklaratën e Limas (ISSAI 1) dhe Deklaratën e Meksikës (ISSAI 10).

Ky tregues mbulon katër dimensione siç janë:

- (i) Korniza kushtetuese e përshtatshme dhe efektive;
- (ii) Pavarësia/ autonomia financiare;
- (iii) Pavarësia/ autonomia organizative;
- (iv) Pavarësia e kreut të ISA-së dhe zyrtarëve të saj.

Për vlerësimin e indikatorit SAI-1 janë marrë për bazë Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligji 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, si dhe në ligje, rregullore e dokumente tjera relevante. Pashmangshmërisht janë marrë në shqyrtim standardet **ISSAI 1**, **ISSAI 10**, **ISSAI 12** dhe **ISSAI 20**.

Dimensioni (i): Korniza kushtetuese e përshtatshme dhe efektive

Bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit mes tyre, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e kategorizon Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës në kapitullin XII - Institucionet e Pavarura. Nenet 136, 137 dhe 138 rregullojnë parimet mbi të cilat mbështet veprimtaria e institucionit si dhe përcaktojnë qartë mandatin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Gjithashtu Kushtetuta përcakton që Auditori i Përgjithshëm i Kosovës zgjidhet nga Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Më tutje paragrafi i dytë i nenit 136 e rregullon që organizimi i brendshëm, kompetencat dhe administrimi i zyrës së Auditorit të Përgjithshëm përcaktohen me Kushtetutë dhe me ligj. Kjo më tutje rregullohet me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055.

Në kuptim të interpretimit të rregullimit kushtetues ekipi ka vlerësuar se Auditori i Përgjithshëm i Kosovës është institucion i pavarur kushtetues me mandat, kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë. Gjithashtu, sipas nenit 136, paragrafi 1 të Kushtetutës Institucioni i Auditorit të Përgjithshëm, në këtë rast Zyra Kombëtare e Auditimit e cila udhëhiqet nga Auditori i Përgjithshëm, është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar.

Emërimi, mandati dorëheqja, suspendimi dhe shkarkimi i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës përcaktohen në nenin 136 paragrafin 3 dhe 4 të Kushtetutës dhe më tej në nenin 4. Paragrafët 4, 10, 11, 12, dhe 13 të ligjit.

Edhe Ligji nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, i siguron Auditorit të Përgjithshëm pavarësi nga ana funksionale, financiare dhe operative dhe se nuk i nënshtrohet urdhrimit ose ndikimit nga cilido person apo institucion tjetër. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Auditori i Përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave kushtetuese e ligjore.

Megjithatë, ekipi i vlerësimit ka vërejtur se ekzistojnë kundërthënie në mes të disa neneve të ligjit të cilat lënë hapësirë për interpretime të ndryshme për sa i përket ushtrimit të mandatit në mënyrë të pavarur dhe pavarësisë së plotë financiare. Edhe pse në praktikë, nuk ka asnjë rast kur ekzekutivi ka ndërhyrë në buxhetin e ZKA-së apo mënyrën e menaxhimit me buxhetin e miratuar.

Kjo është e theksuar në dispozitat e nenit 4.3 dhe 18.3, ku njeri nen i jep Auditorit të Përgjithshëm mandat të gjerë dhe liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave, përderisa neni tjetër e obligon të bëjë auditime të përvitshme të rregullsisë për të gjitha organizatat buxhetore (pavarësisht madhësisë, kompleksitetit, rrezikut, et.) Kjo kërkesë krijon barrë për institucionin dhe bie në kundërshtim me parimet themelore të përcaktuara me nenin 137 të Kushtetutës dhe me vet ligjin.

Sipas nenit 23.8 të ligjit, Auditori i Përgjithshëm mundet në çdo kohë t'i drejtohet Kuvendit për çdo çështje brenda mandatit të vet.

Mbi këtë bazë Auditori i Përgjithshëm ka njoftuar Kuvendin dhe disa herë ka marrë iniciativën duke mbajtur takime me Kryetarin e Kuvendit dhe Kryetarët e Komisioneve Parlamentare relevante për të adresuar nevojën e ndryshim-plotësisimit të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055.

Një grup i autorizuar nga Auditori i Përgjithshëm ka analizuar këto dobësi dhe ka hartuar një koncept dokument ku ka paraqitur të gjitha çështjet e identifikuar, i njëjti i është dorëzuar Auditorit të Përgjithshëm si dhe i është dërguar edhe Kuvendit.

Nevoja për ndryshim-plotësimin e ligjit është adresuar edhe në Raportin e Progresit për vendin sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Auditori i Përgjithshëm përmes kornizës së brendshme normative e ka të materializuar pavarësinë kushtetuese. Pas nxjerrjes së Aktgjykimit (KO203/19) të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, është rikonfirmuar pavarësia funksionale dhe organizative e Auditorit të Përgjithshëm në Kushtetutën e Kosovës. Ky aktgjykim përcakton qartë ndarjen e pushteteve, të ekzekutivit kundrejt pavarësisë së institucioneve të pavarura përfshirë Auditorin e Përgjithshëm.

Edhe në praktikë ekipi nuk ka vërejtur ndërhyrje në pavarësinë funksionale dhe organizative të ZKA-së. Të gjitha proceset e brendshme organizative dhe proceset e punësimit janë kryer në harmoni me kornizën e brendshme rregullative.

Dimensioni (ii): Pavarësia financiare

Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, në disa nene e rregullon pavarësinë financiare të Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit por disa dispozita janë në kundërshtim me Deklaratën e Limas dhe Deklaratën e Meksikës për sa i përket pavarësisë së plotë financiare. ZKA-ja financohet nga Buxheti i shtetit dhe ndjek procesin buxhetor siç përshkruhet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048. Edhe pse ky ligj në nenin 65, rregullon procesin e buxhetimit për institucionet e pavarura duke ju siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së pavarësisë financiare, dhe në praktikë nuk ka asnjë rast kur ekzekutivi ka ndërhyrë në mënyrën se si ZKA-ja e menaxhon dhe shpenzon buxhetin e miratuar, kjo nuk është e mjaftueshme përderisa propozimi i buxhetit duhet të kalojë përmes Qeverisë dhe ligji organik i ZKA-së nuk ofron kurrfarë mbrojtje nga ndërhyrja. Në nenin 13 paragrafin 4 i jep të drejtë Qeverisë të ndryshojë apo modifikojë propozimin buxhetor të ZKA-së duke e njoftuar Kuvendin për këtë.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, është kompetencë e Kuvendit të miratojë Buxhetin e Republikës së Kosovës. Edhe buxheti i ZKA-së është i integruar në Ligjin 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Pas miratimit të buxhetit ZKA-ja menaxhon me buxhetin e vet në mënyrë të pavarur. Në tri vitet e fundit nuk ka pasur asnjë rast të ndërhyrjes nga ekzekutivi.

AP ka adresuar edhe këtë shqetësim në Kuvend që të adresohet përmes ndryshim-plotësimit të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, që edhe rregullimit ligjor të sigurohet pavarësia financiare e ZKA-së në të gjitha aspektet.

Dimensioni (iii): Pavarësia organizative

Korniza ligjore i siguron Auditorit të Përgjithshëm pavarësinë funksionale dhe organizative për të zbatuar mandatin e vet.

Ligji 05/L-055 në nenin 4 e rregullon pavarësinë funksionale dhe operative të Auditorit të Përgjithshëm. Në nenin 10 paragrafët 1 dhe 2 të ligjit thuhet se AP përcakton me rregullore të brendshme organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së dhe miraton rregullore dhe udhëzues të brendshëm për funksionimin e zyrës. Më tej në nenin 15, paragrafin 2 thuhet se AP nxjerr rregullore dhe udhëzues për mënyrën e trajtimit të të gjitha çështjeve në lidhje me Burimet Njerëzore (BNj).

Edhe në praktikë është evidente se AP është i pavarur në ushtrimin e mandatit të vet në aspektin organizativ të institucionit dhe përmes kornizës së brendshme normative ka të rregulluar strukturën organizative dhe specifikat lidhur me marrëdhënien e punës për secilin punonjës. Gjithashtu, AP mund të angazhojë persona apo firma të kualifikuara apo institucion tjetër suprem nëse ka nevojë.

Gjatë vitit 2021, nuk janë shënuar raste të ndonjë ndërhyrje nga palët e treta në menaxhimin dhe organizimin e zyrës. Përmes kornizës së brendshme normative Auditori i Përgjithshëm ka rregulluar strukturën organizative dhe specifikat lidhur me marrëdhënien e punës për secilin punonjës.

Duhet theksuar se Aktgjykimi (KO203/19) i Gjykatës Kushtetuese lidhur me vlerësimin e kushtetueshmërisë së Ligjit 06/L-114 ka rikonfirmuar pavarësinë funksionale dhe organizative të Auditorit të Përgjithshëm në Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Përgjegjshmëria dhe transparenca është e rregulluar në ligjin 05/L-055, sipas nenit 7 të të cilit, ZKA-ja duhet të publikojë të gjitha raportet individuale të auditimit, RVA-në, RVP-në e Z i cili përfshin edhe PFV-të e audituara, udhëzuesit dhe rregulloret e brendshme, si dhe informacione tjera lidhur me zyrën dhe aktivitetet e saj. ZKA-ja në praktikë synon të promovojë dhe të rris në vazhdimësi transparencën dhe publikon në ueb faqen e saj të gjitha informacionet siç kërkohet me ligj dhe mëton të mbaj një komunikim proaktiv me publikun dhe palët e interesit.

Dimensionin (iv): Pavarësia e kreut dhe zyrtarëve të institucionit

Kushtet për emërimin dhe shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm janë të specifikuara në Kushtetutë dhe Ligjin 05/L-055.

Sipas Kushtetutës, neni 136.3, Auditori i Përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, për një mandat pesë vjeçar, me të drejtë rizgjedhje vetëm edhe për një mandat. Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm, sipas përcaktimit kushtetues përfshinë edhe institucionin e Presidentit të vendit, i/e cila duhet t'i propozoj Kuvendit një kandidaturë për miratim.

Edhe në kuptim të procedurës së shkarkimit, paragrafi 4 i po këtij neni, përcakton që vendimi për shkarkimin të AP-së merret nga Kuvendi me shumicë të kualifikuar prej dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve. Në prill të vitit të kaluar ish Auditori të Përgjithshëm i ka përfunduar mandati. Zyra e Presidentes kishte bërë shpallje publike dhe pas një procesi të hapur dhe konkurrues i ka propozuar Kuvendit kandidatin e suksesshëm siç përcaktohet me Kushtetutë dhe ligj. Me qëllim të ritjes së transparencës në proces të përzgjedhjes dhe në përpjekje për të siguruar që në krye të institucioneve të rëndësishme të veçantë të vendosen njerëz profesional dhe të pavarur, Zyra e Presidentes kishte aplikuar Memorandumin e Mirëkuptimit që Kuvendi i Kosovës ka të lidhur me Ambasadën Britanike, dhe kishte ftuar për vlerësim të kandidatëve edhe kompaninë e pavarur e angazhuar nga Ambasada Britanike. Pasi procesi ishte mbyllur me sukses, me propozimin e Presidentes, në gusht të vitit 2021, Kuvendi kishte emëruar Auditorin e re të Përgjithshme të Kosovës.

Asnjëherë nuk ka ndodhur që Kuvendi të shkarkojë një Auditor të Përgjithshëm.

Sipas nenit 27.1 të ligjit 05/L-055 Auditori i Përgjithshëm, Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, Ndhmës Auditorët e Përgjithshëm dhe personeli tjetër i autorizuar për të kryer auditim është plotësisht i pavarur dhe i mbrojtur ligjërisht gjatë ushtrimit të detyrave të tyre ligjore.

Gjetjet dhe vëzhgimet e vlerësimit

Dimensionin	Gjetjet	nota
(i) Korniza kushtetuese e përshtatshme dhe efektive	Kriteret: a, b,c, d, e, f, g, janë përmbushur. Korniza kushtetuese e Kosovës e Përcakton Auditorin e Përgjithshëm si institucion të pavarur dhe rregullon parimet mbi të cilat mbështet veprimtaria e institucionit si dhe përcakton qartë mandatin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar	4

(ii) Pavarësia financiare	Kriteret a, c, f, nuk janë përmbushur, ndërsa kriteret: a, b, d, e, g janë përmbushur. Korniza ligjore nuk i siguron ZKA-së pavarësi të mjaftueshme financiare dhe është në kundërshtim me Deklaratën e Limes dhe Deklaratën e Meksikës. Edhe pse në praktikë nuk ka ndonjë rast të ndërhyrjes nga ekzekutivi, kjo nuk është e mjaftueshme.	1
(iii) Pavarësia Organizative	Kriteret: a, b, c, d, e, f, g, janë përmbushur. Korniza ligjore i siguron Auditorit të Përgjithshëm pavarësinë funksionale dhe organizative për të zbatuar mandatin e vet.	4
(iv) Pavarësia e kreut dhe zyrtarëve të institucionit	Kriteret: a, b, c, d, e, f, g janë përmbushur. Sipas kornizës ligjore Auditori i Përgjithshëm, Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, Ndhmës Auditorët e Përgjithshëm dhe personeli tjetër i autorizuar për të kryer auditim është plotësisht i pavarur dhe i mbrojtur ligjërisht gjatë ushtrimit të detyrave të tyre ligjore.	4

4.1.2 SAI-2: Mandati i ZKA-së – Rezultati [3]

Treguesi SAI-2 ka për qëllim të vlerësojë gjerësinë e mandatit të ZKA-së për sa i përket fushës, natyrës së detyrave dhe përgjegjësi të kreut të institucionit si dhe ISA-it. Si dhe të drejtën për qasje në të gjitha informatat që i duhen për të përmbushur funksionet e veta dhe të drejtën dhe detyrimin për të raportuar.

Treguesi ka tri dimensione:

- (i) Mandat mjaftueshëm i gjerë.**
- (ii) Qasja në informacion.**
- (iii) E drejta dhe detyrimi për të raportuar.**

Për vlerësimin e indikatorit SAI-2 janë marrë për bazë Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligji nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit; Ligji nr.05/L-209 për Bankën Qendrore; Ligji nr.03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë; Ligji nr.05/L-101 për Fondin e Kursimeve Pensionale; Ligji nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Ligji nr.05/L-120 për Trepçën; si dhe standardet ISSAI 1 dhe ISSAI 10.

Dimensioni (i): Mandati

Kushtetuta në nenin 137 përcakton fushëveprimin dhe rregullon gjerësinë e shtrirjes së kompetencave të institucionit të Auditorit të Përgjithshëm, duke i dhënë tagrin që të ushtrojë kontroll financiar ndaj të gjitha veprimtarive ekonomike të të gjitha institucioneve publike dhe organeve tjera shtetërore. Sipas komentarit të Kushtetutës së Kosovës, kontrolli i institucionit të AP-së shtrihet ndaj të gjitha institucioneve që ushtrojnë pushtet publik apo shtetëror. Së dyti neni në fjalë autorizon AP-në që të kontrollojë mënyrat e përdorimit të fondeve publike nga ana e pushtetit qendror dhe lokal, si dhe të

mbrojtje fondet në fjalë nga menaxhimi jo i duhur i tyre nga institucionet e lartpërmendura. Së treti, sipas këtij neni, juridiksioni i AP-së shtrihet edhe në ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë ekonomike të NP-ve, dhe personave juridik ku shteti ka një pjesë të aksioneve, pa përjashtuar personat juridik, huatë, kreditë dhe detyrimet rrjedhëse të të cilave janë të garantuara nga shteti. Pra, kompetenca e AP-së për të ushtruar funksionin e kontrollit financiar dhe veprimtarive ekonomike, përfshinë një numër të madh të institucioneve dhe personave juridik të cilët menaxhojnë pjesë të fondeve publike⁹.

Sipas Ligjit nr.05/055, neni 18, Zyra Kombëtare e Auditimit ka të drejtë t'i auditojë të gjitha aktivitetet financiare administrative dhe të tjera, programe dhe projekte të menaxhuara nga një apo më shumë institucione, përfshirë proceset dhe të ardhurat nga shitja e pasurive, privatizimi dhe koncesionet dhe t'i përcjell fondet publike deri tek përfituesi i fundit. ZKA-ja gjithashtu mund të kryej auditime të detyrueshme të rregullsisë në ndërmarrjet publike si dhe mund të kryej auditime të fondeve të donatorëve dhuruar një entiteti, pas kërkesës nga ndonjë shtet apo organizatë donatore. Më tej, në nenin 19 ligji e rregullon që auditimet kryhen në pajtim me ligjin dhe standardet e auditimit për sektorin publik, ndërsa në nenin 21 ligji rregullon llojet e auditimit.

Ligji përcakton në mënyrë specifike se ZKA-ja është e obliguar të kryej në baza vjetore auditimin e detyrueshëm të rregullsisë së:

- Raportit të Qeverisë për buxhetin e Kosovës;
- Të gjitha OB-të të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë pranuar një buxhet përmes Ligjit vjetor të Buxhetit dhe janë të obliguara të hartojnë pasqyra financiare vjetore.

Megjithatë, disa ligje në fuqi për institucione të caktuara ndjekin një frymë përjashtuese për Auditorin e Përgjithshëm, siç janë Ligji 03/L209 për bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (neni 63 dhe 73); Ligji 05/L-120 për Trepçën; Ligji 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (ndryshuar dhe plotësuar; Ligji 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, të cilat kundërshtojnë plotësisht parimet dhe dispozitat kushtetuese përkatëse lidhur me mandatin e Auditorit të Përgjithshëm. Prandaj, ligjvënësi përmes ligjeve të lartpërmendura, ka bërë reduktime në kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm për auditim të jashtëm. Sipas nenit 23.8 të Ligjit 05/L-055 Auditori i Përgjithshëm mundet, në çdo kohë, t'i drejtohet Kuvendit për çdo çështje brenda mandatit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Auditori i Përgjithshëm e ka adresuar këtë çështje në Kuvend dhe synon që përmes plotësim-ndryshimit, ligjit 05/L-055 t'i jap fuqi juridike ndaj ligjeve tjera sipas mandatit kushtetues. Me përjashtim të obligimit që krijon neni 18.3 për auditimin e rregullsisë të të gjitha organizatave buxhetore në baza vjetore, Auditori i Përgjithshëm, ka liri të plotë në përcaktimin e llojeve të auditimit, raportimin dhe caktimin e auditimeve përcjellëse. E miraton planin vjetor të auditimit dhe zbaton këtë plan pa ndonjë ndërhyrje nga jashtë.

Në tri vitet e fundit ZKA-ja nuk ka pranuar asnjë kërkesë që cenon mandatin e saj kushtetues dhe ligjor.

Me kërkesë të shkruar nga Kuvendi apo Qeveria, Auditori i Përgjithshëm mund të kryej auditime shtesë, por sipas nenit 4 paragrafit 3 të ligjit është në dorën e AP të vlerësojë dhe vendosë nëse duhet të kryej një auditim apo jo. Në praktikë ZKA-ja, gjatë procesit të hartimit të planit vjetor të auditimit, organizon takime publike me përfaqësues të Kuvendit, Shoqërisë Civile dhe mediave për të diskutuar dhe identifikuar temat me interes për auditimet e performancës pastaj AP vendos për planin e auditimit në mënyrë dhe për kapacitetet për të realizuar atë. Plani i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së.

Dimensionii (ii): Qasja në informata

⁹ Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ligji nr.05/L-055, neni 25, i jep Auditorit të Përgjithshëm qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit. Sipas këtij neni, Auditori i Përgjithshëm apo personi i autorizuar nga ai ka qasje dhe liri të plotë të auditojë, në çdo kohë të arsyeshme, prona ose dokumente në çfarëdo forme, të kërkojë informacion apo dëshmi relevante si dhe të verifikojë dhe dokumentojë saktësinë e tyre.

Gjithashtu sipas nenit 26, zyrtaret e autorizuar nga AP mundën në çdo kohë të arsyeshme të hyjnë dhe të qëndrojnë në objektet e entitetit ose institucionit i cili është i caktuar që të auditohet.

Për më tepër nëse një zyrtar i autorizuar që vepron nën autoritetin e AP-së hyn, ose vendos që të hyjë në objektet e entitetit, atëherë entiteti do t'ia mundësojë zyrtarit në fjalë që t'iu qaset të gjitha objektet të cilat janë të arsyeshme për ta ushtruar autoritetin dhe detyrat e ZKA-së.

Sipas nenit 28 të ligjit, zyrtarët e entiteteve të audituara janë të obliguar t'i përgjigjen kërkesave të auditorëve të ZKA-së, të cilat kanë lidhje me auditimin.

Personi përgjegjës nuk lirohet nga përgjegjësia për të ofruar ndonjë dokument apo për t'iu përgjigjur pyetjeve specifike me justifikimin se ofrimi i këtij dokumenti apo përgjigja mund ta implikojë atë apo ta bëjë atë përgjegjës para ligjit.

Nga vlerësimi i praktikës së deritanishme ekipi nuk ka identifikuar asnjë rast kur zyrtarëve të autorizuar nga Auditori i Përgjithshëm u është mohuar e drejta e qasjes në informata. Por në rast se diçka e tillë ndodh, çështja trajtohet sipas Kodit Penal të Kosovës.

Dimension (iii) Të drejtat dhe obligimet për të raportuar

Sipas nenit 138 të Kushtetutës, Auditori i Përgjithshëm duhet t'i paraqes Kuvendit raportin për zbatimin e buxhetit të shtetit, mendimin për raportin e PFV-e të Qeverisë para se ato të miratohen nga Kuvendi si dhe informacione për rezultatet e auditimit sa herë që kërkohen nga Kuvendi. Gjithashtu, Auditori i Përgjithshëm duhet t'i paraqes Kuvendit raportin vjetor për veprimtarinë e vet.

Më tutje Ligji 05/L-055, në nenin 23, përshkruan në mënyrë specifike mënyrën e raportimit për të gjitha raportet e auditimit, ndërsa neni 7 obligon Auditorin e Përgjithshëm të jetë transparent dhe të publikojë në ueb faqen e vet të gjitha raportet e auditimit, raportin për performancën e zyrës duke përfshirë PFV-të e audituara, udhëzuesit dhe rregulloret e brendshme si dhe informacione tjera në lidhje me zyrën dhe aktivitetet e saj. Afatet e raportimit për auditimet e rregullsisë përcaktohen me këtë ligj dhe me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ndërsa për llojet tjera të auditimit Auditori i Përgjithshëm është i lirë të vendosë për kohën e raportimit.

ZKA-ja i dorëzon secilin raport final të auditimit institucionit të audituar dhe Kuvendit të Kosovës, dhe raportet publikohen në ueb faqe një ditë pas dorëzimit. Në rastet kur institucioni i audituar është një komunë, raporti final i auditimit i dorëzohet edhe Kuvendit Komunal përkatës.

Përmbajtja e raportit të auditimit është rezultat i punës audituese nga ekipi dhe rishikimit sipas hierarkisë i cili miratohet nga Auditori i Përgjithshëm. Në këtë aspekt nuk ka asnjë ndërhyrje. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk pengon ose ndikon, dhe as që mund të interpretohet për të penguar ose ndikuar në kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm për ekzekutimin e auditimit ose për organizimin e një auditimi të jashtëm dhe të pavarur të një organizate buxhetore, autoriteti publik ose ndërmarrje publike, në çdo kohë.

Çdo institucion i audituar, brenda 30 ditësh të pranimit të raportit të auditimit duhet t'i dorëzon ZKA-së një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga AP.

Auditori i Përgjithshëm prezanton çdo vit raportin vjetor të auditimit në seancë plenare të Kuvendit.

RVA-ja për vitin fiskal 2020 u prezantua nga Auditori i Përgjithshëm në seancën plenare me 22 nëntor 2021. Me këtë rast ajo ka theksuar se:

Në tri vitet e fundit nuk ka pasur asnjë rast të ndërhyrjes nga jashtë sa i përket përmbajtjes së raporteve të auditimit apo kohës për raportim dhe publikimit të raportit.

Gjetjet dhe vëzhgimet e vlerësimit

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Mandat mjaftueshëm i gjerë.	<p>Kriteret: b, c, e, f, g, h, i, janë përmbushur; kriteret: a dhe d nuk janë përmbushur.</p> <p>Me përjashtim të obligimit që krijon neni 18.3 për auditimin e rregullsisë të të gjitha organizatave buxhetore në baza vjetore, Auditori i Përgjithshëm, ka liri të plotë në përcaktimin e llojeve të auditimit, raportimin dhe caktimin e auditimeve përcjellëse.</p> <p>Gjithashtu, disa ligje në fuqi për institucione të caktuara ndjekin një frymë përjashtuese për Auditorin e Përgjithshëm, siç janë Ligji 03/L209 për bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (neni 63 dhe 73); Ligji 05/L-120 për Trepçën; Ligji 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (ndryshuar dhe plotësuar; Ligji 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, të cilat kundërshtojnë plotësisht parimet dhe dispozitat kushtetuese përkatëse lidhur me mandatin e Auditorit të Përgjithshëm.</p> <p>Sipas nenit 23.8 të Ligjit 05/L-055 Auditori i Përgjithshëm mundet, në çdo kohë, t'i drejtohet Kuvendit për çdo çështje brenda mandatit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.</p>	3
(ii) Qasja në informata	<p>Kriteret: a, b, c, dhe e janë të përmbushura, ndërsa kriteri d nuk aplikohet</p> <p>Ligji nr.05/L-055, neni 25, i jep Auditorit të Përgjithshëm qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit. Sipas këtij neni AP apo personi i autorizuar nga ai ka qasje dhe liri të plotë të auditojë, në çdo kohë të arsyeshme, prona ose dokumente në çfarëdo forme, të kërkojë informacion apo dëshmi relevante si dhe të verifikojë dhe dokumentojë saktësinë e tyre.</p>	4
(iii) Të drejtat dhe obligimet për raportim	<p>Kriteret: a, b, c, d, e, f, g janë të përmbushura</p> <p>Edhe Kushtetuta edhe Ligji rregullojnë në mënyrë specifike të drejtat dhe obligimet për raportim. Në praktikë të gjitha kërkesat zbatohen.</p>	4

4.2 Domeni B: Qeverisja e brendshme dhe etika

“Në **Domenin B** vlerësohet performanca e ISA-s në fushën qeverisjes së brendshme dhe etikës.

Rezultatet e vlerësimit do të tregojnë nëse ZKA-ja po i menaxhon punët e veta në mënyrë efektive dhe nëpërmjet qeverisjes së mirë duke u dhënë shembullin e duhur të tjerëve. Domeni B ka pesë tregues.

Tabela më poshtë jep një pasqyrë të notave për të pesë indikatorët e domenit B, ndërsa në nënkapitujt 4.2.1 - 4.2.5 japin informata të detajuara për secilin tregues.

Domeni B: Qeverisja e Brendshme dhe etika		Dimensionet				Nota e përgjithshme
Treguesi	Emri	i	li	iii	iv	
SAI-3	Cikli i planifikimit strategjik	3	4	3	3	3
SAI-4	Mjedisi i kontrollit organizativ	3	4	3	3	3
SAI-5	Auditimet e kontraktuara	4	4	2		3
SAI-6	Udhëheqja dhe komunikimi i brendshëm	4	2			3
SAI-7	Planifikimi i përgjithshëm i auditimit	1	3			2

4.2.1 SAI-3: Cikli i planifikimit strategjik - [3]

Planifikimi strategjik është një komponent jetik i çdo ISA si një mënyrë për të siguruar që organizata të ketë një drejtim dhe vizion të qartë dhe një plan të menduar siç duhet për ta realizuar atë. Treguesi SAI-3 thekson rëndësinë që një ISA të ketë proces të planifikimit strategjik për të siguruar që vizioni të mund të transformohet në realitet në një mënyrë koherente dhe logjike. Planet Strategjike duhet të plotësohen me Plane Vjetore Operacionale që do të transformojnë vizionet dhe aspiratat strategjike në realitet operacional dhe institucional.

Ky tregues ka katër dimensione:

- (i) **Përmbajtja e Planit Strategjik.**
- (ii) **Përmbajtja e planit vjetor operacional.**
- (iii) **Procesi i planifikimit Organizativ (Zhvillimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor operacional).**
- (iv) **Monitorimi dhe raportimi i performancës.**

Vlerësimi i indikatorit SAI-3 është bërë duke marrë në rishikim Planin Strategjik të ZKA-së 2018-2021 dhe planet operacionale. Me qenë se Plani Strategjik 2018 – 2021 ka përfunduar në fund të vitit të 2021, ekipi ka marrë në shqyrtim edhe dokumente tjera të cilat tregojnë veprimet e ndërmarra për hartimin e planit të ri strategjik të ZKA-së.

Dimensioni (i): Përmbajtja e Planit Strategjik

Plani Strategjik 2018-2021 ishte përgatitur nga Ekipi i Planifikimit Strategjik i udhëhequr nga Zëvendës Auditori i Përgjithshëm. ZKAS e kishte mbështetur këtë proces në kuadër të projektit të bashkëpunimit që ka me ZKA-në. Hartimit të planit i kishte paraprirë një raport i analizës së boshllëqeve për të definuar gjendjen në të cilën ishte institucioni krahasuar me gjendjen e dëshirueshme. Drafti i Planit ishte diskutuar me stafin dhe palët e jashtme si Kuvendi, Përfaqësuesit e Mediave dhe OSHC-ve dhe donatorëve. Plani ishte finalizuar dhe publikuar në shtator të vitit 2018.

Plani Strategjik është përcjell me planet operacionale për vitet 2018-2019, dhe 2020. Ndërsa për vitin 2021 nuk ishte përgatitur plan operacional fare. Kjo edhe për shkak të pandemisë me Covid-19 dhe mos prioritizimit të duhur.

Plani ka të përcaktuar qartë Vizionin, Misionin dhe Vlerat si dhe ka përcaktuar qëllimet strategjike dhe objektivat përmes të cilave ZKA-ja synonte të rriste performancën e vet në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet ndërkombëtare për institucionet supreme të auditimit.

ZKA-ja ka pasur në zbatim Planin Strategjik 2018-2021 i cili është përcjellur me planet vjetore operacionale. Në plan janë të përcaktuara qartë Vizioni, Misioni dhe Vlerat si dhe qëllimet strategjike dhe objektivat përmes të cilave ZKA-ja synonte të rriste performancën e vet në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet ndërkombëtare për institucionet supreme të auditimit. Përveç kësaj, për secilin qëllim plani përmban objektivat strategjike, si dhe treguesit e performancës për rezultatet e pritshme. Megjithatë, treguesit e performancës dhe rezultatet e pritura nuk janë trajtuar të ndara, dhe kjo mund të shkaktojë konfuzion në matjen e rezultateve të reale bazuar në treguesit e performancës dhe atyre të dëshirueshme. Mbi këtë bazë përmes planit operacional janë identifikuar edhe aktivitetet e nevojshme për zbatimin e planit.

Duke qenë se për periudhën vlerësuese Plani Strategjik 2018-2021 kishte përfunduar, ekipi ka kuptuar se aktualisht AP ka themeluar grupin punues për hartimin e planit të ri strategjik 2022-2025. Për qëllime të hartimit të planit të ri ekipi ka ndërmarrë disa veprime siç janë: vlerësimi i nivelit të zbatimit të Planit Strategjik paraprak; hartimi i planit të punës dhe planit kohor për hartimin e Planit të ri strategjik, analiza e boshllëqeve dhe identifikimi i nevojave dhe pritjeve nga palët e interesit etj. Për këtë qëllim, me mbështetjen e SIGMA-s është bërë anketimi i palëve të interesit të ZKA-së dhe rezultatet nga anketimi do të merren parasysh gjatë hartimit, gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme ekipi konsultohet me kolegët nga ZKAS-së të cilët përmes projektit të bashkëpunimit me ZKA-në do ta mbështesin institucionin në këtë proces.

Një draft i parë i Planit Strategjik 2022-2025 është hartuar dhe është në proces të shqyrtimit dhe komentimit në kuadër të institucionit. Edh pse ende një dokument në fazën fillestare ky draft përmban të gjitha elementet sipas Udhëzuesit të IDI për Planifikimin Strategjik.

Dimension (ii): Përmbajtja e Planit Vjetor Operacional

Planet Vjetore Operacionale për vitet 2018- 2019 dhe për vitin 2020, përmbajnë informata të detajuara për projektin, aktivitetet, afatet kohore, rrezikun e mundshëm dhe trajtimin e tij, burimet financiare dhe personat përgjegjës për secilën objektivë sipas qëllimeve të përcaktuara me Planin Strategjik.

Përderisa Plani Vjetor i Auditimit përfshinë informatat relevante në lidhje me auditimet e përzgjedhura nga Auditori i Përgjithshëm për sezonin auditues, Planet Operative Vjetore përfshijnë projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxhetin dhe burimet e financimit, rezultatet, rreziqet, etj, të ndërlidhura me zbatimin e Planit Strategjik.

Për secilën objektivë strategjike janë paraparë një apo më shumë projekte të cilat përmbajnë disa aktivitete dhe janë përcaktuar afatet për realizimin e tyre si dhe zyrtarët përgjegjës për arritjen caqeve të caktuara sipas indikatorëve. Disa nga projektet e planifikuara kërkojnë një afat më të gjatë se një vit për zbatimin e plotë të tyre dhe një pjesë e aktiviteteve për realizimin e tyre kanë filluar në vitin paraprak apo pritet të fillojnë në vitin pasues.

Për secilin projekt është parashikuar buxheti dhe janë identifikuar edhe burimet tjera të financimit, përveç Buxhetit të Kosovës. Pritet që një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të financohen përmes projekteve të përkrahura nga BE, apo nga partnerë profesionalë të ZKA-së, ku vlen të veçohet ZKAS me të cilën ZKA ka marrëveshje bashkëpunimi.

Planet Operative përveç që ndihmojnë organizatën në ruajtjen e fokusit të saj gjatë zbatimit të Planit Strategjik, ai po ashtu lehtëson monitorimin e zbatimit të tij dhe për të matur shkallën e performancës në raport me treguesit e performancës. Planifikimi i aktiviteteve është bërë duke pasur parasysh burimet njerëzore dhe financiare që ka pasur në dispozicion ZKA-ja.

Siç u përmend edhe më lartë, ZKA-ja nuk kishte përgatitur plan operacional për vitin 2021.

Dimensioni (iii): Procesi i planifikimit Organizativ (Zhvillimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor operacional)

Ligji 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, në nenin 20 paragrafi 1, kërkon që AP të miratojë planin strategjik tre vjeçar. Duke pas parasysh këtë si dhe trendin e zhvillimit të ZKA-së, Auditori i Përgjithshëm, në fund të vitit 2017, themeloi ekipin për planifikim strategjik i cili duhej të hartonte dhe t'i propozonte AP-së për miratim Planin Strategjik të ZKA-së 2018-2021.

Pronësia e këtij Plani i takonte Auditorit të Përgjithshëm ndërsa procesi ishte udhëhequr nga Zëvendës Auditori i Përgjithshëm me përfshirjen e shpeshtë edhe të Ndhmës Auditorëve të Përgjithshëm dhe të gjithë stafit të ZKA-së. Për përgatitjen e planit ishin ndërmarrë një sërë aktiviteteve me palët e brendshme dhe të jashtme. Siç u përmend edhe më lartë drafti final i planit është diskutuar me të gjitha palët e interesit para se të miratohej nga Auditori i Përgjithshëm. Tryeza pune të veçanta ishin organizuar me palët e interesit për të prezantuar draftin e planit strategjik. Takimet me stafin dhe komunikimi i brendshëm lidhur me diskutimin dhe shqyrtimin e komenteve të pranuar është mbështetur nga ZKAS, në kuadër të projektit bilateral të bashkëpunimit. Ndërsa, sa i përket komunikimit me palët e jashtme të interesit tryeza pune të veçanta janë mbajtur me përfaqësuesit e Komisioneve Parlamentare për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike; me përfaqësues të OShC-ve, shoqatave profesionale dhe medias si dhe me përfaqësues të donatorëve.

Në vitin 2015 ishte miratuar strategjia për zhvillim korporativ 2015-2020 e pasuar nga plani i ri strategjik 2018-2021. Mund të konstatojmë se ZKA-ja nuk ka pasur boshllëk kohor pa plan strategjik.

Për qëllime të hartimit të planit të ri strategjik 2022- 2025 është bërë analiza e boshllëqeve dhe identifikimi i nevojave dhe pritjeve nga palët e interesit. Me mbështetjen e SIGMA – s në shkurt të vitit 2022 është bërë anketimi i palëve të interesit të ZKA-së dhe rezultatet nga ky anketim do të merren parasysh gjatë hartimit të planit të ri. Megjithatë, ZKA ja nuk ka pasur të vendosur një sistem të monitorimit sistematik të zbatimit të planit strategjik dhe planeve operative vjetore.

Dimension (iv): Monitorimi dhe raportimi i performancës

Me qenë se ZKA-ja nuk ka pasur të vendosur një sistem të monitorimit sistematik të zbatimit të planit strategjik dhe planeve operative vjetore, me strukturën e re organizative, Auditorja e Përgjithshme ka themeluar Departamentin për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza i cili në fushëveprimin e vet ka sigurimin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të planit strategjik, si dhe të planeve tjera vjetore e periodike të institucionit.

Duke pasur parasysh se një monitorim sistematik dhe i mirëfilltë i zbatimit të planit ka munguar, Auditori i Përgjithshëm i ka kërkuar ekipit për hartimin e planit të ri strategjik 2022-2025, që fillimisht të bëjë vlerësimin e nivelit të zbatimit të Planit Strategjik paraprak 2018-2021. Sipas raportit të hartuar nga ekipi objektivat strategjike të ZKA-së janë përbushur plotësisht apo pjesërisht në masën prej 80%. Ndërsa, treguesit e performancës janë përbushur plotësisht apo pjesërisht në masën prej 75%. Qëllimi 3 është realizuar në masën më të madhe, ndërsa qëllimet 1 dhe 2 janë zbatuar pjesërisht.

Monitorimi dhe raportimi i performancës së ZKA-së bëhet përmes Raportit Vjetor të Performancës. Për hartimin e këtij raporti merret për bazë Korniza e INTOSAI-t për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, dhe raporti ofron informata të rëndësishme në lidhje me performancën e institucionit të AP-së, në përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore.

Sipas nenit 19 paragrafit 2 të Ligjit 05/L-055, Kuvendi mundet që, të paktën çdo pesë vjet, të iniciojë vlerësimin e pavarur të ZKA-së, i cili mund të kryhet nga institucion suprem i auditimit apo partner tjetër relevant. Deri më tani ZKA-ja nuk i është nënshtruar asnjëherë një rishikimi të pavarur.

Gjetjet dhe vëzhgimet e vlerësimit

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Përmbajtja e Planit Strategjik	<p>Kriteret: a, b, d, e, f, g janë të përmbushura Ndërsa kriteri c, nuk është i përmbushur</p> <p>ZKA-ja ka pasur në zbatim Planin Strategjik 2018-2021 i cili është përcjellur me planet vjetore operacionale. Në plan janë të përcaktuara qartë Vizioni, Misioni dhe Vlerat si dhe qëllimet strategjike dhe objektivat përmes të cilave ZKA-ja synonte të rriste performancën e vet në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet ndërkombëtare për institucionet supreme të auditimit. Përveç kësaj, për secilin qëllim plani përmban objektivat strategjike, si dhe treguesit e performancës për rezultatet e pritshme. Megjithatë, treguesit e performancës dhe rezultatet e pritura nuk janë trajtuar të ndara, dhe kjo mund të shkaktojë konfuzion në matjen e rezultateve të reale bazuar në treguesit e performancës dhe atyre të dëshirueshme. Mbi këtë bazë përmes planit operacional janë identifikuar edhe aktivitetet e nevojshme për zbatimin e planit.</p> <p>Duke qenë se për periudhën vlerësuese Plani Strategjik 2018-2021 kishte përfunduar, ekipi ka kuptuar se aktualisht AP ka themeluar grupin punues për hartimin e planit të ri strategjik 2022-2025. Për qëllime të hartimit të planit të ri ekipi ka ndërmarrë disa veprime siç janë: vlerësimi i nivelit të zbatimit të Planit Strategjik paraprak; hartimi i planit të punës dhe planit kohor për hartimin e Planit të ri strategjik, analiza e boshllëqeve dhe identifikimi i nevojave dhe pritjeve nga palët e interesit etj. Për këtë qëllim, me mbështetjen e SIGMA është bërë anketimi i palëve të interesit të ZKA-së dhe rezultatet nga anketimi do të merren parasysh gjatë hartimit, gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme ekipi konsultohet me kolegët nga ZKAS-së të cilët përmes projektit të bashkëpunimit me ZKA-në do ta mbështesin institucionin në këtë proces.</p> <p>Një draft i parë i Planit Strategjik 2022-2025 është hartuar dhe është në proces të shqyrtimit dhe komentimit në kuadër të institucionit. Edh pse ende një dokument në fazën fillestare ky draft përmban të gjitha elementet sipas Udhëzuesit të IDI për Planifikimin Strategjik.</p>	3
(ii) Përmbajtja e planit vjetor operacional.	<p>Kriteret: a, b, c, d, e, f, g janë të përmbushura</p> <p>Planet Vjetore Operacionale për vitet 2018- 2019 dhe për vitin 2020, përmbajnë informata të detajuara për projektin, aktivitetet, afatet kohore, rrezikun e mundshëm dhe trajtimin e tij, burimet financiare</p>	4

	<p>dhe personat përgjegjës për secilën objektivë sipas qëllimeve të përcaktuara me Planin Strategjik.</p> <p>Për secilën objektivë strategjike janë paraparë një apo më shumë projekte të cilat përmbajnë disa aktivitete, janë përcaktuar afatet për realizimin e tyre si dhe zyrtarët përgjegjës për arritjen caqeve të caktuara sipas indikatorëve. Disa nga projektet e planifikuara kërkojnë një afat më të gjatë se një vit për zbatimin e plotë të tyre dhe një pjesë e aktiviteteve për realizimin e tyre kanë filluar në vitin paraprak apo pritjet të fillojnë në vitin pasues.</p>	
<p>(iii) Procesi i planifikimit Organizativ (Zhvillimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor operacional)</p>	<p>Kriteret: a, b, c, d, e, g, h, i janë të përmbushura, ndërsa kriteri f, nuk është përmbushur</p> <p>Pronësia e këtij Plani i takonte Auditorit të Përgjithshëm ndërsa procesi ishte udhëhequr nga Zëvendës Auditori i Përgjithshëm me përfshirjen e shpeshtë edhe të Ndhmës Auditorëve të Përgjithshëm dhe të gjithë stafit. Për përgatitjen e planit ishin ndërmarrë një sërë aktivitete me palët e brendshme dhe të jashtme. Siç u përmend edhe më lartë drafti final i planit është diskutuar me të gjitha palët e interesit para se të miratohej nga AP.</p> <p>Plani ishte publikuar në ueb faqen e ZKA-së.</p> <p>Për qëllime të hartimit të planit të ri strategjik 2022- 2025 është bërë analiza e boshllëqeve dhe identifikimi i nevojave dhe pritjeve nga palët e interesit. Me mbështetjen e SIGMA-s është bërë anketimi i palëve të interesit të ZKA-së dhe rezultatet nga ky anketim do të merren parasysh gjatë hartimit të planit të ri.</p> <p>Megjithatë, ZKA ja nuk ka pasur të vendosur një sistem të monitorimit sistematik të zbatimit të planit strategjik dhe planeve operative vjetore.</p>	<p>3</p>
<p>(iv) Monitorimi dhe raportimi i performancës</p>	<p>Kriteret: a, b, c, d, e, g, janë të përmbushura, ndërsa Kriteri f nuk është përmbushur.</p> <p>ZKA ja nuk ka pasur të vendosur një sistem të monitorimit sistematik të zbatimit të planit strategjik dhe planeve operative vjetore.</p> <p>Me strukturën e re organizative, Auditorja e Përgjithshme ka themeluar Departamentin për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza i cili në fushëveprimin e vet ka sigurimin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të Planit strategjik, si dhe të planeve tjera vjetore e periodike të institucionit.</p> <p>Përmes Raportit Vjetor të Performancës ZKA-ja, monitoron dhe raporton për performancën e vet. Për hartimin e këtij raporti merret për bazë Korniza për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, dhe raporti ofron informata të rëndësishme në lidhje me performancën e institucionit të AP-së, në përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore, në pajtim me SNISA.</p> <p>Deri më tani ZKa-ja nuk i është nënshtruar asnjëherë një rishikimi të pavarur.</p>	<p>3</p>

4.2.2 SAI-4: Mjedisi i kontrollit organizativ - Nota [3]

Treguesi SAI-4 ofron informata mbi parimet dhe pritshmëritë për një ZKA në lidhje me:

- sjelljen dhe standardet etike;
- kontrollin e brendshëm në ISA;
- kontrollin e cilësisë gjatë gjithë ciklit të auditimit; dhe
- sigurimin e cilësisë për auditimet e përzgjedhura të përfunduara për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet e auditimit dhe manualët e auditimit”.

Angazhimi për krijimin, ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre kompetencave janë thelbësore që një ISA të operojë brenda një mjedisi që jep rezultate auditimi që mund të mbështeten nga përdoruesit fundorë.

Ky tregues ka katër dimensione:

- (i) **Mjedisi i kontrollit të brendshëm – Etika, Integriteti dhe Struktura Organizative.**
- (ii) **Sistemi i Kontrollit të brendshëm.**
- (iii) **Sistemi i kontrollit të cilësisë.**
- (iv) **Sistemi i sigurimit të cilësisë.**

Vlerësimi i treguesit SAI-4 është bërë duke marrë për bazë Ligjin nr.05/L-055 dhe dokumentet si Kodi i Etikës (2018); rregulloret e brendshme, përshkrimi i detyrave të punës si dhe dokumente tjera relevante.

Dimensioni (i): Mjedisi i kontrollit të brendshëm – Etika, Integriteti dhe Struktura Organizative.

ZKA-ja ka në fuqi Kodin e Etikës i cili është hartuar duke marrë për bazë parimet e SNISA 30 dhe përshtatur në mënyrë specifike për funksionin dhe përgjegjësitë ligjore të përcaktuara për AP-në dhe ZKA-në. Ky kod ri-afirmon dhe paraqet vlerat dhe parimet thelbësore në të cilat bazohet veprimtaria e ZKA-së. Kodi aplikohet ndaj të gjithë punonjësve të ZKA-së, personave dhe të gjitha subjekteve tjera të angazhuara për të ndihmuar AP-në në përmbushjen e mandatit të tij kushtetues.

Ndër parimet bazë të Kodit të Etikës së ZKA-së janë integriteti, pavarësia, objektiviteti dhe paanësia, neutraliteti politik, konflikti i interesit, konfidencialiteti dhe transparenca, kompetenca dhe zhvillimi profesional, rreziqet dhe kontrolli si dhe rregullat e mirësjelljes që përbëjnë sjelljen profesionale, respektin për njeri-tjetrin, përgjegjësinë ndaj entiteteve etj.

I gjithë stafi i ZKA-së është i njoftuar dhe duhet t’ju përmbahet parimeve të Kodit, duke nënshkruar Deklaratën se e ka kuptuar drejt Kodin dhe është në pajtim me rregullat e tij.

Kodi i Etikës për herë të fundit është rishikuar në vitin 2018 dhe është i publikuar në ueb faqen e ZKA-së.

Komisioni i Etikës i themeluar nga Auditori i Përgjithshëm dhe me përbërje prej tre anëtarësh, vepron sipas procedurave të punës dhe dokumenteve tjera përcjellëse. Aktivitetet e Komisionit të Etikës janë: monitorimi dhe respektimi i parimeve etike; shqyrtimi i kërkesave, këshillave dhe rekomandimeve për Auditorin e Përgjithshëm; udhëzime rreth Kodit dhe ngritjes së vetëdijes për zbatimin e Kodit; identifikimi dhe studimi i fushave të nevojshme për përmirësim.

Për stafin e ri të punësuar në ZKA, Komisioni i Etikës ka hartuar një dokument/prezantim me elemente gjithëpërfshirëse të Kodit të Etikës që përbën ndër pjesët kryesore të orientimit dhe zbatimit në punë.

Siç edhe rekomandohet nga praktikat e mira dhe sipas instrumentit IntoSAINT, në pesë vitet e fundit ZKA-ja nuk ka vlerësuar cënueshmërinë dhe aftësinë për qëndrueshmëri ndaj shkeljeve të integritetit si dhe nuk ka të hartuar politikë të integritetit.

Qeverisja e brendshme në ZKA, përcaktohet nëpërmjet rregulloreve të brendshme për Organizim të brendshëm dhe sistematizim (01/2021), Klasifikimin e vendeve të punës (02/2021, Pranim dhe Karrierë (03/2021), si dhe rregulloret për Disiplinë dhe ankesa (04/2021) dhe për Vlerësimin e rezultateve në punë (04/2020). Struktura organizative dhe rregulloret e lartpërmendura janë të publikuara në ueb faqen e zyrës.

ZKA ka të miratuara përshkrimet e vendeve të punës për secilën pozitë audituese. Secili udhëheqës i departamentit përkatës harton Objektivat vjetore të Punes për punonjësit dhe objektivat nënshkruhen nga dy palët (stafi dhe udhëheqësi i departamentit) dhe dorëzohen në Burime Njerëzore.

Për çdo sezonë auditimi aprovohet plani i auditimit si dhe përcaktohet angazhimi i stafit në departamentet e auditimit, funksioni dhe roli përkatës.

Mbi këtë bazë vlerësojmë se mjedisi i punës në ZKA është i zhvilluar bazuar në rregulla dhe standarde duke siguruar se secili punonjës është i njoftuar për të drejtat dhe detyrimet në vendin e punës.

Përmes Kodit të Etikës, dhe rregulloreve tjera në fuqi, ZKA-ja forcon sjelljen profesionale dhe përcakton objektiva për arritje të rezultateve dhe punë efikase dhe efektive.

Dimensioni (ii): Sistemi i kontrollit të brendshëm

Bazuar në ligjin organik të ZKA-së si dhe ligjet dhe rregulloret tjera nacionale, ZKA-ja ka të krijuar një sistem të menaxhimit të brendshëm i cili mundëson identifikimin, zvogëlimin dhe monitorimin e rreziqeve operacionale në organizatë.

Ka të zhvilluar Planin operativ për vlerësimin e rreziqeve, i cili përmban dy objektiva kryesore: parandalimin dhe marrjen e masave adekuate. Drejtori i Përgjithshëm, i cili është përgjegjës për të gjitha shërbimet administrative, është personi kryesor përgjegjës edhe për zbatimin dhe monitorimin e planit operativ për vlerësimin e rreziqeve.

Deklarata e kontrollit të brendshëm dhe deklarata e llogaridhënies nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe publikohet në kuadër të Raportit Vjetor të Performancës.

ZKA-ja nuk ka pasur asnjëherë një vlerësim të mirëfilltë (peer review) deri tani. Megjithatë, përmes instrumenteve tjera sikurse janë auditimi i jashtëm, pyetësorët e vetëvlerësimit, vlerësimet bazike nga donatorë të jashtëm për nevoja të zhvillimit dhe përfitimit nga projektet, merr informacion për nivelin e performancës dhe mbi nivelin e kontroleve të brendshme.

ZKA-ja ka të themeluar funksionin e auditimit të brendshëm dhe Komitetin e auditimit të brendshëm. Mandati dhe përgjegjësitë e tyre janë të rregulluara me Statutin për auditimin e brendshëm dhe Statutin për Komitetin e Auditimit. Siç edhe përcaktohet me ligj dhe rregulloret tjera, kreu i Njesisë së auditimit të brendshëm është e certifikuar dhe me kompetencë të plotë profesionale.

Funksioni i auditimit të brendshëm është i pavarur nga menaxhmenti dhe kjo pavarësi i sigurohet përmes akteve ligjore si dhe Statutit të Auditimit të Brendshëm dhe Statutit të Komitetit të Auditimit. Sikurse edhe pjesa tjetër e stafit, edhe stafi nga njësia e auditimit të brendshëm janë pjesë e trajnimeve dhe programeve për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Punonjësit janë të lirë të raportojnë për shkeljet e dyshuara te zyrtarët përgjegjës për sinjalizim dhe ZKA-ja ka të aprovuar Udhëzuesin për mbrojtjen e sinjalizuesve i cili është publik në ueb faqen e vet.

Rregullorja nr.01/2021 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në nenin 30.2 përcakton që AP përmes një akti të veçantë miraton sistemin vjetor të caktimit të auditorëve nëpër departamente dhe ekipe të auditimit në përputhje me kërkesat e SNISA 140.

Dimension (iii): Sistemi i kontrollit të cilësisë

SC-ja është përgjegjësi dhe në interes të të gjithë punonjësve të ZKA-së. Manualet dhe udhëzuesit e auditimit e rregullojnë dhe promovojnë cilësinë në auditim si esenciale. Ndërsa, sa i përket procedurave tjera të shërbimeve korporative sikurse prokurimi, menaxhimi i pasurisë dhe procedurat financiare, ZKA-ja ka në përdorim rregullore dhe udhëzues që rrjedhin nga Ligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055 dhe ligjet tjera nacionale. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar cilësinë e duhur për sa i përket shërbimeve korporative. Përgjegjësia për të siguruar një sistem të tërësishëm për kontrollin e cilësisë në institucion bie mbi Auditorin e Përgjithshëm.

Disa nga manualet dhe rregulloret përmes të cilave ZKA-ja e rregullon dhe siguron cilësinë janë:

- Udhëzuesi për Auditimet e Rregullsisë (Financiar dhe pajtueshmëri qasje e kombinuar)
- Udhëzuesi për auditimet e performancës;
- Udhëzuesi për auditimet e Teknologjisë së Informacionit;
- Udhëzues për planifikimin strategjik të auditimeve të performancës;
- Udhëzuesi për përcjelljen e Rekomandimeve të Auditimit; Udhëzues për Kontrollin e Cilësisë së Auditimeve të rregullsisë;
- Udhëzues i menaxhimit të cilësisë së auditimit;

SC-ja kryhet përmes menaxherëve të linjës, softuerit të auditimit dhe sipas kërkesave të udhëzuesve dhe rregulloreve në fuqi. Megjithatë, vërehet se ka hapësirë për përmirësim. Manuali i kontrollit të cilësisë në auditimin e rregullsisë nuk është i azhurnuar sipas metodologjisë së re, ndërsa për auditimet e performancës nuk ka fare manual të veçantë. Megjithatë, gjatë vlerësimit është vërejtur se dosjet kanë kaluar përmes procesit të rishikimit. Pjesë e procesit të rishikimit është drejtori i departamentit të auditimit, pastaj vazhdon rishikimi sipas hierarkisë nga NAP, në rastet kur dosja është mostër e rishikimit nga Departamenti për Sigurimin e Cilësisë, pastaj rishikimi vazhdon nga Zv. Auditori i Përgjithshëm dhe Auditori i Përgjithshëm para miratimit.

Dimension (iv): Sistemi i sigurimit të cilësisë

Në strukturën organizative, ZKA-ja ka në funksion Departamentin për Sigurimin e Cilësisë i cili bënë rishikimin e cilësisë për auditime të caktuara dhe ofron siguri të arsyeshme se auditimet janë kryer në përputhje me SNISA.

Ky Departament, përgatit dhe plotëson formularët e përcaktuar me Udhëzuesin e Kontrollit të Cilësisë në Auditim dhe nxjerrë konkluzione për rezultatet e rishikimit, si dhe paraqet komente për nivelin e cilësisë duke ofruar edhe rekomandime për përmirësim. Siguron se gjetjet e auditimit janë të mbështetura në dëshmitë e duhura dhe në raste të caktuara rishikon dhe analizon edhe mostrat e përzgjedhura, si dhe rishikon dhe analizon opinionet e auditimit. Kjo vlen vetëm për auditimet e rregullsisë por jo edhe për auditimet e performancës.

Udhëheqësi i departamentit i raporton drejtpërdrejt Auditorit të Përgjithshëm dhe harton raporte periodike për gjetjet nga procesi i rishikimit.

Siç është cekur edhe më lartë, ZKA-ja deri më tani nuk i është nënshtruar rishikimit të pavarur asnjëherë.

Gjetjet dhe vëzhgimet e vlerësimit

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Mjedisi i kontrollit të brendshëm – Etika, Integriteti dhe Struktura Organizative	<p>Kriteret: a, b, c, d, e, f, g, h, i, j, janë të përmbushura, ndërsa kriteret: k dhe l, nuk janë përmbushur</p> <p>ZKA-ja ka në fuqi Kodin e Etikës i cili është hartuar duke marrë për bazë parimet e SNISA 30 dhe përshtatur në mënyrë specifike për funksionin dhe përgjegjësitë ligjore të përcaktuara për AP-në dhe ZKA-në. Ky kod ri-afirmon dhe paraqet vlerat dhe parimet thelbësore në të cilat bazohet veprimtaria e ZKA-së. Kodi aplikohet ndaj të gjithë punonjësve të ZKA-së, personave dhe të gjitha subjekteve tjera të angazhuara për të ndihmuar AP-në në përmbushjen e mandatit të tij kushtetues.</p> <p>Qeverisja e brendshme në ZKA, përcaktohet nëpërmjet rregulloreve të brendshme për Organizim të brendshëm dhe sistematizim (01/2021), Klasifikimin e vendeve të punës (02/2021, Pranim dhe Karrierë (03/2021), si dhe rregulloret për Disiplinë dhe ankesa (04/2021) dhe për Vlerësimin e rezultateve në punë (04/2020). Struktura organizative dhe rregulloret e lartpërmendura janë të publikuara në ueb faqen e zyrës.</p>	3
(ii) Sistemi i kontrollit të brendshëm	<p>Kriteret: a, b, c, d, e, f, g, h, i, j, janë përmbushur</p> <p>Bazuar në ligjin organik të ZKA-së si dhe ligjet dhe rregulloret tjera nacionale, ZKA-ja ka të krijuar një sistem të menaxhimit të brendshëm i cili mundëson identifikimin, zvogëlimin dhe monitorimin e rreziqeve operacionale në organizatë.</p> <p>Funksioni i auditimit të brendshëm është i pavarur nga menaxhmenti dhe kjo pavarësi i sigurohet përmes akteve ligjore si dhe statutit të auditimit të brendshëm dhe statutit të komitetit të auditimit.</p> <p>Punonjësit janë të lirë të raportojnë për shkeljet e dyshuara te zyrtarët përgjegjës për sinjalizim dhe ZKA-ja ka të aprovuar Udhëzuesin për mbrojtjen e sinjalizuesve i cili është publik në ueb faqen e vet.</p>	4
(iii) Sistemi i kontrollit të cilësisë	<p>Kriteret: b, c, d, e, janë përmbushur, ndërsa kriteri a nuk është i përmbushur</p> <p>Sigurimi i cilësisë është përgjegjësi dhe në interes të të gjithë punonjësve të ZKA-së. Manualet dhe udhëzuesit e auditimit e rregullojnë dhe promovojnë cilësinë në auditim si esenciale. Ndërsa sa i përket procedurave tjera të shërbimeve korporative sikurse prokurimi, menaxhimi i pasurisë dhe procedurat financiare, ZKA-ja ka në përdorim rregullore që rrjedhin nga ligjet nacionale. AP mban përgjegjësinë për të siguruar një sistem të tërësishëm për kontrollin e cilësisë. Kontrolli i cilësisë kryhet përmes menaxherëve të linjës, softuerit të auditimit dhe sipas kërkesave të udhëzuesve dhe</p>	3

	rregulloreve në fuqi Megjithatë, vërehet se ka hapësirë për përmirësim. Manuali i kontrollit të cilësisë në auditimin e rregullsisë nuk është i azhurnuar sipas metodologjisë së re, ndërsa për auditimet e performancës nuk ka fare manual të veçantë.	
(iv) Sistemi i sigurimit të cilësisë	<p>Kriteret: a, b, c, d, e, f, g, janë përmbushur h</p> <p>Në strukturën organizative, ZKA-ja ka në funksion Departamentin për Sigurimin e Cilësisë i cili bënë rishikimin e cilësisë për auditime të caktuara dhe ofron siguri të arsyeshme se auditimet janë kryer në përputhje me SNISA.</p> <p>Ky Departament, përgatit dhe plotëson formularët e përcaktuar me Udhëzuesin e Kontrollit të Cilësisë në Auditim dhe nxjerrë konkluzione për rezultatet e rishikimit, si dhe paraqet komente për nivelin e cilësisë duke ofruar edhe rekomandime për përmirësim. Siguron se gjetjet e auditimit janë të mbështetura në dëshmitë e duhura dhe në raste të caktuara rishikon dhe analizon edhe mostrat e përzgjedhura, si dhe rishikon dhe analizon opinionet e auditimit. Kjo vlen vetëm për auditimet e rregullsisë por jo edhe për auditimet e performancës.</p> <p>Udhëheqësi i departamentit i raporton drejtpërdrejt Auditorit të Përgjithshëm dhe harton raporte periodike për gjetjet nga procesi i rishikimit.</p>	3

4.2.3 SAI-5: Auditimet e kontraktuara - Nota [3]

Treguesi SAI 5 ofron informata për parimet dhe pritshmëritë e një ISA në lidhje me auditimet e jashtme të kontraktuara: kërkesat bazë për përzgjedhjen e kompanisë për të kryer auditime në emër të Auditorit të Përgjithshëm; kontrollin e nevojshëm të cilësisë; dhe, standardet e sigurimit të cilësisë që do të zbatohen.

Ky tregues ka tri dimensione:

- (i) Procesi i përzgjedhjes së kompanisë së kontraktuar për auditim.**
- (ii) Kontrolli i cilësisë në auditimet e kontraktuara.**
- (iii) Sigurimi i cilësisë në auditimet e kontraktuara.**

Vlerësimi i treguesit SAI-5 është bërë duke marrë për bazë Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055, dosjen e tenderit për auditimet e kontraktuara dhe kontratën me kompaninë e përzgjedhur si dhe Manualin e Auditimit të Rregullsisë.

Dimensioni (i): Procesi i përzgjedhjes së kompanisë së kontraktuar për auditim

Sipas Ligjit 05/L-055, neni 12, AP mund t'ë angazhojë persona, firma të kualifikuara apo ndonjë ISA për t'i ndihmuar. Mbi këtë bazë Auditori i Përgjithshëm, përmes një procedure të hapur të prokurimit dhe në përputhje me kushtet e kontratës, angazhon një kompani profesionale dhe të pavarur të auditimit për të audituar një numër të caktuar të OB-ve, në emër të saj. Kompania e përzgjedhur duhet të kryej auditimin në pajtueshmëri të plotë me SNISA dhe me kushtet tjera të përcaktuara me kontratë. Pajtueshmëria me kërkesat relevante të etikës profesionale dhe sigurimit të cilësisë janë të specifikuar në kushtet e kontratës, për tu siguruar që kompania e kontraktuar është e licencuar nga autoriteti publik për të kryer auditime. Procesi i

bashkëpunimit, komunikimit dhe përmbushjes së detyrimeve mbështetet me Planin për menaxhimin e kontratës.

Aktualisht ZKA-ja ka të lidhur kontratë me një operator ekonomik për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të 19 institucioneve të pavarura dhe 6 komunave për vitin 2021.

Për të siguruar reduktimin e familjaritetit dhe sigurimin e rotacionit të stafit të angazhuar në auditim nga kompania për të shmangur familjaritetin dhe rrezikun e konfliktit të interesit, me kontratë është kërkuar që stafi i angazhuar në auditim nga kompania të nënshkruaj deklaratat e pavarësisë profesionale nga organizatat buxhetore në auditim. Megjithatë duhet theksuar se në shtojcën 16 të Manualit të Rregullsisë (qasje e kombinuar) masat për reduktimin e rrezikut të familjaritetit nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike.

Ekipi, për nevoja të vlerësimit, ka rishikuar edhe kontratën dhe një dosje të auditimit të kontraktuar (sipas mostrimit) për vitin 2020. Gjetjet e evidentuara nga ky ri-shikim janë të prezantuara te treguesit SAI-10 dhe SAI-16.

Dimensionii (ii): Kontrolli i cilësisë në auditimet e kontraktuara.

KC në auditimet e kontraktuara bëhet bazuar në planin vjetor të auditimit dhe sipas kushteve të përcaktuara në shtojcën 16 të manualit të rregullsisë (qasje e kombinuar) dhe kontratës së angazhimit.

Kompania e kontraktuar është e obliguar që të siguroj se auditimet janë kryer në pajtueshmëri të plotë me SNISA-të përfshirë edhe kontrollin e cilësisë. Ndërsa personat përgjegjës në ZKA, duhet të kryejnë kontrole të vazhdueshme në të gjitha fazat e auditimit për të siguruar se kërkesat janë përmbushur.

Të gjitha dokumentet dhe letrat e punës për procesin e auditimit janë në pronësi të ZKA-së. Kompania është e obliguar t'i dorëzoj ZKA-së draftin final të raportit të auditimit, përfshirë edhe draft opinionin e auditimit së bashku me dosjen e auditimit e cila përfshinë dëshmi të mjaftueshme për të gjeturat dhe konkluzionet e paraqitura në draft raport.

Përfundimisht Opinioni i auditimit caktohet nga Auditori i Përgjithshëm.

Të gjitha dokumentet nga dosja e auditimit futen në sistemin e auditimit të ZKA-së SITA nga personat e caktuar.

Dimensionii (iii): Sigurimi i cilësisë në auditimet e kontraktuara.

ZKA –ja nuk ka të zhvilluara procedura të shkruara apo plane specifike për SC-në në auditimet e kontraktuara.

Gjithashtu, sigurimi i kontrollit të cilësisë nga personat përgjegjës në ZKA nuk lëshohet në nivel të detajuar ku përfshihet edhe mënyra e përzgjedhjes së mostrave, vlerësim të kontrolleve dhe rreziqeve, vlerësimin e analizës së kornizës ligjore të aplikueshme, etj. gjendja paraqitet më e detajuar edhe te treguesit SAI-10 dhe SAI-16.

Megjithatë, në praktikë me planin vjetor të auditimit caktohen personat përgjegjës të cilët bëjnë rishikimin e draft raporteve të auditimeve të kontraktuara para se ato të dërgohen për komente në entitet. Kësaj i paraprin një proces i komunikimit me kompaninë sa i përket dhënies së komenteve dhe rekomandimeve deri te finalizimi i raportit.

Gjetjet dhe vëzhgimet e vlerësimit

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Procesi i përzgjedhjes së auditimeve të kontraktuara	<p>Kriteri: a, b, c, d, f, g, dhe e janë të përmbushura,</p> <p>Sipas Ligjit nr.05/L-055, neni 12, Auditori i Përgjithshëm mund të angazhojë persona, firma të kualifikuara apo ndonjë ISA tjetër për t'i ndihmuar të kryejnë ndonjë nga detyrat e ZKA-së. Në këtë rast Auditori i Përgjithshëm përmes një procedure të hapur të prokurimit dhe në përputhje me kushtet e kontratës e angazhon një kompani profesionale dhe të pavarur të auditimit për të audituar një numër të caktuar të OB-ve, në emër të saj.</p> <p>Për të siguruar reduktimin e familjaritetit dhe sigurimin e rotacionit të stafit të angazhuar në auditim nga kompania për të shmangur familjaritetin dhe rrezikun e konfliktit të interesit, me kontratë është kërkuar që stafi i angazhuar në auditim nga kompania të nënshkruaj deklaratat e pavarësisë profesionale nga organizatat buxhetore në auditim. Megjithatë duhet theksuar se në shtojcën 16 të Manualit të Rregullsisë (qasje e kombinuar) masat për reduktimin e rrezikut të familjaritetit nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike.</p>	4
(ii) Kontrolli i cilësisë në auditimet e kontraktuara	<p>Kriteret: a, b, c, d, janë të përmbushura</p> <p>Kontrolli i cilësisë në auditimet e kontraktuara bëhet bazuar në planin vjetor të auditimit dhe sipas kushteve të përcaktuara në shtojcën 16 të manualit të rregullsisë (qasje e kombinuar) dhe kontratës së angazhimit.</p> <p>Kompania e kontraktuar është e obliguar që të siguroj se auditimet janë kryer në pajtueshmëri të plotë me SNISA përfshirë edhe KC-në. Ndërsa personat përgjegjës në ZKA, duhet të kryejnë kontrole të vazhdueshme në të gjitha fazat e auditimit për të siguruar se kërkesat janë përmbushur.</p>	4
(iii) Sigurimi i cilësisë në auditimet e kontraktuara	<p>Kriteret: c dhe d janë përmbushur, ndërsa kriteret: a, b, e, f, g, nuk janë përmbushur</p> <p>ZKA nuk ka zhvilluar procedura të shkruara apo plane specifike për SC në auditimet e kontraktuara.</p> <p>Për më tepër, procesi i sigurimit të cilësisë i kryer nga stafi i ZKA-së nuk fokusohet mjaftueshëm në një nivel të detajuar në lidhje me metodën e përzgjedhjes së mostrave, kontrollet dhe vlerësimin e rreziqeve, vlerësimin e analizës së kornizës ligjore në fuqi, etj. Situata është paraqitur më në detaje në treguesit SAI-10 dhe SAI-16,</p>	2

4.2.4 SAI-6: Udhëheqja dhe komunikimi i brendshëm - Nota [3]

Treguesi SAI-6 jep informacion mbi stilin e udhëheqjes së institucionit dhe mënyrën se si vendimet dhe kërkesat komunikohen brenda institucionit. Stili i udhëheqjes është i rëndësishëm në të gjitha organizatat, për të siguruar që menaxhmenti i lartë do të vendosë "tonin në krye" duke vendosur standarde personale të sjelljes, për shembull, në atributet etike, personale, të integritetit dhe objektivitetit.

I gjithë personeli i ZKA-së duhet të mbahet i përditësuar për të gjitha zhvillimet që ndikojnë në institucion dhe këto mund të jenë informacione dhe udhëzime teknike dhe jo-teknike. Në mungesë të një strategjie efektive komunikimi ISA do të rrezikojë që mesazhet e rëndësishme të mos arrijnë deri te marrësit e synuar. Si rezultat i kësaj veprimet ose vendimet e pritshme të mos dorëzohen.

Ku tregues ka dy dimensione:

- (i) Udhëheqja.**
- (ii) Komunikimi i brendshëm.**

Vlerësimi i këtij treguesi është bazuar në Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055, Planin Strategjik, rregullore dhe udhëzues të brendshëm, dhe dokumente tjera relevante.

Dimensionimi (i): Udhëheqja

Menaxhmenti i ZKA-së përbëhet nga Auditori i Përgjithshëm, Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, Ndhimës Auditorët e Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm. Kjo rregullohet me nenin 9 të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055.

Menaxhmenti ZKA-së mban takime të rregullta javore ku diskutohen çështje me interes për institucionin dhe për organizimin e punës në baza ditore. Kabineti i Auditorit të Përgjithshëm dokumenton të gjitha pikat e rëndësishme të agjendës që janë diskutuar. Mbi këtë bazë, Auditori i Përgjithshëm mund të marrë vendimet e nevojshme.

Ndhimës Auditorët e Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtorët e auditimit ndjekin të njëjtën praktikë dhe mbajnë takime javore me stafin e tyre sipas rendit hierarkik.

Takime me të gjithë stafin janë mbajtur në të kaluarën së paku 2-3 herë në vit, por që për shkak të pandemisë tani mbajtja e tyre është reduktuar dhe ato mbahen online. Takimi i fundit me të gjithë stafin është mbajtur online në fund të shtatorit 2021.

Vendimet kryesore janë të dokumentuara dhe i komunikohen të gjithë stafit me kohë. Dokumente dhe vendime tjera sipas relevancës gjithashtu dokumentohen dhe janë të qasshme për të gjitha nivelet organizative. Përmes Rregullores 04/2018 për administrimin e dokumenteve zyrtare dhe Regjistrin për komunikimin e brendshëm rregullohet dhe dokumentohet komunikimi i brendshëm nga të gjitha nivelet.

ZKA-ja ka të identifikuar vlerat kyçe dhe i komunikon ato rregullisht me stafin, përmes komunikimeve formale apo jo formale. Në vazhdimësi i promovon këto vlera edhe në komunikimet e jashtme përmes dokumenteve siç janë Plani Strategjik, Raporti Vjetor i Performancës, Raporti Vjetor i Auditimit si dhe në komunikimet tjera me publikun përmes ueb faqes, konferenca, tryeza e takime publike.

ZKA-ja ka të krijuar një sistem të menaxhimit të brendshëm, përmes të cilit mban përgjegjës të gjitha nivelet hierarkike. Bazë për këtë janë dokumente si Kodi i Etikës, Sistemi Elektronik i Auditimit SITA , si dhe rregullore, udhëzues e politika tjera të cilat e sigurojnë Auditorin e Përgjithshëm për performancën e përgjithshme të organizatës.

ZKA-ja bënë vlerësimin e performancës për të gjithë stafin një herë në vit sipas aktit në fuqi, rregullores 04/2020 për vlerësimin e rezultateve në punë. Megjithatë, ka nevojë për më shumë përpjekje për të instaluar një kulturë më të mirë të menaxhimit të performancës në organizatë. Për nga perspektiva e rritjes së cilësisë kjo është shumë e rëndësishme.

Auditorja e Përgjithshme synon që përmes projektit të bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë të rris fokusin në zhvillimin e Kornizës së Kompetencës e cila do të ketë të integruar të gjitha elementet nga vlerësimi i stafit, promovimi etj. Aktualisht ZKA-ja synon të nxis promovimin e brendshëm të punonjësve, përmes Rregullores 03/2021 për pranimin dhe karrierën në ZKA, programeve për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe trajnimeve të ndryshme. Theks i veçantë në këtë aspekt i është dhënë angazhimit dhe përfitimit nga projektet e bashkëpunimit me Institucionet Supreme të Auditimit, pjesëmarrja në programet e IDI-t, pjesëmarrja në grupe punuese, trajnime e programe të ndryshme të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t.

Dimension (ii): Komunikimi i brendshëm.

ZKA-ja nuk ka të hartuar politika për komunikimin e brendshëm, platformë apo plan specifik për komunikimin e brendshëm dhe si rrjedhojë nuk ka as një sistem të monitorimit për këtë. Gjithashtu, Intraneti i zhvilluar vite më parë nuk është funksional, ndërsa në pesë vitet e fundit pavarësisht përpjekjeve për themelimin e një buletini apo dokumenti tjetër informativ nuk ka arritur të vendos në zbatim këtë dokument si instrument komunikimi.

Megjithatë, në praktikë komunikimi i brendshëm në nivel horizontal dhe vertikal është i hapur dhe efektiv. Menaxhmenti informon dhe konsultohet me stafin në çështje të rëndësishme të veçantë. Për këtë qëllim përdoren forma dhe instrumente të ndryshme të komunikimit si takime, e-maila, SITA , platforma të ndryshme digjitale të komunikimit, folderët publik etj.

ZKA-ja ka të identifikuar vlerat kyçe dhe i komunikon ato rregullisht me stafin, përmes komunikimeve formale apo jo formale.

Gjetjet dhe vëzhgimet e vlerësimit

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Udhëheqja	<p>Kriteri: a, b, c, d, e, f, g, h, janë përmbushur</p> <p>Menaxhmenti ZKA-së mban takime të rregullta javore ku diskutohen çështje me interes për institucionin dhe për organizimin e punës në baza ditore. Kabineti i Auditorit të Përgjithshëm dokumenton të gjitha pikat e rëndësishme të agjendës që janë diskutuar. Mbi këtë bazë Auditori i Përgjithshëm mund të marrë vendimet e nevojshme.</p> <p>ZKA-ja ka të identifikuar vlerat kyçe dhe i komunikon ato rregullisht me stafin, përmes komunikimeve formale apo jo formale. Në vazhdimësi i promovon këto vlera edhe në komunikimet e jashtme përmes dokumenteve sic janë Plani Strategjik, Raporti Vjetor i Performancës, Raporti Vjetor i Auditimit si dhe në komunikimet tjera me publikun përmes ueb faqes, konferenca, tryeza e takime publike.</p>	4
(ii) Komunikimi i brendshëm	<p>Kriteri: a, d, f, nuk janë përmbushur, ndërsa kriteret: b, c, e, janë përmbushur</p> <p>ZKA-ja nuk ka të hartuar politika për komunikimin e brendshëm, një platformë apo plan specifik për komunikimin e brendshëm, si rrjedhojë nuk ka as një sistem të monitorimit për këtë. Gjithashtu, Intraneti i zhvilluar vite më parë nuk është funksional, ndërsa në pesë vitet e fundit pavarësisht përpjekjeve për themelimin e një broshure nuk ka arritur të vendos në zbatim këtë dokument si instrument komunikimi.</p>	2

4.2.5 SAI-7: Planifikimi i përgjithshëm i auditimit [2]

SAI-7 kërkon informacion mbi proceset që rregullojnë hartimin e një plani të përgjithshëm të auditimit, kontrollin dhe përbajtjen e këtij plani.

Ky tregues matet përmes dy dimensioneve:

(i) Procesi i planifikimit të përgjithshëm të auditimit/kontrollit

(ii) Përbajtja e përgjithshme e planit të auditimit/kontrollit

Vlerësimi i SAI-7 u bazua kryesisht në dokumentet si më poshtë;

- Ligji për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë¹⁰ (ndryshuar dhe plotësuar)
- Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës
- Planin strategjik i ZKA-së 2018- 2021
- Planin vjetor të auditimit 2021/22,
- Planin i shpërndarjes së stafit,
- Monitorimi-raportimi i planit të auditimit
- Manualin e auditimit; Financiar dhe pajtueshmëri; si dhe performancë
- Procesverbalet nga takimet e menaxhmentit dhe shënimet e brendshme në lidhje me planifikimin për temat e auditimit 2020-2021 (analiza e burimeve njerëzore, shprehja e interesit, analiza e ndërmarrjeve publike, propozimet e auditimeve të performancës etj.)
- Procesverbalet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike

Dimensioni (i) Procesi i planifikimit të përgjithshëm të auditimit/kontrollit

PVA hartohet duke marrë për bazë nenin 20 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Planin Strategjik të ZKA-së (2018-2021)¹¹, përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë¹².

Duke marrë parasysh se kryerja e një numri të madh të auditimeve është e obligueshme, ZKA-ja gjatë hartimit të planit vjetor të auditimit nuk ka mundësi të ndjek qasjen e bazuar në rrezik për auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë. Një qasje pjesërisht e bazuar në rrezik përdoret për auditimet e ndërmarrjeve publike. Megjithatë për auditimet jo mandatore, kryesisht kemi vërejtur se planifikimi hartohet duke analizuar kapacitet/burimet e mbetura në dispozicion. Gjithashtu mungon analizë për adresimin e kërkesave dhe pritshmërive të palëve të interesit.

Më poshtë është përshkruar procesi i ndjekur dhe mangësitë e identifikuara në këtë dimension.

ZKA-ja nuk ka procedurë të brendshme që përcakton procesin e planit vjetor. Megjithatë, në bazë të dëshmive të ofruara kemi vërejtur se procesi i planit vjetor të auditimit është i dokumentuar mjaftueshëm.

Hartimi i Planit Vjetor të Auditimit është kërkesë e paraparë me Ligj¹³.

¹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2524>

¹¹ <https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/09/Strategjia-2018-07-13-ALB.pdf>

¹² Megjithëse në ligjin për ZKA përdoret termi auditim i rregullsisë, sipas SNISA-ve të përditësuara nuk përdoret me tutje ky term. Ky lloj i auditimit tashme emërtohet me termin Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë, pasi që standardet SNISA-t i trajtojnë ndaras auditimet financiare nga ato të pajtueshmërisë.

¹³ LIGJI Nr. 05/L-055 PËR AUDITORIN E PËRGJITHSHËM DHE ZYRËN KOMBËTARE, neni 20

Zyra Kombëtare e Auditimit është e obliguar të kryej në baza vjetore auditimin e detyrueshëm të rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë)¹⁴. Kjo dispozitë e obligon ZKA-në për të kryer auditime të rregullsisë në gjitha institucionet publike që marrin buxhet nga shteti. Pra ZKA-ja është e obliguar që të auditojë në baza vjetore të gjitha këto organizata buxhetore që përbëjnë afërsisht 90% të auditimeve, pa i lejuar Auditorit të Përgjithshëm ndonjë hapësirë për tu lëshuar në kriteret tjera në përzgjedhjen e OB për auditim, siç është mundësia për të ndjekur metodologjinë e bazuar në rrezik ashtu siç kërkohet në kriterin ISSAI 40¹⁵.

Po ashtu, ne kemi vërejtur se përzgjedhja e auditimeve për ndërmarrjet publike bëhet përmes një analize ku përfshihet: mbulueshmëria e sektorëve të ndryshëm, përfshirja e NP-ve nga të tri nivelet (: qendrore, rajonale dhe lokale) ndjeshmëria dhe kompleksiteti i NP-ve etj. Mirëpo nuk kemi gjetur dëshmi se është bërë analizë e thellë e bazuar në rrezik. Vlen të përmendet që për auditimin e ndërmarrjeve publike, merren në konsideratë burimet dhe kapacitetet e mbetura në dispozicion.

Sipas ligjit¹⁶, Auditori i Përgjithshëm miraton Planin e Auditimit në baza vjetore dhe e dorëzon atë tek Komisioni për Mbikëqyrjen e financave Publike (KMFP), deri më 31 tetor të çdo viti. Në përputhje me këtë dispozitë ligjore dhe në afatin e paraparë, ZKA-ja ka finalizuar procesin e Planit Vjetor të Auditimit 2021/2022. Plani sipas praktikës është shqyrtuar edhe në Kuvendin e Kosovës, respektivisht në KMFP¹⁷.

Përveç ligjit, në manualin e auditimit, financiar dhe të pajtueshmërisë, dhe performancës, janë përkrahur kushtet që duhet të përmbajnë planet strategjike dhe vjetore të auditimeve si dhe përzgjedhja e temave.

ZKA-ja ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë lidhur me planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit dhe kontrollit të auditimit. Ky proces është i rregulluar përmes strukturës organizative dhe Rregullores (ZKA) nr. 01/2021 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Departamenti për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza, respektivisht drejtori i departamentit, nën udhëzime të drejtpërdrejta të Auditorit të Përgjithshëm dhe kabinetit të tij është përgjegjës për hartimin e planit vjetor të auditimit dhe raporton tek Auditori i Përgjithshëm për zbatimin dhe progresin e këtij plani. Ndërsa, për planin detaj të auditimit dhe monitorimin e zbatimit të tij, përgjegjës janë drejtorët e departamenteve të auditimit, të cilët raportojnë për progresin e arritur tek Ndhmës Auditorët e Përgjithshëm përkatës.

Po ashtu, menjëherë pas përgatitjes së planit vjetor, përgatitet edhe plani i shpërndarjes së stafit nëpër ekipe të auditimit, plan i cili përmban entitetet që do të auditohen, ekipet e autorizuara për secilin auditim, linjat e raportimit, etj. Pas konsolidimit të stafit, përgatiten edhe objektivat individuale të punës për të gjithë stafin, bazuar në përgjegjësinë e deleguar nga Auditori i Përgjithshëm.

Ndërsa, plani detaj i auditimit dhe plani kohor, përgatitet dhe monitorohet përmes SITA-as. Po ashtu, ky plan diskutohet në takime të niveleve të ndryshme të menaxhmentit, lidhur me progresin dhe ngecjet eventuale. Gjatë hartimit të planit të auditimit merren në konsideratë, **buxheti dhe resurset** në dispozicion. Ne kemi vlerësuar se menaxhmenti ka bërë analiza të burimeve njerëzore para

14 LIGJI Nr. 05/L-055 PËR AUDITORIN E PËRGJITHSHËM DHE ZYRËN KOMBËTARE, respektivisht neni 18, paragrafi 3 : Zyra Kombëtare e Auditimit është e obliguar të kryej në baza vjetore auditimin e detyrueshëm të rregullsisë.

15 ISSAI 40 Elementi 3, Procesi i planifikimit të auditimit/kontrollit ndjek një metodologji të bazuar në rrezik

16 LIGJI Nr. 05/L-055 PËR AUDITORIN E PËRGJITHSHËM DHE ZYRËN KOMBËTARE, neni 20

17 [Proc_nr_26_dft_16_11_2021_KMFP_D9S9dYhUYh.pdf \(kuvendikosoves.org\)](#)

shpërndarjes së stafit, duke marrë në konsideratë aftësitë dhe kompetencën e stafit, përvojën e punës etj. Po ashtu, është aplikuar procesi i shprehjes së interesit për pozitat e udhëheqësve të ekipeve. Gjatë shpërndarjes së stafit merren në, konsideratë ligje të tjera për të punësuarit si dhe nënat me fëmijë nën tre vjeç nga aspekti gjeografik i vendndodhjes së entiteteve nën auditim. Për të evituar konfliktin e mundshëm të interesit draft plani është qarkulluar te stafi dhe në rast të raportimit për konflikt të mundshëm të interesit, bëhet riallokimi i ekipeve.

Pavarësisht, se ZKA-ja në parim përkrah përfshirjen e palëve të interesit në procesin e përgatitjes së planit të auditimit, në vitin për të cilin është kryer vlerësimi nuk kemi gjetur dëshmi se janë marrë parasysh kërkesa nga të gjitha palët e interesit dhe janë analizuar ato. Bazuar në ISSAI 12:5 "ISA duhet të sigurojë që pritshmëritë e palëve të interesuara dhe rreziqet e shfaqura janë faktorizuar në planet e auditimit/ programi i kontrollit.

Dimensioni (ii) Përmbajtja e përgjithshme e planit të auditimit/kontrollit

Plani i auditimit, përmban auditimet e planifikuara, objektivat, afatin kohor, resurset në dispozicion etj.

Përmes planit të veçantë për shpërndarjes së stafit definohet qartë pozicioni dhe **linjat e raportimit dhe objektivat** për secilin staf të angazhuar në auditim. Përveç kësaj bazuar në titullin profesional dhe përgjegjësitë e përcaktuara në ekip përgatiten objektivat individuale të punës të cilat edhe nënshkruhen.

Plani detaj i auditimit, përfshin **planifikimin kohor** për secilin staf dhe secilin aktivitet. Plani vjetor i auditimit i pasuar me planet e detajuara, hartohen në përputhje me përbushjen e obligimeve ligjore, respektivisht Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055 dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike (me plotësim ndryshime)03/L-048. PVA zbatohet nga 1 shtatori 2021 deri më 31 gusht 2022. Auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) në subjektet individuale kryhen për çdo vit, duke filluar në shtator, ndërsa përfundojnë me raportet e auditimit, të cilat publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve të rregullsisë përmbyllet në fund të muajit gusht, kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës dhe publikohet në ueb faqen e ZKA-së. Ndërsa, fushat, objektivat, koha e auditimit dhe e raportimit të auditimeve të performancës përcaktohen në Planin Vjetor të Auditimit. Plani kohor për auditimet me marrëveshje përcaktohet bazuar në marrëveshjet/kontratat me donatorë.

Plani përmban elemente të përgjithshme të **buxhetit dhe resurseve në dispozicion**. Mirëpo, ne kemi vërejtur se mungon analizë e thellë e rrezikut për planin e auditimit apo rreziqeve për të mos kryer punën sipas planit. Megjithatë disa faktorë të mundshëm të rrezikut janë përmendur në hyrje të këtij plani.

Dimensioni	Gjetjet	Nota
<i>(i) Procesi i planifikimit të përgjithshëm të auditimit/kontrollit</i>	Kriteret: b, d, e, f janë përmbushur Kriteret: a, c dhe g nuk janë përmbushur Procesi i ndjekur për hartimin e planit vjetor është i dokumentuar mjaftueshëm, pavarësisht se mungon procedura e brendshme që përcakton procesin e planit vjetor. Për hartimin e planit vjetor të auditimit, ZKA-ja merr për bazë të gjitha obligimet sipas mandatit. Duke qene e obliguar të auditojë të gjitha institucionet që marrin buxhet nga shteti, ZKA-ja nuk mund të aplikoj hartimin e planit vjetor bazuar në rrezik. Kjo për shkak se resurset duhet të orientohen për kryerjen e auditimeve mandatore. ZKA-ja kryen një numër të vogël të auditimeve të performancës dhe ndërmarrjeve publike. Në mungesë të kapaciteteve dhe mungesës së një analizë të mirëfilltë mund të nxjerrim përfundimin se nuk merren në konsideratë dhe nuk adresohen pritjet nga palët e interesit siç parashikohet në ISSAI 12.	1
<i>(ii) Përmbajtja e përgjithshme e planit të auditimit/kontrollit</i>	Kriteret: a, b, c, d , janë plotësuar Kriteri: e nuk është plotësuar Plani i auditimit, përmban auditimet e planifikuara, objektivat, afatin kohor, resurset në dispozicion etj. Ndërsa, planet e tjera përcjellëse, sigurojnë se objektivat dhe përgjegjësitë janë të qarta për stafin. Ndërsa, mungon një analizë e detajuar lidhur me rreziqet e mos zbatimit të planit të përgjithshëm.	3

4.3 Domeni C: Cilësia e Auditimit dhe Raportimi

Domeni C synon të vlerësojë cilësinë si dhe rezultatet e punës së auditimit/kontrollit që përfaqëson funksionin thelbësor të çdo ISA. Domeni C përfshin 13 tregues.

Domeni C: Cilësia e Auditimit dhe raportimi		Dimensioni				Notimi i përgjithshëm
Treguesi	Emri	i	ii	iii	iv	
SAI-8	Mbulueshmëria me auditim	4	2	1		2
SAI-9	Standardet e Auditimit Financiar dhe Menaxhimi i Cilësisë	4	4	4		4
SAI-10	Procesi i auditimit financiar	3	3	4		3
SAI-11	Rezultatet e auditimit Financiar	2	4	4		3
SAI-12	Standardet e Auditimit të Performancës dhe Menaxhimi i Cilësisë	2	3	2		2
SAI-13	Procesi i Auditimit të Performancës	2	3	3		3
SAI-14	Rezultatet e Auditimit të Performancës	4	4	2		3
SAI-15	Standardet e Auditimit të Pajtueshmërisë dhe Menaxhimi i Cilësisë	4	4	4		4
SAI-16	Procesi i Auditimit të Pajtueshmërisë	1	4	4		3

SAI-17	Rezultatet e Auditimit të Pajtuëshmërisë	2	4	4		3
SAI-18	Standardet e Auditimit të Kontrollit Juridiksional dhe Menaxhimi i Cilësisë					n/a
SAI-19	Procesi i Auditimit të Kontrollit Juridiksional					n/a
SAI-20	Rezultatet e Kontrollit Juridiksional					n/a

4.3.1 SAI-8: Mbulueshmëria e Auditimit – Nota [2]

Ky tregues mat mbulueshmërinë e auditimit të arritur nga ISA në tri disiplinat kryesore të auditimit: financiar, performancë dhe pajtuëshmëri. Ndërsa, dimensiononi i katërt nuk është i aplikueshëm.

Ky tregues ka katër dimensione:

(i) Mbulimi i auditimit financiar.

(ii) Mbulimi, përzgjedhja dhe objektivi i auditimit të performancës.

(iii) Mbulimi, përzgjedhja dhe objektivi i auditimit të pajtuëshmërisë.

(iv) Mbulimi i Kontrollit Juridiksional 18.

Dimensiononi (i): Mbulimi i auditimit financiar

Ky dimension vlerëson nivelin e mbulueshmërisë së auditimit të pasqyrave financiare vjetore të publikuara.

Meqenëse ZKA-ja ka mandat ligjor, të rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055, për auditimin e të gjitha entiteteve të sektorit publik të cilat përgatisin pasqyrat financiare vjetore, ky dimension është kategorizuar me **notën 4**.

Gjatë periudhës së auditimit 2020/2021, ZKA-ja kishte kryer gjithsej 127 auditime, ku përfshihen: Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, 90 Organizata Buxhetore dhe 12 ndërmarrje publike, 11 auditime të performancës dhe 13 projekte të financuara nga Banka Botërore dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

Gjatë këtij sezoni 100% e pasqyrave financiare vjetore të pranuar nga ZKA-ja janë audituar. Dhe si rezultat mbulueshmëria e auditimit financiar dhe të pajtuëshmërisë është arritur me sukses.

Dimensiononi (ii): Mbulimi, Përzgjedhja dhe Objektivi i Auditimeve të Performancës

ZKA-ja është e obliguar që të kryej auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtuëshmërisë), mirëpo sipas ligjit ka mandat të kryej edhe auditime të performancës. Auditimet e performancës janë po aq të rëndësishme sa edhe auditimet financiare dhe të pajtuëshmërisë. Auditimet e performancës janë të orientuar drejt ekzaminimit të performancës, ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike. Auditimet e performancës mbulojnë jo vetëm operacione specifike financiare, por një gamë më të gjerë të veprimtarisë së qeverisë që përfshin si sistemet organizative ashtu edhe ato administrative.

¹⁸ Ky dimension nuk është pjesë e këtij vlerësimi

Auditimet e performancës të ndërmarra nga ZKA-ja janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim, që janë në përputhje me kërkesat e ISSAI 100:22. Të gjitha raportet e vlerësuara nga ekipi, përmbajnë një apo më shumë nga tri elementet e auditimit të performancës.

ZKA-ja gjatë pesë viteve të fundit ka kryer 57 auditime të performancës duke mbuluar fusha me rëndësi siç janë: zhvillimi ekonomik, edukimi, mbledhja e të hyrave, mjedisi, shëndetësia, financa publike, infrastruktura, siguria sociale dhe tregu i punës, etj. Pra fushat e mbuluara plotësojnë kriteret bazuar në ISSAI 12:5, ISSAI 300:36.

ZKA-ja nuk ka plan strategjik për përzgjedhjen e temave të auditimit të performancës. Prandaj, temat e auditimit nuk përzgjidhen “nëpërmjet procesit të planifikimit strategjik (dhe/ose operacional) të ISA-së, i cili mundëson që të analizohen temat e mundshme dhe të kryhen kërkime për të identifikuar rreziqet dhe problemet”, ashtu siç kërkohet nga ISSAI 300:36.

Në ZKA, **procesi i përzgjedhjes së temave të auditimit** bëhet në baza vjetore. Ky proces fillon me propozimin e temave nga niveli poshtë - lartë, ku secili anëtar i ekipit propozon tema të auditimit, bazuar në një hulumtim paraprak. Procesi i përzgjedhjes së temave pastaj diskutohet dhe prioritetizohet në nivele të ndryshme menaxheriale. Për shkak se ZKA-ja, është e obliguar të kryej auditimin (financiar dhe të pajtueshmërisë) e të gjitha organizatave buxhetore, shumica e kapaciteteve janë të orientuar në përmbushjen e mandatit ligjor, si rrjedhojë numri i auditimeve të performancës është më i vogël dhe para se temat të përzgjidhen dhe të vendosen në PVA merren në konsideratë kapacitet apo burimet në dispozicion. Në disa raste angazhon edhe ekspertë të jashtëm. Megjithatë, në planet e auditimit dhe temat e përfshira duhet ti nënshtrohen një procesi nga lartë- poshtë me analiza me të thella të rrezikut në sektorin publik¹⁹

Bazuar në ISSAI 300, gjatë fazës së planifikimit auditorët e ZKA-së duhet të marrin parasysh rëndësinë e temës, duhet të vlerësohet nëse tema është e auditueshme si dhe procesi i përzgjedhjes së temës duhet të synojë të maksimizojë ndikimin e pritur të auditimit si dhe të kenë parasysh kapacitetet e auditimit. Ne kemi vlerësuar se formati i propozimit të temave të auditimit përmban të gjitha këto elemente.

Gjithashtu, ZKA-ja nuk ka një proces interaktiv me palët e interesit, proces i cili do të siguronte se janë kuptuar pritshmëritë e palëve dhe rreziqet e shfaqura janë faktorizuar në planet e auditimit, ISSAI 12:5.

Megjithatë gjatë intervistave dhe dëshmimeve të ofruara, ne kemi kuptuar se ka pasur raste kur së bashku me shoqërinë civile dhe institucionet akademike janë diskutuar temat e mundshme të auditimit, para se ato të hyjnë në planin e auditimit. Mirëpo, për shkak të pandemisë dhe faktorëve të tjerë në dy vitet e fundit, kjo praktikë nuk është zbatuar. Ndërsa, kërkesat për auditim nga Kuvendi adresohen përmes Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike, për të cilat vendos Auditori i Përgjithshëm nëse do të auditohen apo jo.

¹⁹ISA duhet të vendos prioritete për auditimin e performancës bazuar në nocionin se ekonomia, efikasiteti dhe efektiviteti janë objektiva auditimi të një rëndësie të njëjtë me ligjshmërinë dhe rregullsinë e menaxhimit financiar dhe kontabilitetit. ISSAI 1:4

ZKA-ja është duke punuar intensivisht në përmirësimin e procesit të auditimeve të performancës, fillimisht duke rregulluar procesin e planit strategjik të performancës, me ç’rast është hartuar edhe nënshkruar Udhëzuesi për Planifikimin Strategjik të Auditimeve të Performancës. Ky udhëzues është hartuar me përkrahjen e USAID²⁰ dhe ekspertëve të angazhuar në bashkëpunim me një grup auditorë të performancës. Megjithatë deri në kohën kur është kryer ky vlerësim, udhëzuesi nuk ka gjetur zbatim.

Dimensioni (iii): Mbulimi, Përzgjedhja dhe Objektivi i Auditimeve të Pajtuëshmërisë

Gjatë vitit 2020 ZKA-ja ka nxjerrë Doracakun për Auditimin e Pajtuëshmërisë (auditim i pavarur i pajtuëshmërisë), mirëpo ky Doracak ende nuk është aprovuar. Si rrjedhojë, ZKA-ja ende nuk ka filluar të bëjë auditime të veçanta të pajtuëshmërisë.

Megjithatë me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit është e obliguar të kryej në baza vjetore auditimin e rregullsisë si qasje e kombinuar (financiar dhe të pajtuëshmërisë) të të gjitha organizatave buxhetore²¹. Edhe pse qasja për secilin lloj të auditimit ndryshon, megjithatë përdoret e njëjta dosje dhe pako e letrave të punës (duke përfshirë pjesën financiare dhe ato të pajtuëshmërisë). Si rrjedhojë, ZKA-ja nuk mund të bëjë përzgjedhjen e temave të auditimit dhe as përzgjedhja e tyre nuk bëhet bazuar në rrezik dhe materialitet.

Prandaj, pavarësisht kësaj në baza vjetore ZKA-ja kryen auditimin e pajtuëshmërisë (në kuadër të auditimeve të rregullsisë në baza vjetore) duke përfshirë në këto auditime tri fusha të rëndësishme si: prokurimi, pagat dhe mbledhja e të hyrave.

Si rezultat i kësaj, edhe në gjatë këtij vlerësimi kemi bërë rishikimin e mostrave të njëjta dhe dosjeve të tyre, meqenëse është qasje e kombinuar. Mirëpo, këto mostra janë trajtuar ndaras sipas natyrës së kritereve të kërkuara.

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i)	Kriteri a është përmbushur ISA ka arritur të kryej auditimin e pasqyrave financiare për të gjitha Organizata Buxhetore, duke përmbushur mandatin e saj.	4
(ii)	Kriteret b, e, f, g, h janë përmbushur Kriteret a, c, d nuk janë përmbushur ZKA-ja ka mandat të kryej auditime të performancës. Gjatë pesë viteve të fundit ka kryer auditime me tema të rëndësishme. Mirëpo, ZKA-ja ende nuk ka proces dhe plan strategjik për përzgjedhjen e temave të auditimit të performancës, i cili do të siguronte se të gjitha pritshmëritë e palëve të treta janë marrë në konsideratë dhe janë analizuar. Megjithatë gjatë planit vjetor të auditimit, përzgjedhja e temave behet duke marrë në konsideratë rëndësinë e temës,	2

²⁰ Projekti USAID Transparent, Effective and Accountable Municipalities (USAID TEAM)

²¹ Niveli i zbatimit të standardeve të auditimit të pajtuëshmërisë përshkruhet me gjerësisht në SAI 15

	auditueshmërinë, maksimizimi i përfitimit si dhe kapacitetet/burimet në dispozicion.	
(iii)	<p>Kriteret a dhe d janë përmbushur Kriteri b nuk është përmbushur, ndërsa c nuk aplikohet</p> <p>ZKA-ja ka arritur të kryej auditimin e pajtueshmërisë për të gjitha Organizatat Buxhetore, duke përmbushur mandatin e saj. Mirëpo, ISA nuk kryen auditime të veçanta të pajtueshmërisë, rrjedhimisht nuk mund të përzgjedhë temat e auditimit bazuar në rrezik dhe materialitet, prandaj është vlerësuar me 1.</p>	1

4.3.2 SAI 9- Standardet e Auditimit Financiar dhe Menaxhimi i Cilësisë – Nota [4]

Përmes këtij indikator kemi vlerësuar qasjen e ZKA-së për auditimin financiar sa i përket standardeve dhe udhëzimeve të përgjithshme për auditimin e rregullsisë (financiar dhe i pajtueshmërisë)²², menaxhimit të ekipeve të auditimit, si dhe aftësive dhe kontrollit të cilësisë në nivel të angazhimit të auditimit.

Edhe pse ZKA-ja kryen auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë me të njëjtin Manual, megjithatë standardet e aplikuara dhe procesi i zhvilluar është i ndryshëm në mes tyre. Po ashtu në raportin e auditimit, ZKA-ja jep Opinion financiar për pasqyrat financiare vjetore, kurse në aspektin e pajtueshmërisë për vitin 2020 ka dhënë Konkluzion të pajtueshmërisë në relacion me kornizën ligjore. Prandaj edhe indikatorët janë vlerësuar të ndara nga njëra tjetra.

Vlen të specifikohet që ZKA-ja ka të hartuar edhe Doracakun për Auditim të Pajtueshmërisë (auditim i veçantë), i cili ende nuk është miratuar nga Auditori i Përgjithshëm, dhe si rrjedhojë nuk është kryer asnjë auditim i veçantë në fushën e pajtueshmërisë.

Vlerësimi i funksionimit të nivelit organizativ, bëhet në pjesë tjera të këtij raporti, përkatësisht te indikatorët e kontrollit të cilësisë SAI-4 dhe zhvillimi profesional dhe trajnimet te SAI- 23.

Ky indikator përfshinë tri dimensione:

- (i) Standardet dhe Politikat e Auditimit Financiar;**
- (ii) Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit të auditimit financiar; dhe**
- (iii) Kontrolli i Cilësisë në Auditimin Financiar.**

Vlerësimi i indikatorit SAI-9 është bazuar kryesisht në:

- Ligji nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
- Doracaku i Auditimit Financiar dhe Pajtueshmërisë, 2020 (metodologjia e qasjes së kombinuar);
- Pako e letrave të punës për Auditimin Financiar dhe të Pajtueshmërisë;

²² Doracaku i Auditimit Financiar dhe i Pajtueshmërisë (qasje e kombinuar), është udhëzues për kryerjen e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë. Edhe pse është i njëjti doracak, në këtë indikatorë do të vlerësohet pjesa e auditimit financiar.

- Kodi i etikës, 2018;
- Udhëzuesi i Kontrollit të Cilësisë për auditimet e rregullsisë;
- Rregulloren nr.01/2021 për Organizim të Brendshëm;
- Rregulloren nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; dhe
- Ligji nr.03/ L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Dimensionin (i): Standardet dhe Politikat e Auditimit Financiar

Sipas vlerësimit tonë, ky dimension është kategorizuar me **notën 4**, për arsye se nga 22 kriteret e përcaktuara në këtë dimension janë të përmbushura apo të arritura të gjitha prej tyre.

SAI 9 (i)- përmbledh në përgjithësi kushtet dhe ambientin e auditimit financiar konform kornizës për raportim financiar dhe menaxhimin të përgjegjësive. Për vlerësim të këtij dimensionin kemi marrë për bazë dhe kemi analizuar Ligjin për ZKA, ligjet për Menaxhim të Financave Publike dhe raportim vjetor financiar, si dhe në mënyrë të detajuar kemi trajtuar Doracakun për Auditim Financiar dhe të Pajtuëshmërisë.

Sipas Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055, ZKA është e obliguar të kryej në baza vjetore auditimin e detyrueshëm të rregullsisë së:

- Raportit të Qeverisë për Buxhetin e Kosovës;
- Të gjitha organizatave buxhetore të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë pranuar një buxhet përmes Ligjit vjetor të Buxhetit dhe janë të obliguara të hartojnë Pasqyra Vjetore Financiare;
- Po ashtu, mund të kryej auditime të detyrueshme të rregullsisë në ndërmarrjet publike, apo çfarëdo institucioni i cili përdorë paranë publike në një formë apo tjetër.

Nga kjo, mund të themi se ky Ligj specifikon qartë mandatin e ZKA-së për auditim financiar të pasqyrave vjetore financiare, si dhe rregullon kushtet dhe kriteret për realizimin e një auditimi të tillë.

Po ashtu, si dëshmi shtesë për rregullimin dhe sqarimin e mandatit të ZKA-së është marrë edhe Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive 03/L-048, ku thekson se 'Auditori i Përgjithshëm do të përgatisë dhe t'i dorëzojë Kuvendit një raport mbi deklaratat financiare të BO-ve dhe NP-ve për vitin e kaluar fiskal. Nëse BO-ja është komunë, raporti po ashtu duhet t'i sigurohet kuvendit komunal. Ky raport do të parashtrojë opinionet e Auditorit të Përgjithshëm mbi atë se nëse deklaratat financiare të këtyre BO-ve japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të financave të këtyre organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike'.

Ndërkaq, sa i përket vlerësimit të metodologjisë për realizimin e auditimit financiar, si bazë kemi trajtuar Doracakun e Auditimit Financiar dhe të Pajtuëshmërisë (qasje e kombinuar).

Ky Doracak është azhurnuar dhe ndryshuar gjatë vitit 2020, në bashkëpunim me Institucionin Suprem të Auditimit të Polonisë. Përveç ndryshimeve tjera, risi në këtë Doracak ka qenë dhënia e

opinionit/ konkluzionit për pajtueshmëri. Në këtë udhëzues përshkruhen qartë të gjitha procedurat për realizimin e auditimit të rregullsisë, duke filluar nga faza e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të auditimit. Brenda këtij dokumenti, përveç përshkrimit të procedurave dhe letrave të punës, janë dhënë edhe shembuj konkret për realizimin sipas rasteve përkatëse.

Ky doracak është miratuar në pajtueshmëri me Kornizën e Deklarimeve Profesionale të INTOSAI-t (KDPI), të cilat përfshijnë Parimet Themeluese dhe Thelbësore të INTOSAI-t; Standardet e INTOSAI-t, të cilat përmbajnë Parimet Themelore të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA 100-129); Kërkesat Organizative të ISA-ve (SNISA 130-199); Parimet e Auditimit Financiar (SNISA 200-299); Parimet e Auditimit të Pajtueshmërisë (SNISA 4000-499); Standardet e Auditimit Financiar (SNISA 2000-2899), si dhe Standardet e Auditimit të Pajtueshmërisë (SNISA 4000-4899). Këto dy grupe të fundit të standardeve janë përdorur kryesisht për zhvillimin e procesit të detajuar të auditimit financiar dhe pajtueshmërisë së ZKA-së.

Dokumentimi dhe dëshmitë në auditim

Në Doracakun për Auditim Financiar dhe të Pajtueshmërisë, janë të prezantuar dhe sqaruar të gjitha hapat që duhet ndjekur për fillimin e një auditimi. Meqenëse auditimi i pasqyrave financiare të subjekteve publike, janë të detyrueshme për ISA-në dhe ky Doracak është përgatitur në pajtim me ISSAI-të, atëherë secili hap gjatë një auditimi është i rregulluar dhe kushtëzuar me dokumentet e nevojshme.

Si rrjedhojë, për fillimin e një auditimi duhet të bëhet planifikimi i qartë duke dokumentuar kështu Vlerësimin e Rreziqeve në Auditim; Planifikimin e përgjithshëm strategjik; të kuptuarit entitetit si dhe vlerësimin e rreziqeve të vetvetishme dhe të kontrollit; Rishikimin Analitik; Programet e auditimit (testet e kontrollit, substanciale dhe të pajtueshmërisë); Vlerësimin e rreziqeve nga mashtrimi apo mos pajtueshmërive me kornizën ligjore; përcaktimi i materialitetit dhe dokumentimi i tij; përzgjedhjen e mostrave pas analizave të të dhënave, dhe konfirmimet e jashtme.

Përderisa në fazën e ekzekutimit dhe raportimit të auditimit, janë përcaktuar letrat e punës të cilat duhet plotësuar dhe analizuar për të dokumentuar implementimin e një auditimi, si dhe dokumentimin për dhënien e një opinionit. Para dhënies së opinionit, ekipi i auditimit duhet të dokumentoj secilën mostër dhe gjetje me dëshmitë përkatëse, duke dhënë bazë të arsyeshme për prezantimin e tij në raportin e auditimit.

Të gjitha këta hapa dokumentohen përmes së ashtuquajturës Dosje e Auditimit, ku vendosen të gjitha letrat e punës dhe dëshmitë e një auditimi të realizuar (të gjitha fazat e një auditimi).

Përveç kësaj, në vitin 2020 ZKA ka filluar implementimin e softuerit të auditimit SITA, ku përmes këtij softueri dokumentohen të gjitha auditimet e kryera. Puna e realizuar gjatë këtij viti, ka dëshmuar se SITA është i sigurt sa i përket sigurisë së të dhënave, dhe se i tërë procesi i auditimit regjistrohet dhe evidentohet në këtë softuer (dosja e auditimit- planifikimi, ekzekutimi dhe raportimi). Qasja në auditime është e rregulluar sipas angazhimeve të auditorëve, të përcaktuar sipas Planit Vjetor. Po ashtu, funksionimi i hierarkisë së kontrollit dhe aprovimit të auditimeve, rregullohet dhe bëhet përmes SITA-s.

Komunikimi

Sipas Doracakut të Auditimit, komunikimi i ZKA-së me entitetin e audituar duhet të fillojë nga momenti i informimit për fillimin e auditimit dhe kërkesës për përcaktimin e personit kontaktues në kuadër të entitetit të audituar. Ky informim bëhet nga departamenti i auditimit për Zyrtarin Kryesor Administrativ të entitetit, përmes një letre angazhimi ku informohen për planin, përgjegjësitë e ZKA-së dhe të entitetit të audituar, kërkohen dokumentet e nevojshme për realizimin e atij auditimi, si dhe interpretohen personat të cilët përbëjnë ekipin. Si formë tjetër e komunikimit është edhe zhvillimi i intervistave me personat përgjegjës në entitet, si dhe dokumentimi i tyre në dosjen e auditimit.

Dimension i (ii): Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit të auditimit financiar

Ky dimension i SAI 9 (ii)- vlerëson nëse ZKA-ja ka vendosur një sistem për të siguruar se anëtarët e ekipit të auditimit si pjesë e stafit, posedojnë kompetencë dhe aftësi profesionale të mjaftueshme për të kryer një auditim, sipas kërkesave të ISSAI 200.

Për vlerësimin e këtij dimension kemi marrë për bazë Doracakun e Auditimit dhe planet e trajnimeve për zhvillim të vazhdueshëm profesional për stafin auditues, dhe është kategorizuar me **notën 4**, sepse të gjitha kriteret e përcaktuara janë përmbushur.

ZKA-ja ka të vendosur një sistem për të siguruar se i gjithë stafi auditues, ka përvojën dhe kompetencën profesionale për kryerjen e një auditimi financiar. Kjo sigurohet fillimisht në plotësimin e kriterëve gjatë rekrutimit, dhe njëkohësisht kërkesave të brendshme për certifikim apo trajnim të vazhdueshëm profesional.

Po ashtu, si bazë e vlerësimit është marrë edhe Rregullorja për Klasifikim të Vendeve të Punës nr. 02/2021. Me këtë Rregullore janë përcaktuar qartë kriteret të cilat duhet plotësuar për ushtruar detyrat përkatëse. Përveç shkollimit dhe certifikimit të kërkuar për auditorë, ndër tjerash si kriter që duhet plotësuar përcaktohet edhe përvoja e duhur në auditim. Pozitat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara sipas detyrave të auditorëve. Që do të thotë se për të ushtruar një pozitë menaxheriale apo pozitë me përgjegjësi më të larta, përveç tjerash kërkohet edhe përvoja disa vjeçare në auditim, e disa prej tyre brenda vet ZKA-së.

Gjithashtu në Doracakun e Auditimit, janë prezantuar rolet dhe përgjegjësitë e secilës pozitë të përshkruar në Strukturën Organizative. Si rrjedhojë, secili auditor varësisht pozitës që ushtron brenda ZKA-së, e ka të rregulluar rolin e vet për auditimet e angazhuara, si dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga ky auditim. Kështu, pozita e Drejtorit të Auditimit është caktuar si përgjegjës për menaxhimin e një departamenti të auditimit, ku përfshihen disa auditime dhe së paku dy apo tre ekipe të auditimit. Si linjë menaxheriale vijon Udhëheqësi i Ekipit, ku menaxhon dhe organizon punën dhe anëtarët e ekipit të auditimeve të përcaktuara me plan vjetor. Si dhe anëtarët e ekipeve, me profile të ndryshme të përvojave dhe certifikimeve ku kontribuojnë në kryerjen e auditimit dhe kompletimin e dosjes së auditimit në bashkëpunim me UE.

Nga kjo:

- Drejtori i auditimit apo ndryshe të ashtuquajturit 'Rojtarët e Cilësisë' është përgjegjës që të sigurojë se ekipi punon në pajtim me standardet dhe etikën profesionale të përvetësuar nga zyra. Ata po ashtu do të formulojnë strategjinë e auditimit për angazhimet individuale, duke i reflektuar zhvillimet e jashtme si të domosdoshme. Sipas kërkesës, ata do t'i rishikojnë vendimet e marra gjatë auditimit. Ata mbajnë dhe promovojnë kontaktet me jashtë për promovimin e qëllimit të auditimit. Ata po ashtu janë përgjegjës për të siguruar që burimet e shfrytëzuara të auditimit janë në kuadër të planit ose nëse jo, që ndryshimet në plan janë dakorduar për të ardhmen, dhe në mënyrë përkatëse.

Ata po ashtu do t'i rishikojnë dhe do të marrin vendime lidhur me raportet që duhet të përgatiten në përfundim të auditimit, duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, ndonjë prej raporteve zyrtare të auditimit që duhen përgatitur dhe opinionet që duhen dhënë.

- Udhëheqësi i ekipit ka përgjegjësi të përditshme për menaxhimin e auditimit. Ai e udhëheq ekipin në kryerjen e vlerësimit të rrezikut të entitetit dhe përgatit propozimet përfundimtare për Memorandumin planifikues të auditimit (ku përfshihet planifikimi i detajuar lidhur me njohjen e mjedisit të kontrollit të entitetit të audituar dhe vlerësimin e çdo rreziku të mundshëm që lidhet me Pasqyrat Financiare), si dhe çfarëdo procedure shtesë (substanciale) që do të shfrytëzohet për auditim. Formulon pikëpamjet për rekomandimet lidhur me rreziqet e përfshira dhe burimet e kërkuara, duke përfshirë edhe aftësitë e ndonjë eksperti që mund të nevojitet. Udhëheqësi i ekipit, po ashtu merr vendime lidhur me metodat e auditimit që do të përdoren dhe kryen punën e nevojshme për sigurimin e cilësisë. Veç kësaj, nga ai pritet të jetë vigjilent ndaj problemeve në momentin kur ato paraqiten, duke përdorur masat përkatëse të sigurimit të cilësisë, siç janë diskutimet e rregullta me anëtarët e ekipit gjatë kryerjes së punës.
- Auditorët pjesëmarrës marrin pjesë në punën planifikuese për çdo detyrë. Ata i kryejnë angazhimet e auditimit dhe i dokumentojnë dëshmitë në fazën e ekzekutimit të bazuar në planin e auditimit. Ata sigurojnë që kjo është organizuar si duhet, si bazë për hartimin e raportit në përfundim të secilit angazhim.
Të gjithë anëtarët e ekipit kanë një përgjegjësi individuale dhe kolektive për të rrënjosur cilësinë në secilin angazhim. Kjo përfshinë edhe të qenit në dijeni të objektivave të angazhimeve të caktuara, arritjen e gjykimeve të mirë informuara, të bazuara në dëshmi, komunikim të çështjeve kryesore tek udhëheqësi i ekipit, dhe dokumentimin e gjykimeve dhe vendimeve në dosjen e auditimit.
- Puna e ofruar nga specialistët duhet të planifikohet për mundësinë, sipas nevojës, që të përdoren resurset e specialisteve për angazhimet, përfshirë ekspertet e ZKA-së dhe të sigurohen që ata të përdoren në fazat e duhura.

Të njëjtën kohë, në momentin e angazhimit të ekipit të auditimit, secili auditor i përfshirë në ekipin përkatës nënshkruan objektivat dhe përgjegjësitë e veta lidhur me atë auditim. Këto objektiva përcaktohen në baza vjetore në nivel të linjës menaxheriale.

Në të njëjtën kohë, janë theksuar standardet të cilat auditori i ka për detyrë të i njoh dhe të i analizoj për kryerjen e një auditimi (ISSAI 200).

Sa i përket zhvillimit të vazhdueshëm profesional, aftësive dhe përvojës së nevojshme për kryerjen e një auditimi financiar, ISA ka marrëveshje me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës (si Institucion i akredituar për certifikimin e auditorëve dhe kontabilistëve), për certifikimin e stafit në sektor publik dhe privat. Ky është edhe njëri prej kriterëve të cilin duhet plotësuar për angazhimin e auditorëve (e rregulluar kjo me Rregulloren nr. 02/2021).

Përveç kësaj, me planin vjetor të trajnimeve, auditorët i nënshtrohen trajnimeve të ndryshme sipas nevojës në baza vjetore. Ky plan analizohet sipas azhurnimeve të mundshme të standardeve apo ligjeve në vend, e të cilat janë të nevojshme për auditim. Gjithashtu, nga SHKÇAK organizohen trajnimet për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si kriter për mbajtjen e auditorëve të azhurnuar, me ç' rast pajisen me certifikate.

Meqenëse gjatë vitit 2020 është ndryshuar Doracakun i Auditimit Financiar dhe të Pajtushmërisë dhe njëkohësisht hyrja në funksion e softuerit të auditimit SITA, gjatë kësaj periudhe janë ndjekur trajnimet nga i gjithë stafi auditues për të dyja fushat.

Trajnimi lidhur me Doracakun është mbajtur gjatë vitit 2020 dhe një pjesë në vitin 2021, nga ekspertë të Institucionit Suprem të Auditimit të Polonisë, ku pjesëmarrës kanë qenë të gjithë auditorët. Në fund të këtij trajnimi, stafi i është nënshtuar një testi provues ku edhe janë pajisur me certifikata.

Po ashtu, edhe për softuerin e auditimit, stafi është trajnuar nga ekspertët e kontratës dhe njëkohësisht janë shkëmbyer idetë dhe nevojat të cilat janë paraqitur për integrimin e tyre në softuer.

Vlen të theksohet se ky vit ka qenë sfidë si për stafin, po ashtu edhe për ISA në përgjithësi. Këto sfida kanë reflektuar edhe në punë, sidomos në përmbushjen e afateve kohore të planifikuara. Prandaj për auditimet e vitit 2020 ka pasur vonesa në publikimin e Raportëve të Auditimit, si rezultat i ndryshimeve brenda ISA-së e po ashtu edhe për shkak të situatës me pandeminë COVID-19.

Dimensioni (iii): Kontrolli i Cilësisë në Auditimin Financiar

Dimensioni 9 (iii)- ka të bëjë me procedurat e rregulluara për kontrollin e cilësisë, si dhe aplikimin e tyre në praktikë, dhe është kategorizuar me **notën 4**, sepse të gjitha kriteret e përcaktuara janë përmbushur.

Për ta trajtuar këtë dimension, kemi vlerësuar procedurat e shkruara në Doracakun e Auditimit, Udhëzuesin për Kontrollin e Cilësisë për auditimin e rregullsisë, pakon e aprovuar të letrave të punës si dhe regjistrimin e tyre në softuer.

Këto procedura duhet të sigurojnë se plotësohen standardet profesionale ndërkombëtare, korniza ligjore në vend, si dhe sigurimin e cilësisë në punë me qëllim të arritjes së një auditimi dhe raportimi sa më profesional.

Ashtu siç e kemi theksuar në dimensionin e dytë, ZKA-ja ka të rregulluar dhe vendosur një sistem për kontrollin e cilësisë brenda zyrës. Konform kësaj sipas Rregullores nr.01/2021 për Organizimin

e Brendshëm dhe Rregullores nr.02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës, janë përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e fillimisht secilit departament dhe njëkohësisht edhe secilës pozitë brenda këtyre departamenteve.

Në Departamentet operative përgjegjëse për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Pajtushmërisë janë caktuar pikat të cilat e specifikojnë mandatin dhe detyrat e këtij departamenti. Ky udhëhiqet nga drejtori i departamentit, i cili pastaj i raporton Ndhmës Auditorit të Përgjithshëm.

Si pikë kyçe është edhe pozita e Udhëheqësit të Ekipit, ku përveç organizimit të punës dhe ekipit të auditimit, raporton te Drejtori i Departamentit.

Për mënyrën e rishikimit të punës gjatë auditimit janë të rregulluar me hapa të caktuara në Doracakun e Auditimit. Mënyra e kontrollit të cilësisë është e rregulluar edhe përmes SITA-s, ku çdo letër e punës e vendosur në dosje vlerësohet nga UE dhe DA dhe aprovohet për të vazhduar tutje.

Për periudhën e planifikimit të auditimit, pas përfundimit të pakos së letrave të punës për këtë fazë në fund përgatitet Memorandumi i Planifikimit të Auditimit ku prezantohet plani strategjik për auditim, duke përfshirë pikat kyçe që duhen për këtë fazë, si: materialitetin, konkluzionet për vlerësim të kontrolleve, mostrimi, objektivat e auditimit dhe planin e detajuar kohor për realizimin e atij auditimi. Në fund ky dokument aprovohet nga DA dhe Ndhmës Auditori i Përgjithshëm.

Pas kësaj, ekipi i auditimit merr dritën e gjelbër për fillimin e ekzekutimit të auditimit. Në këtë fazë ekipi evidenton të gjitha mostrat sipas programit të pyetjeve dhe i bashkëngjijt të gjitha dëshmitë përkatëse. Dhe pas përfundimit të kësaj periudhe UE së bashku me ekipin finalizojnë Draft Raportin dhe me gjithë dosje dërgohet për rishikim nga DA, ku siguron se formati i draftit është sipas standardeve, të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet janë të qarta dhe mbështeten me dëshmi, dhe e mbështetin opinion e auditimit. Pas ndryshimeve të mundshme, Drafti në fjalë rishikohet nga Departamenti për Sigurimin e Cilësisë (varësisht nëse është përzgjedhur si mostër për rishikim) dhe në fund rishikohet nga Ndhmës Auditori i Përgjithshëm. Të gjitha këto pika kontrolli në fund të secilës fazë të auditimit evidentohen me një listë të ashtuquajtur Listë Kontrolluese, ku UE, UA dhe Departamenti për Sigurimin e Cilësisë (në rast se është bërë kontrolli për atë auditim) e plotësojnë me të gjitha dokumentet të cilat janë vendosur dhe bëjnë referencimin për to.

Sipas këtij procesi të përshkruar, ekipi i auditimit nuk mund të kalojë në fazën e ardhshme të auditimit, pa u aprovuar dosja e planifikimit, rrjedhimit e ekzekutimit deri te ajo e raportimit. Për secilin koment nga rishikuesi mbeten dëshmitë si dhe për çdo ndryshim të bërë në letra të punës apo edhe në raport mbetet historia e këtyre dëshmimeve.

Rol kyç në kontrollin e cilësisë luan edhe Departamenti për Sigurimin e Cilësisë në Auditim, i cili bënë rishikimin e cilësisë në auditim dhe ofron siguri të arsyeshme se auditimet janë kryer në përputhje me SNISA-t. Përveç kësaj:

- Rishikon dhe analizon gjetjet e auditimit dhe siguron se ato janë të mbështetura me dëshmitë e duhura;

- Në raste të caktuara rishikon dhe analizon mostrat e përzgjedhura nga dosjet e auditimit nëse ato kanë qenë të mjaftueshme, reprezentative dhe janë trajtuar me kujdesin e duhur;
- Analizon opinionet e auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare dhe jep këshilla për përshtatshmërinë e opinioneve me gjetjet në raport, aty ku është e nevojshme;
- Informon menaxhmentin e lartë të ISA-së për të gjitha çështjet me ndikim domethënës në auditim, etj.

Nëse ekziston dallim në gjykime profesionale ndërmjet drejtorit të departamentit të auditimit dhe udhëheqësit të ekipit lidhur me çështjet kryesore (për shembull, ndikimi i disa të gjeturave në pasqyrat financiare, zbatimin e standardeve të kontabilitetit, ose llojin e modifikimit të opinionit), atëherë drejtori do ta diskutojë çështjen me Departamentin për Sigurimin e Cilësisë në Auditim dhe do ta njoftoj udhëheqësin e divizionit përkatës. Të gjitha korrigjimet, gjykimet e ndryshme profesionale ose ndryshimet në konkluzione dhe rekomandime të cilat paraqiten gjatë rishikimit të draft raportit të auditimit dokumentohen nga drejtori i departamentit dhe vendosen në softuer.

Vlen të theksohet se ky Udhëzues për Kontrollin e Cilësisë nuk është azhurnuar ende sipas Doracakut dhe metodologjisë së re, i cili ka filluar të aplikohet gjatë vitit 2020.

Me Doracakun e Auditimit rregullohet edhe çështja e përdorimit të ekspertëve të jashtëm (aty ku është e nevojshme). Sipas kësaj dhe shabllonit të letrës së punës (intervistat me ekipin e vitit të kaluar) e cila përdoret gjatë fazës së planifikimit, ekipi duhet të vlerësojë nëse ka nevojë për përdorimin e punës së një eksperti. Deri më tani në auditimin e rregullsisë nuk ka qenë asnjë rast ku është përdorur puna e ndonjë eksperti të jashtëm.

Rezultatet e vlerësimit dhe konkluzionet

Dimensioni	Rezultati	Vlerësimi
(i) Standardet dhe Politikat e Auditimit Financiar	<i>Të gjitha kriteret janë përmbushur.</i> SAI ka adaptuar dhe është në funksion Doracakut i Auditimit Financiar dhe të Pajtuëshmërisë (qasje e kombinuar), konform standardeve ndërkombëtare të auditimit (SNISA 2000 dhe SNISA 4000). Po ashtu, ky Doracak është bërë edhe në pajtim me mandatin e ZKA-së të rregulluar me ligj si dhe me Kodin e Etikës Profesionale, gjithashtu e rregulluar me SNISA 130.	4
(ii) Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit të auditimit financiar	<i>Të gjitha kriteret janë përmbushur.</i> ISA ka vendosur një sistem për të siguruar se anëtarët e ekipit të auditimit si pjesë e stafit, posedojnë kompetencë dhe aftësi profesionale të mjaftueshme për të kryer një auditim, sipas kërkesave të ISSAI 200. Kjo është e rregulluar me rregulloret e brendshme si dhe me planet vjetore të cilat planifikohen për trajnimin e vazhdueshëm profesional të stafit. Gjithashtu ekzistojnë	4

	marrëveshjet me shoqatat profesionale për certifikimin e auditorëve të rregullsisë.	
(iii) Kontrolli i Cilësisë në Auditimin Financiar	<p><i>Të gjitha kriteret janë përmbushur.</i></p> <p>ISA ka të rregulluar mënyrën e funksionimit të kontrollit të cilësisë sipas linjave menaxheriale. Kjo është përshkruar po ashtu në rregullore të brendshme, si dhe në udhëzuesin për kontrollin e cilësisë. Secili auditor dhe udhëheqës i ekipit apo departamentit i angazhuar për kryerjen e një auditim fillimisht është i njoftuar me përgjegjësitë të cilat i ka, si dhe me objektivat e auditimit në fjalë (përcaktimi i objektivave në fillim të procesit të auditimit).</p>	4

4.3.3. SAI 10- Procesi i Auditimit Financiar – Nota [3]

Ky indikator vlerëson se si auditimi financiar është realizuar në praktikë, në fazën e planifikimit, implementimit dhe raportimit të auditimit.

Ky indikator përfshinë tri dimensione:

- (i) Planifikimi i auditimit financiar;**
- (ii) Implementimi i auditimit financiar; dhe**
- (iii) Vlerësimi i dëshmive të auditimit, përfundimi dhe raportimi në auditimet financiare.**

Vlerësimi i indikatorit SAI-10 është bazuar në mostrat e përzgjedhura për testimin e dosjeve të aplikuara në auditim. Burimet e informacioneve të cilat janë përdorë janë:

- Dosjet e auditimit (financiar);
- Softueri i auditimit SITA;
- Intervistat e zhvilluara sipas nevojës me auditorët e angazhuar në ato auditime;
- Doracakut i Auditimit Financiar dhe të Pajtuëshmërisë;
- Kodi i Etikës së ZKA-së;
- Deklarata e Pavarësisë për stafin auditues; dhe
- Përcaktimi i objektivave për auditor për atë vit auditues.

Viti i cili e kemi marrë për vlerësimin e këtyre dosjeve është viti 2020, ku metodologjia e re ka filluar të aplikohet (ndryshimi i doracakut të auditimit), si dhe softueri i auditimit ka hyrë në funksion. Gjatë këtij viti janë kryer gjithsej 116 auditime financiare dhe të pajtuëshmërisë.

ZKA-ja përveç auditimeve të cilat i kryen, një pjesë të tyre bëhet edhe nga kompani private e kontraktuar. Për vitin 2020, ZKA-ja ka kontraktuar një kompani për auditimin e disa komunave dhe institucioneve të pavarura. Prandaj në mostrat e testuara, kemi marrë edhe një prej tyre.

Kështu gjatë përzgjedhjes së mostrave kemi përzgjedhur:

- Një ministri me buxhet më të lartë (Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale);
- Një komunë (Komuna e Vushtrrisë);
- Një ndërmarrje publike (KRU Prishtina sh.p.k);
- Një institucion të pavarur (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve); dhe
- Një institucion të audituar nga kompania e kontraktuar (Avokati i Popullit).

Dimensionimi (i): Planifikimi i auditimit financiar

Dimensionimi 10 (i)- bënë vlerësimin se si është realizuar në praktikë planifikimi i auditimit financiar konform standardeve. Ky dimension është kategorizuar me **notën 3**, sepse të gjitha kriteret e përcaktuara janë përmbushur. Sa i përket kriterit për kryerjen e një rishikimi të pavarur nga jashtë ISA-së, është realizuar një rishikim në vitin 2019 nga ZKAS-ja. Megjithatë ky rishikim është bërë për Doracakun e Auditimit dhe metodologjisë së vjetër, prandaj për këtë rast nuk është relevante.

Nga viti 2016 në kuadër të ZKA-së është themeluar Departamenti për Kontrollin e Cilësisë, ku ka bërë rishikimin e dosjeve të auditimit dhe raporteve të tyre. Ky rishikim ka përfshirë secilin ekip të auditimit (së paku një dosje e auditimit për ekip), ku sipas listës kontrolluese janë identifikuar çështjet e rëndësishme që do të duhej të rregullohen gjatë planifikimit të auditimit. Pas planifikimit, dosjet i janë nënshtruar rishikimit edhe pas kryerjes së punës në teren dhe njëkohësisht raportit të auditimit së bashku me opinionin e dhënë. Prandaj kjo pjesë mund të merret si rishikim i pavarur nga stafi i ISA-së.

Në shtator të vitit 2021 ka hyrë në fuqi Rregullorja për Organizimin e Brendshëm, ku ky departament është riemëruar si Departamenti për Sigurimin e Cilësisë në Auditim. Funkcioni i tij mbetet i njëjtë ku si objektive kryesore e këtij departamenti është sigurimi i cilësisë së auditimeve të kryera në përputhje me ISSAI-t dhe dhënia e sigurisë për përshtatshmërinë e opinioneve për pasqyrat financiare vjetore.

Gjatë vlerësimit të dosjeve kemi arritur në një konkluzion të përgjithshëm se planifikimi i auditimit ishte bërë konform kërkesave të Doracakut dhe njëkohësisht edhe të standardeve ndërkombëtare.

Përfundim në disa kriteret bënë dosja e auditimit nga kompania e kontraktuar, ku në disa raste nuk ishin përmbushur këto kriteret apo nuk kanë qenë të aplikueshme. Arsyeja apo mangësia është se kontrata e përcaktuar nga ISA e cila është lidhur me kompaninë private, nuk kishte përfshirë apo kërkuar disa kriteret të cilat duhen të përmbushen sipas Doracakut të Auditimit.

Më poshtë do të prezantojmë procesin e planifikimit nga mostrat e testuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë dimension:

- *Përcaktimi i materialitetit*- është i rregulluar me Doracakun e Auditimit për mënyrën dhe kushtet që duhet plotësuar për caktimin e tij. Materialiteti përcaktohet dy herë gjatë atij viti të auditimit (njëherë në fazën e planifikimit në buxhetin e planifikuar, ku përzgjidhen

mostrat për vlerësimin e kontrolleve, si dhe materialiteti final në fazën e ekzekutimit të auditimit, ku caktohen në buxhetin final të realizuar). Në këtë letër të punës përveç materialitetit të zgjedhur, sqarohet mënyra e përcaktimit të tij, si dhe prezantohet materialiteti i performancës, përqindja e precizitetit dhe gabimit të mundshëm.

Në të gjitha mostrat e testuara, ky kriter ishte përmbushur. Ekipet kishin arritur ta dokumentojnë materialitetin e përcaktuar dhe të japin shpjegime të qarta rreth procedurës së ndjekur. Ata kanë caktuar materialitetin e përgjithshëm në nivel të pasqyrave financiare, si dhe materialitetin e performancës dhe nivelit trivial. Gjithashtu kanë përcaktuar edhe materialitetin në nivel më të ulët apo më të lartë (varësisht prej situatës së auditimit), dhe kishin dhënë konkluzione të qarta për këtë (përveç dosjes së auditimit të kontraktuar, ku nuk kishte ndonjë shpjegim rreth mënyrës së përcaktimit të materialitetit).

- *Planifikimi i përgjithshëm, vlerësimi i kontrolleve dhe rreziqeve, dhe njohja e entitetit*- edhe kjo pjesë është e rregulluar me Doracakun e Auditimit. Janë të përcaktuara qartë kushtet dhe hapat që duhet ndjekur për të arritur një planifikim të mirë dhe të kuptueshëm edhe për lexuesit që nuk janë pjesëmarrës në auditim. Konform këtyre kërkesave janë edhe letrat e punës për secilin rast, ku edhe vetë kërkesat e këtyre letrave qojnë në plotësimin e të dhënave sipas Doracakut dhe standardeve. Të gjitha këto letra janë të vendosura në softuer dhe secila është e rishikuar dhe aprovuar nga personat përgjegjës të atyre auditimeve.

Strategjia e përgjithshme e auditimit ishte bërë për të gjitha mostrat e testuara. Në këtë dokument është sqaruar në mënyrë të detajuar metoda e planifikuar e auditimit, duke përfshirë kështu: qasjen e planifikuar; strategjinë e përgjithshme; objektivat; materialitetin; rreziqet e vetvetishme dhe të kontrollit, si dhe planin e detajuar kohor dhe burimet e nevojshme.

Përjashtim bënë edhe në këtë pikë auditimi i kontraktuar, ku është bërë plani i përgjithshëm i atij auditimi, mirëpo jo me të gjitha kriteret e kërkuara sipas Doracakut. Këtu nuk përfshihen në mënyrë të detajuar vlerësimi i rreziqeve të vetvetishme dhe të kontrollit, materialiteti, si dhe plani kohor është i prezantuar por jo i detajuar sipas datave. Ndërsa sa i përket njohjes së mjedisit të entitetit dhe vlerësimit të kontrolleve, nga 5 mostrat e testuara 4 prej tyre kanë bërë vlerësimin tyre, kurse auditimi i kontraktuar nuk kishte një letër të tillë.

Nga këto 4 mostra, ekipet e angazhuara kishin plotësuar letrat e punës për njohjen e entitetit, vlerësimin e mjedisit të kontrollit dhe rreziqeve të mundshme, vlerësimin funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe vlerësimin e rreziqeve nga mashtrimi apo mospajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret përkatëse. Për të gjitha këto fusha, ishin dhënë konkluzionet e arritura dhe ishin mbështetur me sqarime të qarta dhe dëshmi adekuate.

- *Letër angazhimi dhe deklarata e pavarësisë profesionale*- kërkesë tjerë e cila duhet të përmbushet sipas Doracakut, është edhe njoftimi i entitetin për fillimin e auditimit dhe komunikimin e personave të angazhuar së bashku me kohën e planifikuar. Po ashtu, para

fillimit të atij auditimit, secili ekip nënshkruan Deklaratën e Pavarësisë Profesionale për atë auditim, përfshirë këtu edhe Drejtorin e Auditimit, Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm dhe Auditorin e Përgjithshëm.

Në të gjitha mostrat e testuara ishte dokumentuar komunikimi me entitetin e audituar. Secili ekip kishte dërguar letër angazhimin ku janë theksuar detyrat dhe përgjegjësitë e ekipit, informatat të cilat ju nevojiten për atë auditim, si dhe anëtarët që përbëjnë atë auditim. Përmes këtij komunikimi është treguar edhe koha e planifikuar për auditim si dhe është kërkuar për caktimin e personit kontaktues gjatë atij auditimit.

Po ashtu ishin nënshkruar edhe deklaratat e pavarësisë profesionale dhe ishin vendosur në dosjet përkatëse.

Dimensioni (ii): Implementimi i auditimit financiar

Në këtë dimension kemi vlerësuar se si implementimi i auditimit financiar është realizuar në praktikë. Ky vlerësim është bazuar në po të njëjtat mostra të përzgjedhura sipas listës së prezantuar më lartë.

Nga vlerësimi i dosjeve të auditimit mund të themi se implementimi i auditimit konform planifikimit dhe letrave të punës në përgjithësi është realizuar mirë, përveç në disa kritere të cilat nuk janë përmbushur në dosjen e auditimit të kontraktuar, me të njëjtën arsye të sqaruar te dimensionin 10 (i).

Ky dimension vlerëson në përgjithësi procedurën e realizimit të auditimit duke u mbështetur në dëshmitë përkatëse, dizajnimin e testeve substanciale dhe të pajtueshmërisë, bazën e mostrave të testuara sipas programeve, përdorimi i punës së ekspertëve të jashtëm dhe auditimit të brendshëm aty ku është e nevojshme, dëshmitë në auditim për mostrat dhe opinion e dhënë, si dhe nëse i gjithë plani i auditimit ka arritur të realizohet me sukses.

- *Dëshmitë në auditim*- nga të gjitha mostrat e vlerësuara, i gjithë procesi i realizuar në auditim ishte dokumentuar mirë dhe kishte dëshmi të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha gjetjet, konkluzionet apo edhe opinion e dhënë në raportin e auditimit. Dëshmitë dhe letrat e punës janë vendosur në softuer, dhe identifikimi i tyre është bërë përmes letrave përkatëse të punës të caktuara me pakon sipas Doracakut të Auditimit. Kështu për identifikimin fillimisht të mostrave të cilat janë testuar nga ekipet e auditimit përdoret matrica e testeve, të cilat përfshijnë testet (kontrollit, substanciale dhe të pajtueshmërisë) të aprovuara gjatë fazës së planifikimit, të dhënat kryesore për secilën mostër, si dhe konkluzionet e arritura nga ato teste dhe dhënien e informacionit për ndikimin e tyre në raport. Te secila mostër e regjistruar është e lidhur edhe dosja me të gjitha dokumentet përkatëse sipas testeve. Pas kësaj kanë vijuar letrat e punës për ato mostra të cilat janë identifikuar gjetje, ku përfshijnë elemente të cilat prezantohen në raport, si: kriteri, gjendja, shkaku, konkluzioni dhe rekomandimi. Pastaj vjen letra finale e punës, ku përfshihen të gjitha gjetjet për një fushë të caktuar.

Kjo është finalizuar me plotësimin e një letre të punës, ku janë evidentuar të gjitha gjetjet që kanë qenë materiale në nivel të pasqyrave financiare dhe është shpjeguar ndikimi i tyre në opinion e raportit të auditimit.

Vlen të theksohet se në disa raste jo gjithmonë janë sipas këtij përshkrimi letrat e punës në dosjen e kontraktuar. P.sh. në matricës e testimeve nuk përfshihet ndonjë sqarim apo konkluzion të arritur nga testet, po ashtu teste të kontrollit nuk ka sepse nuk kanë realizuar dhe nuk kanë sqaruar arsyen e kësaj. Po ashtu nuk ka ndonjë letër të punës me gjetje, kjo për arsye se raporti i auditimit nuk ka pasur të gjetura. Megjithatë do të duhej të përgatitet një letër pune ku e tregon procedurën dhe rezultatin nga testimet e realizuara.

Meqenëse ZKA-ja bënë auditim me qasje të kombinuar (financiar dhe të pajtueshmërisë), të gjitha mostrat të cilat testohen janë të regjistruara në të njëjtën matricë, por me teste të veçanta në aspektin financiar dhe të pajtueshmërisë. Prandaj edhe dëshmitë sa i përket përputhshmërisë apo jo me ligjet dhe rregulloret në fuqi për ato mostra të testuara, ishin bashkangjitur në dosjet përkatëse të auditimit.

- *Dëshmitë lidhur me konfirmime të jashtme në auditim*- meqenëse me ligj është e rregulluar që institucionet shtetërore punojnë me parimin e CASH-it (përveç ndërmarrjet publike të cilat e kanë të instaluar parimin aktual), atëherë kriteri i cili lidhet me konfirmimet e jashtme, si dëshmi të rëndësishme në 4 mostrat nuk është e aplikueshme. Ndërsa te dosja e NP-së janë të vendosura dhe ekzistojnë dëshmitë përkatëse për këto konfirmime. Përcaktimi i përdorimit të punës së auditimit të brendshëm apo ndonjë ekspertit të jashtëm është vlerësuar nga ekipet për 4 dosje, ku kishin dhënë sqarimet e mos përdorimit të punës së tyre. Ndërsa në dosjen e auditimit të kontraktuar nuk kishe ndonjë evidencë se ekipi kishte vlerësuar një gjë të tillë.
- *Kryerja e procedurave të auditimit sipas planit*- ky kriter është matur përmes softëer-it SITA. SITA është i dizajnuar në atë mënyrë, që çdo hap i përcaktuar me letra të punës nuk mund të kalojë në hapin e radhës pa qenë i aprovuar nga drejtori i auditimit përkatës. Kështu pas aprovimit të planit të auditimit, ekipi duhet të i ndjek të gjithë hapat sipas planifikimit për të realizuar një auditim. Ky si kusht për të kaluar në pjesën e gjenerimit të raportit. Prandaj, nga mostrat e vlerësuara të gjitha kishin kryer auditimin sipas planit (përveq që në tri mostra kishte pasur vonesë në dorëzimin dhe publikimin e raportit të auditimit), dhe nuk vërehet se ka pasur ndryshime në plan gjatë auditimit. E gjithë dosja e auditimit në fund është aprovuar nga Drejtori i Auditimit dhe Ndihmës Auditori i Përgjithshëm.

Dimensioni (iii): Vlerësimi i dëshmimeve të auditimit, përfundimi dhe raportimi në auditimet financiare

Sipas standardeve të auditimit (ISSAI 2000 dhe ISSAI 4000) dhe Doracakut të Auditimit, çdo raport i auditimit duhet të mbështetet me dëshmi adekuate dhe të qëndrueshme, kjo për arsye që opinionit dhe rekomandimet e dhëna të jenë sa më objektiv.

Prandaj në këtë dimension kemi vlerësuar cilësinë e dëshmimeve në dosje të auditimeve të testuara, si dhe objektivitetin e përmbajtjes së raporteve të auditimit.

Nga këto vlerësime, ne arritëm në përfundimin se ekipet e auditimit të angazhuar në këto auditime kishin arritur të dëshmojnë qartë procesin e auditimit, si dhe ishte lehtë i kuptueshëm edhe për një lexues që nuk është auditor apo nuk ka përvojë në auditim. Po ashtu, kishin arritur të japin një opinion të bazuar në dëshmi, të japin rekomandime adekuate sipas natyrës të së gjeturës, si dhe të dëshmojnë komunikimin me entitetet e audituara.

Dosja e auditimit është një dosje ku të gjitha letrat e punës (duke filluar nga planifikimi, implementimi dhe raportimi) evidentohen aty. Në ZKA kjo dosje ruan të gjitha dëshmitë e rëndësishme për secilin auditim: dosjen e përhershme (ligjet dhe rregulloret të cilat janë përdorë) dhe dosjen aktuale (materialiteti, mostrimi, plani strategjik i auditimit, vlerësimet e rreziqeve, të kontrollit, dëshmitë e testimeve, intervistat e zhvilluara me zyrtarët kyç të entitetit, vlerësimet përfundimtare të keqdeklarimeve materiale, gjetjet e auditimit me të gjitha elementet e kërkuara, draft raportet dhe raportet finale, letër konfirmimet, etj.).

- *Vlerësimi i dëshmimeve të auditimit*- nga të gjitha mostrat e vlerësuara të gjitha dosjet kishin dëshmi të mjaftueshme dhe të qëndrueshme, të cilat, mbështesin opinionin dhe rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit. Të gjitha këto dëshmi janë të listuara dhe të lidhura qartë, si dhe lehtë të kuptueshme edhe nga një person i cili nuk është i angazhuar në auditim. E gjithë procedura e dosjes së dokumenteve ishte ndjekur sipas kërkesave të Doracakut, ku forma, përmbajtja dhe cilësia e saj ishin në nivel të mirë.

Nga të gjitha dosjet e vlerësuara kemi hasur në opinione të ndryshme të auditimit, ku kjo ka bërë që ekipi i vlerësimit të ketë material të mjaftueshëm për vlerësimin e bazës së këtyre opinioneve sipas kërkesave të standardeve.

Llojet e opinioneve në këto mostra ishin: një Opinion i Kualifikuar; një Opinion i Kundërt; një Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes; dhe dy Opinion i Pakualifikuar. Të gjitha këto opinione kishin mbështetjen me dëshmitë përkatëse dhe të gjitha ishin të vendosura në letrat e punës dhe të aprovuara sipas linjës menaxheriale.

- *Komunikimi me entitetin e audituar*- mbajtja e takimit përmbyllës me entitetin pas përfundimit të auditimit është e kërkuar sipas Doracakut të Auditimit dhe njëkohësisht sipas shabllonit të letrave të punës. Të gjitha ekipet kishin mbajtur takimin përmbyllës dhe kishin përshkruar procesin e njoftimit të përmbajtjes së pritur të raportit. Njëkohësisht është prezantuar edhe pjesëmarrja në takim dhe kishin sqaruar për pajtimin apo jo të personave përgjegjës të atij entiteti me gjetjet e identifikuar. Përjashtim këtu bënë dosja e auditimit të kontraktuar, ku nuk është mbajtur një takim i tillë, sepse në raportin e auditimit nuk kishte asnjë gjetje të identifikuar.

Pjesë e komunikimit me entitetin është edhe dërgimi i Draft Raportit në entitet dhe periudha e caktuar për komentet e mundshme. Është e rregulluar me ligjin për ZKA-në. Që nga momenti i dërgimit të draftit, entiteti ka afat prej 15 ditë kalendarike që t'i ofrojë komentet e mundshme lidhur me gjetjet në atë draft.

Të gjitha draftet e dërguara kishin të bashkangjitur edhe Letrën Përcjellëse si dëshmi për mundësinë e komentimit të atij drafti nga entiteti.

Po ashtu, në raportet finale janë të bashkangjitura letër konfirmimet nga entiteti për pranimin e përmbajtjes së raportit.

- *Përmbajtja e raportit të auditimit* - është e rregulluar sipas shabllonit të përcaktuar në pajtim me kërkesat e standardeve dhe Doracakut të Auditimit. Të gjitha raportet kishin elementet e kërkuara, si: titullin e raportit; adresën e ISA-së; detyrat dhe përgjegjësitë e ISA-së dhe menaxhmentit të audituar; opinionin i dhënë; nënshkrimi i Auditorit të Përgjithshëm dhe kohën e publikimit të raportit.

Raportet kishin të gjitha elementet dhe shkrimi i tij ishte mjaftueshëm i qartë. Gjetjet janë mirë të prezantuara dhe të sqaruara, duke treguar ndikimin e secilës gjetje dhe rekomandimin e dhënë për menaxhmentin e audituar.

Rezultatet e vlerësimit dhe konkluzionet

Dimensioni	Rezultati	Vlerësimi
(i) Planifikimi i auditimit financiar	<p><i>Kriteri b, dhe së paku 6 kriteret tjera janë përmbushur. Kriteret e, f, i, g dhe h nuk janë përmbushur (vetëm në dosjen e auditimit të kontraktuar).</i></p> <p>Ne kemi vlerësuar se të gjitha dosjet e planifikimit ishin mirë të përgatitura. Të gjitha letrat e punës kishin përmbajtje cilësore dhe lehtë të kuptueshme. Qasja e auditimit ishte e sqaruar mirë dhe e mbështetur me konkluzione dhe dëshmi përkatëse.</p> <p><i>Vëmendje: Kriteret e listuara si të pa përmbushura më lartë në narrativ, janë vetëm për dosjen e auditimit të kontraktuar. Prandaj edhe është vlerësuar me notën 3, duke marrë parasysh mesataren e dosjeve të vlerësuara.</i></p> <p><i>Të gjitha dosjet tjera të cilat janë përgatitur nga stafi i ISA i kanë përmbushur edhe kriteret e, f, i dhe g, dhe janë të dokumentuara në dosjen e auditimit.</i></p>	3
(ii) Implementimi i auditimit financiar	<p><i>Kriteri a, f dhe së paku 3 kriteret tjera janë përmbushur. Kriteri d (pika 3 dhe 4), nuk janë përmbushur.</i></p> <p>Sipas vlerësimit tonë i gjithë procesi i implementimit të auditimit është shumë mirë i dokumentuar me dëshmi relevante. Dosjet e auditimit janë regjistruar në softuerin SITA, në të cilat kanë qasje vetëm stafi auditues i angazhuar për atë auditim. Në fund të secilit auditim është bërë edhe arkivimi i atyre dosjeve.</p>	3

	<p><i>Vëmendje: Kriteret e listuara si të pa përmbushura më lartë, janë vetëm për dosjen e auditimit të kontraktuar. Prandaj edhe është vlerësuar me notën 3. Të gjitha dosjet tjera të cilat janë përgatitur nga stafi i ISA-së i kanë përmbushur të gjitha kriteret.</i></p>	
<p>(iii) Vlerësimi i dëshmimeve të auditimit, përfundimi dhe raportimi në auditimet financiare</p>	<p><i>Të gjitha kriteret janë përmbushur.</i></p> <p>Raportet kishin të gjitha elementet e kërkuara dhe shkrimi i tij ishte mjaftueshëm i qartë. Gjetjet janë mirë të prezantuara dhe të sqaruara, duke treguar ndikimin e secilës gjetje dhe rekomandimin e dhënë për menaxhmentin e audituar. Opinionet ishin të bazuara dhe të mbështetura mirë me dëshmi përkatëse.</p> <p>Për secilin draft janë të bashkangjitura edhe letrat përcjellëse, ku i është dhënë mundësia për dhënien e komenteve të mundshme nga entiteti i audituar. Po ashtu, pjesë e raporteve finale është edhe letër konfirmimi, ku entiteti ka konfirmuar përmbajtjen e raportit.</p>	<p>4</p>

4.3.4 SAI 11- Rezultatet e Auditimit Financiar – Nota [3]

Ky indikator vlerëson dorëzimin dhe publikimin e rezultateve të auditimit financiar në kohën e planifikuar, si dhe monitorimin e implementimit të rekomandimeve.

Ky indikator ka tri dimensione vlerësuese:

- (i) Dorëzimi me kohë i raporteve të auditimit financiar;**
- (ii) Publikimi me kohë i raporteve të auditimit financiar; dhe**
- (iii) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe observimi nga ISA.**

Vlerësimi i këtij indikator është bazuar në mostrat e përzgjedhura për testimin e dosjeve. Burimet e informacioneve të cilat janë përdorë janë:

- Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me plotësim ndryshimet;
- Rregullore e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit;
- Doracak i Auditimit Financiar dhe i Pajtuashmërisë;
- Dorëzimin e raporteve tek entitetet e audituara dhe letër-përcjellëset e raporteve;
- Konfirmimet e pranimit të raporteve të auditimit;
- Dorëzimin e raporteve në Kuvend dhe komisionet përkatëse parlamentare;

- Publikimin e raporteve në ueb faqe, listën e raporteve të publikuar me datat e publikimit; dhe
- Planin e zbatimit të rekomandimeve të dorëzuara nga entitetet e audituara.

Dimensioni (i): Dorëzimi me kohë i raporteve të auditimit financiar

Ky indikator vlerëson dorëzimin me kohë të raporteve të auditimit në entitet. Sipas Rregullores së Punës, pas përfundimit të auditimit, ekipi ka për detyrë të përgatisë draft raportin dhe ta dërgojë atë në entitet për komente (nëse ka komente) me një afat prej 15 ditë kalendarike. Në rast se ka komente, ZKA-ja i shqyrton ato para finalizimit të raportit, dhe nëse ato komente nuk janë të mbështetura me dëshmi, ZKA e publikon atë raport duke i bashkangjitur edhe komentet nga entiteti. Kurse, në rastet ku entiteti i audituar nuk ka komente, atëherë ai dërgon një letër konfirmim, me ç' rast i bashkëngjitet raporti final. Procesi i dërgimi të raportit tek entiteti duhet të jetë para datës 30 qershor, ku është afati ligjor për publikimin e tyre, sipas LMFP-së, neni 48.2.

Në dosjet e vlerësuara të gjitha letër përcjellëse për dërgimin a draftit ishin pjesë e letrave të punës, po ashtu edhe letër konfirmimet ishin të bashkangjitura në raport.

Auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) në subjektet individuale kryhen për çdo vit, duke filluar në shtator të atij viti, ndërkaq përfundojnë gjatë vitit vijues me raportet e auditimit, të cilat publikohen deri në fund të muajit qershor dhe në fund të muajit gusht për Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) (e rregulluar LMFP-në).

Cikli i auditimeve të rregullsisë përmbyllet në fund të muajit gusht, kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

Gjatë vitit 2020 janë audituar: RVA; 90 BO dhe 12 Ndërmarrje Publike. Megjithatë për shkak të situatës me pandeminë COVID-19, ndryshimeve në metodologjinë e auditimit, si dhe hyrjes në funksion të softuerit SITA, ka pasur vonesë në dorëzimin, rrjedhimisht edhe në publikimin e një numri të raporteve të auditimit. Vetëm 40% e tyre kanë arritur të dorëzohen dhe publikohen me kohë, dhe si rezultat i kësaj, ky dimension është vlerësuar me **notën 2**.

Vlen të theksohet se që nga themelimi i ZKA-së, ky ka qenë viti i parë ku ka pasur vonesa në publikimin e Raporteve të Auditimit.

Dimensioni (ii): Publikimi me kohë i raporteve të auditimit financiar

Në anën tjetër ky dimension vlerëson nëse publikimi i raporteve është bërë brenda afateve të përcaktuara me ligj, pas komenteve apo konfirmimit nga entiteti i audituar.

ZKA i dorëzon institucioneve të audituara raportet finale të auditimit. Kopje mund t'i dorëzohen çdo institucioni tjetër të ndërlidhur. ZKA publikon raportet finale të auditimit një (1) ditë pas dorëzimit të raporteve të tilla.

Të gjitha raportet e auditimit të realizuara janë në dispozicion në ueb faqen e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Dimensioni (iii): Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve dhe vëzhgimi nga ZKA

Në këtë dimension, ekipi i vlerësimit, ka vlerësuar nëse ZKA ka përcjellë zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Me rastin e publikimit të raportit, entitetet e audituara brenda 30 ditëve, duhet të përgatisin planin e veprimit dhe ta dorëzojnë ZKA-së sipas formatit të kërkuar, përfshirë kohën dhe mënyrën se si do ti zbatoj rekomandimet. Po ashtu, sipas kësaj procedure entitetet dy herë në vit duhet të raportojnë për progresin në zbatimin e rekomandimeve. Këtë raport duhet ta dorëzoj edhe në Kuvend, apo Kuvendet komunale.

Nga 5 dosjet e vlerësuara, 3 prej tyre kishin dorëzuar planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve; një nuk kishte dorëzuar; dhe për auditimin e kontraktuar kjo nuk ishte e aplikueshme sepse në raport nuk kishte gjetje të identifikuara.

Është kërkesë e Doracakut të Auditimit dhe praktikë brenda ZKA që gjatë auditimit të vitit aktual, ekipet audituese bëjnë vlerësimin dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve për vitin e kaluar. Dhe në bazë të atyre vlerësimeve, vendoset edhe si çështje në raport, në rast se shkalla e zbatimit të tyre është e ulët. Po ashtu, këto rekomandime evidentohen në softuer në një bazë të veçantë, ku secili ekip i angazhuar në atë auditim e ka për detyrë të azhurnoj të dhënat lidhur statusin e secilit rekomandim. Statusi i implementimit të rekomandimeve të caktuara duhet të vendoset bazuar në analiza të dëshmimeve të auditimit, i cili është deri në një masë i ngjashëm me atë për procedurë substanciale të auditimit.

Përveç kësaj, ISA çdo vit publikon edhe planet e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve që dërgohen nga entitetet e audituara.

Edhe pse ISA vlerëson zbatimin e rekomandimeve çdo vit, përgjegjës për të siguruar se ato po zbatohen është KMFP-ja në kuadër të Kuvendit të Kosovës, të cilët kërkojnë nga institucionet që përveç në ZKA të dorëzojnë planin e zbatimit edhe në KMFP.

Rezultatet e vlerësimit dhe konkluzionet

Dimensioni	Rezultati	Vlerësimi
(i) Dorëzimi me kohë i raporteve të auditimit financiar	<p><i>Kriteri 3 është përmbushur.</i></p> <p>Gjatë vitit 2020 janë audituar: RVA; 90 Organizata Buxhetore dhe 12 Ndërmarrje Publike. Megjithatë për shkak të situatës me pandeminë COVID-19, ndryshimeve në metodologjinë e auditimit, si dhe hyrjes në funksion të softuerit SITA, ka pasur vonesë në dorëzimin, rrjedhimisht edhe në publikimin e një numri të draft auditimeve. Vetëm 40% e tyre kanë arritur të publikohen me kohë, dhe si rezultat i kësaj, ky dimension është vlerësuar me notën 2.</p>	2

(ii) Publikimi me kohë i raporteve të auditimit financiar	<p><i>Është përmbushur kriteri 4.</i></p> <p>ZKA ka arritur të i publikoj raportet finale të auditimit një (1) ditë pas dorëzimit të tyre në entitet. Po ashtu, të gjitha raportet e auditimit të realizuara janë në dispozicion në ueb faqen e ZKA-së.</p>	4
(iii) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe observimi nga ISA	<p><i>Të gjitha kriteret janë përmbushur.</i></p> <p>ISA e ka të rregulluar përmes Doracakut të Auditimit që gjatë auditimit të vitit aktual, ekipet audituese bëjnë vlerësimin dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve për vitin e kaluar. Po ashtu të gjitha këto rekomandime regjistrohen dhe azhurnohet statusi i tyre në softuer.</p>	4

4.3.5 SAI 12: Standardet e Auditimit të Performancës dhe Menaxhimi I cilësisë – Nota [2]

Përmes këtij indikatori kemi vlerësuar qasjen e ZKA –së ndaj auditimit të performancës sa i përket: standardeve dhe udhëzimeve të përgjithshme për auditimin e performancës; mënyrën se si në praktik janë duke u zbatuar çështjet e menaxhimit të ekipit të auditimit; si dhe aftësive dhe kontrollit të cilësisë në nivelin e angazhimit të auditimit.

Ndërsa cilësia e këtyre funksioneve në nivel organizativ do të vlerësohet në pjesë të tjera të këtij raporti përkatësisht në kuadër të: SAI-4- kontrolli i cilësisë si në SAI-23 Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit.

Për të vlerësuar SAI -12, janë marrë në konsideratë tri dimensione

- (i) Standardet, politikat dhe procedurat e auditimit të performancës;**
- (ii) Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit në auditimet e performancës;**
- (iii) Kontrolli i cilësisë në auditimin e performancës.**

Për të vlerësuar këtë dimension kryesisht jemi bazuar në dokumentet e mëposhtme:

- Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës,
- Manual themelor për auditimin e performancës, manuali i auditimit të prokurimit 2016,
- Pako e letrave të punës për Auditimin e Performancës,
- Rishikimi i praktikave të auditimit të performancës në ZKA- SNAO, tetor 2019
- Vlerësimi i gjendjes së ZKA-së- Raporti i progresit- Bashkëpunimi për Zhvillim Institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, dhjetor 2020
- Rregullore të brendshme- Rregullore (ZKA) Nr. 02/2021 për klasifikimin e vendeve të punës²³, Rregullore (ZKA) nr. 01/2021 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës²⁴, Rregullore (ZKA) Nr. 03/2021 për pranimin dhe karrierën²⁵.

²³ <https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/09/Rregullorja-02-2021-shqip.pdf>

²⁴ <https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/03/Rregullore-ZKA-012021-per-organizimin-e-brendshem-Shq.pdf>

²⁵ [Rregullorja-03-2021-shqip.pdf \(zka-rks.org\)](https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/03/Rregullorja-03-2021-shqip.pdf)

- Kodi i etikës, 2018
- Angazhimi i ekspertëve, termet e referencës, kontrata me ekspertët e angazhuar,
- Lista e stafit të angazhuar në auditimet e performancës, shkollimi, certifikimet, zhvillimi profesional i tyre,
- Plani i trajnimeve të brendshme dhe të jashtme
- Plani vjetor i auditimit - shpërndarja e stafit,
- Objektivat e punës të stafit për të gjitha nivelet
- Rishikimet ndërkolegiale të drafteve,
- Intervista me stafin e angazhuar në auditimin e performancës të niveleve të ndryshme menaxheriale.

Dimension (i): Standardet dhe politikat e auditimit të performancës;

Kushtetuta e vendit dhe Ligji i veçantë, i japin AP-së mandat të gjerë të auditimit, përfshirë edhe kryerjen e auditimeve të performancës²⁶. Në zbatim të tyre ZKA-ja gjatë kryerjes së auditimeve të performancës vlerëson efikasitetin, efektivitetin dhe/ose ekonomikitetin e një aspekti të veçantë të operacioneve në tërësi ose të pjesëshme të ndonjë institucioni, programi ose aktiviteti²⁷.

ZKA-ja ka adaptuar Kornizën së INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale (KIDP). Për auditimet e performancës, ZKA-ja përdor ISSAI 3000 si dhe udhëzimet e përdorimit të auditimit të performancës (ISSAI 3000-3899). Po ashtu me qëllim që ti ndihmojë auditorët e performancës në menaxhim dhe ekzekutim efikas e efektiv të auditimeve të performancës është hartuar Manuali Themelor për Auditimin e performancës dhe Manuali i auditimit të prokurimit.

Manuali i Auditimit të Performancës është hartuar në vitin 2009 dhe rishikuar/përditësuar në vitin 2016. Të dy këto versione janë hartuar në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Ndërsa me qëllim të zbatimit të këtij manuali janë hartuar edhe letrat e punës. Të gjitha letrat e punës janë të vendosur në sistemin për menaxhimin e auditimit-SITA.

Në bazë të vlerësimit të situatës aktuale, është vërejtur se është filluar përditësimi i këtij manuali. Janë themeluar grupet punuese për të vlerësuar çështjet e nevojshme për përditësim. Ky dokument do të rishikohet në bashkëpunim me ZKAS-në. Mirëpo deri më tani nuk kemi gjetur ndonjë draft të këtij dokumenti.

Manuali dhe letrat e punës, përmbushin pjesërisht kriteret e kërkuara nga ky dimension. Manual dhe letrat e punës përshkruajnë qartë nevojat për të përcaktuar qasjen e auditimit, dizajnin e auditimit, ekzekutimin e auditimit dhe raportimin.

Më poshtë janë prezantuar më në detaje kriteret dhe udhëzimet sipas manualit të auditimit të performancës;

- Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, auditimi i performancës ndjek zakonisht **njërin nga tre qasjet**: qasjen e orientuar në rezultate, e cila vlerëson nëse objektivat e paracaktuara janë arritur ashtu si duhet; qasjen e orientuar tek problemi, e cila verifikon dhe

²⁶ Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Neni 18 Mandati i auditimit, pika 5

²⁷ Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Neni 21 Llojet e auditimit, pika 3.

analizon shkaqet e problemit(ve) të veçantë; ose qasjen e orientuar tek sistemi, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese: ose një kombinim të të tri qasjeve.

- Auditorët e performancës duhet të identifikojnë dhe formulojnë **kriteret auditimit** adekuate, të cilat duhet të jenë në përputhje me pyetjet e auditimit.
- Auditorët duhet të kenë parasysh të rrezikojnë mos-përfshirjen e aspekteve të rëndësishme si dhe **rrezikun** që dëshmitë e mjaftueshme do të rezultojnë me një konkluzion të gabuar; auditorët rrezikojnë mos-përfshirjen e aspekteve të rëndësishme.
- Zhvillimi i komunikimit duke krijuar marrëdhënieve të mira dhe të duhura me jashtë është një faktor kyç në realizimin efikas dhe efektiv të rezultateve të auditimit të performancës. Auditorët duhet të synojnë të mbajnë marrëdhënie të mira me të gjithë hisedarët e përfshirë, të promovojnë një rrjedhje të lirë dhe të hapur të informatave për atë sa lejojnë kërkesat e konfidencialitetit, dhe të bëjnë diskutime në një atmosferë të respektit dhe kuptimit të ndërsjellë rreth rolit dhe përgjegjësi përkatese të secilit hisedar.
- Një plan i përgjithshëm i aktiviteteve i cili përfshinë kërkesat për staf, d.m.th **kompetencat e mjaftueshme** (përfshirë pavarësinë e stafit të angazhuar), burimet njerëzore, dhe ekspertizën e mundshme të jashtme të kërkuar për auditim, një indikacion të njohurive të theksuara të auditorëve në lëmin që do të auditohet.
- Qëllimi kryesor i **dokumentimit** është që përveç ndihmës për auditorët, **dëshmitë e auditimit** të regjistrohen për të mbështetur konkluzionet dhe rekomandimet, për të ndihmuar menaxhimin dhe monitorimin e auditimit, dhe që të mundësojë që puna të rishikohet nga zyrtarët më të lartë, drejtori dhe Auditori i Përgjithshëm.
- Auditori duhet ta **planifikojnë auditimin** në një mënyrë të atillë që të sigurojë se ai është i cilësisë së lartë dhe se kryhet në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive, dhe në kohë.
- Auditori duhet të ketë duhet të ketë parasysh që për të pasur **dëshmi** të mira nga të dhënat dhe informatat dhe që të rezultojë me gjetje të auditimit, konkluzione dhe rekomandime, do të ishte mirë që burimet e shumta të të dhënave dhe informatat të kombinohen.
- **Raporti i auditimit** duhet të përmbajë informata rreth objektivës audituese, pyetjeve audituese, fushës audituese, kriterëve audituese, metodologjisë, burimeve të të dhënave, çfarëdo kufizimesh rreth të dhënave të shfrytëzuara, dhe gjetjeve të auditimit. Raporti duhet të jetë në **kohë**, i saktë, objektiv, **bindës, konstruktiv**, dhe po atë **qartë** dhe konciz sa e lejon tema. Ai duhet të jetë po ashtu i **lehtë për tu lexuar, i mirë-strukturuar** dhe të **mos përmbajë dykuptimësi**. Në përgjithësi, duhet të kontribuojë drejt njohurive më të mira dhe t'i theksojë përmirësimet e nevojshme. Të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit duhet të bazohen në dëshmi dhe duhet të dallohen qartë në raport. Të gjitha pikëpamjet **relevante** duhet të merren në konsideratë në raport dhe raporti duhet të jetë i **baraspeshuar** dhe i **drejtë**.
- Politika e ZKA-së është që ti vë **raportet** e auditimit të performancës në dispozicion të **publikut**, si dhe ti shpërndajmë ato sa më gjerë. Përveç entitetit të audituar, raporti i dërgohet **edhe Kuvendit, Qeverisë, medias dhe palëve të interesit**. Një kopje e raportit mund ti dërgohet edhe individëve që kanë kontribuar për auditimit. Më pas, **raporti publikohet në faqen e internetit**. Edhe sipas ligjit, raportet e auditimit janë në dispozicion në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që kanë klasifikim (si sensitive dhe jo për publik) apo ndalesa tjera ligjore apo administrative në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- Raporti i auditimit ka disa qëllime përfshirë edhe ofrimin të **rekomandimeve** në lidhje me ndryshimin/et që nevojiten. Rekomandimet, aty ku jepen, duhet të prezantohen në një mënyrë të logjikshme, racionale dhe të bazuara në njohuri si dhe të bazohen në të gjetura auditimi kompetente dhe relevante. Ata duhet të jenë të zbatueshëm, të shtojnë vlerë dhe të

adresojnë objektivin dhe pyetjet e auditimit. Ata duhet t'i adresohen entitetit që ka përgjegjësinë dhe kompetencën për zbatimin e tyre.

- Për të vlerësuar përfitimet nga puna e Auditorit të Përgjithshëm është e rëndësishme që të kryhet **përcjellja e zbatimit të rekomandimeve**. Kjo ndihmon për vlerësimin e efektivitetit të raporteve të auditimit të performancës lidhur me përmirësimin e shërbimeve publike, duke i bërë ato më efektive. Vendimi për të përcjellë ndikimin e rekomandimeve duhet të bazohet mbi analizën e rezultateve (reagimeve) për të mbështetur veprimet që do të merren për rekomandimet, të cilat paraqiten në planin e veprimit të përgatitur nga entitetet. Lidhur me përcjelljen e rekomandimeve, ZKA-ja ka hartuar një udhëzues të veçantë Udhëzuesi për përcjelljen e rekomandimeve të Auditimit të Performancës.

Megjithatë janë disa elemente të tjera që nuk janë mjaftueshëm të sqaruara të cilat mund të përmirësohen tutje.

Gjithashtu, sipas vlerësimit tonë manuali duhet të jetë i shkruar në atë mënyrë që të përkojë me realitetin vendor si dhe të përmbajë me shumë sqarime dhe shembuj praktik për përdoruesit e tij.

Sipas vlerësimit tonë, ky dimension është vlerësuar më 2, sepse pavarësisht se manuali përmbush kriteret bazike, ka vend për përmirësim, veçanërisht në plotësimin e kriterëve si më poshtë

- *Në çdo auditim të performancës është e nevojshëm për të identifikuar elementët si (auditori, pala përgjegjëse, përdoruesit e synuar, objektiva dhe kriteret). ISSAI 300:15*
 - Në manualin e auditimit, nuk është specifikuar mjaftueshëm, veçanërisht se si dhe ku duhet të identifikohen përgjegjësitë e auditorit dhe përdoruesit e fundit për secilin auditim në veçanti, ndërsa elementet e tjera rregullohen me manual dhe me letra të punës si palët përgjegjëse, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimi kriteret e auditimit. Te gjitha këto prezantohen edhe ne raportin e auditimit.
- *Nevoja për të "përcaktuar një objektiv auditimi të qartë që ndërlihet me parimet e ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit". ISSAI 300:25*

Në manual janë të përshkruara si objektiva ashtu edhe elementet e auditimit të performancës, pra 3 E-të, megjithatë manuali nuk e përcakton qartë objektiven dhe ndërlihdjen e saj me 3 E-të.
- *Nevoja për të zbatuar gjykimin profesional dhe skepticizmin. ISSAI 300:31*
 - Auditorët e performancës përdorin në vazhdimësi si gjykimin profesional ashtu edhe skepticizmin, mirëpo ne manual nuk është mjaftueshëm e përshkruar dhe specifikuar si kur ato duhet të përdoret apo për të demonstruar ndonjë raste apo shembuj.
- *Auditorët duhet ti zbatojnë procedurat për ta ruajtur cilësinë, duke siguruar se janë përmbushur kërkesat e zbatueshme "ISSAI 300:32*

Në manual është përshkruar rëndësia e kontrollit të cilësisë, megjithatë nuk ka procedurë të kontrollit të cilësisë e cila përshkruan nivelet dhe mekanizmat e kontrollit të cilësisë në auditimin e performancës.
- *Auditorët duhet ta marrin parasysh materialitetin në të gjitha fazat e procesit të auditimit. ISSAI 300:35*

- Nuk ka shpjegime të mjaftueshme apo shembuj konkrete se si duhet të merret parasysh materialiteti në të gjitha fazat e auditimit. Materialiteti është e specifikuar vetëm në fazën e përzgjedhjes së temave dhe parastudim.

Dimensioni (ii): Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit në auditimet e performancës;

Ky dimension ka shqyrtuar nëse ZKA-ja ka të vendosur një sistem për të siguruar që stafi i angazhuar për të kryer auditime të performancës, zotëron kompetencën profesionale, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të kryer auditimin në fjalë.

ZKA-ja ka krijuar një sistem relativisht të mirë i cili siguron që “ekipi i auditimit [përfshirë edhe ekspertët të jashtëm aty ku kërkohet] kanë kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin”. Prandaj ky dimension është vlerësuar me 3.

Më poshtë kemi shpjeguar masat e ndërmarra dhe nevojat për përmirësim që ISA duhet të ndërmarrë për tu siguruar plotësisht se auditorët kanë njohuri të duhura të auditimit të performancës duke përfshirë të kuptuarit e standardeve të auditimit të zbatueshme.

ISA ka krijuar një sistem për të siguruar që “ekipi i auditimit [bashkë, dhe duke përfshirë ekspertë të jashtëm aty ku kërkohet] ka kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin”, duke përfshirë: ISSAI 300:30. Shih gjithashtu ISSAI 40: fq. 10.

- ZKA-ja, përkatësisht burimet njerëzore brenda ZKA-së, kanë një bazë e të dhënave në Excel e cila përmban informata të detajuara për stafin, veçanërisht lidhur me përgatitjet akademike dhe profesionale si dhe certifikimet dhe trajnimet profesionale të kryera. Gjithashtu, përmes rregullores, së brendshme janë vendosur kualifikime themelore të veçanta për nivele të ndryshme të auditimit të performancës (junior, auditor, auditor senior). Këto kritere duhet të aplikohen si për rekrutimet e reja ashtu edhe për auditorët të cilës duhet të kalojnë nga auditimet e tjera²⁸ brenda organizatës²⁹ (rekrutime të brendshme). Auditorët e performancës kanë njohuri të shëndosha të auditimit të performancës, duke përfshirë të kuptuarit e standardeve të auditimit të zbatueshëm.
- Një numër i madh i auditorëve të performancës kanë të përfunduar **skemat e certifikimit të auditimit** të sektorit publik (auditor i certifikuar i sektorit publik, auditor i brendshëm, auditor i TI-së i certifikuar) që përfshin edhe këto njohuri lidhur me funksionimin e organizatave ndërsa një numër i auditorëve kanë kaluar nga auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë prandaj kanë njohuri të mjaftueshme të organizatave, programeve dhe funksioneve qeveritare ashtu siç kërkohet me *ISSAI 300:30*. Pjesë e stafit që kryen auditime të prokurimit dhe IT-së, posedojnë edhe certifikime përkatëse për këto auditime si për prokurim ashtu edhe për auditimin e IT-së.
- Që kur ka filluar kryerja e auditimeve të performancës, ZKA-ja në vazhdimësi ka përfituar trajnime të ndryshme për auditorët e performancës nga ZKAS-ja, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe nga ISA e Holandës dhe Britanisë së Madhe përmes projekteve të binjakëzimit të financuar nga BE-ja, si dhe donatorë të shumtë.
- Në bashkëpunim me ZKA-në e Suedisë, janë mbajtur trajnime dhe punëtori metodat e shkrimit të raporteve mirë të strukturuar; ofrimi dhe pranimi i kritikave konstruktive; dizajnimi i raporteve të auditimit të performancës. Gjithashtu, ZKAS-ja ka përkrahur ZKA-në edhe duke mentoruar drejtpërdrejt ekipet gjatë fazave të ndryshme të auditimit.

²⁸ [Rregullore \(ZKA\) Nr. 03/2021 për pranimin dhe karrierën](#), neni 37 lëvizja e auditorëve brenda kategorisë profesionale.

²⁹ [Rregullore \(ZKA\) Nr. 02/2021 për klasifikimin e vendeve të punës](#); neni 26 Auditor senior i performancës 27 auditor i performancës .28 auditor junior i performancës

Përveç kësaj, me qëllim të sigurimit të zbatimit të standardeve të auditimit në bashkëpunim me ZKAS-në është zhvilluar edhe **programi profesional për të gjithë auditorët e performancës**. Programi i filluar në vitin 2019, është finalizuar në janar të vitit 2020 dhe ka përfshirë një “modul e-learning”, seminare dhe detyra praktike. Për të marrë pjesë në program, të gjithë auditorët është dashur të jenë pjesë e një ekipi të auditimit, që nga faza e para-studimit deri në finalizimin e raportit të auditimit. Në fund të programit, të gjithë auditorët iu kanë nënshtruar testit me shkrim. Tetëmbëdhjetë auditorë të performancës, përfshirë edhe tre menaxherë kanë marrë pjesë dhe e kanë kryer me sukses programin e trajnimit, si dhe janë pajisur me **certifikata**.

Me qëllim të rritjes së cilësisë së raporteve të auditimit të performancës, Zyra Kombëtare e Auditimit ka filluar me trajnimin për avancimin e **aftësive analitike dhe kërkimore** të auditorëve të performancës. Përmes këtyre trajnimeve auditorët e performancës të Zyrës Kombëtare të Auditimit do t’i avancojnë njohuritë në analiza më të thella dhe metodat kërkimore si dhe teknikat e shkrimit të raporteve të performancës në mënyrë që ato të jenë të shkruara me gjuhë të thjeshtë dhe të jenë miqësore ndaj lexuesit.

- ZKA-ja në bashkëpunim me Institucionin Suprem të Auditimit të SHBA-ve (GAO) dhe Agjencinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) kanë mbajtur trajnimin për Auditimet e performancës. Në këtë trajnim bashkë me auditorët e ZKA-së kanë marrë pjesë auditorë të performancës nga vendet e rajonit si Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria.
- Drejtorët dhe udhëheqësit e ekipeve kanë ndjekur trajnimin me temën kundër mashtrimit në prokurimin publik dhe projektet e BE-së. Ky trajnim është organizuar në kuadër të projektit “Komunat transparente, efektive dhe llogaridhënëse”, i iniciuar dhe financuar nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).
- Po ashtu, në kuadër të projektit me Bankën Botërore, auditorë të performancës të ZKA-së kanë ndjekur trajnimin “online” katër ditor me temën “Prokurimi sipas rregullave të Bankës Botërore”. Trajnimi ka pasur për qëllim dhënien e informacioneve të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket rregullave dhe mënyrës se si duhet të auditohen projektet e Bankës Botërore.
- Në bashkëpunim me Universitetin e Kembrixhit dhe Kolegjin UBT, ZKA-ja ka zhvilluar punëtorinë “Simulimi i politikave”, ku rast studimi ka qenë Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Një grup i përzier i auditorëve të performancës dhe atyre financiar kanë marrë pjesë në këtë punëtori, e cila është moderuar nga profesorë të Universitetit të Kembrixhit dhe të Kolegjit UBT.
- Dy auditore të performancës të ZKA-së kanë ndjekur për tre muaj janë përfshirë në programin e punës praktike profesionale në GAO.
- Po ashtu, bazuar në planin e trajnimeve, gjatë vitit 2021/22 stafi i angazhuar në auditimet e performancës kanë vazhduar të përfitojë trajnime lidhur me analizat e detajuara të auditimit dhe shkrimin e raporteve të auditimit. Ndërsa, drejtoret e auditimit dhe udhëheqësit e ekipeve

kanë ndjekur trajnime për zhvillimin e aftësive në prezantim publik³⁰ si dhe trajnime dhe punëtori lidhur me zhvillimin e aftësive të lidhshme dhe udhëheqjes së ekipeve të auditimit.

- Bazuar në planin vjetor të zhvillimit profesional, punonjësit e performancës kanë përfituar edhe nga trajnimet e ofruara nga institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe kanë marrë pjesë në shumë punëtori ndërkombëtare që lidhen me auditimet e performancës, IT-së dhe prokurimit.

ZKA-ja në nivel të përgjithshëm ka të rregulluar qartë linjat e raportim përmes rregulloreve të brendshme dhe organogramit. Po ashtu, pas shpërndarjes së planit vjetor të auditimit, hartohen dhe nënshkruhet objektivat individuale të punës për secilin auditor si dhe vlerësimi i rezultateve bazuar në nivelin e përmbushjes së këtyre objektiveve.

Megjithatë, trajnimet dhe zhvillimi profesional i stafit kanë nevojë të orientohen në pika kyçe siç janë hulumtimet e thella ,metodat dhe teknikat e shkencave sociale, aftësitë e thella analitike, të shkruarit dhe komunikimit. Trajnimet lidhur me përdorimin e teknikave si “Stakeholders mapping”, “fishbone diagram” “RACI analiza”, “SWOT analiza” “grupet e fokusit”, “analiza e përmbajtjes” si dhe avancimi i njohurive për fazën se kur duhet të përdoren këto teknika do të ndihmonin auditorët në faza të ndryshme të auditimit, duke ndikuar edhe në dokumentimin e auditimit dhe arsyetonin aplikimin e gjykimit profesional. Vlen të përmendet që aktualisht, në bashkëpunim me ZKAS-në janë duket u zhvilluar trajnime të llojit të tillë.

Gjithashtu, zhvillimi profesional për auditorët e performancës nuk është i orientuar në nevojat individuale të stafit. Sistemi duhet të sigurohet që ka kompetenca të brendshme për të arritur të zhvilloje programe bazike për auditorët e performancës që do të angazhohen në të ardhmen.

Dimensioni (iii): Kontrolli i cilësisë në auditimin e performancës.

Përmes dimensionit iii të indikatorit 12 kemi shqyrtuar se si masat e **kontrollit të cilësisë për auditimin e performancës** janë zbatuar në praktikë, siç evidentohet nga një rishikim i dy dosjeve të auditimit.

Më poshtë do të përmbledhim gjendjen se si ZKA-ja mat kontrollin e cilësisë për auditimet e performancës dhe se si ato zbatohen në praktikë.

Sipas vlerësimit tonë gjithë puna e kryer në auditimet e performancës duke filluar nga faza e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit, i nënshtrohet rishikimit nga nivele të ndryshme menaxheriale, si një mjet për të kontribuar në cilësinë dhe për të promovuar mësimin dhe zhvillimin e personelit si dhe procesi i rishikimit dokumentohet. Kontrolli i cilësisë kryhet dhe sigurohet në disa nivele, duke u nisur në nivelin e parë - drejtorët e departamentit dhe pastaj në nivelin e dytë nga ndihmës auditorët e përgjithshëm.

Rishikimi kolegjial për memorandumit dhe draft-raportin e auditimit bëhet nga anëtarët e emëruar (auditorë me përvojë) brenda divizionit, përpara se draft - raporti të shqyrtohet nga menaxhmenti. Parastudimet dhe draft-raporti rishikohen në mënyrë sistematike, përmes diskutimeve brenda ekipit nga udhëheqësi i auditimit dhe menaxhmenti i lartë. Për disa nga temat janë angazhuar

³⁰ Program I trajnimit është realizuar në kuadër të projektit “Promovimi i rolit të Auditorit të Përgjithshëm / ZKA-së në Kosovë”. Projekti është mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë Holandeze, Rrjeti të Gazetarisë Hulumtuese në Ballkan- BIRN Kosova, si dhe ACDC-ja. Personeli drejtues i ZKA-së ka ndjekur programin e trajnimit, që kishin për qëllim zhvillimin e aftësive të komunikimit në paraqitjet publike, rrjetet sociale dhe shkrimin e komunikatave.

këshilltarë të jashtëm nga ZKAS dhe sipas nevojës apo specifikave të temës që auditohet angazhohen edhe ekspertë vendorë të fushave përkatëse.

Dosjet e auditimit janë të vendosura në sistemin për menaxhimin e auditimit -STA, dhe të gjitha letrat e punës janë të vendosur sipas hapave, proces i cili siguron se asnjë fazë nuk është kaluar pa aprovimet e nevojshme. Përveç kësaj nga nivelet e rishikimi duhet të plotësohen listat kontrolluese. Po ashtu, në rastet kur ka mendime të ndryshme në opinione brenda nivele të rishikimit ato janë dokumentuar dhe plotësuar me dëshmitë përkatëse.

Procedurat për autorizimin e publikimit të raportit ekzistojnë dhe zbatohen në praktikë.

Po ashtu, pavarësisht se nuk është e rregulluar qarte kur duhet të identifikohet nevoja për ekspertë ne kemi vërejtur se ka rast kur është kërkuar nga ekipet janë angazhuar ekspertë në fusha dhe auditime specifike siç janë siguria e ushqimit si dhe siguria e trafikut rrugor.

Përveç kriterëve që janë përmbushur, më poshtë janë listuar kriteret që ende nuk janë përmbushur

- KC dhe rëndësia e kontrollit të cilësisë është përshkruar në manualin e performancës megjithatë nuk ka procedurë të kontrollit të cilësisë e cila përshkruan nivelet dhe mekanizmat e kontrollit të cilësisë në auditimin e performancës. Auditorët duhet të aplikojnë procedura për të ruajtur cilësinë, duke siguruar që kërkesat e zbatueshme janë përmbushur. *ISSAI 300:32*
- Po ashtu, Departamenti i cilësisë brenda ISA-së i cili kryen rishikimin e auditimeve të realizuara, duke u siguruar që gjatë kryerjes së punës ekipet e auditimit kanë zbatuar plotësisht SNISA-t, metodologjinë e përcaktuar me Doracakun e Auditimeve të aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe udhëzimet tjera. Megjithatë, në mungesë të kapaciteteve, ky departament nuk është i përfshirë në rishikimin e raporteve të auditimit të performancës dhe nuk ka rishikime të tjera të pavarura që janë aplikuar para se raportet të publikohen. Ndërsa, rishikimet nder-kolegiale që zbatohen në ZKA nuk përfshije rishikime të gjithë procesit dhe dosjeve të auditimit, mirëpo vetëm pjesë të caktuara.

Vlen të përmendet që në vitin 2019 nga ZKAS, është realizuar një rishikim i ftohtë për praktikat e auditimit të performancës. Rishikimi ka vlerësuar se ZKA zbaton shumicën e proceseve të auditimit, megjithatë është potencuar nevoja për forcim të kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë si dhe nevoja për përditësimin e manualit të performancës.

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Standardet, politikat dhe procedurat e auditimit të performancës	<p>Kriteret, c, d, e, f, g, k, l, m, n, o, p, q, r, s, t, u, janë përmbushur Kriteret a, b, h, i, j nuk janë përmbushur</p> <p>Shumica e kriterëve janë plotësuar, duke qenë se ZKA-ja ka adaptuar ISSAI 3000. Po ashtu ka hartuar manualin e auditimeve të performancës dhe letrat e punës. Kriteret e përmbushura janë përmendur në manualin e performancës. Megjithatë, ne kemi vlerësuar se manuali dhe udhëzimet e letrave të punës kanë nevojë për përditësim lidhur me kriteret apo udhëzime shtesë të cilat duhet të adresohen veçanërisht dhe në detaje siç janë (a) <i>nevojshëm për të identifikuar elementët veçanërisht përdoruesit e synuar për secilin auditim</i>, (b) <i>përcaktuar një objektivi auditimi të qartë që ndërlidhet me parimet e ekonomizimit, efikasitetit dhe</i></p>	2

	<i>efektivitetit, (h)Nevoja për të zbatuar gjykimin profesional dhe skepticizmin . (i) Në manual është përshkruar rëndësia e kontrollit të cilësisë, megjithatë nuk ka procedurë të kontrollit të cilësisë e cila përshkruan nivelet dhe mekanizmat e kontrollit të cilësisë në auditimin e performancës. (j)Po ashtu, në manual nuk ka shpjegime të mjaftueshme apo shembuj konkretë se si duhet të merret parasysh materialiteti në të gjitha fazat e auditimit.</i>	
(ii) Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit në auditimet e performancës	<p>Kriteret a, c,e,f,g,h,i,j, k, l, m ,n janë përmbushur</p> <p>Kriteret b, d, nuk janë përmbushur</p> <p>ZKA-ja ka të vendosur një sistem pjesërisht të qëndrueshëm për të siguruar që stafi i angazhuar për të kryer auditime të performancës, zotëron kompetencën profesionale, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të kryer këtë lloj të auditimit. Megjithatë, trajnimet dhe zhvillimi profesional i stafit kanë nevojë të orientohen në pika kyçe siç janë hulumtimet e thella ,metodat e shkencave sociale dhe teknikat aftësitë e thella analitike, të shkruarit dhe komunikimit (b dhe d)</p> <p>Pavarësisht se stafi i angazhuar në vazhdimësi përditësohet me teknika dhe trajnime të fushës, mirëpo ende nuk ka siguruar sistem të brendshëm të trajnimeve dhe mungon qasja e trajnimeve bazuar në vlerësimet individuale, duke qenë se trajnimet ofrohen për të gjithë stafin pa dallim niveli dhe kompetencës.</p>	3
(iii) Kontrolli i cilësisë në auditimin e performancës	<p>Kriteret a, c, d, f janë përmbushur</p> <p>Kriteret e, b, nuk janë përmbushur</p> <p>Pavarësisht se në praktikë ka një kontroll të cilësisë në nivel të rishikimit, ISA ende nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme për kontroll të cilësisë në auditimet e performancës. Prandaj, ky dimension është vlerësuar me 2.</p>	2

4.3.6 SAI 13: Procesi i Auditimit të Performancës – Nota [3]

Përmes këtij treguesi vlerësohet se si ZKA kryhen auditimet e performancës në praktikë.

Në këtë tregues vlerësohen tre dimensione:

- (i) Planifikimin e auditimeve të performancës.**
- (ii) Zbatimin-Ekzekutimin e Auditimeve të Performancës.**
- (iii) Raportimin e Auditimeve të Performancës.**

Për të vlerësuar këtë tregues kemi përzgjedhur tri dosje të auditimit

1. Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Statistikave, 2020
2. Zbatimi i rekomandimeve të raportit “Administrimi i programit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike dhe vlerësimi i rezultateve”, 2020
3. Vlera për para në prokurimet e centralizuara – Pjesa e parë, 2018

Përveç këtyre dosjeve janë rishikuar edhe dokumentet si më poshtë;

- Propozimi dhe përzgjedhja e temave,
- Rishikimet ndërkolegiale për raportet e vlerësuara,
- Vlerësimi nga raporti i misionit për pilot auditimet e It-së nga ekspertet e angazhuar në kuadër të projektit "Fuqizimi i mëtejshëm i ndikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit" projekt i financuar nga BE,
- Rishikimi i praktikave të auditimit të performancës në ZKA, I realizuar në kuadër bashkëpunimit me ZKA-në e Suedisë, si dhe dokumente të tjera relevante.

ZKA-ja kryen një numër të vogël të auditimeve të performancës krahasuar me ato financiare dhe të pajtueshmërisë. Në vitin 2021, janë kryer 13 auditime të performancës, në vitin 2020, 8 Auditime të performancës (për fusha të ndryshme), ndërsa në vitin 2019 janë kryer 13 auditime.

Dimensioni (i): Planifikimi i Auditimit të Performancës

Ekipi ka vlerësuar se dosjet e planifikimit janë përgatitur mirë, konform udhëzimeve të ISA-it (manualit dhe letrave të punës) megjithatë disa mangësi të identifikuar në manualin dhe letrat e punës në fazën e planifikimit kanë reflektuar si mangësi edhe në dosjet e auditimit, meqenëse nuk kanë qenë të detyrueshme të zbatohen nga ekipet e auditimit.

Ekipi ka vlerësuar se pavarësisht se shumica e kritereve të këtij dimensionit janë përmbushur megjithatë janë identifikuar disa kritere të cilat nuk janë përmbushur dhe si rezultat ky dimension është notuar me 2.

Gjatë rishikimit të dosjeve të auditimit për në fazën e planifikimit është vërejtur se dosjet janë mirë të dokumentuara, ekipet kanë njohuri për metodologjinë e auditimit të performancës dhe kanë zbatuar hapat e paraparë në letrat e punës.

- Për t'u siguruar që auditimi është planifikuar siç duhet, auditorët duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për çështjen-temën. Auditimi i performancës në përgjithësi kërkon që njohuritë specifike të auditimit, thelbësore dhe metodologjike të përvetësohen përpara fillimit të auditimit (“para-studimi”). *ISSAI 300:37*. Në dy nga tri dosjet e auditimit që kemi rishikuar ne kemi gjetur se ekipet me rastin e propozimit të temës kanë pohuar se kanë njohuri specifike për temën e auditimit si dhe kanë përvetësuar metodologjinë e nevojshme. Ndërsa, në një të tretën dosje nuk kemi gjetur dëshmi se kjo është marrë në konsideratë. Megjithatë, ekipi i angazhuar në këtë auditim është i specializuar në fushën e auditimit.
- **Identifikimi i rrezikut dhe problemet e mundshme**- *ISSAI 300:36*. Në një dosje të auditimit kemi vërejtur se me përzgjedhjen e temave të mundshme është identifikuar rreziku dhe problemet e mundshme, në një të tretën nga dosjet nuk është relevantë

ndërsa në një dosje nuk është bërë kjo. Kjo për arsye që pakoja e letrave të punës është përditësuar në vitin 2018, pra pas kryerjes së këtij auditimi.

- Në të gjitha dosjet e rishikuara, është përcaktuar qartë **objektiva e auditimit** dhe ndërlidhja e objektivës me parimet e ekonomisë, efikasiteti apo/dhe efektiviteti. Objektiva e auditimit është zbërthyer në **pyetjen kryesore të auditimit**, e cila pastaj edhe zbërthyer edhe në nën pyetjet e auditimit, përveç në memo para studimorë kjo është përshkruar edhe në dizajn matrice. Pastaj janë hartuar edhe **kriteret e auditimit** që korrespondojnë me pyetjet e auditimit.
- Në të gjitha dosjet kemi gjetur se është përshkruar qartë **metodologjinë e auditimit**, duke sqaruar qasjen e auditimit, përdorimin e shumëllojshmërisë së teknikave për të marrë dëshmi dhe siguri të auditimit.

Gjithashtu, **planifikimi kohor** plotëson të gjitha parakushtet e kërkuara sipas shabllonit, është përgatitur për tu realizuar në atë mënyrë që të jetë sa më realist dhe i arritshëm.³¹ Plani detaj përveç pjesës së punës në auditim, përfshin të gjitha elementet e rishikimeve, arkivimin etj. deri te aktivitetet e publikimit.

Gjithashtu, është vërejtur se secili auditor i angazhuar në auditim si dhe të gjitha nivelet e rishikimit kanë nënshkruar deklaratën e pavarësisë profesionale, para daljes në auditim, dokument i cili është hartuar bazuar në Kodin e Mirësjelljes Profesionale.

Ndërsa, më poshtë janë listuar çështjet që kanë nevojë për përmirësim

Materialiteti në të gjitha fazat e auditimit- ISSAI 300:33.

Edhe sipas manualit që është në përdorim, ka mangësi sa i përket materialiteti apo rëndësisë së çështjes. Materialiteti dokumentohet vetëm në rastin propozimit të temës së auditimit. Rëndësia e auditimit merret në konsideratë në të gjitha fazat, megjithatë nuk ceket prerazi arsyeimi për secilën çështje/gjetje të vendosur në letrën e punës dhe raport. Por, logjika e përdorur është se çështjet e testuara, shtjellohen në letrën e punës dhe ato më të rëndësishme/materiale barten në draft raporte, ndërsa çështjet e rëndësisë së ulët mund të dërgohen me letër-menaxhment.

1. Diskutimi i kriterëve më entitetin ISSAI 300:27.

Në dosjet e auditimit nuk kemi hasur në dëshmi që kriteret e auditimit janë diskutuar me entitetin/entitetet e audituara. Sipas praktikës, ekipet diskutojnë në përgjithësi kriteret e auditimit, megjithatë nuk ka një proces të dëshmuar se kjo ka ndodhur në të vërtetë.

2. Rreziku i mashtrimit ISSAI 300:37

Gjatë rishikimit të dosjeve nuk kemi vërejtur se ekipet kanë vlerësuar rreziqe të mashtrimeve.

Trajtimi i mashtrimit në ZKA është i rregulluar më udhëzues kundër mashtrimit. Procedurat e brendshme të ZKA-së kundër mashtrimit, merren parasysh në të gjitha fazat e auditimit, ekipet janë të

³¹ Në planifikim detaj përveç të tjerash janë marrë në konsideratë të gjitha ditët e pushimeve, trajnimeve të planifikuara.

trajnuara për të identifikuar mashtrimin dhe në rast se hasin në vepër të dyshuar të mashtrimit, raportojnë atë të Departamenti për çështje juridike dhe kundër mashtrimeve.

3. *Angazhimi i ekspertëve të jashtëm ISSAI 300:30*

Nuk ka letër të punës e cila e rregullon angazhimin e ekspertëve të jashtëm. Megjithatë, angazhimi i ekspertëve të jashtëm ka filluar të aplikohet viteve të fundit në disa raporte të auditimit. Në dosjet e auditimit të rishikuara nuk kemi vërejtur se ka ndonjë pjesë apo letër e punës ku ekipet kanë kërkuar të kenë ekspertë të jashtëm. Ndërsa, në përgjithësi të gjitha angazhimet e ekspertëve janë bërë vetëm për faza të tjera të auditimit, veçanërisht në fazën e ekzekutimit.

Gjithashtu, vlen të përmendet që identifikimi i nevojave për angazhimet e ekspertëve duhet të bëhet që në fazat e hershme, për shkak të procedurave të prokurimit cilat të duhet të ndjekin e që marrin një kohë të konsiderueshme.

Dimensioni (ii): Zbatimi/Ekzekutimi i Auditimeve të Performancës

Në këtë dimension ekipi ka vlerësuar se si ishte përcaktuar në praktikë faza e zbatimit të auditimit të performancës. Vlerësimi është bazuar në tri mostrat e përzgjedhura. Më poshtë do të përmbledhim gjetjet se si është kryer auditimi në praktikë.

Sipas vlerësimit të tri dosjeve në rishikim, mund të konkludojmë se ekzekutimi i auditimit përmbushë shumicën e kriterëve të vendosura. Meqenëse asnjë nga dosjet nuk i janë nënshkruar rishikimit të pavarur, ky dimension është vlerësuar me **3**.

Në tri dosjet e auditimit ekipet kanë marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe kanë vlerësuar këto dëshmi për të vendosur mbi gjetjet dhe konkluzionet në pajtim me objektivat dhe pyetjet e auditimit si dhe kanë dhënë rekomandime bazuar në këto dëshmi.

Dosjet e ekzekutimit ishin hartuar bazuar në matricën e auditimit (programi i auditimit) ku ekipet i janë përgjigjur pyetjeve të auditimit dhe aty ku ka pasur të gjetura është bërë përshkrimi i të gjeturave duke përfshirë të gjitha kriteret e të gjeturës. Përveç kësaj, në letrat e punës janë referencuar të gjitha dëshmitë e auditimit që janë marrë në konsideratë për secilën të gjetur. Secila e gjetur është pasuar me konkluzionet dhe rekomandimet. Të gjitha dëshmitë janë dokumentuar në dosjen e ekzekutimit. Po ashtu të dëshmitë e auditimit, vërehet se ekipi ka përdorur disa lloje të dëshmimeve dhe teknikave për të formuar të gjeturën.

Në kemi vlerësuar se bazuar në gjetjet, ekipet e auditimit kanë ushtruar gjykimin profesional për të arritur në konkluzione. Të dhënat e mbledhura ishin dëshmi të arsyeshme, të mjaftueshme, relevante, të vlefshme dhe të besueshme për të përmbushur objektivin, përgjigjet në të gjitha pyetjet dhe për të nxjerrë konkluzione. Ekipet kanë dhënë konkluzione të arsyeshme. Konkluzionet e nxjerra nga të gjeturat në bazë të dëshmimeve, racionalitetit dhe kriterëve specifikë të auditimit, dallohen qartë nga të gjeturat dhe janë në harmoni me objektivin e auditimit, pyetjet e auditimit dhe të gjeturat. Kjo vërteton se ekipet kanë përdorur gjykimin profesional.

Përmes dëshmimeve në dosjet e auditimit, ne kemi vërejtur se ekipet kanë mbajtur komunikim efektiv dhe të mirëfilltë me entitetet e audituara dhe akterët përkatës gjatë gjithë procesit të auditimit.

Sipas procedurave të ZKA-së, auditorët duhet ti njoftojnë entitetet e audituara mbi aspektet kyçe të auditimit, duke përfshirë edhe objektivin e auditimit, pyetjet dhe çështjen e temës së auditimit. Komunikimi me entitetin dëshmohet përmes, njoftimit të entitetit, letër-informimit, shkëmbimit të e-mailave, dokumentimit të intervistave, letër-përcjellëses së draft raportit, komentet apo pajtimet e entitetit, etj.

Sipas ISSAI 300.28 auditorët, në mënyrë aktive, duhet të menaxhojnë rrezikun e auditimit, i cili paraqet rrezikun e konkluzioneve të pasakta ose jo të plota, duke ofruar informacion të çekuilibruar ose duke dështuar për të shtuar vlerë për përdoruesit. Ne kemi vlerësuar se të gjitha ekipet menaxhuan rrezikun e dhënies së konkluzioneve të pasakta dhe informacion duke i dhënë entit të audituar mundësinë për të dhënë komente dhe komentet mbi provat dhe informacionin e mbledhur. Ekipet e auditimit kanë menaxhuar rrezikun e keqinformimi duke analizuar informacionin nga burime të ndryshme dhe duke e përafuar me të kriteret e formuluar në planin e auditimit. Megjithatë ekipet duhet të plotësojnë dosjet me arsyetimet se si e kanë menaxhuar dhe nëse është bere vlerësimi i këtyre rreziqeve edhe në fazën e ekzekutimit.

Nga dosjet nën vlerësim mund të koloadojmë se ekipet e auditimit ka vlerësuar **materialitetin e çështjes**. Të dy raporte e auditimit janë shqyrtuar nga Parlamenti, përkatësisht Komisioni për mbikëqyren e financave publikeve dhe janë vlerësuar për cilësinë e informacionit të dhënë, prandaj mund të vlerësojmë se kanë pasur vlerë të shtuar për përdoruesit.

Ndërsa, sipas ISSAI 300:38-3, **dëshmitë e auditimit**, duhet të vendosen në kontekst dhe të gjitha argumentet përkatëse, pro dhe kundër, si dhe perspektivat e ndryshme duhet të merren parasysh përpara se të mund të nxirren konkluzione, riformulimit të objektivit dhe pyetjeve të auditimit. Ekipet kanë marrë parasysh perspektiva të ndryshme para se të arrinin në konkluzione, mirëpo në asnjë nga auditimet nuk ka pasur çështje të cilat kanë bere që të riformulohet objektiva, apo pyetjet e auditimit.

I gjithë procesi i ekzekutimit të auditimit është shumë mirë i dokumentuar me dëshmi relevante. Dosjet e auditimit janë ruajtur në folder publik, ku qasje në këto dosje ka vetëm ekipi i angazhuar për auditim deri në rastin kur ato arkivohen. Në dosje ka dëshmi se ato janë arkivuar konform rregullores dhe listës së dokumenteve që duhen arkivuar³². Qasja në dosje mbyllet me rastin e arkivimit. Nga vitit 2020, auditimet kryhen përmes sistemit SITA, mirëpo dosjet në rishikim i përkasin viteve të mëhershme.

Vlen të përmendet se raporti i auditimit "Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Statistikave, është rishikuar nga projekti i binjakëzimit". Raporti i misionit nga ekspertet ka vlerësuar se ekipi ka njohuri të shkëlqyera të IT, cilësia e raportit është shume e mire, po ashtu fushat e auditimit dhe auditimit ishin të përgatitura mire dhe kishin një numër të madh gjetjesh të rëndësishme.

³² Rregullores (ZKA) Nr.02/2019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.04/2018 për Administrimin e Dokumentacionit Zyrtar, Për caktimin e afatit të ruajtjes referohet Listës për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe Afateve të Ruajtjes së Tyre,

Dimensioni (iii) Raportimi i Auditimit të Performancës

Në këtë dimension kemi vlerësuar fazën e raportimit të auditimit të performancës. Më poshtë kemi prezantuar si është kryer raportimi në praktikë për auditimet që kemi vlerësuar. Sipas vlerësimit tonë në tri auditimet e performancës, procesi i raportimit plotëson kriteret e kërkuara.

Raportet e auditimit, pavarësisht se kane strukture të njëjta dallojnë për nga natyra dhe fushëveprimi.

Raporti i auditimit Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Statistikave, është raport i auditimit të performancës dhe IT-së, ku objektivë e këtij auditimi ishte të vlerësohet nëse Divizioni i Teknologjisë së Informacionit ka arritur të menaxhojë operacionet dhe sistemet elektronike për të mbështetur arritjen e objektivave të planifikimit strategjik të ASK-së. Pra, është vlerësuar nëse janë vendosur mekanizmat e nevojshëm për kontrollet e përgjithshme të TI-së, që përfshijnë mjedisin e përgjithshëm në të cilin aktivitetet e TI-së janë zhvilluar, operuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur.

Raporti i auditimit "Zbatimi i rekomandimeve të raportit "Administrimi i programit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike dhe vlerësimi i rezultateve" është raport për zbatimin e rekomandimeve. Përmes këtij raporti është vlerësuar niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit "Administrimi i Programit për trajtim jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike" të publikuar në shkurt të vitit 2017. Po ashtu, është vlerësuar nëse institucionet përgjegjëse kanë analizuar informatat dhe rezultatet e Programit për të rritur kapacitetin e institucioneve shëndetësore publike në trajtimin e një numri më të madh të pacientëve.

Ndërsa, raporti i auditimit të performancës në prokurim, Vlera për para në prokurimet e centralizuara – Pjesa e parë. Objektive e auditimit ishte ka vlerësuar analizimi i planifikimin dhe monitorimin e gjashtë procedurave (tetë kontratave aktuale) të centralizuara, për të konstatuar se a janë vendosur bazat për të arritur objektiven e synuar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit përmes prokurimeve të centralizuara pra, a është arritur ekonomia.

Në një auditim të performancës, auditorët raportojnë gjetjet e tyre mbi ekonominë dhe efikasitetin [e përdorimit të burimeve] dhe efektivitetin me të cilin përmbushen objektivat." ISSAI 300:39. Tri raportet e auditimit kanë informata të qarta që ndërlidhen me objektivat dhe gjetjet e auditimit. Në këto raporte sqarohen mjaftueshëm dhe në mënyrë të detajuar të gjitha gjetjet e auditimit që lidhen me devijimet nga kriteret e auditimit.

Raportet kanë një strukturë të mirë ku prezantohen qartë objektiva, kriteret, gjetjet si dhe konkluzionet dhe rekomandimet.

Raportet në përgjithësi janë të kuptueshëm, shpjeguar në një gjuhë të thjeshtë për lexuesit. Në raportin e IT-së, ekipi është munduar të jap sqarime shtese për çështje të caktuara, duke e elaboruar çështjen edhe për lexues që nuk janë të fushës. Ndërsa, në raportin e prokurimit, paraqiten edhe shembuj konkret dhe janë prezantuar devijimet përmes tabelave për ta bërë me të kuptueshme për publikun dhe lexuesin. Megjithatë ekipet në vazhdimësi janë duke u zhvilluar për të gjetur mënyra me të thjeshta të shkrimit që raportet të jenë më të qarta për lexuesit/publikun.

Raportet janë të shkruara në mënyrë të balancuar duke treguar edhe rastet pozitive të vërejtura përveç gjetjeve negative.

Konkluzionet janë prezantuar bazuar në analizën e gjeturave dhe devijimeve nga objektivat dhe kriteret. Ndërsa, rekomandimet janë prezantuar në një mënyrë të logjikshme, racionale dhe të bazuara në njohuri si dhe të bazohen në të gjetura auditimit. Rekomandimet kanë për qëllim për të shtuar vlerë dhe të adresojnë objektivin dhe pyetjet e auditimit. Ata i adresohen entitetit që ka përgjegjësinë dhe kompetencën për te zbatuar.

ISA-të duhet të deklarojnë se cilat standarde zbatojnë kur kryejnë auditime dhe kjo deklaratë duhet të jetë e qasshme për përdoruesit e raportit të ISA-së.” *ISSAI 100:8* .

Në faqen e parë të raporteve të të gjitha auditimeve të performancës përshkruhet paragrafi "Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000), ndërsa për auditimin e IT-së referohet edhe dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100b).

Sipas ligjit³³ dhe procedurave të ZKA-së³⁴, raporti para se të publikohet, dërgohet te entiteti i audituar, ku entiteti ka afat prej 15 ditëve për të komentuar. Ne dosjet e raportimit ne kemi gjetur se drafti është dërguar ne entitet për komente.

Po ashtu, çdo mosmarrëveshje [me entitetin e audituar] duhet të analizohet dhe gabimet faktike të korigjohen. Ekzaminimi i komenteve duhet të regjistrohet në letrat e punës në mënyrë që të dokumentohen ndryshimet në draft raportin e auditimit ose arsyet e mos bërjes së ndryshimeve.” *ISSAI 300:29*.

Sipas procedurave të ZKA-së, auditorët shqyrtojnë komentet pras pranimit te tyre nga entiteti. Në rast të mospajtit, raporti publikohet me komente. Në dosjet e rishikuara, ky proces është i dokumentuar. Ne dy dosje janë komentet e entitetit dhe dëshmitë shtese të ofruara të cilat janë dokumentuar sipas procedurave te ZKA-së. Po ashtu, të gjitha dosjet kanë letër konfirmimin se pajtohen me komentet.

Ndërsa si **mangësi** është vërejtur materialiteti/ rëndësia e gjetjeve në raportet e auditimit, apo matja e tyre para se ato të shkruhen në raportet e auditimit. Sipas ISSAI 300:33 duhet të menaxhohet rreziku i prodhimit të gjetjeve ose raporteve të auditimit të papërshtatshme ose me ndikim të ulët. Ne kemi vërejtur se në të gjitha dosjet e auditimit, të gjitha gjetjet e auditimit, pavarësisht nga rëndësia janë pjese e raportit të auditimit.

³³ [Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së](#)

[Kosovë](#), neni 22 Komentet mbi draft raportet

³⁴ [Rregullore e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit](#), neni 11 hartimi I draft raportit, neni 12 komentet lidhur me draft raportin e auditimit

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Planifikimi i auditimeve të performancës	<p>Kriteret a, b, d, e, f, g, i, k, m janë përmbushur Kriteret c, h, j, l, nuk janë përmbushur</p> <p>Ne kemi vlerësuar se dosjet e planifikimit janë përgatitur mirë, konform udhëzimeve të ISA-së (manualit dhe letrave të punës) megjithatë disa mangësi të identifikuara në manualin dhe letrat e punës në fazën e planifikimit kanë reflektuar si mangësi edhe në dosjet e auditimit, meqenëse nuk kanë qenë të detyrueshme të zbatohen nga ekipet e auditimit.</p>	2
(ii) Zbatimin/Ekzekutimi i Auditimeve të Performancës	<p>Kriteret a,b,c,d,e,f,g,h,i,j,k janë përmbushur</p> <p>Sipas vlerësimit tonë i gjithë procesi i ekzekutimit të auditimit është shumë mirë i dokumentuar me dëshmi relevante. Dosjet e auditimit janë ruajtur në folder publik, në të cilat ka qasje vetëm ekipi i angazhuar për auditim deri në rastin kur ato arkivohen.</p> <p>Nga vlerësimi i tre dosjeve mund të konkludojmë se ekzekutimi i auditimit përmbush kriteret e kërkuar, përveç se asnjë nga dosjet nuk i janë nënshkruar një rishikimi të pavarur, prandaj ky dimension është vlerësuar me 3.</p>	3
(iii) Raportimi i Auditimeve të Performancës	<p>Kriteret a, b, c, d, e, g, h, i, j, k, l janë plotësuar Kriteri F nuk është plotësuar</p> <p>Raportet e auditimit përmbajë të gjitha elementet e nevojshme si informata rreth objektivës audituese, pyetjeve, fushës audituese, kriteret, metodologjisë, burimeve të të dhënave dhe gjetjeve të auditimit. Gjetjet qartazi konkludojnë rreth pyetjeve audituese,</p> <p>Raportet janë të strukturuar mirë dhe të shkruara në mënyrë të balancuara. Raportet në përgjithësi janë të kuptueshëm dhe shpjeguar në një gjuhë relativisht të thjeshtë për lexuesit.</p> <p>Komentet dhe mospajtimet me entitetet e audituara janë mirë të dokumentuara sipas procedurave.</p> <p>Sipas vlerësimit tonë në tri auditimet e performancës, procesi i raportimit plotëson kriteret e kërkuara përveç kriterit f ku nuk kemi gjetur dëshmi nese ekipet kane marre ne konsiderate materialitin ne të gjitha fazat e auditimit, duke qene se te gjitha gjetjet janë prezantuar edhe në raport. Poashtu, raportet nuk i janë nënshkruar një rishikimi të pavarur, prandaj ky dimension është vlerësuar me 3.</p>	3

4.3.7 SAI 14: Rezultatet e auditimit të performancës – Nota [3]

Ky tregues lidhet me rezultatet e auditimit të performancës.

Ai vlerësoi tre dimensione:

- (i) Dorëzimi në kohë i raporteve të auditimit të performancës**
- (ii) Publikimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës**
- (iii) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe observimeve nga ISA**

Për të vlerësuar SAI 14 ne jemi bazuar në tri dosjet e auditimit dhe kemi shqyrtuar dokumentet si në vijim

- Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 03/l-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me plotësim ndryshimet³⁵;
- Rregullore e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit³⁶;
- Manualin e Auditimit të Performancës;
- Udhëzues për Përcjelljen e Rekomandimeve të Auditimit të Performancës³⁷;
- Dorëzimin e raporteve tek entitetet e audituara, letër-përcjellëset e raporteve;
- Konfirmimet e pranimit të raporteve të auditimit;
- Dorëzimin e raporteve në Kuvend dhe komisionet përkatëse parlamentare;
- Publikimin e raporteve në ueb faqe, listën e raporteve të publikuar me datat e publikimit; dhe
- Planin e zbatimit të rekomandimeve të dorëzuara nga entitetet e audituara.

Dimension (i): Dorëzimi në kohë i raporteve të auditimit të performancës

Sipas ISSAI 20, të gjitha raportet e auditimit të performancës i dorëzohen autoritetit përkatës (Legjislativit, subjektit të audituar dhe/ose ministrisë përkatëse) brenda 15 ditëve nga përfundimi i auditimit (ose brenda kornizës kohore të përcaktuar ose të rënë dakord me ligj, nëse ekziston). ISSAI 20:8.

Nuk ka ndonjë datë të përcaktuar me ligj se kur duhet të dorëzohen raportet e auditimit të performancës. Ndërsa, koha e auditimit dhe e raportimit të auditimeve të performancës përcaktohen në Planin Vjetor të Auditimit.

Sipas ligjit dhe procedurave të brendshme, ZKA-ja dorëzon tek institucionet e audituara raportet finale të auditimit. Një kopje mund t'i dorëzohen çdo institucioni tjetër të ndërlidhur. Zyra Kombëtare e Auditimit publikon raportet finale të auditimit një (1) ditë pas dorëzimit të raporteve të tilla.

³⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

³⁶ <https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/06/Rregullore-e-pun%C3%ABs-p%C3%ABr-zbatimin-e-auditimit-dhe-planeve-t%C3%AB-veprimit.pdf>

³⁷ https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/12/Follow_Up_PA_Guideline_Final_Sq.pdf

Në dosjet e auditimeve kemi gjetur dëshmi se janë dërguar letër-përcjellëset e nënshkruara dhe protokolluara se bashku me raportin e auditimit tek entitetet e audituara, kuvendi. Ndërsa, nga lista e siguruar për publikimet në ueb faqe mund të vërejmë se këto raporte janë publikuar në ueb faqe sipas procedurës. Pas dorëzimit të raportit tek entiteti/ entitetet e audituara, atyre u jepet kohë prej 15 ditësh për të dërguar komente apo të nënshkruajnë letër-kormfirmimin se pajtohen me të gjitha gjetjet e auditimit.

Dimension (ii): Publikimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës

Përmes këtij dimension i është vlerësuar nëse raportet e auditimit të performancës, publikohen dhe janë të qasshme për publikun.

Pra, ISA duhet të publikoj të gjitha raportet e auditimit të performancës brenda 15 ditëve pasi lejohet t'i publikojë ato, përveç kur është e rregulluar ndryshme me ligj. SSAI 20:8. Po ashtu, bazuar në ligj, raportet publikohen pasi të kanë marrë miratimin nga Auditori i Përgjithshëm.

Të gjitha raportet e auditimit të plota janë të publikuara në ueb faqen e ISA-së³⁸. Pas pranimit të letër-konfirmimit se entiteti pajtohet me raportin e auditimit apo nëse nuk pajtohet komentet publikohen në fund të raportit, nuk ka ndonjë afat të përcaktuar ligjor se kur publikohen raportet. Megjithatë, nga praktika kemi vërejtur se raporte publikohen një ditë pasi ato të dërgohen në entitet dhe Kuvend.

Dimension (iii): Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve dhe vëzhgimi nga ISA

Në këtë dimension, ekipi ka vlerësuar nëse ZKA ka bërë përcjellje të zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Me rastin e publikimit të raportit, entitetet e audituara brenda 30 ditëve, duhet të përgatisin planin e veprimit dhe ta dorëzojnë tek ISA sipas formatit të kërkuar, përfshirë kohën dhe mënyrën se si do ti zbatoj rekomandimet. Po sipas kësaj procedure, entitetet duhet të raportojnë dy herë në vit për progresin në zbatimin e rekomandimeve. Këtë raport duhet ta dorëzoj edhe në Kuvend, apo Kuvendet komunale.

Në dy nga tri dosjet që kemi vlerësuar ne kemi gjetur të dëshmi se entitetet kanë përgatitur dhe dorëzuar planin e veprimit. Ndërsa, në dosjet e auditimit nuk ka pasur dëshmi se entitetet e audituara kanë dorëzuar raportet e progresit për zbatimin e rekomandimeve. Progresi i zbatimit të rekomandimeve vlerësohet vetëm ne rastin kur kryhen auditime të veçanta të implementimit.

ISA nuk ka praktike të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për të gjitha raportet e auditimit. Në disa raste janë kryer disa auditime të veçanta për zbatimin e rekomandimeve, ndërsa në vitin 2020 është publikuar një raport përmbledhës për vlerësimin e rekomandimeve në raportet e dhëna në vitin 2017. Gjithashtu, ISA nuk ka krijuar një praktikë për vlerësimin e materialitetit dhe rëndësisë së problemeve të identifikuara për të përcaktuar nëse një auditimin i zbatimit të rekomandimeve kërkon një auditim të zbatimit të rekomandimeve apo një auditim të ri shtesë.

Prandaj, mund të konkludojmë që nuk ka qasje e cila ndiqet në vazhdimësi mirëpo kjo është bërë në baza ad-hock.

³⁸ <https://www.zka-rks.org/publications/>

Mirëpo, në rastet kur këto auditime janë kryer, ZKA ka vlerësuar jo vetëm nivelin e zbatimit të rekomandimeve por është fokusuar nëse subjekti i audituar i ka trajtuar në mënyrë adekuate problemet dhe ka korrigjuar situatën themelore pas një periudhe të arsyeshme kohore, ashtu siç kërkohet në ISSAI 300:42. Gjithashtu, është munduar të vlerësohet edhe ndikimi dhe veprimet e ndërmarra deri në kohën kur është kryer auditimi.

Megjithatë vitin e fundit, ZKA ka arritur progres në zbatimin e rekomandimeve, fillimisht duke publikuar planet e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve, pastaj është hartuar udhëzimin për zbatimin e rekomandimeve të performancës³⁹. Ndërsa, aktualisht ka krijuar bazën e të dhënave për zbatimin e rekomandimeve⁴⁰ e cila është e qasshme në ueb faqe të ZKA-së. Mirëpo, aktualisht është ende herët për të vlerësuar zbatueshmërinë dhe efektivitetin e tyre në praktikë.

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Planifikimi i auditimeve të performancës	Të gjitha kriteret janë përmbushur ISA dorëzon me kohë të gjitha raportet e auditimit tek entitetet e audituara dhe Kuvendi.	4
(ii) Publikimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës	Të gjitha kriteret janë përmbushur Të gjitha raportet e auditimit janë të qasshme në ueb faqen e ISA-së.	4
(iii) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe observimeve nga ISA	Kriteret b, c, d , janë përmbushur Kriteret a, f, g nuk janë përmbushur ISA nuk ka praktike sistematike të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për të gjitha raportet e auditimit. Megjithatë vitin e fundit ka pasur progres në këtë drejtim.	2

4.3.8 SAI 15: Standardet e Auditimit të Pajtueshmërisë dhe Menaxhimi i Cilësisë – Nota [4]

Treguesi SAI-15 mat nivelin e përputhshmërinë me standardet dhe udhëzimet e tjera përkatëse për auditimin e pajtueshmërisë. Gjithashtu është vlerësuar edhe kompetenca dhe përvoja e personelit të angazhuar për kryerjen e këtyre auditimeve.

Ky tregues mbulon tri dimensione:

- (i) Standardet dhe politikat e auditimit të pajtueshmërisë**
- (ii) Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit të auditimit të pajtueshmërisë**
- (iii) Kontrolli i cilësisë në auditimin e pajtueshmërisë**

³⁹ https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/12/Follow_Up_PA_Guideline_Final_Sq.pdf

⁴⁰ <http://rekomandimet.zka-rks.org:3000/portanalyfics/portfolio?id=61433bbae3b0a74c11bb5c96&lang=SQ>

Për vlerësimin e këtij indikatori janë marrë për bazë dokumentet si në vijim:

- Ligji nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
- Doracakun i Auditimit Financiar dhe Pajtueshmërisë, 2020 (metodologjia e qasjes së kombinuar);
- Pako e letrave të punës për Auditimin Financiar dhe të Pajtueshmërisë;
- Kodi i etikës, 2018;
- Udhëzuesi i Kontrollit të Cilësisë për auditimet e rregullsisë;
- Rregulloren nr.01/2021 për Organizim të Brendshëm;
- Rregulloren nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; dhe
- Ligji nr.03/ L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe Listat e certifikimeve dhe trajnimeve të stafit, etj.

Ashtu siç kemi sqaruar edhe në treguesit e tjerë, ZKA-ja nuk kryen auditime të veçanta të pajtueshmërisë (pajtueshmërisë për procedura), mirëpo në baza vjetore kryen auditime të rregullsisë (financiare dhe pajtueshmërisë për transaksione). Prandaj, vlerësimi për këtë tregues do të bëhet bazuar në qasjen e kombinuar të auditimit, vetëm për pjesën e pajtueshmërisë.

Dimensionin (i) Standardet dhe politikat e auditimit të pajtueshmërisë

Auditimi i rregullsisë siç përcaktohet në Ligjin e ZKA-së parashikon auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, përfshirë vlerësimin e pajtueshmërisë me statutet dhe rregulloret e zbatueshme. Prandaj, për të përmbushur mandatin e saj, ZKA-ja kryen auditime me qasje të kombinuar.

ZKA-ja në bashkëpunim me projektin e binjakëzimit të zbatuar nga ISA e Polonisë, ka hartuar Doracakun e Auditimit të Pajtueshmërisë (si auditim i pavarur), mirëpo ende nuk është zbatuar dhe kryer asnjë auditim i veçantë.

Për përgatitjen e Doracakut të Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë dhe dosjes së letrave të punës, janë marrë për bazë Standardet e Auditimit Financiar (SNISA 2000-2899), ashtu dhe Standardet e Auditimit të Pajtueshmërisë (SNISA 4000-4899).

ZKA-ja përdor qasje të kombinuar për auditimin e raportimit financiar dhe atë të pajtueshmërisë me autoritetet, që do të thotë, të dy aspektet e lartpërmendura trajtohen brenda procesit të njëjtë të auditimit, dhe kur është e mundur, brenda procedurave të njëjta e auditimit⁴¹.

Objektivat- në raportin me qasje të kombinuar janë të ndara për pjesën financiare dhe pjesën të pajtueshmërisë. Objektiva e auditimit si pjesë e pajtueshmërisë është që të ofroj siguri të arsyeshme se proceset raportuese të kontabilitetit/financiar dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me autoritetet. Gjatë kryerjes së auditimit të tillë, lëndët në fokus janë proceset dhe

⁴¹ Për shembull, kur kontrollojmë saktësinë e një shume të një transaksioni (çështje kontabiliteti) bazuar në dëshmi të filla si faturë, ne mund të kontrollojmë njëkohësisht nëse fatura është autorizuar nga personi i duhur (çështje pajtueshmërie).

transaksionet e lidhura me marrjen dhe shpenzimin e fondeve publike. Ato duhen të jenë në pajtueshmëri me autoritetet përkatëse dhe këto autoritete janë kriteret për auditim të tillë.

Kriteret për të vlerësuar çështjet e pajtueshmërisë janë pohimet e pajtueshmërisë (të tilla si aderimi, bindja, transparenca ose ndarjet) dhe autoritetet përkatëse (ligjet, rregulloret, rregullat, standardet, praktikat më të mira) të zbatueshme në kontekstin e marrjes dhe shpenzimit të fondeve publike.

Materialiteti- është i rregulluar në Doracakun e Auditimit sipas standardeve ndërkombëtare. Sipas këtij Doracaku, materialiteti për pajtueshmëri duhet të konsiderohet në mënyrë të ngjashme si materialiteti në përgjithësi me disa tipare specifike – më shumë përqendrim në aspektin cilësor. Ky materialitet duhet të konsiderohet nga auditori gjatë:

- Fazës së planifikimit: të ndihmojë vlerësimin e rreziqeve materiale dhe përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të auditimit;
- Fazës së ekzekutimit: ekzaminimi kur merrni parasysh informacionin e ri që mund të kërkojë rishikimin e procedurave të planifikuara, dhe vlerësimin e efektit të mos pajtueshmërisë; dhe
- Fazës së raportimit: raportimi kur arrihet në konkluzione përfundimtare dhe, kur kërkohet, formimi i një opinionit auditimi.

Në identifikimin e materialitetit të pajtueshmërisë, auditori i kushton vëmendje fushave të veçanta të fokusit legjislativ, interesit publik ose pritjeve, kërkesave, fondeve të rëndësishme publike dhe mashtrimit. Po ashtu, auditorët duhet të marrin në konsideratë materialitetin sasior dhe cilësor. *Materialiteti sasior* përcaktohet duke vendosur një vlerë numerike - pragun e materialitetit. Ky prag shërben si faktor përcaktues, si në llogaritjen e madhësive të mostrës për testimet substanciale, ashtu edhe në interpretimin e rezultateve të auditimit.

Po ashtu, në auditimin e pajtueshmërisë duhet të vlerësohet edhe *materialiteti cilësor*. Edhe pse jo material në mënyrë sasimore, disa lloje të mos pajtueshmërisë ose parregullsive mund të kenë ndikim material në një çështje. Materialiteti cilësor përfshin artikuj që mund të jenë materiale nga natyra ose nga konteksti. Në disa raste, aspektet cilësore mund të reflektojnë se vlera më e ulët e mos pajtueshmërisë është gjithashtu materiale; në disa raste, mos pajtueshmëria nuk ka të bëjë me vlerën, sasinë ose madhësinë. Për këto rast janë prezantuar edhe shembuj konkret në Doracak.

Vlen të sqarohet se në këtë dimension janë vlerësuar standardet dhe politikat e auditimit të rregulluara me doracak të brendshëm. Kjo pjesë është cituar nga manuali i auditimit, ku është sqaruar që me këtë manual është i rregulluar edhe përcaktimi i materialitetit cilësor në auditimin e pajtueshmërisë.

Dokumentimi dhe dëshmitë në auditim- meqenëse auditimi i pajtueshmërisë funksionon konform të njëjtin Doracak si atë financiar, atëherë edhe metoda e rregullimit të dokumentimit dhe përgatitjes së dëshmimeve është e njëjtë. Prandaj, me qëllim që mos të përsëriten të njëjtat, më në detaje rreth këtij procesi është përshkruar te pjesa më lartë në përshkrimin për auditimin financiar.

Komunikimi- sipas Doracakut të Auditimit, komunikimi i ZKA-së me entitetin e audituar duhet të filloj nga momenti i informimit për fillimin e auditimit. Ky informim bëhet nga departamenti i auditimit për Zyrtarin Kryesor Administrativ të entitetin, përmes një letre angazhimi ku informohen për planin, përgjegjësitë e ZKA-së dhe të entitetit të audituar, kërkohen dokumentet e nevojshme për realizimin e atij auditimi, si dhe interpretohen personat të cilët përbëjnë ekipin. Si formë tjetër e komunikimit është edhe zhvillimi i intervistave me personat përgjegjës në entitet, si dhe dokumentimi i tyre në dosjen e auditimit.

Dimensioni (ii): Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit të auditimit të pajtueshmërisë

Ekipet e auditimit që kryejnë auditimin e kombinuar financiar dhe të pajtueshmërisë kanë kompetencë për të kryer këtë lloj të auditimit. Pjesa e kompetencës është shpjeguar hollësisht në auditimin financiar, megjithatë në këtë pjesë do të shpjegojmë se sa janë plotësuar kriteret shtesë për auditimin e pajtueshmërisë.

I gjithë stafi i ZKA-së është nënshtruar trajnimeve për aplikimin e metodologjisë për auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë. Para daljes në teren i gjithë stafi është testuar për njohuritë në manual. Gjithashtu, para fillimit të sezonit të auditimit në baza vjetore mbahen trajnime të brendshme, nga departamenti për Metodologji në Auditim ku trajtohen çështjet me shembuj konkret në ato raste ku është identifikuar se ka pasur më shumë vështirësi në sezonin e kaluar. Gjithashtu, ligjet dhe rregulloret e reja shpërndahen te stafi nga departamenti ligjor dhe në rastet kur ato janë të reja mbahen trajnime të veçanta.

Përveç, kësaj për çështje të pajtueshmërisë në rastet kur paraqitet nevoja, ekipet e auditimit marrin interpretime dhe këshilla edhe nga Departamenti për Çështje Ligjore, brenda ZKA-së.

Sipas vlerësimit tonë ekipet kanë njohuri për standardet e aplikueshme, kornizën rregullative dhe ligjore, njohuri të mjaftueshme për operimin e auditimit si dhe kanë udhëzime në Doracakun e Auditimit me shembuj konkret.

Ashtu si për auditimet financiare, kemi vlerësuar se linjat e raportimit janë të qarta dhe ato zbatohen në praktikë (e njejta linjë e raportimit dhe e kontrollit të cilësisë funksionon edhe në këtë fushë të auditimit. Të gjitha janë të rregulluara përmes softëer-it të auditimit).

Para fillimit të auditimit, ekipet pohojnë se kanë njohuritë e nevojshme për të kryer auditimit, ndërsa vlerësojnë edhe nevojën për ekspertë, përmes letrave të caktuara të punës. Deri me tani nuk kemi hasur në raste që është kërkuar ndonjë ekspert për çështje të caktuara të pajtueshmërisë⁴².

Dimensioni (iii) Kontrolli i cilësisë në auditimin e pajtueshmërisë

Përmes këtij dimension i janë vlerësuar procedurat e rregulluara për kontrollin e cilësisë, si dhe aplikimin e tyre në praktikë. Ky dimension është kategorizuar me notën 4, sepse të gjitha kriteret e përcaktuara janë përmbushur.

⁴² Lidhur me kompetencën e stafit, më në detaje është shpjeguar te pjesa e auditimit financiar, meqenëse ekipet janë të njejta.

Për ta trajtuar këtë dimension, kemi vlerësuar procedurat e shkruara në Doracakun e Auditimit, Udhëzuesin për Kontrollin e Cilësisë për auditimin e rregullsisë, pakon e aprovuar të letrave të punës si dhe regjistrimin e tyre në softuerin e auditimit.

Meqenëse të gjitha procedurat e auditimit të pajtueshmërisë dhe rishikimet aplikohen të njëjta sikurse edhe për pjesën financiare të auditimit, në këtë pjesë kemi prezantuar vetëm vlerësimin dhe konfirmimin që ky dimension ka përmbushur të gjitha kriteret e caktuara. Prandaj detajet për këtë pjesë të kontrollit të cilësisë janë shtjelluar në **SAI 9 dimensioni iii**.

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Standardet dhe politikat e auditimit të pajtueshmërisë	Të gjitha kriteret janë plotësuar ISA ka adaptuar dhe është në funksion Doracaku i Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë (qasje e kombinuar), konform standardeve ndërkombëtare të auditimit (SNISA 2000 dhe SNISA 4000). Po ashtu, ky Doracak është bërë edhe në pajtim me mandatin e ISA të rregulluar me ligj si dhe me Kodin e Etikës Profesionale, gjithashtu e rregulluar me SNISA 130.	4
(ii) Menaxhimi dhe aftësitë e ekipit të auditimit të pajtueshmërisë	Të gjitha kriteret janë plotësuar ISA ka vendosur një sistem për të siguruar se anëtarët e ekipit të auditimit si pjesë e stafit, posedojnë kompetencë dhe aftësi profesionale të mjaftueshme për të kryer një auditim të kombinuar. Kjo është e rregulluar me rregullore të brendshme si dhe me planet vjetore të cilat planifikohen për trajnimin e vazhdueshëm profesional të stafit.	4
(iii) Kontrolli i cilësisë në auditimin e pajtueshmërisë	Të gjitha kriteret janë plotësuar ISA ka të rregulluar mënyrën e funksionimit të kontrollit të cilësisë me udhëzim të veçantë. Po ashtu linjat e raportimit janë të qarta.	4

4.3.9 SAI – 16: Procesi i Auditimit të Pajtushmërisë – Nota [2]

Ky indikator vlerëson se si auditimi financiar është realizuar në praktikë, në fazën e planifikimit, implementimit dhe raportimit të auditimit.

Ky indikator ka tri dimensione:

- (i) **Planifikimi i auditimit të pajtushmërisë;**
- (ii) **Implementimi i auditimit të pajtushmërisë; dhe**
- (iii) **Vlerësimi i dëshmive të auditimit, përfundimi dhe raportimi në auditimet e pajtushmërisë.**

Vlerësimi i indikatorit SAI-16 është bazuar në mostrat e përzgjedhura për testimin e dosjeve të aplikuara në auditim. Burimet e informacioneve të cilat janë përdorë janë:

- Dosjet e auditimit;
- Softueri i auditimit SITA;
- Intervistat e zhvilluara sipas nevojës me auditorët e angazhuar në ato auditime;
- Doracakut i Auditimit Financiar dhe të Pajtushmërisë;
- Kodi i Etikës së ISA të Kosovës;
- Deklarata e Pavarësisë për stafin auditues; dhe
- Përcaktimi i objektivave për auditor për atë vit auditues.

Viti i cili e kemi marrë për vlerësimin e këtyre dosjeve është viti 2020, ku metodologjia e re ka filluar të aplikohet (ndryshimi i doracakut të auditimit), si dhe softueri i auditimit ka hyrë në funksion. Gjatë këtij viti janë kryer gjithsej 116 auditime financiare dhe të pajtushmërisë (qasje e kombinuar).

Ashtu siç është sqaruar më lartë, ZKA kryen auditime financiare dhe të pajtushmërisë si qasje e kombinuar. Edhe pse qasja për secilin lloj të auditimit ndryshon, megjithatë përdoret e njëjta dosje dhe pako e letrave të punës (duke përfshirë pjesën financiare dhe ato të pajtushmërisë). Auditimi i pajtushmërisë, nënkupton pajtushmërinë e transaksioneve me autoritetet dhe ligjet përkatëse të aplikueshme në vend. Dhe për këtë arsye mostrat e njëjta të cilat janë vlerësuar në aspektin financiar, janë trajtuar edhe për pajtushmëri.

Auditim i veçantë i pajtushmërisë për procedura, si i ndarë nga auditimi financiar ende nuk ka filluar të bëhet nga ISA.

Dimensioni (i): Planifikimi i auditimit të pajtushmërisë

Në këtë dimension kemi vlerësuar rezultatet e aplikimit të standardeve dhe kërkesave të Doracakut të Auditimit në praktikë. Ky dimension është kategorizuar me **notën 1**, kjo për arsye se në disa prej kritereve të përcaktuara në këtë dimension nuk janë përmbushur nga dosja e auditimit të kontraktuar. Mangësia në këtë rast është si rezultat i kushteve të caktuara në kontratën e lidhur mes ISA dhe kompanisë private.

Duhet të theksohet se të gjitha këto kritere (a,b, g dhe h) janë plotësuar nga dosjet e auditimit të kryera nga stafi i ISA-së. Mirëpo, meqë kushti është që nëse vetëm njëra nga dosjet nuk e plotëson njërin nga kriteret, duhet të jetë si i kriter i pa plotësuar, atëherë kjo mostër ka ndikuar që të jetë vlerësimi me këtë notë.

Nga vlerësimi i dosjeve kemi arritur në një konkluzion të përgjithshëm se planifikimi i auditimit të pajtueshmërisë ishte bërë konform kërkesave të Doracakut dhe njëkohësisht edhe të standardeve ndërkombëtare. Përfundim në disa kritere bënë dosja e auditimit nga kompania e kontraktuar, ku në disa raste nuk ishin përmbushur këto kritere apo nuk kanë qenë të aplikueshme.

Gjatë planifikimit të auditimit të pajtueshmërisë, ekipet kanë për detyrë të identifikojnë autoritetet dhe ligjet e aplikueshme për atë entitet të audituar. Dhe lidhur me këtë kriter ekipet kishin identifikuar të gjitha ligjet, rregulloret dhe udhëzimet si pjesë e mbulueshmërisë së këtij auditimi. Po ashtu, është bërë qasja e përgjithshme ku janë specifikuar të gjitha ato ligje apo nene të aplikueshme si dhe pohimet e auditimit të cilat i mbulojnë, si dhe te pako e njohjes së entitetit është sqaruar korniza ligjore që entiteti funksionon.

Përfundim për këtë kriter bënë dosja e kontraktuar, me ç' rast nuk kishte ndonjë dokument apo letër pune ku e dëshmon identifikimin e kësaj fushe.

Si pjesë e planifikimit është edhe identifikimi i rreziqeve (të vetvetishme dhe të kontrollit) për krijimin e qasjes së atij auditimi. Të njëjtin rast kemi edhe te ky kriter, ku auditimet e kryera nga stafi i ZKA-së kishin evidentuar dhe vlerësuar të gjitha rreziqet e mundshme, qoftë të vetvetishëm, të kontrollit apo nga mashtrimi që mund të ballafaqohet entiteti. Këto letra të punës janë pjesë e shabllonit të dosjes së auditimit, dhe të gjitha janë të evidentuara në softuerin e auditimit. Megjithatë edhe te kjo pikë vlerësimi nuk është i mirë për arsye se dosja e auditimit nga kompania private nuk përmban një dokument të tillë, ku dëshmon se këto rreziqe janë trajtuar.

Përcaktimi i materialitetit është bërë konform kërkesave të Doracakut. Ky materialitet është i njëjtë si materialiteti financiar, për arsye se caktohet si bazë e shpenzimeve apo buxhetit të planifikuar (varësisht në cilën fazë audituese është planifikimi). Megjithatë nuk është vërejtur se është bërë një analizë e detajuar gjatë përcaktimit të materialitetit cilësor të pajtueshmërisë, por është vendosur të zgjidhet me metodën e njëjtë si për materialitetin financiar.

Po ashtu ishte dokumentuar mirë edhe qasja e krijuar e auditimit përmes Memorandumit final të auditimit, ku janë caktuar objektivat, resurset të cilat priten të përdoren, koha e detajuar e auditimit me fokusin në pajtueshmërinë me autoritetet.

Edhe komunikimi me entitetin ishte aplikuar dhe dëshmuar mirë. Para fillimit të auditimit ishte dërguar secili ekip kishte dërguar letër angazhimit ku janë theksuar detyrat dhe përgjegjësitë e ekipit, informatat të cilat ju nevojiten për atë auditim, si dhe anëtarët që përbëjnë atë auditim. Përmes këtij komunikimi është treguar edhe koha e planifikuar për auditim si dhe është kërkuar për caktimin e personit kontaktues gjatë atij auditimit.

Po ashtu ishin nënshkruar edhe deklaratat e pavarësisë profesionale dhe ishin vendosur në dosjet përkatëse.

Dimensioni (ii): Zbatimi/ ekzekutimi i auditimit të pajtueshmërisë

Në këtë dimension ekipi i vlerësimit ka vlerësuar kritere të ndryshme të cilat duhet marrë parasysh gjatë implementimit të auditimit të pajtueshmërisë dhe nëse ato kritere janë përcjellur nga ekipet e auditimit.

Ky dimension është vlerësuar me **notën 4**, sepse të gjitha ato kritere të përcaktuara janë përmbushur në dosjet e auditimit, si dhe rishikim të pavarur nga Departamenti i Sigurimit të Cilësisë kishte për një nga pesë dosjet e vlerësuara.

Edhe në këtë dimension, njëjtë si në SAI 10 (ii) vlerëson në përgjithësi procedurën e realizimit të auditimit duke u mbështetur në dëshmitë përkatëse, dizajnimin e testeve të pajtueshmërisë, bazën e mostrave të testuara, përdorimin apo jo të punës së ekspertëve të jashtëm, dëshmitë në auditim për mostrat dhe opinion e dhënë, si dhe nëse i gjithë plani i auditimit ka arritur të realizohet me sukses.

Në mënyrë që mos përsëriten të njëjtat si në sqarimet e bëra te SAI 10 (ii), si konkluzion i përgjithshëm, të gjitha dosjet e vlerësuara kishin arritur të dëshmojnë me evidenca përkatëse dhe të qarta. Memorandumi i auditimit, është një dokument ku ekipet kishin prezantuar gjithë qasjen e planifikuar të auditimit, vlerësimin e rreziqeve, materialitetin, dhe kohën e planifikuar për kryerjen e këtyre hapave. Po ashtu edhe te llogaritja e madhësisë së mostrave, është prezantuar numri i mostrave dhe shpjegimi i kalkulimit të tyre, të cilat janë vendosur për auditim.

Sqarim: Mostrimi për auditim të pajtueshmërisë ka qenë e njëjtë për të gjitha entitetet e audituara. D.m.th., të njëjtat mostra të cilat janë përzgjedhur për teste financiare, i janë nënshtruar edhe për teste të pajtueshmërisë (ku testet e pajtueshmërisë janë të ndryshme, por mostrat e njëjta). Prandaj letrat e punës janë të njëjta për ty dy llojet e auditimeve. Mirëpo përveç kësaj, ekipet kanë audituar edhe disa procedura të prokurimit të realizuara atë vit, procedura të rekrutimit (nëse ka pasur) si dhe procedurat e mbledhjes së të hyrave.

Gjithashtu ishte bërë përditësimi i njohjes së entitetit, duke plotësuar me informatat rreth rreziqeve të mundshme për mashtrim apo manipulim, ku me ç' rast ekipet nuk kishin vlerësuar raste të dyshuara të mashtrimit. Ekipet gjatë intervistave me entitetin e audituar, kishte diskutuar ndër të tjera edhe për lëndët nën hetime (nëse ka pasur). Përjashtim këtu bënë dosja e kontraktuar, ku kishte evidentuar përgjegjësitë nga mashtrimi, mirëpo nuk kishte të dëshmuar se është diskutuar me entitetin.

Dëshmitë e auditimit ishin evidentuar në matricat përkatëse të testimit, ku ishte e plotësuar me të gjitha testet e pajtueshmërisë për të cilat ekipi i kishte caktuar gjatë planifikimit. Brenda kësaj matrice janë regjistruar të gjitha të dhënat për mostrat e testuara në të gjitha kategoritë ekonomike, dhe janë bashkangjitur dëshmitë përkatëse. Gjetjet e auditimit (letra e punës), përmbajnë të gjitha gjetjet të cilat janë pjesë e raportit final (duke përfshirë çështjet për opinion financiar, konkluzion të pajtueshmërisë dhe gjetjet tjera sipas kategorive ekonomike). Po ashtu, për të gjitha këto çështje janë të bashkangjitura edhe dëshmitë përkatëse. Raporti i Auditimit ka prezantuar konkluzionin për pajtueshmëri, duke treguar gjendjen e identifikuar, ndikimin e tyre dhe rekomandimet për to.

Mund të themi se auditimet ishin realizuar sipas planit, përveç afateve kohore ku ka pasur vonesa në publikimin e raportit. Kjo ka ndodhur në shumicën e auditimeve, për arsye të situatës pandemike, ndryshimit të metodologjisë së auditimit dhe hyrja në funksion e softuerit të auditimit SITA.

Dimensionimi (iii): Vlerësimi i dëshmive të auditimit, përfundimi dhe raportimi në auditimet e pajtueshmërisë

Dokumentimi dhe dëshmitë në auditim- Ashtu si për pjesën financiare të auditimit edhe te pjesa e pajtueshmërisë, i gjithë procesi është i dokumentuar, përfshirë programet që do të testohen, njohja e entitetit, vlerësimi i rrezikut, vlerësimi i kontroleve të brendshme, fushëveprimi i auditimit, etj. Po ashtu i gjithë procesi i ekzekutimit është i kompletuar me dëshmi përkatëse të cilat janë të mjaftueshme për të mbështetur konkluzionin e dhënë për pajtueshmëri. Çështje të rëndësishme në të gjitha fazat janë arsyetuar me sqarime të nevojshme në rastet kur është ushtruar gjykimi profesional. Në të gjitha auditimet dosja është vendosur në SITA, sipas hapave të paraparë. Letrat e punës dhe trajtimi i gjetjeve është i qartë dhe i dëshmuar me evidenca përkatëse, dhe këto ishin prezantuar në Raportin e Auditimit.

Vlerësimi i dëshmive të auditimit- nga mostrat e vlerësuara të gjitha dosjet kishin dëshmi të mjaftueshme dhe të qëndrueshme, të cilat, mbështesin konkluzionin e dhënë për pajtueshmëri në raportin e auditimit. Të gjitha këto dëshmi janë të listuara dhe të lidhura qartë, si dhe lehtë të kuptueshme edhe nga një person i cili nuk është i angazhuar në auditim.

E gjithë procedura e dosjes së dokumenteve ishte ndjekur sipas kërkesave të Doracakut, ku forma, përmbajtja dhe cilësia e saj ishin në nivel të mirë.

Komunikimi me entitetin e audituar- mbajtja e takimit përmbyllës me entitetin pas përfundimit të auditimit është e kërkuar sipas Doracakut të Auditimit dhe njëkohësisht sipas shabllonit të letrave të punës. Të gjitha ekipet kishin mbajtur takimin përmbyllës dhe kishin përshkruar procesin e njoftimit të përmbajtjes së pritur të raportit. Njëkohësisht është prezantuar edhe pjesëmarrja në takim dhe kishin sqaruar për pajtimin apo jo të personave përgjegjës të atij entiteti me gjetjet e identifikuar. Përrjashtim këtu bënë dosja e auditimit të kontraktuar, ku nuk është mbajtur një takim i tillë, sepse në raportin e auditimit nuk kishte asnjë gjetje të identifikuar.

Pjesë e komunikimit me entitetin është edhe dërgimi i Draft Raportit në entitet dhe periudha e caktuar për komentet e mundshme. Kjo është e rregulluar me Ligjin nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës që nga momenti i dërgimit të draftit, entiteti ka afat prej 15 ditë kalendarike që të i ofrojë komentet e mundshme lidhur me gjetjet në atë draft.

Të gjitha draftet e dërguara kishin të bashkangjitur edhe Letrën Përcjellëse si dëshmi për mundësinë e komentimit të atij drafti nga entiteti. Po ashtu, në raportet finale janë të bashkangjitura letër konfirmimet nga entiteti për pranimin e përmbajtjes së raportit.

Raporti i Auditimit është përgatitur sipas shabllonit dhe kritereve të përcaktuara me Doracakun e Auditimit. Trajtimi i gjetjeve dhe pjesa narrative e raportit ishte i plotë dhe i shkruar konform

objektivave. Përjashtim ka afati kohor i publikimit të 3 mostrave të raportit, ku ka pasur vonesa në publikim. Kjo ka ndodhur për arsyet e sqaruara më lartë.

Të gjitha raportet kishin elementet e kërkuara, si: titullin e raportit; adresën e ZKA-së; detyrat dhe përgjegjësitë e ISA dhe menaxhmentit të audituar; konkluzionin për pajtueshmëri, kriteret; nënshkrimi i Auditorit të Përgjithshëm dhe kohën e publikimit të raportit.

Po ashtu, raportet kishin të gjitha elementet dhe shkrimi i tij ishte mjaftueshëm i qartë. Gjetjet për pjesën e pajtueshmërisë janë mirë të prezantuara dhe të sqaruara, duke treguar ndikimin e secilës gjetje dhe rekomandimin e dhënë për menaxhmentin e audituar.

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimenzioni	Rezultati	Vlerësimi
(i) Planifikimi i auditimit të pajtueshmërisë	<p><i>Kriteri c, d, f, i, j dhe k janë përmbushur. Kriteret a, b, g dhe h nuk janë përmbushur.</i></p> <p>Kemi vlerësuar se të gjitha dosjet e planifikimit ishin mirë të përgaditura. Të gjitha letrat e punës kishin përmbajtje cilësore dhe lehtë të kuptueshme. Çasja e auditimit ishte e sqaruar mirë dhe e mbështetur me konkluzione dhe dëshmi përkatëse. Po ashtu, një nga pesë dosjet e vlerësuara i ishin nënshtruar rishikimit të pavaur nga Departamenti i Kontrollit të Cilësisë.</p> <p><i>Vëmendje: Kriteret e listuara si të pa përmbushura më lartë, janë vetëm për dosjen e auditimit të kontraktuar. Të gjitha dosjet tjera të cilat janë përgatitur nga stafi i ISA i kanë përmbushur edhe kriteret a, b, g dhe h, dhe janë të dokumentuara në dosjen e auditimit.</i></p>	1
(ii) Implementimi i auditimit të pajtueshmërisë	<p><i>Të gjitha kriteret janë përmbushur.</i></p> <p>Sipas vlerësimit tonë i gjithë procesi i implementimit të auditimit është shumë mirë i dokumentuar me dëshmi relevante. Dosjet e auditimit janë regjistruar në softëerin SITA, në të cilat kanë qasje vetëm stafi auditues i angazhuar për atë auditim. Në fund të secilit auditim është bërë edhe arkivimi i atyre dosjeve.</p>	3
(iii) Vlerësimi i dëshmimeve të auditimit, përfundimi dhe raportimi në auditimet e pajtueshmërisë	<p><i>Të gjitha kriteret janë përmbushur.</i></p> <p>Raportet kishin të gjitha elementet e kërkuara dhe shkrimi i tij ishte mjaftueshëm i qartë. Gjetjet janë mirë të prezantuara dhe të sqaruara, duke treguar ndikimin e secilës gjetje dhe rekomandimin e dhënë për menaxhmentin e audituar. Opinionet ishin të bazuara dhe të mbështetura mirë me dëshmi përkatëse.</p>	3

4.3.10 SAI-17: Rezultatet e auditimit të pajtueshmërisë – Nota [3]

SAI-17 vlerëson sa efikas është ZKA në dorëzimin dhe publikimin e raporteve të auditimit të pajtueshmërisë.

Ky indikator kërkon informacion se si bëhen auditimet e pajtueshmërisë në praktikë gjatë planifikimit, fazat e zbatimit/ekzekutimit dhe raportimit të ciklit të auditimit.

Ky tregues ka tre dimensione:

- (i) Dorëzimi në kohë i rezultateve të auditimit të pajtueshmërisë;**
- (ii) Publikimi në kohë i rezultateve të auditimit të pajtueshmërisë; dhe**
- (iii) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe observimeve nga ISA.**

Ashtu siç kemi sqaruar edhe në treguesit e tjerë, ZKA nuk kryen auditime të veçanta të pajtueshmërisë, mirëpo në baza vjetore kryen auditime të financiare dhe pajtueshmërisë. Prandaj, dosjet të cilat janë vlerësuar për këtë pjesë, janë të njëjta me ato të cilat janë trajtuar edhe në pjesën financiare.

Burimet e tjera të informacioneve janë:

- Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me plotësim ndryshimet;
- Rregullore e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit;
- Doracaku i Auditimit Financiar dhe i Pajtueshmërisë;
- Dorëzimin e raporteve tek entitetet e audituara dhe letër-përcjellëset e raporteve;
- Konfirmimet e pranimit të raporteve të auditimit;
- Dorëzimin e raporteve në Kuvend dhe komisionet përkatëse parlamentare;
- Publikimin e raporteve në ueb faqe, listën e raporteve të publikuar me datat e publikimit; dhe
- Planin e zbatimit të rekomandimeve të dorëzuara nga entitetet e audituara.

Dimensioni (i): Dorëzimi në kohë i raporteve të auditimit të pajtueshmërisë

Ky dimension vlerëson nëse raportet e auditimit të pajtueshmërisë dorëzohen në kohën e duhur.

Sipas ligjit dhe procedurave të zbatueshme, ZKA duhet t'i dorëzojë entitetit të audituar dhe Kuvendit, raportet e auditimit të rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) brenda 6 muajve pas pranimit të pasqyrave dhe shënimeve të tjera, respektivisht deri më 30 qershor. Cikli i auditimeve të rregullsisë përmbyllet në fund të muajit gusht, kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

ISA gjatë sezonit 2020/2021 ka arritur të përfundoj me kohë vetëm 40% të auditimeve. Kjo ka ndodhur si pasojë e rrethanave të Covid- 19, ndryshimeve në metodologjinë e auditimit dhe

përdorimit të SITA-as. Pavarësisht, vonesave në raportet individuale, Raporti i Auditimit të Bxuhetit të shtetit ka arritur të publikohet brenda afatit ligjor.

Në dosjet e auditimeve kemi gjetur dëshmi se janë dërguar letër-përcjellëset e nënshkruara dhe protokolluara së bashku me raportin e auditimit tek entitetet e audituara dhe Kuvendi. Po ashtu, në ueb faqe mund të vërejmë se këto raporte janë publikuar sipas procedurës.

Dimensioni (ii): Publikimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Pajtushmërisë

Përmes këtij dimension i është vlerësuar nëse raportet e auditimit të pajtushmërisë, publikohen dhe janë të qasshme për publikun.

Ashtu, sikurse edhe në auditimet e tjera, të gjitha raportet e auditimit publikohen që dhe janë të qasshme për publikun në ueb faqen e ZKA-së⁴³.

Dimensioni (iii): Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe observimeve nga ISA

Në këtë dimension, ekipi, ka vlerësuar nëse ISA ka bërë përcjellje të zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Me rastin e publikimit të raportit, entitetet e audituara brenda 30 ditëve, duhet të përgatisin planin e veprimit dhe ta dorëzojnë tek ISA sipas formatit të kërkuar, përfshirë kohën dhe mënyrën se si do të zbatoj rekomandimet. Po ashtu, sipas kësaj procedure, entitetet duhet të raportojnë dy herë në vit për progresin në zbatimin e rekomandimeve. Këtë raport duhet ta dorëzojë edhe në Kuvend, apo Kuvendet komunale.

Nga 5 dosjet e vlerësuara, 3 prej tyre kishin dorëzuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve; një nuk kishte dorëzuar planin; dhe për auditimin e kontraktuar kjo nuk ishte e aplikueshme sepse në raport nuk kishte gjetje të identifikuar.

Ndërkaq sa i përket raportimit për progresin e zbatimit të rekomandimeve, nuk gjenden dëshmi në asnjërën prej dosjeve se ka pasur raportime të tilla.

Siç kemi shpjeguar në auditimet financiare, sipas Doracakut të Auditimit, gjatë kryerjes së auditimit në baza vjetore, pjesë e auditimit është vlerësimi dhe raportimi i nivelit të zbatimit për vitin paraprak. Po ashtu, niveli i zbatimit të rekomandimeve, publikohet në ueb faqe, sikurse edhe publikimi i planeve të veprimit.

ISA vlerëson zbatimin e rekomandimeve, megjithatë përgjegjës për të siguruar se ato po zbatohen është KMFP-ja, të cilët kërkojnë nga institucionet që përveç në ZKA të dorëzojnë planin e zbatimit edhe në komision.

⁴³ <https://ëëë.zka-rks.org/publications/>

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Dorëzimi në kohë i raporteve të auditimit të pajtueshmërisë	<i>Kriteri 3 është përmbushur.</i> ISA ka dorëzuar me kohë të vetëm 40 % të raporteve të auditimit të rregullsisë tek entitetet e audituara dhe Kuvend brenda afatit ligjori, prandaj është vlerësuar me notën 2.	2
(ii) Publikimi në kohë i Raporteve të Auditimit të pajtueshmërisë	<i>Është përmbushur kriteri 4.</i> Të gjitha raportet e auditimit janë të qasshme në ueb faqen e ISA-së.	4
(iii) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe observimeve nga ISA	<i>Të gjitha kriteret janë përmbushur.</i> ISA ka praktikë të mirë të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të kombinuar (financiar dhe pajtueshmëri) prandaj është vlerësuar me 4.	4

4.4 Domeni D: Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse

Domene D shqyrton nëse ISA po menaxhon operacionet e veta në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive dhe nëse është në përputhje me rregullat dhe rregulloret në fuqi. Domene D përfshin një tregues të vetëm.

Domene D: Menaxhimi financiar, pasuritë dhe shërbimet mbështetëse		Dimensionet			Notimi i përgjithshëm
Treguesi	Emri	i	ii	iii	
SAI-21	Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet mbështetëse	4	2	4	3

4.4.1 SAI-21: Menaxhimi financiar, pasuritë dhe shërbimet mbështetëse – Nota [3]

SAI-21 shqyrton sistemin e brendshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit të ZKA-së, si dhe politikat dhe praktikën e saj në lidhje me shërbimet mbështetëse dhe burimet që nevojiten. Ato përfshijnë IT, pasuritë dhe infrastrukturën, si dhe mbështetjen administrative. ZKA ka të miratuar Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës. Me këtë rregullore përcaktohet organizimi i brendshëm, funksionimi dhe menaxhimi i njësive organizative, si dhe sistematizimi i vendeve të punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Njësitë organizative e ZKA-së janë:

- Departamentet e auditimit;
- Departamentet mbështetëse (Departamenti për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve);
- Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar;
- Departamenti për Buxhet dhe Burime Njerëzore (Divizioni për Buxhet dhe Financa dhe Divizioni për Burime Njerëzore);
- Departamenti për Shërbime të Përbashkëta (Divizioni për Logjistikë; Divizioni për Administrimin e Dokumenteve; dhe Divizioni për Përkthime);

- Departamenti për TI
- Njësia për Prokurim
- Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Ky tregues ka 3 dimensione:

- (i) Menaxhimi financiar.**
- (ii) Planifikimi dhe përdorimi efektiv i pasurive dhe infrastrukturës.**
- (iii) Shërbimet mbështetëse administrative.**

Vlerësimi i këtij treguesi është mbështetur në ligjin 05/L-055, Ligjin 03/L-048 dhe Rregullat e Thesarit

Dimensio (i): Menaxhimi financiar

ZKA-ja, burim kryesor të financimit ka Buxhetin e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, ZKA-ja pranon donacione dhe grante të ndryshme për të mbështetur aktivitetet dhe funksionet e saj. Ndërsa të hyrat që i realizon nga kryerja e auditimeve të projekteve të ndryshme, të financuara kryesisht nga donatorët, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës. ZKA-ja bën përpjekje të vazhdueshme të zbatoj me përpikëri të gjitha rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë me menaxhimi financiar dhe kontrollin në Republikën e Kosovës.

Ka të përcaktuara rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimi e aktivitetet financiare konform rregullave të Thesarit.

Të gjitha proceset e menaxhimi financiar rregullohen përmes kornizës ligjore në nivel vendi kryhen përmes Sistemit Informativ për Menaxhimi e Financave Publike (SIMFK), si dhe Rregulloret të Brendshme të ZKA-së

Edhe buxhetimi edhe shpenzimi bëhen në pajtim me rregullat e lartpërmendura. Në baza vjetore përgatit PFV-të të cilat auditohen nga një auditor i jashtëm i pavarur i angazhuar nga Kuvendi dhe të cilat publikohen në RVP.

Rregullorja ZKA (Nr. 01/2021) për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, neni 23 përcakton mënyrën e organizimit të Departamentit për Buxhet dhe Burime Njerëzore të ZKA-së. Divizioni për Buxhet realizon të gjitha proceset financiare sipas procedurave të përcaktuara ligjore të Kornizës Ligjore në nivel qendror si:

- Planifikimi dhe përgatitja e propozim buxhetit të ZKA-së;
- Ekzekutimi i pagesave dhe transaksioneve të tjera financiare;
- Drejtimi i funksionimit dhe administrimit të financave në ZKA;
- Përgatitja/hartimi i Pasqyrave Financiare Vjetore, raportimi periodik te Drejtori i Përgjithshëm dhe Auditori i Përgjithshëm si dhe përgatitjen e të dhënave për raportin vjetorë të performancës së ZKA-së etj.

Rregullorja ZKA (Nr. 02/2021) për Klasifikimin e Vendeve të Punës, nenet 11, 17, 36 dhe 37 përshkruan kërkesat që duhet plotësuar për stafin e angazhuar në procese financiare. I gjithë stafi ka diplomë universitare, përvojë relevante dhe certifikimet e nevojshme për të kryer punën përkatëse.

Dimensio (ii): Planifikimi dhe përdorimi efektiv i pasurive dhe infrastrukturës

ZKA-ja nuk ka objekt në pronësi të veten dhe është e detyruar të kryej aktivitetet e veta të punës në një objekt me qira. Kjo ka ndikim edhe financiar edhe operativ si dhe ka ndikim në planifikimin afatgjatë sa i përket sigurisë dhe mirëqenies së punonjësve.

Nuk ka strategji afatgjate për nevoja të infrastrukturës dhe plan afatshkurtër për TI-në. Një draft i strategjisë për TI-në është në proces të hartimit.

ZKA-ja çdo vit e rifreskon infrastrukturën e TI-së bazuar në nevojat dhe kërkesat institucionale.

Në baza të rregullta menaxhon dhe raporton për pasuritë e veta sipas kërkesave ligjore.

Qasja në dokumentacion dhe arkiv është e rregulluar sipas Kodit shtetëror për Arkivat dhe rregullores së ZKA-së për administrimin e dokumenteve.

Dimensionii (iii): Shërbimet mbështetëse administrative

Stafi i shërbimeve të përbashkëta ka përgatitjen profesionale, shkathtësitë dhe përvojën dhe burimet e duhura për të kryer punën në mënyrë efektive.

Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara qartë me rregulloret e brendshme dhe përshtatjet e detyrave të punës.

Rregullorja ZKA (Nr. 01/2021) për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, neni 25 përshkruan detyrat dhe përgjegjësitë e departamentit të IT-së që janë:

- Menaxhimi dhe mbrojtja e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit për të ofruar shërbimet e TI-së në ZKA;
- Administrimi dhe mbrojtja e burimeve të të dhënave dhe e aplikacioneve të sistemit;
- Realizimi i punëve operacionale të TI-së dhe projekteve të TI-së;
- Realizimi i shërbimeve të mirëmbajtjes, mbrojtjes dhe menaxhimit të infrastrukturës së TI si pjesë e operacioneve të TI-së;
- Ripërtëritja dhe përshtatja e infrastrukturës së TI si pjesë e projekteve të TI-së;
- Analiza e nevojave buxhetore për departament të TI dhe për projekte të ripërtëritjes së infrastrukturës së TI-së;
- Përgatitje udhëzues dhe politika për teknologji informative; dhe
- Siguron dhe ofron informata për Drejtorin e Përgjithshëm dhe e këshillon atë rreth projekteve të teknologjisë informative.

Stafi i angazhuar dhe përgjegjës për fushën e IT ka përgatitjen, përvojën dhe shkathtësitë e nevojshme. Rregullorja ZKA (Nr. 02/2021) për Klasifikimin e Vendeve të Punës, neni 13, 40, 41 dhe 42 përshkruan kërkesat që duhet plotësuar për stafin e angazhuar në procese të IT-së. I gjithë stafi ka diplomë universitare, përvojë relevante dhe certifikimet e nevojshme për të kryer punën përkatëse.

Rregullorja ZKA (Nr. 01/2021) për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, neni 24 përshkruan detyrat dhe përgjegjësitë e departamentit të Shërbimeve të Përbashkëta që përfshin:

1. Menaxhimi dhe ofrimi i shërbimeve nga fusha e shërbimeve të përbashkëta me qëllim të ofrimit të mbështetjes për të gjithë personelin e ZKA-së;
2. Analizimi dhe vlerësimi i proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandimi për ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
3. Ofrimi i ndihmës logjistike për personelin e ZKA-së dhe sigurimi i mbështetjes në kohë dhe më cilësi;
4. Siguron dhe ofron informata për Drejtorin e Përgjithshëm dhe e këshillon atë rreth proceseve të shërbimeve të përbashkëta, që përfshijnë por nuk kufizohen në logjistikë, siguri dhe mirëmbajtje të objektit dhe përkthime, me qëllim se të gjitha proceset administrative dhe teknike të ZKA-së janë duke operuar në mënyrë efikase dhe efektive.

Stafi i angazhuar dhe përgjegjës për fushën e Shërbimeve të Përbashkëta ka përgatitjen, përvojën dhe shkathtësitë e nevojshme. Rregullorja ZKA (Nr. 02/2021) për Klasifikimin e Vendeve të Punës, neni 12, 20, 43 përshkruan kërkesat që duhet plotësuar për stafin e angazhuar në procese të Administrimit të Dokumentacionit-Arkivimit. I gjithë stafi ka diplomë, përvojë relevante dhe certifikimet e nevojshme për të kryer punën përkatëse. Stafi i angazhuar dhe përgjegjës për fushën e logjistikës dhe aseteve ka përgatitjen, përvojën dhe shkathtësitë e nevojshme për kryerjen e punëve në mënyrë efektive, kërkesat e Rregullores ZKA (Nr. 02/2021) për Klasifikimin e Vendeve të Punës, neni 12, 18,38, 45 plotësohen me kualifikimet e stafit që janë të angazhuar me detyrat në divizionin e logjistikës.

ZKA në mënyrë të vazhdueshme me qëllim të funksionimit institucional sa më të mirë në nivel institucioni ndryshon Rregulloret e brendshme ku bazohet puna jonë.

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetja	Nota
(i) Menaxhimi financiar	<p>Kriteret: a, b, c, d, e, f, g, h, i, j, k, janë përmbushur</p> <p>ZKA-ja, burim kryesor të financimit ka Buxhetin e Republikës së Kosovës. Të gjitha proceset të menaxhimit financiar kryhen përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Financave Publike (SIMFK).</p> <p>Divizioni për Buxhet në kuadër të ZKA-së realizon të gjitha proceset financiare sipas procedurave të përcaktuara ligjore të Kornizës Ligjore në nivel qendror si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi dhe përgatitja e propozim buxhetit të ZKA-së; 2. Ekzekutimi i pagesave dhe transaksioneve të tjera financiare; 3. Drejtimi i funksionimit dhe administrimit të financave në ZKA; 4. Përgatitja/hartimi i Pasqyrave Financiare Vjetore, raportimi periodik te Drejtori i Përgjithshëm dhe Auditori i Përgjithshëm si dhe përgatitjen e të dhënave për raportin vjetorë të performancës etj. <p>Menaxhimi Financiar institucional rregullohet me Kornizën Ligjore të nivelit qendror dhe rregullave të institucionit.</p>	4
(ii) Planifikimi dhe përdorimi efektiv i pasurive dhe infrastrukturës	<p>Kriteret: c, d, e, janë përmbushur, ndërsa kriteret a, dhe b, nuk janë përmbushur.</p> <p>ZKA-ja nuk ka objekt në pronësi të veten dhe është e detyruar të kryej aktivitetet e veta të punës në një objekt me qira.</p> <p>Nuk ka strategji afatgjate për nevoja të infrastrukturës dhe plan afatshkurtër për TI-në. Një draft i strategjisë për TI-në është në proces të hartimit.</p> <p>ZKA-ja çdo vit e rifreskon infrastrukturën e TI-së bazuar në nevojat dhe kërkesat institucionale.</p>	2

	Në baza të rregullta menaxhon dhe raporton për pasuritë e veta sipas kërkesave ligjore. Qasja në dokumentacion dhe arkiv është e rregulluar sipas Kodit shtetëror për Arkivat dhe rregullores së ZKA-së për administrimin e dokumenteve.	
(iii) Shërbimet mbështetëse administrative	Kriteret: a, b, c, d janë përmbushur. Stafi i shërbimeve të përbashkëta ka përgatitjen profesionale, shkathtësitë dhe përvojën dhe burimet e duhura për të kryer punën në mënyrë efektive. Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara qartë me rregulloret e brendshme dhe përshkrimet e detyrave të punës.	4

4.5 Domeni E: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Plani i Trajnimeve dhe Zhvillimi

Ky domen pasqyron gjendjen e vlerësuar të funksionimit të Burimeve Njerëzore dhe trajnimeve në kuadër të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Gjatë vlerësimit, ne kemi mbledhur informacione, kemi analizuar gjendjen faktike, praktikat institucionale dhe kornizën ligjore.

Domene E: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, plani i trajnimit, dhe zhvillimi		Dimensionet				Notimi i përgjithshëm
Treguesi	Emri	i	ii	iii	iv	
SAI-22	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4	4	4	3	4
SAI-23	SAI-23 Trajnimi dhe zhvillimi profesional	2	4	4	4	4

Për të realizuar këtë vlerësim jemi bazuar në:

- Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
- Rregulloren (ZKA) nr. 01/2021 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- Rregulloren (ZKA) Nr. 02/2021 për klasifikimin e vendeve të punës;
- Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2021 për pranimin dhe karrierën;
- Rregulloren (ZKA) Nr. 04/2020 për vlerësimin e rezultateve në punë; dhe
- Planin Strategjik të Zyrës Kombëtare të Auditimit 2018-2021.

4.5.1 SAI-22: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore – Nota [4]

Vlerësimi i Indikatorit Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është realizuar përmes 4 dimensioneve dhe secili dimension është vlerësuar duke u bazuar në kriteret përkatëse për vlerësim.

Ky tregues ka 4 dimensione:

- (i) Funkzioni i Burimeve Njerëzore.**
- (ii) Strategjia e Burimeve Njerëzore.**
- (iii) Rekrutimi i Burimeve Njerëzore.**
- (iv) Shpërblimi, promovimi dhe mirëqenia e personelit**

Vlerësimi i këtij treguesi është mbështetur në kornizën ligjore të ZKA-së.

Dimension (i): Funksionimi i Burimeve Njerëzore

ZKA ka të aprovuar kornizën ligjore të brendshme përmes së cilës rregullon menaxhimin dhe funksionimin e Burimeve Njerëzore. Në përputhje me nevojat për zbatimin e mandatit ligjor të ZKA-së dhe përmbushjen e objektivave strategjike si dhe në përputhje me kërkesat e SNISA 140 për rotacion të personelit të auditimit, me Planin Vjetor të Auditimit sipas nenit 20.2 të Ligjit, Auditori i Përgjithshëm me akt të veçantë miraton sistemimin vjetor të auditorëve nëpër departamente dhe ekipe të auditimit, përfshirë edhe sistemimin e Ndhmës Auditorëve të Përgjithshëm në funksionin e mbikëqyrjes së angazhimeve.

Departamenti për Buxhet dhe Burime Njerëzore është njësi organizative mbështetëse përgjegjëse për menaxhimin e Burimeve Njerëzore, financave dhe zhvillimit profesional. Ky departament ka dy divizione:

- Divizioni për Burime Njerëzore
- Divizioni për Financa.

Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit kurse divizionet nga udhëheqësit e divizioneve. Stafi në departamentin për Buxhet dhe Burime Njerëzore ka kualifikim superior, trajnime nga fusha e administratës, financave dhe Burimeve Njerëzore si dhe përvojë disa vjeçare në ZKA.

Roli, kualifikimet dhe kërkesat për secilin vend të punës përcaktohen në rregullore dhe përmes përshkrimit të detyrave të punës. Katalogu i Përshkrimeve të Detyrave të punës është dokument i miratuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Departamenti për Buxhet dhe Burime Njerëzore ofron shërbime dhe këshilla për të gjithë personelin e ZKA-se për të siguruar se ZKA është duke zbatuar praktikatat me të mira në menaxhimin e stafit të saj, kjo është përcaktuar me Rregulloren e ZKA (Nr. 01/2021) për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, neni 23, pika 1.6.

ZKA ka të miratuar Rregulloren (ZKA) 04/2020 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, neni 23 përcakton rolin e Burimeve Njerëzore që mbledh formularët e vlerësimit nga stafi, DBNJ harton raportin dhe bën identifikimin e nevojave për trajnim të cilat shërbejnë si indikatorë për hartimin e Planit të Trajnimeve për stafin.

Roli, kualifikimet dhe kërkesat për secilin vend të punës përcaktohen në rregullore dhe përmes përshkrimit të detyrave të punës përcaktohen qartë detyrat dhe obligimet për vendin e punës. Departamenti për Buxhet dhe Burime Njerëzore ofron shërbime dhe këshilla për të gjithë personelin e ZKA-se për të siguruar se ZKA është duke zbatuar praktikatat me të mira në menaxhimin e stafit të saj.

Pasi mbledh formularët e vlerësimit nga stafi, DBNJ harton raportin dhe bën identifikimin e nevojave për trajnim të cilat shërbejnë si indikatorë për hartimin e planit të trajnimeve.

Detyrat dhe përgjegjësitë e departamentit për Buxhet dhe Burime Njerëzore, janë:

- Përcaktimi i objektivave të departamentit në përputhje me strategjinë dhe objektivat e ZKA-së dhe dizajnimi i planeve vjetore të punës të detajuara për t'i përmbushur këto objektiva;
- Planifikimi dhe përgatitja e propozim buxhetit të ZKA-së;
- Ekzekutimi i pagesave dhe transaksioneve të tjera financiare;
- Drejtimi i funksionimit dhe administrimit të financave në ZKA;
- Zhvillimi, zbatimi dhe monitorimi i të gjitha i procedurave për plotësimin e vendeve të punës në përputhje me procedurat e rekrutimit të ZKA-së;
- Ofrimi i shërbimeve dhe këshillave për të gjithë personelin e ZKA-së për të siguruar se ZKA është duke zbatuar praktikën më të mira në menaxhimin e personelit të saj;
- Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Profesional në përputhje me SNISA-t përfshirë programet për trajnim fillestar dhe edukimin e vazhdueshëm profesional, koordinon aktivitetet me departamentet përkatëse për hartimin dhe zbatimin e Planit Vjetor të Trajnimit, si dhe bashkëpunon me IDI për zhvillimin profesional të personelit të ZKA-së;
- Administron bazën e të dhënave për menaxhimin e të dhënave të personelit;
- Analizimi dhe vlerësimi i proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandimi për ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
- Përgatitja/hartimi i Pasqyrave Financiare Vjetore, raportimi periodik të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Auditorit të Përgjithshëm si dhe përgatit të dhëna për raportin vjetor të performancës; dhe
Siguron dhe ofron informata për Drejtorin e Përgjithshëm dhe e këshillon atë rreth menaxhimit financiar, procedurave, kontrolleve financiare, rekrutimit dhe procedurave të trajnimit të ZKA-së, me qëllim që të sigurojë se misioni i ZKA-së është përmbushur.

Dimensioni (ii): Strategjia e Burimeve Njerëzore

Qëllimet strategjike të BNJ në ZKA janë paraqitur në strategjinë në nivel institucioni, është hartuar plani strategjik i auditimit për vitin 2018-2021 ndër qëllimet e së cilës të zhvilloj dhe të forcoj kapacitetin institucional për të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative.⁴⁴

Objektivat strategjike

- Të zhvilloj më tej aftësitë menaxheriale, përfshirë zhvillimin e sistemeve dhe të strukturave të përshtatshme organizative për të siguruar qeverisje efektive dhe efikase;
- Të siguroj burimet njerëzore për të përkrahur rritjen e portofolios së auditimeve dhe të rris kapacitetin profesional të personelit;
- Të avancoj kornizën rregullative për menaxhimin dhe vlerësimin e performancës së personelit;
- Të forcoj kontrollet e brendshme për të siguruar cilësinë e proceseve të ZKA-së;
- Të siguroj mbështetje teknike dhe hapësirë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për punë;
- Të shtoj kujdesin për mirëqenien e personelit.

⁴⁴ [PLANI STRATEGJIK I ZYRES KOMBËTARE TË AUDITIMIT \(zka-rks.org\)](http://zka-rks.org) fq.18

Në rregulloret e brendshme të ZKA-së në mënyrë të detajuar përshkruhet roli dhe rëndësia e departamentit për Buxhet dhe Burime Njerëzore si kategori funksionale e organizimit institucional, ku përveç rolit parësor për monitorimin dhe sigurimin e proceseve të rekrutimit ofron përkrahje, për stafin në lidhje me çështjet e Burimeve Njerëzore. Gjithashtu luan një rol gjatë procesit të vlerësimit të performancës dhe përmes bashkëpunimit me departamentet përkatëse koordinon aktivitetet për realizimin e planit të trajnimeve për stafin.

BNJ mirëmban dhe azhurnon bazën e të dhënave të personelit me të dhënat personale, profesionale. Të gjitha dosjet ruhen në mënyrë diskrete në Burime Njerëzore dhe secila dosje përmban dokumentet e edukimit universitar, formulari i kodit etik, certifikim, trajnime, pushime, kontratat të punës dhe të gjitha dëshmitë relevante që duhet të jenë në dosje personale sipas rregullave në fuqi.

Çështjet strategjike për BNJ mund të adresohen përmes një strategjie të veçantë apo të përfshihen në planin strategjik të institucionit, varësisht se si menaxhmenti e vlerëson të nevojshme.

Dimensionii (iii): Rekrutimi i Burimeve Njerëzore

Procesi i rekrutimit të Burimeve Njerëzore në ZKA është i rregulluar me Rregulloren për pranimin dhe karrierën në ZKA, qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktoj procedurat për pranimin, zhvillimin e karrierës në ZKA si dhe të përcaktoj të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e punës në ZKA. Gjithashtu merren parasysh edhe kërkesat sipas INTOSAI-P-1 (Deklarata e Limës, pika 14) ku thuhet se në rekrutimin e personelit të Institucioneve Supreme të Auditimit, kërkohen njohuri mbi nivelin mesatar si dhe përvoja e duhur profesionale.

ZKA ka procedurat të shkruara në zbatim për procesin e rekrutimit. Duke vepruar në parim me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke konsideruar vlerat dhe parimet ligjore marrëdhënia e punës në ZKA themelohet bazuar në rregulla të shkruara. Për çdo vit kalendarik nga DBBNJ hartohet plani i rekrutimit dhe dorëzohet tek Auditori i Përgjithshëm. Vendet e lira të punës plotësohen në përputhje me planin e rekrutimit, duke u bazuar në nevojat e njësive organizative dhe rrethanat tjera. Planin e rekrutimit aprovohet nga Auditori i Përgjithshëm. Për stafin ekzistues dhe stafin potencial rekrutues, ZKA aplikon kritere për klasifikimin e vendeve të punës:

Përgjegjësia, kompleksiteti, kualifikimet, përvoja profesionale dhe përvoja menaxheriale.

ZKA varësisht nga kriteret klasifikon vendet e punës në kategori funksionale: Kategori e lartë drejtuese, kategori e mesme drejtuese, kategori e ulët drejtuese, kategori profesionale dhe mbështetëse. Roli, kualifikimet dhe kërkesat për secilin vend të punës përcaktohen në rregullore dhe përmes përshkrimit të detyrave të punës përcaktohen qartë detyrat dhe obligimet për vendin e punës. Procedurat e rekrutimit janë publike duke filluar nga shpallja e rekrutimit, konkursi shpallet në faqen elektronike të ZKA-së, në tabelën e shpalljeve në ZKA dhe nëse konkursi është i jashtëm shpallet edhe së paku në dy medie. Konkursi përmban të dhënat e përgjithshme për aplikim që ndërliken me pjesën profesionale dhe procedurale për vendin e lirë të punës.

ZKA promovon llojllojshmërinë dhe kujdeset që të e ritheksoj edhe në shpalljen publike (konkurs) për vendet e lira të punës. Procedura e përzgjedhjes së stafit të ri është e rregulluar me rregullore. Auditori i përgjithshëm emëron Komisionin përzgjedhës në përbërje prej tre anëtarëve, ku njëri prej tyre caktohet Kryesues. Komisioni duhet të ketë përfshirje gjinore dhe etnike, anëtarë të komisionit mund të emërohen edhe persona tjerë jashtë ZKA-së, por të cilët punojnë në institucione tjera publike apo

organizata qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës. Komisioni është përgjegjës për përzgjedhjen e stafit të ri kurse Divizioni i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të rekrutimit në të gjithë hapat e procesit.

Dimensionimi (iv): Shpërblimi, promovimi dhe mirëqenia e personelit

Përmes vlerësimit të rezultateve në punë bëhet matja e realizimit të objektivave të paracaktuara dhe matja e sjelljes profesionale e punonjësit.

Pas miratimit të Planit Vjetor të Auditimit përcaktohen objektivat e secilit staf të ekipit të auditimit, ku pas përfundimit të sezonit auditues vlerësimi bazohet në të arriturat e objektivave të paracaktuara. Për secilin vit kalendarik respektivisht pas përfundimit të sezonit bëhet vlerësimi i bazuar në objektivat e paracaktuara. Vlerësimi kryhet nga nivelet e menaxhimit sipas linjës raportuese.

Procesi i vlerësimit të rezultateve në punë të stafit të ZKA-së është i bazuar në rregullore dhe kryhet për çdo sezonë auditues, pra për secilin vit kalendarik.

Promovimi i stafit në ZKA bëhet në baza meritore ku kriteret janë të përcaktuara sipas rregulloreve në fuqi.

Zhvillimi i karrierës në kuadër të ZKA –së është i përcaktuar me rregullore, që përfshin Lëvizjen brenda kategorisë, Lëvizja e auditorëve brenda kategorisë funksionale si dhe ngritja në detyrë. Të gjitha proceset e zhvillimit në karrierë dhe promovimit janë të rregulluara me procedurë të shkruar.

ZKA ka të rregulluar procesin e kompensimeve të tjera përveç pagës mujore. Secili punonjës që arrin (10) vite të punës së pandërprerë në ZKA, shpërblehet me pagesë jubilarë në lartësi prej 50% të pagës së tij të fundit, respektivisht vlerën e një page mesatare në Kosovë. Përveç kompensimit në vlerë monetare iu ndahet edhe mirënjohje për kontributin e dhënë në ZKA.

Nuk është hartuar programi për të rritur mirëqenien e personelit, si dhe aktiviteteve sociale, rekreative dhe profilaktike që përfshijnë shumicën dërmuese të personelit nuk u është dhënë rëndësia dhe vëmendja e mjaftueshme, siç ishte planifikuar me Strategjinë 2018-2021.

ZKA-ja në bashkëpunim me SIGMA, ka zhvilluar anketimin e palëve të interesit përfshirë edhe stafin e institucionit. dhe ka marrë mendimin e tyre në lidhje me

- Strategjia dhe puna e ZKAK-së
- Trajnimi dhe zhvillimi
- Mjedisi dhe kultura e punës
- Marrëdhëniet e brendshme
- Komunikimi i brendshëm
- Komunikimi me palët e interesit.

Anketimet e SIGMA-së me palët e interesit dhe personelin e ZKA-së. janë realizuar me qëllim që ta ndihmojnë ZKAK-në në zhvillimin efektiv të strategjisë së saj dhe të planeve përkatëse të veprimit.

Menaxhmenti i ZKA –së i ofron kushte dhe hapësirë pune të përshtatshme për të gjithë stafin.

Bazuar në dimensionit dhe kriteret, ne vlerësojmë se:

ZKA ka procedura dhe rregulla për funksionimin e Burimeve Njerëzore, çështjet strategjike janë të adresuara në Planin Strategjik Institucional 2018-2021, tashmë janë hartuar në Strategjinë 2022-2025, proceset e rekrutimit janë të mbështetura në rregullore dhe është e rregulluar gjithashtu çështja e promovimit. Në bazë të analizës vlerësojmë se:

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetja	Nota
(i) Burimet Njerëzore	Kriteret: a, b, c, d, e, f, g janë të përmbushura Rregulloret e brendshme të ZKA -së përcaktojnë qartë kriteret përkatëse për vendet e punës. ZKA ka të aprovuar kornizën ligjore të brendshme përmes së cilës rregullon menaxhimin dhe funksionimin e Burimeve Njerëzore. Departamenti për Buxhet dhe Burime Njerëzore është njësi organizative mbështetëse përgjegjëse për menaxhimin e Burimeve Njerëzore, financave dhe zhvillimit profesional.	4
(ii) Strategjia për Burimet Njerëzore	Kriteret: a, b, c, d, e, f, g , janë të përmbushura Ne planin strategjik të ZKA është përfshirë qëllimi strategjik për qeverisje dhe zhvillim të kapaciteteve institucionale si dhe në rregulloret e brendshme të ZKA-se përcaktohet qartë funksionimi dhe mbarëvajtja e proceseve dhe procedurave që përfshin BNJ.	4
(iii) Rekrutimi i Burimeve Njerëzore	Kriteret: a, b, c, d, e, f, g janë të përmbushura ZKA ka procedurat të shkruara në zbatim për procesin e rekrutimit. Duke vepruar në parim me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke konsideruar vlerat dhe parimet ligjore marrëdhënia e punës në ZKA themelohet bazuar në rregulla të shkruara. Për çdo vit kalendarik nga DBBNJ hartohet plani i rekrutimit dhe dorëzohet tek Auditori i Përgjithshëm. Vendet e lira të punës plotësohen në përputhje me planin e rekrutimit, duke u bazuar në nevojat e njësive organizative dhe rrethanat tjera. Planin e rekrutimit aprovohet nga Auditori i Përgjithshëm. Për stafin ekzistues dhe stafin potencial rekrutues, ZKA aplikon kritere për klasifikimin e vendeve të punës:	4
(iv) Shpërblimi, promovimi dhe mirëqenia e stafit	Kriteret: a, b, c, d, e, f, g, h janë të përmbushura Promovimi i stafit në ZKA bëhet në baza meritore ku kriteret janë të përcaktuara sipas rregulloreve në fuqi. Zhvillimi i karrierës në kuadër të ZKA –së është i përcaktuar me rregullore, që përfshin Lëvizjen brenda kategorisë, Lëvizja e auditorëve brenda kategorisë funksionale si dhe ngritja në detyrë. Të gjitha proceset e zhvillimit në karrierë dhe promovimit janë të rregulluara me procedurë të shkruar. ZKA ka të rregulluar procesin e kompensimeve të tjera përveç pagës	3

	<p>mujore. Secili punonjës që arrin (10) vite të punës së pandërprerë në ZKA, shpërblehet me pagesë jubilarë në lartësi prej 50% të pagës së tij të fundit, respektivisht vlerën e një page mesatare në Kosovë. Përveç kompensimit në vlerë monetare iu ndahet edhe mirënjohje për kontributin e dhënë në ZKA.</p>	
--	--	--

4.5.2 SAI-23: Zhvillimi Profesional dhe trajnimet – Nota [4]

Vlerësimi i Indikatorit Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi është realizuar përmes 4 dimensioneve dhe secili dimension është vlerësuar duke u bazuar në kriteret përkatëse për vlerësim. Zhvillimi profesional duhet të shkojë përtej kornizës tradicionale të njohurive **juridike, ekonomike dhe kontabël** dhe të përfshijë teknika të tjera të menaxhimit.

Ky tregues ka 4 dimensione:

(i) Planet dhe Proceset për Zhvillim dhe Trajnim Profesional

(ii) Zhvillim dhe Trajnim Profesional i Auditimit Financiar

(iii) Zhvillimi dhe Trajnimi Profesional i Auditimit të Performancës

(iv) Zhvillimi dhe Trajnimi Profesional i Auditimit të Pajtueshmërisë

ZKA ka të instaluar një proces zinxhir që fillon me procesin e vlerësimit të performancës aty ku bëhet identifikimi i nevojave individuale për trajnim.

Dimensioni i: Planet dhe Proceset për Zhvillim dhe Trajnim Profesional

Pasi përfundon procesi i vlerësimit të performancës dhe bëhet identifikimi i nevojave për trajnim dhe mbledhja e informatave me rregullore është përgjegjësi e Departamentit për Buxhet dhe Burime Njerëzore për koordinim me departamentet përkatëse për hartimin dhe zbatimin e planit të trajnimeve dhe bashkëpunimi me IDI për zhvillim profesional të stafit. Plani i trajnimeve hartohet sipas nevojave për zhvillim të stafit ekzistues por në praktikë e zyrës ka qenë me rëndësi të veçantë ofrimi i pakos së trajnimeve për Doracakun Administrativ, Manualët e Auditimit, Rregullat e mirësjelljes etj.

1. Sipas Rregullores (ZKA) Nr. 03/2021 për pranimin dhe karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, (neni 40), Plani për zhvillim profesional përgatitet nga DBBNJ në bashkëpunim me departamentet përkatëse dhe miratohet nga Auditori i Përgjithshëm. ZKA ka të miratuar Udhëzuesin (ZKA) NR. 03/2019 për përgatitjen e skemës së trajnimeve bazike për punonjësit fillestar por që në praktikë ka një hendek të aplikimit dhe kjo pritë të përmirësohet dhe të përfshihet në planet e trajnimeve si pako e trajnimeve hyrëse. Në planet e trajnimeve të ZKA-së përfshihen temat me interes dhe që janë të nevojshme për të i ofruar njohuri stafit si procedura, politikat dhe proceset e reja të ZKA-së. ZKA për çdo vit kalendarik organizon trajnime të brendshme për stafin, nga fusha të ndryshme me theks në fushën e auditimit, Projekt dokumenti dhe planet e aktiviteteve me SNAO (trajnimet për përdorimin e gjuhës së qartë dhe të thjeshtë për auditorët e performancës dhe grupin e punues për përgatitjen e RVP dhe RVA). Në vazhdimësi trajnimet e mbështetja nga SNAO nuk ka munguar, aktualisht është në fazë të aplikimit projekt dokumenti dhe plani i veprimit për komponentët lidërsip dhe menaxhimi dhe planifikimi të projektit me SNAO. Sipas Rregullores ZKA (Nr. 01/2021) për

Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, neni 23, pika 1.7, Departamenti për Buxhet dhe Burime Njerëzore është përgjegjës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Profesional në përputhje me SNISA-t përfshirë programet për trajnim fillestar dhe edukimin e vazhdueshëm profesional, koordinon aktivitetet me departamentet përkatëse për hartimin dhe zbatimin e Planit Vjetor të Trajnimit, si dhe bashkëpunon me IDI për zhvillimin profesional të personelit të ZKA-së. Stafi që përcaktohet të marr pjesë në trajnime ndjek procedurat e nevojshme për pjesëmarrje.

Dimensionii (ii): Zhvillimi dhe Trajnimi Profesional i Auditimit Financiar

Për stafin e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme është ofruar përkrahje e zhvillimit profesional.

Kjo është realizuar ndër vite dhe vazhdon të realizohet në forma të ndryshme përmes:

- Skemave të certifikimit;
- Trajnimeve të brendshme;
- Trajnimeve të jashtme;
- Punëtori, Seminare, Tryeza Pune etj.
- Edukimi i vazhdueshëm Profesional në baza vjetore.

Stafi Auditues i auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë me përkrahje nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka ndjekur skemat të certifikimit të sektorit privat dhe publik. Rrjedhimisht pas certifikimit të suksesshëm janë përcaktuar në pozitat profesionale përkatëse në ZKA.

ZKA ka marrëveshje me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës (institucion i licencuar dhe akredituar) përmes së cilës i siguron stafit anëtarësinë e rregullt vjetore dhe mbajtjen e ligjëratave për edukimin e vazhdueshëm profesional.

Zyra Kombëtare e Auditimit në vazhdimësi ka pasur përkrahje nga ekspertë të jashtëm të fushave nga auditimi financiar dhe pajtueshmërisë që përmes programeve tutoriale, trajnim-takimeve, dhe mentorimeve stafi ka përfituar njohuri që e ka kaluar në përvojë me qëllim të kryerjes së punëve në mënyrë efikase dhe efektive.

Dimensionii (iii): Zhvillimi dhe Trajnimi Profesional i Auditimit të Performancës

Për stafin e auditimit të performancës ka qenë më sfiduese ofrimi i trajnimeve, megjithëse në mënyrë të vazhdueshme është ofruar përkrahje përmes punëtorive, seminareve, tryezave të punës. Me theks të veçantë ka pasur përkrahje nga ekspertë të fushave nga auditimi i performancës nga ZKAS që përmes programeve tutoriale, trajnim-takimeve stafi ka përfituar njohuri që e ka kaluar në përvojë me qëllim të kryerjes së punëve në mënyrë efikase dhe efektive.

ZKA ka të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me SNAO, fushëveprimi dhe objektivi i të cilit është zhvillimi institucional me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve, forcimin e aftësive dhe shkathtësive veçanërisht në fushat e Auditimit të Performancës dhe Kapacitetit Organizativ.

Neni 25, 26, 27 i Rregullores ZKA nr. 02/2021 për Klasifikimin e vendeve të punës ZKA përshkruan qartë kualifikimet dhe kërkesat për stafin profesional auditues në Performancë:

Auditor Senior – Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë fakulteti;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor I certifikuar ose auditor I certifikuar I sektorit publik) apo të ketë diplomë master;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza prej tyre së paku tre (3)vite në auditim të performancës;
- Të ketë përvojë pune në udhëheqjen e dy (2) auditimeve në ZKA;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Auditor – Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë fakulteti
- Certifikatë për auditim të jashtëm (kontabilist I certifikuar ose auditor I sektorit publik) apo diplomë në master;
- Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre së paku dy (2) vite në auditimin e performancës;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Auditor Junior – Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në hulumtim apo analiza, preferohet përvoja në auditim.

Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Dimensioni (iv): Zhvillimi dhe Trajnimi Profesional për Auditimin e Pajtushmërisë

Për stafin e auditimit financiar dhe të pajtushmërisë është ofruar përkrahje për zhvillim profesional në mënyrë të vazhdueshme.

Nenet 25, 26, 27 të Rregullores ZKA nr. 02/2021 për Klasifikimin e vendeve të punës ZKA përshkruajnë qartë kualifikimet dhe kërkesat për stafin profesional auditues.

Auditor Senior – Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë fakulteti;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor I certifikuar ose auditor I certifikuar I sektorit publik);
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku tre (3)vite në ZKA;
- Të ketë përvojë pune në udhëheqjen e tre (3) auditimeve në ZKA.

Auditor – Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë fakulteti;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (kontabilist I certifikuar ose auditor I sektorit publik);
- Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike, prej tyre së paku tre (3)vite në auditim të jashtëm.

Auditor Junior – Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë fakulteti

- Certifikatë në njërin nga skemat e certifikimit si teknik kontabiliteti dhe asistent auditor I sektorit publik.

Tre (3) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike. Kjo është realizuar ndër vite dhe vazhdon të realizohet në forma të ndryshme përmes:

- Skemave të certifikimit;
- Trajnimeve të brendshme;
- Trajnimeve të jashtme;
- punëtorive, seminareve, tryezave të punës etj.
- Edukimi i vazhdueshëm Profesional në baza vjetore.

Stafi Auditues i rregullsisë me përkrahje nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka ndjekur skemat të certifikimit të sektorit privat dhe publik. Rrjedhimisht pas certifikimit të suksesshëm janë përcaktuar në pozitë profesionale përkatëse në ZKA.

ZKA ka marrëveshje me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës (institucion i licencuar dhe akredituar) përmes së cilës i siguron stafit anëtarësinë e rregullt vjetore dhe mbajtjen e ligjëratave për edukimin e vazhdueshëm profesional.

Zyra Kombëtare e Auditimit në vazhdimësi ka pasur përkrahje nga ekspertë të fushave nga auditimi i rregullsisë që përmes programeve tutoriale, trajnim-takimeve stafi ka përfituar njohuri që e ka kaluar në përvojë me qëllim të kryerjes së punëve në mënyrë efikase dhe efektive.

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetja	Nota
(i) Planet dhe Proceset për Trajnim dhe Zhvillim Profesional	<p>Kriteret: a, b, c, janë të përmbushura, ndërsa kriteret: d, e, f, g, nuk janë të përmbushura</p> <p>Pasi përfundon procesi i vlerësimit të performancës dhe bëhet identifikimi i nevojave për trajnim dhe mbledhja e informatave me rregullore është përgjegjësi e Departamentit për Buxhet dhe Burime Njerëzore për koordinim me departamentet përkatëse për hartimin dhe zbatimin e planit të trajnimeve dhe bashkëpunimi me IDI për zhvillim profesional të stafit. Plani i trajnimeve hartohet sipas nevojave për zhvillim të stafit ekzistues por në praktikë e zyrës ka qenë me rëndësi të veçantë ofrimi i pakos së trajnimeve për Doracakun Administrativ, Manualet e Auditimit, Rregullat e mirësjelljes etj.</p> <p>Plani i Trajnimeve është gjithëpërfshirës.</p>	2
(ii) Zhvillim Profesional dhe Trajnimi për Auditim Financiar	<p>Kriteret: a, b, c, d, janë të përmbushura</p> <p>Për stafin e auditimit financiar në mënyrë të vazhdueshme është ofruar përkrahje e zhvillimit profesional.</p> <p>Kjo është realizuar ndër vite dhe vazhdon të realizohet në forma të ndryshme përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Skemave të certifikimit; 	4

	<ul style="list-style-type: none"> - Trajnimeve të brendshme; - Trajnimeve të jashtme; - Punëtori, Seminare, Tryeza Pune etj. - Edukimi i vazhdueshëm Profesional në baza vjetore. <p>Stafi Auditues i rregullsisë me përkrahje nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka ndjekur skemat të certifikimit të sektorit privat dhe publik. Rrjedhimisht pas certifikimit të suksesshëm janë përcaktuar në pozitë profesionale përkatëse në ZKA.</p> <p>ZKA ka marrëveshje me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës (institucion i licencuar dhe akredituar) përmes së cilës i siguron stafit anëtarësinë e rregullt vjetore dhe mbajtjen e ligjëratave për edukimin e vazhdueshëm profesional.</p> <p>Zyra Kombëtare e Auditimit në vazhdimësi ka pasur përkrahje nga ekspertë të fushave nga auditimi i rregullsisë që përmes programeve tutoriale, trajnim-takimeve stafi ka përfituar njohuri që e ka kaluar në përvojë me qëllim të kryerjes së punëve në mënyrë efikase dhe efektive.</p>	
<p>(iii) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditim të Performancës</p>	<p>Kriteret: a, b, c, d, janë të përmbushura</p> <p>Për stafin e auditimit të performancës ka qenë më sfiduese ofrimi i trajnimeve, megjithëse në mënyrë të vazhdueshme është ofruar përkrahje përmes punëtorive, seminareve, tryezave të punës por me theks ka pasur përkrahje nga ekspertë të fushave nga auditimi i performancës nga SNAO që përmes programeve tutoriale, trajnim-takimeve stafi ka përfituar njohuri që e ka kaluar në përvojë me qëllim të kryerjes së punëve në mënyrë efikase dhe efektive.</p> <p>ZKA ka të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me SNAO, fushëveprimi dhe objektivi i të cilit është zhvillimi institucional me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve, forcimin e aftësive dhe shkathtësive veçanërisht në fushat e Auditimit të Performancës dhe Kapacitetit Organizativ.</p>	4
<p>(iv) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për auditim të pajtueshmërisë</p>	<p>Kriteret: a, b, c, d, janë të përmbushura</p> <p>Për stafin e auditimit financiar në mënyrë të vazhdueshme është ofruar përkrahje e zhvillimit profesional.</p> <p>Stafi Auditues me përkrahje nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka ndjekur skemat të certifikimit të sektorit privat dhe publik. Rrjedhimisht pas certifikimit të suksesshëm janë përcaktuar në pozitë profesionale përkatëse në ZKA.</p> <p>ZKA ka marrëveshje me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës (institucion i licencuar dhe akredituar) përmes së cilës i siguron stafit anëtarësinë e rregullt vjetore dhe mbajtjen e ligjëratave për edukimin e vazhdueshëm profesional.</p> <p>Zyra Kombëtare e Auditimit në vazhdimësi ka pasur përkrahje nga ekspertë të fushave nga auditimi i rregullsisë që përmes programeve tutoriale, trajnim-takimeve stafi ka përfituar njohuri që e ka kaluar në përvojë me qëllim të kryerjes së punëve në mënyrë efikase dhe efektive.</p>	4

4.6 Domeni F: Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit

Domeni F shikon shkallën në të cilën ISA ka krijuar komunikime efektive me palët kryesore të interesit. Domeni F përfshin dy tregues.

Domeni F: Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit		Dimensionet				Nota e Përgjithshme
Indikator i	Emri	i	ii	iii	iv	
SAI-24	Komunikimi me legjislativin, ekzekutivin dhe Gjyqësorin	3	4	4	4	4
SAI-25	Komunikimi me mediat, qytetarët dhe OSHC-të	2	3			2

4.6.1 SAI-24: Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin - Nota [4]

Treguesi SAI-24 jep informacion mbi ekzistencën e një strategjie aktuale për rregullimin e komunikimeve në nivele për ISA-në. Ai gjithashtu eksploron statusin e kanaleve të komunikimit dhe efektivitetin e tyre me një sërë palësh të tjera të interesuara. Rezultatet nga një ISA janë raportet. Përmbajtja e këtyre duhet t'u vihet në dispozicion në mënyrë koherente atyre që pritet të kenë interes ose janë të mandatuar të veprojnë sipas përmbajtjes së këtyre raporteve.

Ky tregues ka katër dimensione:

- (i) **Strategjia e Komunikimit.**
- (ii) **Praktikat e mira të komunikimit me Legjislaturën**
- (iii) **Praktikat e mira të komunikimit me Ekzekutivin**
- (iv) **Praktikat e mira të Komunikimit me Gjyqësinë, prokurorinë dhe Agjencitë hetuese**

Vlerësimi i këtij treguesi është bazuar në Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055, Strategjinë e Komunikimit 2020-2022, raportin e SIGMA për rezultatet nga anketimi si dhe raporte dhe dokumente tjera relevante.

Dimensioni (i): Strategjia e komunikimit

Në këtë dimension kemi vlerësuar nëse Strategjinë e Komunikimit 2020-2022, ndërlidhet me Planin Strategjik 2018-2021, dhe sa është duke u zbatuar ajo.

Strategjia e Komunikimit 2020-2022, i përmban parimet e komunikimit të ZKA-së, qëllimet dhe objektivat përmes të cilave synon të rris ndikimin dhe ngrit vetëdijen publike rreth rolit të ZKA-së Dhe i përcakton qëllimet dhe objektivat që ZKA-ja kërkon të arrijë gjatë viteve, 2020-2022, në përputhje me Planin e vet Strategjik 2018-2021.

Strategjia e Komunikimit është e ndërlidhur me qëllimin e tretë të Planit Strategjik 2018-2022, "Të zhvilloj dhe të mirëmbaj marrëdhënie të mira me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale dhe rajonale të ISA-ve" .

Për të përcaktuar nevojat dhe kërkesat për komunikim me audiencën e synuar, në këtë strategji ZKA-ja ka identifikuar palët e veta të interesit, ka përcaktuar mesazhet kyçe dhe ka identifikuar instrumentet për komunikim të jashtëm.

Megjithatë, në të kaluarën ZKA-ja nuk ka bërë monitorim sistematik lidhur me komunikimin e vet efektiv me palët e jashtme. . Për nevoja të planifikimit strategjik, në shkurt të vitit 2022, me përkrahjen e SIGMA-ës ka kryer anketimin e palëve të interesit dhe një nga aspektet e vlerësuara është edhe komunikimi efektiv i ZKA-së me palët e jashtme.

Rezultatet e anketimit paraqesin një pamje në përgjithësi mjaft pozitive, kur bëhet fjalë për komunikimin e jashtëm të ZKAK-së me palët e ndryshme të interesit. Ka pasur një numër komentesh pozitive nga subjektet e audituara që tregonin se cilësia e komunikimit është e mirë dhe se nuk ka probleme, por kishte edhe komente që reflektonin dëshirën për komunikim më të mirë, më të shpeshtë, të drejtpërdrejtë dhe të hapur.

Dimensionimi (ii): Praktikimi i mirë të komunikimit me Legjislativin

Kuvendi i Republikës së Kosovës është një ndër partnerët kryesor dhe më të rëndësishëm të ZKA-së, në angazhimin e vazhdueshëm për të mbajtur përgjegjëse organizatat buxhetore për menaxhimin e financave publike.

ZKA-ja ruan marrëdhënie të mira me legjislativin dhe inkurajon zbatimin e ligjit dhe ndihmon Kuvendin në mbikëqyrjen dhe llogaridhënien publike.

ZKA Raporton në baza të rregullta në Kuvend për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm.

Sipas kërkesave ligjore ZKA-ja i dorëzon Kuvendit brenda afateve të përcaktuara ligjore dhe e njofton për çështje tjera të caktuara si:

- Planin Vjetor të Auditimit;
- Të gjitha raportet individuale të auditimit;
- Raportin Vjetor të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Qeverisë;
- Raportin Vjetor të Performancës së ZKA-së; si dhe
- Çështje tjera në kuadër të mandatit të vet.

Ka bashkëpunim të afërt me komisionet parlamentare në veçanti me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, dhe në vazhdimësi përgatit informatat e nevojshme dhe përmbledhje të raporteve të auditimit, si dhe u ofron deputetëve këshillat e nevojshme me rastin e shqyrtimit të raporteve në komisionet parlamentare. ZKA-ja ka të caktuar një zyrtar për koordinimin e punës dhe komunikimit me Kuvendin dhe komisionet parlamentare relevante.

Për secilin raport të auditimit të shqyrtuar në KMFP dhe KBPT, auditorët e ZKA-së përgatitin një informacion të përmbledhur i cili u dërgohet deputetëve paraprakisht. Në rastet kur kërkohet nga deputetët, organizohen edhe takime përgatitore ku sqarohen në detaje të gjitha çështjet e paraqitura në raport të auditimit. Në të gjitha rastet përfaqësues të ZKA-së (nga niveli i menaxhmentit, drejtori dhe UE) marrin pjesë në takim kur një raport si auditimit shqyrtohet dhe e prezantojnë raportin.

Sipas nevojës, Auditori i Përgjithshëm mban takime të veçanta me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe drejtuesit dhe anëtarët e KMFP-së dhe KBPT-së.

Auditori i Përgjithshëm një herë në vit fton anëtarët e KMFP dhe KBPT në Zyrën Kombëtare të Auditimit për t'i njoftuar lidhur me zhvillimet më të fundit për sa i përket auditimit të jashtëm të sektorit publik. Në të tilla raste kërkohet edhe mendimi i deputetëve lidhur me punën e ZKA-së dhe pritjet nga ana e tyre. Në rastet e zgjedhjeve të legjislativës së re, ZKA-ja organizon sesione informuese për deputetët e rinj.

Komunikimi me Kuvendin varësisht nga çështja në trajtim zhvillohet në baza të rregullta javore e në raste të caktuara edhe ditore. Bashkëpunimi i ngushtë në mes të stafit mbështetës për komisionet parlamentare dhe zyrtarit koordinues të ZKA-së është mjaft profesional dhe lehtëson shumë komunikimin dhe koordinimin e punës në mes të të dyja institucioneve.

Dimensionimi (iii): Praktikën e mira të komunikimit me ekzekutivin

ZKA-ja ka zhvilluar komunikim konstruktiv me Ekzekutivin. Për komunikimet me ekzekutivin ndjek dy qasje: atë të komunikimit për nevoja të auditimit të cilat i rregullon me manualët dhe rregulloret për auditim si dhe komunikimin si palë e interesit të cilën e rregullon përmes strategjisë për komunikim. Përmes Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, rregullon në përgjithësi komunikimin e ZKA-së me entitet e audituara ndërsa në veçanti përmes nenit 8, rregullon komunikimin me menaxhmentet e tyre. Ndër të tjera kjo rregullore përcakton procesin e auditimit dhe komunikimit me palën e audituar që nga faza e planifikimit, njoftimit për auditim, administrimin e dokumenteve, trajtimin e komenteve e deri te finalizimi dhe publikimi i raportit. Gjithashtu edhe raportimin për zbatimin e planit të veprimit dhe zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Rregullorja e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit do të rishikohet gjatë këtij nëse ka nevojë për ndryshim-plotësim.

Ekipi nuk ka identifikuar asnjë rast kur zyrtarët e ZKA-së kanë ndërhyrë në çështjet menaxheriale apo organizative të organizatave nën auditim.

Brenda kompetencave institucionale kujdes i veçantë i kushtohet bashkëpunimit profesional me Thesarin. Komunikimi i rregullt ndërmjet dy institucioneve ka bërë që të evidentohen me kohë dhe të shmangen një sërë gabimesh në raportimin financiar të OB-ve.

Nga anketimi i fundit i kryer nga SIGMA, rezulton se subjektet e audituara janë shprehur pozitivisht lidhur me komunikimin e jashtëm të ZKA-së.

Dimensionimi (iv): Praktika të mira të komunikimit me Gjyqësinë, Prokurorinë dhe Agjencitë hetuese

ZKA-ja ka bashkëpunim shumë të mirë dhe komunikim të rregullt si me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Agjencinë Kundër Korrupsionit, gjyqësorin dhe Policinë e Kosovës, dhe organet tjera relevante. Përveç kësaj, nëpërmjet Njësisë për Luftimin e Mashtrimit, ZKA-ja bashkëpunon ngushtë me organet e drejtësisë dhe organizmat tjera përkatëse për luftimin e korrupsionit duke ju ofruar informata relevante të siguruara në proceset e auditimit për raste të caktuara, të cilat mund të përmbajnë elemente të mashtrimit apo trajtohen nga hetuesia. Në raport me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit, ZKA-ja vepron në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me legjislacionin kombëtar të fushës penale. Për këtë qëllim ka të hartuar Udhëzuesin e Auditimit mbi Mashtrimin, përmes të cilit ofron udhëzime të qarta dhe përcakton përgjegjësitë e auditorëve të ZKA-së në trajtimin, zbulimin, raportimin dhe komunikimin e rasteve të dyshuara të mashtrimit, korrupsionit ose ndonjë aktiviteti tjetër të paligjshëm.

Përveç këtyre, Auditori i Përgjithshëm ka kultivuar komunikim konstruktiv dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Institucionin e Avokatit të Popullit. Vlen të përmendet se tashmë është bërë praktikë organizimi i një konference të përbashkët të të dyja institucioneve, ZKA-së dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, ku ftohen përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe palëve tjera të interesit për të trajtuar një temë me interes të përbashkët sikurse janë temat për mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtave të njeriut në këtë aspekt.

Siç përcaktohet edhe me nenin 7 të Ligjit 05/L-055, ZKA-ja publikon të gjitha raportet e auditimit dhe ato janë të qasshme për prokurorinë apo organet tjera të drejtësisë.

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Strategjia e komunikimit	<p>Kriteret a, b, c, d, e dhe g janë përmbushur Ndërsa kriteri f nuk është përmbushur</p> <p>Në këtë dimension kemi vlerësuar nëse Strategjinë e Komunikimit 2020-2022, ndërlidhet me Planin Strategjik 2018-2021, dhe sa është duke u zbatuar ajo.</p> <p>Strategjia e Komunikimit 2020-2022, i përmban parimet e komunikimit të ZKA-së, qëllimet dhe objektivat përmes të cilave synon të rris ndikimin dhe ngrit vetëdijen publike rreth rolit të ZKA-së Dhe i përcakton qëllimet dhe objektivat që ZKA-ja kërkon të arrijë gjatë viteve, 2020-2022, në përputhje me Planin e vet Strategjik 2018-2021.</p> <p>Strategjia e Komunikimit është e ndërlidhur me qëllimin e tretë të Planit Strategjik 2018-2022, “Të zhvilloj dhe të mirëmbaj marrëdhënie të mira me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale dhe rajonale të ISA-ve” .</p> <p>Për të përcaktuar nevojat dhe kërkesat për komunikim me audiencën e synuar, në këtë strategji ZKA-ja ka identifikuar palët e veta të interesit, ka përcaktuar mesazhet kyçe dhe ka identifikuar instrumentet për komunikim të jashtëm.</p> <p>Megjithatë, në të kaluarën ZKA-ja nuk ka bërë monitorim sistematik lidhur me komunikimin e vet efektiv me palët e jashtme, dhe kjo është bërë vetëm në vitin 2022 në kuadër të anketimit të palëve të jashtme për nevoja të zhvillimit të planit të ri strategjik.</p>	3
(ii) Praktikat e mira të komunikimit me Legjislacionin	<p>Të gjitha kriteret janë përmbushur</p> <p>Kuvendi i Republikës së Kosovës është një ndër partnerët kryesor dhe më të rëndësishëm të ZKA-së, në angazhimin e vazhdueshëm për të mbajtur përgjegjëse organizatat buxhetore për menaxhimin e financave publike.</p> <p>ZKA-ja ruan marrëdhënie të mira me legjislativin dhe inkurajon zbatimin e ligjit dhe ndihmon Kuvendin në mbikëqyrjen dhe llogaridhënien publike.</p> <p>Ka bashkëpunim të afërt me komisionet parlamentare në veçanti me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, dhe në vazhdimësi përgatit informatat e nevojshme dhe përmbledhje të raporteve të auditimit, si dhe u ofron deputetëve këshillat e nevojshme me rastin e shqyrtimit të raporteve në komisionet parlamentare</p> <p>Sipas nevojës Auditori i Përgjithshëm mban takime të veçanta me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe drejtuesit dhe anëtarët e KMFP-së dhe KBPT-së.</p> <p>AP një herë në vit fton anëtarët e KMFP dhe KBPT në Zyrën Kombëtare të Auditimit për t’i njoftuar lidhur me zhvillimet më të</p>	4

	fundit për sa i përket auditimit të jashtëm të sektorit publik. Në të tilla raste kërkohet edhe mendimi i deputetëve lidhur me punën e ZKA-së dhe pritjet nga ana e tyre. Në rastet e zgjedhjeve të legjislaturës së re, ZKA-ja organizon sesione informuese për deputetët e rinj.	
(iii) Praktikrat e mira të komunikimit me ekzekutivin	<p>Të gjitha kriteret janë përmbushur</p> <p>ZKA-ja ka zhvilluar komunikim konstruktiv me Ekzekutivin. Për komunikimet me ekzekutivin ndjek dy qasje: atë të komunikimit për nevoja të auditimit të cilat i rregullon me manualët dhe rregulloret për auditim si dhe komunikimin si palë e interesit të cilën e rregullon përmes strategjisë për komunikim.</p> <p>Përmes Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, rregullon në përgjithësi komunikimin e ZKA-së me entitetet e audituara ndërsa në veçanti përmes nenit 8, rregullon komunikimin me menaxhmentet e tyre.</p> <p>Ekipi nuk ka identifikuar asnjë rast kur zyrtarët e ZKA-së kanë ndërhyrë në çështjet menaxheriale apo organizative të organizatave nën auditim.</p>	4
(iv) Praktikrat e mira të komunikimit me Gjqësinë, Prokurorinë dhe Agjencitë hetuese	<p><i>Të gjitha kriteret janë përmbushur</i></p> <p>ZKA-ja ka bashkëpunim shumë të mirë dhe komunikim të rregullt me si me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Agjencinë Kundër Korrupsion, gjyqësorin dhe Policinë e Kosovës, dhe organet tjera relevante. Siç përcaktohet edhe me nenin 7 të Ligjit 05/L-055, ZKA-ja publikon të gjitha raportet e auditimit dhe atë janë të qasshme për prokurorinë apo organet tjera të drejtësisë. Përveç kësaj, nëpërmjet Njesisë për Luftimin e Mashtrimit, ZKA-ja bashkëpunon ngushtë me organet e drejtësisë dhe organizmat tjera përkatëse për luftimin e korrupsionit duke ju ofruar informata relevante të siguruara në proceset e auditimit për raste të caktuara, të cilat mund të përmbajnë elemente të mashtrimit apo trajtohen nga hetuesia.</p>	4

4.6.2 SAI-25: Komunikimi me Mediat, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile- Nota [2]

Ky tregues vlerëson masën në të cilën ISA i afrohet publikut të gjerë nëpërmjet medias dhe shoqërisë civile për të informuar mbi rolin dhe rezultatet e punës së vet.

Ka 2 dimensione”:

- (i) Praktikrat e mira të komunikimit me media.**
- (ii) Praktikrat e mira të komunikimit me qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.**

Vlerësimi i këtij treguesi është bazuar në Ligjin 05/L-055, Strategjinë e Komunikimit 2020-2022, raportin e SIGMA për rezultatet nga anketimi si dhe raporte dhe dokumente tjera relevante.

Dimensionimi (i): Praktikimi dhe miratimi i komunikimit me media.

Për t'iu përgjigjur sfidave të tregut të medias, ZKA-ja rishikon dhe modernizon vazhdimisht qasjen e saj të komunikimit, duke pasur gjithmonë parasysh që reputacioni dhe emri i saj janë ndër pasuritë e saj më me vlerë. ZKA-ja ka Departamentin e Komunikimit dhe staf të caktuar për komunikim me mediat. Udhëheqësi i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, ka për detyrë të përcjellë mesazhet e ZKA-së në mënyrë efektive dhe profesionale të palët e interesit përfshirë edhe mediat.

ZKA-ja synon të jetë burim i besueshëm i mendimit të pavarur, objektiv dhe profesional dhe në vazhdimësi ka kultivuar një komunikim efektiv dhe korrekt me gazetarët dhe mediat në përgjithësi. Si rezultat i kësaj, prezantimi i punës audituese dhe aktiviteteve të ZKA-së është gjithëpërfshirës dhe evident në mediat e shkruara dhe elektronike.

Për të qenë sa më efektiv në komunikimin e vet me mediat ZKA-ja përdor mjete dhe kanale të ndryshme të komunikimit sikurse janë njoftimet përmes e-mailës, uebfaqja, mediat sociale, intervistat, paraqitja në tv dhe radio etj.

Për periudhën në vlerësim ZKA-ja kishte lëshuar komunikata për media për raportet kryesore siç janë Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e vendit, RVP e ZKA-së dhe për të gjitha raportet e auditimit të performancës. Gjithashtu komunikata për media janë lëshuar edhe për planin vjetor të auditimit dhe zhvillime tjera të rëndësishme.

Megjithatë, gjatë vitit 2020 është mbajtur vetëm një konferencë për media, përderisa në vitin 2021 ZKA-ja nuk kishte mbajtur asnjë konferencë për media. Shkak i kësaj mund të themi se ishte edhe situata pandemike.

Monitorimi i mediave bëhet në baza të rregullta ditore, dhe javore, dhe këto raporte dërgohen te AP dhe grupi i menaxhmentit për informim. Në fund të vitit kalendarik përpilohet raporti vjetor për monitorimin e mediave. Sipas raportit për vitin 2021, puna, aktivitetet dhe raportet e ZKA-së dhe AP-së janë prezantuar relativisht mirë nga mediat duke u botuar 1082 artikuj gjithsejtë.

Gjithmonë sipas raportit është parë se gazetaret ditore, portalet, televizionet kanë publikuar artikuj të ndryshëm lidhur me raportet e auditimit, të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna në këto raporte, shqyrtimin e tyre në Kuvend dhe Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike si dhe aktivitete, konferenca dhe punëtori të ndryshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Pavarësisht se janë krijuar praktika të mira të komunikimit me media dhe rezultatet e kësaj pune janë dukshëm pozitive, ekipi i vlerësimit ka vërejtur se mungon një procedurë e shkruar për sa i përket trajtimit të kërkesave dhe komunikimit me mediat.

Dimensionimi (ii): Praktikimi dhe miratimi i komunikimit me qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.

ZKA-ja është e vetëdijshme që komunikimi nuk nënkupton vetëm ofrimin e informacionit, por është gjithashtu një proces i ndërsjellë. Prandaj, përveç komunikimit të rezultateve të punës së saj, ZKA-ja ruan kanale të hapura për palët e saj të interesit dhe sidomos për opinionin publik që të marrë reagimet e tyre dhe iniciativa për punën e saj në të ardhmen, në mënyrë që t'i përgjigjet më mirë nevojave të publikut.

Rendësi e veçantë i kushtohet komunikimit me organizatat e shoqërisë civile dhe vënies në dispozicion të informatave të kërkuara nga to. Edhe uebfaqja e ZKA-së, si burimi kryesor i informacionit përditësohet në vazhdimësi duke i ofruar qytetarëve qasje në të dhëna për raportet e auditimit.

Edhe komunikimi përmes rrjeteve sociale është rritur në vazhdimësi. ZKA-ja ka llogari dhe është aktive në Facebook si platforma më e popullarizuara në vend si dhe Twitter.

ZKA në faqen e saj të internetit ka në dispozicion listën e kontakteve ku qytetarët dhe palët e tjera të interesit mund të kontaktojnë me email ose telefonatë dhe të ngrenë çdo çështje që konsiderohet me interes. Gjithashtu ZKA është aktive në kanalet e mediave sociale në Facebook dhe Twitter që përveç promovimit të punës së auditimit shërbejnë edhe si kanale komunikimi me audiencën.

Për të kontribuar në debatin publik, përfaqësuesit e ZKA-së gjithashtu marrin pjesë në debatet publike të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile, duke ndarë pikëpamjet dhe opinionin e ZKA-së në mënyrë profesionale me qëllim rritjen e ndikimit të saj dhe ofrimin e informacionit më të mirë të bazuar në prova për publikun.

Megjithatë, ekipi ka gjetur se mungon komunikimi aktiv dhe i drejtpërdrejtë i ZKA-së me qytetarët. Gjithashtu edhe pse ueb faqja përmban informacione të shumta lidhur me rolin, mandatin dhe punën e ZKA-së nuk ka të publikuara përmbledhje të shkurtra për raportet e auditimit për t'i ndihmuar dhe lehtësuar qytetarëve qasjen më të shpejtë në informacionin lidhur me rezultatet e auditimit.

Vlerësimi i gjetjeve dhe vëzhgimeve

Dimensioni	Gjetjet	Nota
(i) Praktikrat e mira të komunikimit me media.	<p>Kriteret b, c, d dhe e janë përmbushur</p> <p>Ndërsa kriteret a dhe f nuk janë përmbushur</p> <p>Për t'iu përgjigjur sfidave të tregut të medias, ZKA-ja rishikon dhe modernizon vazhdimisht qasjen e saj të komunikimit, duke pasur gjithmonë parasysh që reputacioni dhe emri i saj janë ndër pasuritë e saj më me vlerë. ZKA-ja ka Departamentin e Komunikimit dhe staf të caktuar për komunikim me mediat. Udhëheqësi i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, ka për detyrë të përcjellë mesazhet e ZKA-së në mënyrë efektive dhe profesionale te palët e interesit përfshirë edhe mediat.</p> <p>ZKA-ja synon të jetë burim i besueshëm i mendimit të pavarur, objektiv dhe profesional dhe në vazhdimësi ka kultivuar një komunikim efektiv dhe korrekt me gazetarët dhe mediat në përgjithësi. Si rezultat i kësaj, prezantimi i punës audituese dhe aktiviteteve të ZKA-së është gjithëpërfshirës dhe evident në mediat e shkruara dhe elektronike.</p> <p>Për të qenë sa më efektiv në komunikimin e vet me mediat ZKA-ja përdor mjete dhe kanale të ndryshme të komunikimit sikurse janë njoftimet përmes e-mailës, ueb faqja, mediat sociale, intervistat, paraqitja në tv dhe radio etj.</p> <p>Megjithatë, gjatë vitit 2020 është mbajtur vetëm një konferencë për media, përderisa në vitin 2021 ZKA-ja nuk kishte mbajtur asnjë konferencë për media. Shkak i kësaj mund të themi se ishte edhe situata pandemike.</p> <p>Pavarësisht se janë krijuar praktika të mira të komunikimit me media dhe rezultatet e kësaj pune janë dukshëm pozitive, ekipi i vlerësimit ka vërejtur se mungon një procedurë e shkruar për sa i përket trajtimit të kërkesave dhe komunikimit me mediat.</p>	2
	<p><i>Kriteret a, c, e, f, g dhe h janë përmbushur</i></p> <p><i>Ndërsa kriteret b dhe d nuk janë përmbushur</i></p>	3

<p>(ii) Praktikrat e mira të komunikimit me qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.</p>	<p>ZKA-ja është e vetëdijshme që komunikimi nuk nënkupton vetëm ofrimin e informacionit, por është gjithashtu një proces i ndërsjellë. Prandaj, përveç komunikimit të rezultateve të punës së saj, ZKA-ja ruan kanale të hapura për palët e saj të interesit dhe sidomos për opinionin publik që të marrë reagimet e tyre dhe iniciativa për punën e saj në të ardhmen, në mënyrë që t'i përgjigjet më mirë nevojave të publikut.</p> <p>Rendësi e veçantë i kushtohet komunikimit me organizatat e shoqërisë civile dhe vënies në dispozicion të informatave të kërkuara nga to. Edhe ueb faqja e ZKA-së, si burimi kryesor i informacionit përditësohet në vazhdimësi duke i ofruar qytetarëve qasje në të dhëna për raportet e auditimit.</p> <p>Edhe komunikimi përmes rrjeteve sociale është rritur në vazhdimësi. ZKA-ja ka llogari dhe është aktive në Facebook si platforma më e popullarizuara në vend si dhe Twitter.</p> <p>ZKA në faqen e saj të internetit ka në dispozicion listën e kontakteve ku qytetarët dhe palët e tjera të interesit mund të kontaktojnë me email ose telefonatë dhe të ngrenë çdo çështje që konsiderohet me interes. Gjithashtu ZKA është aktive në kanalet e mediave sociale në Facebook dhe Twitter që përveç promovimit të punës së auditimit shërbejnë edhe si kanale komunikimi me audiencën.</p> <p>Për të kontribuar në debatin publik, përfaqësuesit e ZKA-së gjithashtu marrin pjesë në debatet publike të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile, duke ndarë pikëpamjet dhe opinionin e ZKA-së në mënyrë profesionale me qëllim rritjen e ndikimit të saj dhe ofrimin e informacionit më të mirë të bazuar në prova për publikun</p> <p>Megjithatë, ekipi ka gjetur se mungon komunikimi aktiv dhe i drejtëpërdrejtë i ZKA-së me qytetarët. Gjithashtu edhe pse uebfaqja përmban informacione të shumta lidhur me rolin, mandatin dhe punën e ZKA-së nuk ka të publikuara përmbledhje të shkurtra për raportet e auditimit për t'i ndihmuar dhe lehtësuar qytetarëve qasjen më të shpejtë në informacionin lidhur me rezultatet e auditimit.</p>	
--	---	--

Kapitulli 5: Procesi i zhvillimit të kapaciteteve të ZKA-së

5.1 Reformat e kohëve të fundit dhe ato në vijim

ZKA ka mbetur konsekuente në angazhimin e saj për t'i ofruar Kuvendit të Kosovës, autoriteteve tjera dhe qytetarëve informacion objektiv dhe të pavarur mbi gjendjen e institucioneve publike të shtetit lidhur me menaxhimin e burimeve publike që u janë besuar. ZKA ka vazhduar aktivitetet e rregullta në lidhje me procesin e auditimit. Në tetor 2022, PVA 2022/2023 u miratua nga Auditorja e Përgjithshme dhe i është dorëzuar Kuvendit. Numri i përgjithshëm i auditimeve të planifikuara për këtë sezon është 134, nga të cilat 113 janë auditime të rregullsisë (financiare dhe të përputhshmërisë), 9 auditime të performancës, 5 auditime prokurimi, 4 auditime TI, 3 auditime të pajtueshmërisë (të veçuara).

Me qëllim që të përmbushë mandatin e saj dhe të ketë një rol në ndryshimin pozitiv në jetën e qytetarëve, në janar 2023, Auditorja e Përgjithshme ka miratuar Planin Strategjik 2023-2026 të Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili i hap rrugën e një rrugëtimi katër vjeçar. Çdo fushë, qëllim, objektivë dhe aktivitet është përzgjedhur me kujdes. Draft raporti i KMF/ISA i ka shërbyer ekipit për planifikimin dhe zhvillimin strategjik si një bazë solide në procesin e zhvillimit dhe hartimit të planit të ri strategjik.

Në anën tjetër, me iniciativën e Auditorit të Përgjithshëm, KMFP ka marrë së fundi vendimin që të angazhojë SIGMA-n për të bërë rishikimin ndërkolegial të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Ky rishikim do të fokusohet në: kornizën ligjore dhe pavarësinë, qeverisjen dhe menaxhimin, procesin e auditimit dhe raportimin, cilësinë e auditimit, planifikimin strategjik dhe operacional, menaxhimin e personelit; menaxhimin e burimeve, marrëdhëniet e jashtme dhe angazhimin e palëve të interesit.

Që nga themelimi i saj, ZKA është ndërtuar mbi baza të forta ligjore dhe institucionale. Krahas vendosmërisë për të kryer punën e auditimit në mënyrë të pavarur, ZKA i kushton vëmendje të veçantë edukimit të vazhdueshëm institucional dhe profesional dhe adaptimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira të auditimit të kryera nga organizatat ndërkombëtare profesionale të auditimit.

Gjatë vitit 2021, ZKA ka pasur një komunikim produktiv me palët e interesit dhe ka zhvilluar më tej një qasje gjithëpërfshirëse, duke qenë mikpritëse dhe pjesëmarrëse në shumë takime, seminare dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit. Në nivel kombëtar, partneriteti me komisionet parlamentare dhe organizatat e shoqërisë civile është forcuar më tej, ndërsa në nivel ndërkombëtar, bashkëpunimi ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit është avancuar më tej përmes takimeve, seminareve dhe aktiviteteve të tjera në kuadër të EUROSAT-t dhe INTOSAT-t.

Në vitin 2020, ZKA u bë anëtare e plotë e EUROSAT-t dhe INTOSAT-t. Që atëherë ZKA është anëtare e grupeve të ndryshme të punës dhe task-forcave si

- Task Forca e INTOSAT-t për Pjesëmarrjen e qytetarëve dhe angazhimin e shoqërisë civile;
- Task Forca e EUROSAT-t për Auditimet e komunave;
- Grupi i Punës i EUROSAT-t për Teknologjinë e Informacionit;
- Grupi i Projektit i EUROSAT-t për bashkëpunim me palët e interesit jo-ISA

Në nivel rajonal, ZKA ka qenë aktive në Rrjetin e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale për në BE. Auditorja e Përgjithshme ra dakord dhe miratoi Planin

e Punës së Rrjetit 2022 – 2025, i cili mbulon trajnime, seminare dhe konferenca në tema me interes të përbashkët.

Në kuadër të rrjetit, aktualisht ZKAS po zhvillon trajnimin për auditimin e performancës për ISA-të e Ballkanit Perëndimor. Pesë auditorë të performancës të ZKA-së janë duke ndjekur këtë trajnim. Lidhur me këtë, dy auditorë të tjerë të performancës kanë ndjekur programin e trajnimit dhe janë certifikuar vitin e kaluar.

Pak kohë më parë Auditorja e Përgjithshme e Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i Maqedonisë së Veriut dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë, kanë nënshkruar marrëveshjen për auditimin e përbashkët të performancës për “Barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në zonat rurale, përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”. Bazuar në këtë marrëveshje, palët kanë rënë dakord të kryejnë auditimin e barazisë gjinore për të verifikuar nëse ka politika dhe masa në vendet e tyre për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës. Ky proces lehtësohet dhe mbështetet nga UN Women.

ZKA vazhdimisht i kërkon të gjithë stafit të saj, pjesëmarrës në aktivitete ndërkombëtare, që të jenë aktivë, të ndajnë përvojën e tyre dhe të përfitojnë nga të tjerët.

Projekti “Bashkëpunimi për Zhvillim Institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2020-2023” përcakton dy fusha të bashkëpunimit, përkatësisht zhvillimin e kapaciteteve organizative në nivel të ZKA-së dhe zhvillimin e fushës profesionale, me fokus në auditimin e performancës. Auditimi i performancës është një komponent i projektit, dhe fusha e zhvillimit të kapaciteteve organizative është ndarë në shtatë komponentë të projektit, përkatësisht: Kontrolli i Cilësisë dhe Sigurimi i Cilësisë (KC/SC); Menaxhimi dhe planifikimi; MBNJ dhe Zhvillimi Profesional; Komunikimi; Aftësi Drejtuese; Angazhimi ndërkombëtar; dhe Zhvillimi i TI-së funksionale. Çdo nënprojekt ka qëllimet dhe objektivat e tij individuale, siç thuhet në Dokumentin e Projektit. Gjatë dy viteve të fundit aktivitetet janë zhvilluar në përputhje me Planet Vjetore të Aktiviteteve dhe në përgjithësi, aktivitetet për projektin janë realizuar në nivel të kënaqshëm. Meqenëse projekti përfundon në dhjetor 2023, të dyja palët kanë rënë dakord të zgjasin bashkëpunimin deri në vitin 2024.

Projekti i Binjakëzimit “Forcimi i Mëtejshëm i Ndikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit”, ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe Polonisë, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i implementuar nga Zyra Supreme e Auditimit e Polonisë, përfundoi me sukses në vitin 2021. Projekti zgjati 18 muaj dhe përbëhej nga tre komponentë kryesorë: 1. Komunikimi me qytetarët, Parlamentin dhe palët e tjera të interesit; 2. Forcimi i kapaciteteve institucionale të ZKA-së; dhe 3. Përditësimi i manualeve dhe dokumenteve të punës së auditimit (financiar dhe i pajtueshmërisë) në përputhje me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.

Gjatë viteve 2021-2022, gjashtë auditorë të ZKA-së morën pjesë në programin arsimor të IDI-s “Edukimi Profesional i Auditorëve” (PESA-P) dhe aktualisht po i nënshtrohen provimeve. Krahas kësaj një nga trajnerët ndjek programin e posaçëm të certifikimit si trajner i ISA-së në kuadër të programit PESA-P.

Aktualisht, ZKA po shqyrton pjesëmarrjen në tre programe të tjera të lançuara nga IDI për zhvillim profesional siç janë ‘LOTA Pioneers’, ‘Equal Futures Audit Changemakers’ dhe në programin e ri ‘PESA – P’. Menaxhmenti dhe auditorët janë në një dialog aktiv për të analizuar kapacitetet e pjesëmarrjes dhe identifikuar të emëruarit e mundshëm.

5.2 Përdorimi i rezultateve të ISA-së nga ofruesit e jashtëm të mbështetjes financiare

NAO nuk ka asnjë detyrim ligjor për të audituar përdoruesit e fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Evropian ose ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare, përveç rasteve kur kërkohet me shkrim nga një shtet apo organizatë ndërkombëtare donatore. Kjo rregullohet me nenin 18 paragrafi 6. Për këtë, ZKA ka nënshkruar ndër vite marrëveshje me donatorë të ndryshëm si Banka Botërore dhe SIDA për auditimin e projekteve të financuara prej tyre. Në sezonin e auditimit 2021/2022, ZKA auditoi 14 projekte të financuara nga donatorë ndërkombëtarë, ndërsa në sezonin e auditimit 2022/2023 janë planifikuar të auditohen 11 projekte donatore. Prandaj, ofruesit e jashtëm e konsiderojnë ZKA-në partner të besueshëm dhe profesional.

ZKA ka një bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e BE-së në Kosovë me qëllim të rritjes së ndikimit dhe kontributit në menaxhimin më të mirë të financave publike. Në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) të Republikës së Kosovës me BE-në, ZKA-ja ka përmbytur me sukses masat e përcaktuara me Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

ZKA gjithashtu bashkëpunon ngushtë me organizata të tjera ndërkombëtare që veprojnë në vend. Së fundmi ZKA ka nënshkruar dhe Memorandumin e Mirëkuptimit me USAID-in, për të forcuar përpjekjet e përbashkëta në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit dhe në ngritjen e kapaciteteve të komunave në zbatimin e rekomandimeve të auditimit dhe menaxhimin më të mirë të financave publike.

Shtojca 1: Përmbledhje e Treguesve të Performancës

Treguesi	Emri i treguesit	(i)	(ii)	(iii)	(iv)	Notimi i përgjithshëm
Domeni A	Pavarësia dhe Korniza Ligjore					
SAI-1	Pavarësia e ZKA-së	4	1	4	4	3
SAI-2	Mandati i ZKA-së	3	4	1		33
Domeni B	Qeverisja e Brendshme dhe etika					
SAI-3	Cikli i planifikimit strategjik	3	4	3	3	3
SAI-4	Mjedisi i kontrollit organizativ	3	4	3	3	3
SAI-5	Auditimet e kontraktuara	4	4	2		3
SAI-6	Udhëheqja dhe komunikimi i brendshëm	4	2			3
SAI-7	Planifikimi i përgjithshëm i auditimit	1	3			2
Domeni C	Cilësia e Auditimit dhe raportimi					
SAI-8	Mbulueshmëria me auditim	4	2	1		2
SAI-9	Standardet e Auditimit Financiar dhe Menaxhimi i Cilësisë	4	4	4		4
SAI-10	Procesi i auditimit financiar	3	3	4		3
SAI-11	Rezultatet e auditimit Financiar	2	4	4		3
SAI-12	Standardet e Auditimit të Performancës dhe Menaxhimi i Cilësisë	2	3	2		2
SAI-13	Procesi i Auditimit të Performancës	2	3	3		3
SAI-14	Rezultatet e Auditimit të Performancës	4	4	2		3
SAI-15	Standardet e Auditimit të Pajtueshmërisë dhe Menaxhimi i Cilësisë	4	4	4		4
SAI-16	Procesi i Auditimit të Pajtueshmërisë	1	4	4		3
SAI-17	Rezultatet e Auditimit të Pajtueshmërisë	2	4	4		3
SAI-18	Standardet e Auditimit të Kontrollit Juridiksional dhe Menaxhimi i Cilësisë					n/a
SAI-19	Procesi i Auditimit të Kontrollit Juridiksional					n/a
SAI-20	Rezultatet e Kontrollit Juridiksional					n/a
Domeni D	Menaxhimi financiar, pasuritë dhe shërbimet mbështetëse					
SAI-21	Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet mbështetëse	4	2	4		3
Domeni E	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, plani i trajnimit, dhe zhvillimi					
SAI-22	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4	4	4	3	4
SAI-23	SAI-23 Trajnimi dhe zhvillimi profesional	2	4	4	4	4
Domeni F	Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit					
SAI-24	Komunikimi me legjislativin, ekzekutivin dhe Gjyqësorin	3	4	4	4	4
SAI-25	Komunikimi me mediat, qytetarët dhe OSHC-të	2	3			2

Shtojca 2: Burimet e informacionit dhe dëshmisë për të mbështetur notimin e treguesit

Lista e të intervistuarve

Intervistë me drejtorin e Departamentit për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analizë,

Intervistë me stafin e angazhuar në auditimin e performancës të niveleve të ndryshme menaxheriale

Intervistë me stafin e angazhuar në auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë të niveleve të ndryshme menaxheriale

Dokumentet e rishikuara

Vlerësimi i ISA-7,8, 9,10,11,12,13, 14, 15, 16, 17 është bazuar kryesisht në dokumentet e mëposhtme:

- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe plotësuar);
- Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
- Kodi i Etikës, 2018;
- Plani strategjik i ZKA 2018-2021;
- Plani Vjetor i Auditimit 2021/22;
- Plani i trajnimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Plani i shpërndarjes së stafit, 2021/22;
- Monitorimi-raportimi i planit të auditimit; dhe
- Procesverbalet nga takimet e menaxhmentit dhe shënimet e brendshme lidhur me planifikimin për temat e auditimit 2020-2021 (analiza e burimeve njerëzore, shprehja e interesit, analiza e ndërmarrjeve publike, propozimet e auditimit të performancës, etj.)

Rregulloret e brendshme të ZKA-së

- Rregullorja (ZKA) nr.02/2021 për klasifikimin e vendeve të punës;
- Rregullorja (ZKA) nr.01/2021 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- Rregullorja (ZKA) nr.03/2021 për pranim dhe karrierë.

Manuali i Auditimit të ZKA

- Manuali i Auditimit Financiar dhe Pajtueshmërisë 2020 (metodologjia e qasjes së kombinuar);
- Manuali bazë për auditimin e performancës, manuali i auditimit të prokurimit 2016,
- Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit
- Udhëzues për kontrollin e cilësisë për auditimet e rregullsisë;
- Rregulloren e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit;
- Udhëzues për përcjelljen e rekomandimeve të auditimit të performancës;
- Udhëzime për planifikimin strategjik të auditimeve të performancës;
- ZKA hartoi Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë.

- Paketa e letrave të punës për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë;
- Paketa e letrave të punës për auditimin e Performancës;
- Angazhimi i ekspertëve, termat e referencës, të kontraktuara me ekspertë të angazhuar;
- Lista e stafit të angazhuar në auditimin e performancës, arsimimin, certifikimet, zhvillimin e tyre profesional;
- Deklarata e pavarësisë për stafin e auditimit;
- Përcaktimi i objektivave për auditorin për atë vit auditimi;
- Dorëzimi i raporteve tek entitetet e audituara dhe letrat-përcjellëse të raporteve;
- Konfirmimet e pranimit të raporteve të auditimit;
- Dorëzimi i raporteve në Kuvend dhe komisionet përkatëse parlamentare;
- Publikimi i raporteve në faqen e internetit, lista e raporteve të publikuara me datat e publikimit;
- Plani i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga subjektet e audituara;
- Rishikimet e drafteve ndër kolegë;
- Procesverbal i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike;
- Rishikimi i praktikës së auditimit të performancës në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, rishikim i ftohtë 2019;
- Baza e Planifikimit të Projektit mes Zyrës Kombëtare e Auditimit e Suedisë dhe Zyrës Kombëtare e Auditimit e Kosovës, 2020;
- Vlerësimi/baza Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës (ZKA), 2017;
- Vlerësimi nga raporti i misionit për pilot auditimet e TI-së nga ekspertë të angazhuar në kuadër të projektit “Fuqizimi i mëtejshëm i ndikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit” të financuar nga BE;
- Draft-propozimi dhe përzgjedhja e temave, 2021-22; dhe
- Rishikimet ndërmjet kolegëve për raportet e vlerësuara.

Dosjet e rishikuara të auditimit

- **Auditimi financiar**

Për të vlerësuar këtë tregues, ne përzgjedhëm tre dosje auditimi

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
2. Komuna e Vushtrrisë;
3. KRU Prishtina sh.p.k;
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Institucioni i Avokatit të Popullit – (institucion i audituar nga kompania e kontraktuar).

- **Auditimi i performancës**

Për të vlerësuar këtë tregues, ne përzgjedhëm tre dosje auditimi

1. Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve të TI në Agjencinë e Statistikave, 2020
2. Zbatimi i rekomandimeve të raportit “Administrimi i programit të trajtimit mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike dhe vlerësimi i rezultateve”, 2020
3. Vlera për para në prokurimin e centralizuar – Pjesa e parë, 2018


- **Auditimi i pajtueshmërisë**

Për të vlerësuar këtë tregues, ne përzgjedhëm tre dosje auditimi

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
2. Komuna e Vushtrrisë;
3. KRU Prishtina sh.p.k;
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Institucioni i Avokatit të Popullit – (institucion i audituar nga kompania e kontraktuar)



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



Zyra Kombëtare e Auditimit | Lagjja Arbëria | Rr. Ahmet Krasniqi, 210 | 10000 Prishtina
Republika e Kosovës

